

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPERISE

AVOKATI I POPULLIT

R A P O R T

**Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit
1 Janar – 31 Dhjetor
Viti 2001**

Botim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Tiranë, 2002

Mesazh i Avokatit të Popullit

**Zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,
Zoti Kryetar i Pozitës,
Zoti Kryetar i Opozitës,
Të nderuar deputetë,
Të respektuar përfaqësues të përfaqësive diplomatike dhe të medias,**

Kam nderin që, në emër të Institucionit të Avokatit të Popullit, t'ju paraqes në këtë raport veprimtarinë tonë për vitin 2001.

Krijimi i Institucionit të Avokatit të Popullit është padyshim produkt i pjekurisë demokratike të klasës politike shqiptare për të qenë mendjehapur ndaj kërkesave në rritje që Komuniteti Ndërkombëtar shtron para vendit tonë, në përgatitjet e Republikës së Shqipërisë për t'u përfshirë në proceset integruese evropiane.

Si Avokat i Popullit, unë kam si detyrë të ngulis tek cilido mendimin se mirëqeverisja, përkujdesja për shtetin e së drejtës, krijimi i kulturës së respektit për të drejtat e njeriut si dhe antikorrupsioni, janë kushte parësore për të realizuar detyrën, që gjithë shoqëria dhe Qeveria shqiptare kanë përcaktuar për të ecur në rrugën e gjatë të integritetit institucional, social, kulturor, ekonomik me Bashkimin Evropian. Duke patur parasysh që i tërë ky proces po zhvillohet në rrethanat e globalizmit, përballimi i sfidave të së ardhmes e bën edhe më të pajustificueshme çdo vonesë në proceset e së tashmes.

Nëse demokracitë në tranzicion lipset të konsolidojnë procesin demokratik, arritjen e mirëqeverisjes dhe respektin për të drejtat e njeriut, kjo do të thotë se roli i Avokatit të Popullit (Ombudsmanit) do të jetë gjithmonë e më i rëndësishëm. Aftësia e Shtetit Shqiptar për të ushtruar në mënyrë të efektshme përgjegjësitë e veta në mbrojtje të të drejtave të qytetarit varet kryesisht nga fuqia e institucioneve të vendit. Parlamenti pluralist, një Qeveri e kontrolluar thellë dhe me transparencë nga përfaqësuesit e zgjedhur në Parlament si dhe një gjyqësor i paanshëm, janë të domosdoshëm dhe të pazëvendësueshëm.

Por, shoqëria moderne po provon çdo ditë e më tepër se ekzistenca dhe veprimtaria e këtyre institucioneve, sipas ndarjes klasike të tre pushteteve, është e pamjaftueshme pa ekzistencën dhe veprimtarinë e institucioneve të tjera, që së bashku krijojnë sistemin e kontrollit dhe balancës. Në këtë sistem, rol kanë padyshim edhe shoqëria civile e fortë dhe shtypi i lirë e i përgjegjshëm. Pikërisht, në këtë sistem, diku midis

sferës së qeverisjes dhe asaj të shoqërisë civile është vendosur edhe Institucioni i Ombudsmanit, si instancë kombëtare, garante e demokracisë për një vend me qeverisje demokratike, ekzistenca dhe mirëfunksionimi i të cilit është një nga kushtet për t’u pranuar nga Bashkimi Evropian.

Në vizionin dhe funksionin e Avokatit të Popullit synohet që zgjidhja e një konflikti të krijojë precedentin e parandalimit të konfliktualitetit dhe mohimit të zgjidhjeve përjashtuese. Koncepti i bashkëjetesës në shoqërinë civile parakupton gjetjen e asaj që na bashkon, dhe pikërisht funksionimin e shtetit të së drejtës dhe respektimin e kontratës sociale, në rezultatën e të cilave çdo shoqëri gjen edhe paqen sociale, aq të munguar në këto 10 vjet të tranzicionit të shoqërisë demokratike shqiptare.

Së fundi, në shprehje të gadishmërisë time dhe të Institucionit që drejtoj, për të qenë i hapur dhe bashkëpunuar me të gjitha instancat e Administratës Publike Shqiptare dhe OJQ-të, më lejoni të citoj vlerësimin që Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Geert Hinrich Ahrens bëri në Konferencën e 4-t “Për reformat gjyqësore në Shqipëri”, organizuar nga Këshilli i Evropës në Strasburg më 28-29 Janar 2002: **“Bashkëpunimi i suksesshëm ndërkombëtar, i pasqyruar në krijimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të Institucionit të Avokatit të Popullit, veçanërisht gjatë vitit të fundit, tregon se mund të bëhet ndryshim i vërtetë në Shqipëri dhe se institucionet demokratike mund të ndërtohen nga fillimi”**.

Mbetem i hapur dhe në pritje të vlerësimit Tuaj. Faleminderit.

AVOKATI I POPULLIT

Ermir DOBJANI

Tiranë, më 01.03.2001

PËRMBAJTJA:

Mesazhi i Avokatit të Popullit

Përmbajtja

Hyrje

Prezantim i shkurtër i Raportit

KREU I PARË

1. Institucioni i Avokatit të Popullit dhe e drejta e mirëadministrimit e Bashkimit Evropian.	14
2. Kushtetuta dhe ligji shqiptar “Për Avokatin e Popullit” reflektojnë dhe pasqyrojnë përvojën dhe rekomandimet e Komunitetit Ndërkombëtar për këtë Institucion.	16
3. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit	22
4. Krijimi dhe vënia në funksionim e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri.	26
5. Mbështetja ndërkombëtare.	27
6. Buxheti i Institucionit për vitin 2001.	29
7. Vështirësitë e Institucionit dhe shkaqet e tyre.	30
8. Ku i mbështesim arritjet e deritanishme të Institucionit.	31
9. Sfidat, objektivat e Institucionit për vitin 2002 e në vazhdim.	31
10. Strategjia për të ardhmen e Institucionit.	32

KREU I DYTË

1. Statistika përmbledhëse e vitit 2001.	34
2. Avokati i Popullit dhe Kuvendi i Shqipërisë.	38
3. E drejta e mirëqeverisjes në shtetin e së drejtës.	41
4. Avokati i Popullit dhe Antikorrupsioni.	45
5. Avokati i Popullit dhe Gjykata Kushtetuese.	48
6. Opinione të përgjithshme rreth situatës të të Drejtave të Njeriut në Shqipëri.	52
7. Veprimtaria e Avokatit të Popullit në marrëdhëniet me publikun.	57
8. Marrëdhëniet me Jashtë	63
I. Aktivitete të organizuara nga Këshilli i Evropës.	64
a. <i>Mbledhja e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, përfshirë edhe Ombudsmanët e vendeve të përfshira në Paktin e Stabilitetit.</i>	64
b. <i>Mbledhja e Ombudsmanëve të Evropës Qëndrore dhe Lindore me Komisionerin e të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës.</i>	64
c. <i>Mbledhja e Lubjanës-Slloveni.</i>	66
d. <i>Mbledhja e Ombudsmanëve në Strasburg me Komisionerin e të Drejtave të Njeriut në Këshillin e Evropës.</i>	67
e. <i>Mbledhja e Tavolinës së Shtatë me Ombudsmanët e të gjitha vendeve të Evropës.</i>	68

II. Aktivitete të organizuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara(OKB)	68
a. Konferenca Botërore kunder Racizmit, diskriminimit racial, ksenofobisë dhe intolerances.	68
b. Konferenca Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Demokratizimin	69
c. Konferenca e dytë Mesdhetare e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut.	71
d. Konferenca Ndërkombëtare Konsultative mbi Edukimin në Shkollë me Lirinë e Fesë ose Besimit, Tolerancës dhe Mos-Diskriminimit.	72
III. Konferenca të tjera Ndërkombëtare	74
a. Në kërkim të vlerave universale të drejtësisë administrative	74
b. Kongresi i Dytë i Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të vendeve Frankofone	75
IV. Vizitat e Ombudsmanëve të Shteteve të tjera në Shqipëri.	76
V. Vizita për shkëmbimin e eksperiences dhe trajnimin e stafit të zyrës së Avokatit të Popullit pranë zyrave homologe	77
VI. Ekspertë të huaj në zyrën e Avokatit të Popullit.	78
VII. Bashkëpunimi me Amnesty International.	79
VIII. Konferenca Kombëtare, “Shteti dhe Shoqëria Civile në Mbrojtje të së Drejtës së Jetës”.	79
IX. Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2001.	84

KREU I TRETË

Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat dhe njoftimet (rastet), të grupuara sipas institucioneve qeveritare.	85
1. Këshilli i Ministrave (Qeveria)	85
a. Ankesa për Grupin Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave	86
b. Ankesa për Zyrat e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	87
c. Ankesa për Komisionet e Kthimit të Pronave ish Pronarëve	89
2. Ministria e Drejtësisë	92
a. Ankesa për burgjet dhe administratën e burgjeve	92
b. Ankesa për Zyrat e Përmbarimit	100
c. Avokati i Popullit, marrëdhëniet e tij me gjykatat dhe pushtetin gjyqësor dhe ankesat lidhur me to.	104
d. Ankesat për Prokurorinë	111
3. Ministria e Rendit Publik	116
4. Ministria e Mbrojtjes	130
5. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	139
6. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale	145
a. Instituti i Sigurimeve Shoqërore Shtetërore	145
b. Ndihma dhe Perkahja Sociale	149
c. Instituti i Integritit të ish tëPërndjekurve Politik	150

7.	Ministria e Punëve Publike dhe Rregullimit të Territorit	150
	a. ankesa për ndertimet pa leje	151
8.	Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimeve	154
	a. <i>Agjensia Kombëtare e Privatizimit.</i>	158
	b. <i>Korporata Elektroenergjitike Shqiptare.</i>	159
	c. <i>Telekom-i.</i>	160
9.	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	161
	a. <i>ankesa për çeshtje të ligjit "Për Tokën".</i>	161
	b. <i>ankesa për pasurinë e ish-kooperativave bujqësore.</i>	163
	c. <i>probleme për pyjet.</i>	163
	d. <i>probleme për cilesinë e ushqimeve.</i>	164
	e. <i>Ankesa për Drejtoritë e Bujqësisë dhe Ushqimit në Rrethe.</i>	164
	f. <i>Ankesa për Drejtoritë e Ujrave në Rrethe.</i>	165
10.	Ministria e Financave	165
11.	Ministria e Arsimit	171
12.	Ministria e Shendetësisë	177
13.	Ministria e Punëve të Jashtme	179
14.	Ministria e Transporteve	182
15.	Ministria e Bashkepunimit Ekonomik me Jashtë	183
16.	Ankesa për Shërbimet Sekrete	186
17.	Përgjithësime për Shërbimet Publike	188
18.	Përgjithësime për Marrëdhëniet e punës	190
19.	Konkluzione lidhur me rastet që kanë të bëjnë me Administratën Publike.	192

KREU I KATËRT

1.	Në ndjekje të rasteve të prezantuara në Raportin Vjetor 2000.	195
2.	Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit ("ex officio")	197

ANEKSE

1.	Vlerësime të Institucioneve dhe personaliteteve ndërkombëtare për punën e Avokatit të Popullit.	213
2.	Letra falenderimi nga qytetarët	215
3.	Grafikët	218

HYRJE

Mirëqeverisja dhe sjellja e mirë administrative kushtëzohen edhe nga ekzistenca e një sistemi të pavarur e të paanshëm për të shqyrtuar mënyrën se si ka vepruar Qeveria. Kjo është si në interes të Qeverisë, ashtu edhe të qytetarit.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, miratuar më 28 Nëntor 1998, pas 8 viteve të ndryshimeve demokratike, për herë të parë në historinë e Shqipërisë parashikohet edhe Institucioni i Avokatit të Popullit, si instancë kombëtare, garante e demokracisë përmes mbrojtjes në realitet të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në vendin tonë.

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila në 5 nene të saj përcakton detyrat, statusin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit, në shkurt të vitit 1999, Kuvendi miratoi Ligjin Nr.8454, dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Sot ka rreth 350 ombudsmanë ose mediatorë në 125 vënde, që veprojnë në të gjithë kontinentet.

Në një shoqëri të sundimit të ligjit, gjykatat natyrisht që janë mbrojtësit kryesorë të të drejtave të individëve. Avokati i Popullit (Ombudsmani) është një institucion jogjyqësor, thënë ndryshe, një mjet i veçantë në llojin e tij, që i ndihmon qytetarët, kur këta ndeshin vështirësi me administratën.

Në rastin tonë, Kuvendi i Shqipërisë e miratoi Avokatin e Popullit, duke përcaktuar vlerat dhe parimet mbi të cilat vepron ky Institucion. Ato janë pavarësia, paanshmëria, profesionalizmi dhe konfidencialiteti.

Avokati i Popullit, përmes veprimtarisë së tij, ndikon që të afrojë gjithnjë e më shumë administratën publike me qytetarin, të cilit ajo i shërben. Synimi ynë është që sa më shpejt të arrihen treguesit dhe standartet që Komuniteti Ndërkombëtar ka përcaktuar dhe zbaton në praktikë për institucionet kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Karta e të Drejtave të Njeriut e Bashkimit Evropian, e miratuar në Samitin e Nisës në dhjetor 2000, në nenin 43, ka përcaktuar si kusht edhe ekzistencën e Institucionit të Ombudsmanit. Pra, ngritja dhe funksionimi i Avokatit të Popullit në Shqipëri plotëson një kusht për pranimin në Bashkimin Evropian.

Misioni i Avokatit të Popullit është të bëjë sa më transparente Administratën, sikundër e kërkon ekologjia e demokracisë. Ndërkaq, roli i Avokatit të Popullit (Ombudsmanit) nuk kufizohet thjesht tek mbrojtja e të drejtave të qytetarëve në raport me padrejtësitë dhe abuzimet e administratës ose të nëpunësit publik. Për shkak të shumë mangësive që vijnë nga zbatimi i ligjit në praktikë, Avokati i Popullit mund të thellohet edhe më tej në funksion të rolit të “mësuesit që vlerëson administratën”, duke respektuar njëkohësisht autoritetet legjitime dhe ndihmuar në realizimin e politikave prioritare të shtetit në tërësi.

Në këtë kuptim, përveç mbrojtjes së të drejtave të njeriut, një nga objektivat e tij kryesore është të zhvillojë atë që quhet *kultura e qeverisjes së mirë*. Kjo do të thotë administrim i mirë, çiltërsi, transparencë dhe llogaridhënie e administratës publike para njerëzve që paguajnë taksa për ta mbajtur atë. Avokati i Popullit, përmes rekomandimeve të tij, mundohet të edukojë Administratën, duke e bërë atë të kuptojë rolin e saj të vërtetë ndaj qytetarëve, pra të përqëndrohet te arsyeja e vërtetë e ekzistencës së saj, jo si pronare dorështrënguar e të drejtave të qytetarëve, por si shërbetore e paguar prej tyre.

Për Këshillin e Evropës, Ombudsmani dhe institucione të tjera të ngjashme përbëjnë elementin themelor të infrastrukturës së të drejtave të njeriut në një shoqëri demokratike. Në perspektivën e integritit të vendit tonë, përderisa legjislacioni i Komunitetit Evropian është i detyrueshëm për secilin Shtet Anetar, ky legjislacion, sidomos për kushtet e Shqipërisë, është burim reference edhe për institucionin e Avokatit të Popullit, sidomos për argumentimin e rekomandimeve, dërguar administratës. Kjo është arsyeja që ne marrim pjesë aktivisht në rrjetin e komunikimit dhe bashkëpunimit me zyrat e ombudsmanëve të rajonit, në kuadrin e Institutit Evropian të Ombudsmanit.

Shërbimi i Avokatit të Popullit ndihmon që individëve t’u krijohen shanse të barabarta, në mënyrë që të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën. Kjo arrihet, kryesisht, në bazë të bisedimeve, të paanësisë dhe të standarteve më të gjëra të drejtësisë. Tiparet themelore të institucionit të Avokatit të Popullit janë pavarësia nga qeveria dhe nga çdo ndikim politik, lehtësia e kontaktimit, shpejtësia, fleksibiliteti, efektiviteti dhe forca e rekomandimeve të tij. Cilësojmë “forcën e rekomandimeve”, sepse është pikërisht mungesa e forcës detyruese, ajo që kushtëzon edhe praninë sa më të madhe të forcës argumentuese. Është pikërisht kjo “forcë argumentuese” e bazuar në ligj, ajo që e bën rekomandimin e Avokatit të Popullit, nga formalisht “jo detyrues”, në thelb “bindës për tu zbatuar”.

Ndonëse ombudsmanët nuk kanë fuqi detyruese, ata lipset të ushtrojnë një shkallë të lartë autoriteti bindës, për të ndryshuar mënyrën e sjelljes së administratës dhe autoriteteve publike, me rekomandimet e tyre.

Ashtu si në vende të tjera, edhe administrata shqiptare nuk mund t'i shpëtojë lehtë psikologjisë së të qenit "institucion monopol". Kjo do të thotë se tendenca për të diktuar dhe qenë e mbyllur, më tepër se sa për të dëgjuar dhe sqaruar, është e pranishme, sidomos në sjelljen e saj me qytetarët. Pikërisht, këtu qëndron një drejtim tjetër i punës së Avokatit të Popullit, në përpjekje për ta bërë publikun të kuptojë se të drejtat e tij përbëjnë detyrim për administratën publike.

Vetë fakti i ekzistencës së Institucionit të Avokatit të Popullit ka një ndikim pozitiv në administratë, së paku për arsyen e thjeshtë se kjo e fundit e di se është një palë e tretë që e vëzhgon performancën e saj në raport me qytetarin. Nga ana tjetër, ne kemi punuar dhe punojmë që njerëzit ta dinë se mund të ankohen pranë nesh, përmes një procedure të lehtë dhe pa shpenzime, për ato vendime të administratës, që i konsiderojnë të padrejta ose të pafavorshme për ta.

Avokati i Popullit nuk është një institucion akuze dhe as gjurmimi ndaj administratës publike në Shqipëri, sikundër kriticizmi i tij ndaj punës së administratës nuk përbën qëllim në vetvete. Sigurisht, ne do të kritikojmë veprimet ose mosveprimet e administratës në rekomandimet dhe raportet tona, sikurse veprojnë ombudsmenët në të gjitha vendet, por qëllimi parësor nuk është për të punuar kundër institucioneve publike, por për të bërë një administratë publike sa më të mirë.

Në vendet e tjera është vënë re se, si Ombudsmani mund të ndryshojë pozitivisht imazhin e administratës në publik. Edhe tek ne, kjo mund të ndihmojë për ta bërë administratën shqiptare më të përgjegjshme për cilësitë e vendimeve të saj dhe për përgjegjësitë ndaj publikut.

Si përfundim, do të thonim se Institucioni i Avokatit të Popullit shprehet në modelin e atij mekanizmi të kontrollit dhe balancës, i cili, duke qenë pjesë e pushtetit publik, pengon ekzeset e këtij pushteti, madje u mëson autoriteteve parimet e mirësjelljes administrative. Ky institucion punon në funksion të realizimit të asaj që quhet "drejtësi e butë". Ai është më pak formal, por lehtësisht i arritshëm për të gjithë qytetarët. Duke qenë një institucion i aftë për fleksibilitet dhe shumëdisiplinshmëri, Avokati i Popullit synon lartësimin e duhur të progresit të administratës dhe mirëqeverisjes.

Avokati i Popullit në Shqipëri nuk është dhe nuk do të jetë asnjëherë në Opozitë me Qeverinë, pavarësisht se cilat forca politike do ta kenë atë, por do të jetë gjithmonë një Oponencë për Mirëqeverisje. Ky është thelbi i

filozofisë së funksionimit të këtij institucioni dhe si i tillë ai duhet mirëkuptuar e trajtuar nga të gjitha palët që bëjnë politikën në Shqipëri.

Sikundër ka thënë kolegu Sir Brian Elwood, President i Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit: “Kërkimi i rrugëve për menaxhimin më të mirë të çështjeve kolektive, na çon të gjithëve në një udhëtim zbulues për gjetjen e ndihmësve të përshtatshëm. Institucioni i Ombudsmanit është një nga këta ndihmës”.

PREZANTIMI I SHKURTËR I RAPORTIT

Sipas nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 26 të Ligjit nr.8454 dt.04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, Avokati i Popullit paraqet në Kuvend një Raport Vjetor, i cili diskutohet në seancë plenare.

Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit është një ndër mjetet kryesore nëpërmjet të cilit ai mund të ndikojë për funksionimin e shtetit të së drejtës, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, forcimin e demokracisë, mirëadministrimin e punëve nga Administrata Publike dhe formulimin prej saj të politikave të zhvillimit të vendit.

Pas Raportit të parë të paraqitur në mars 2001, për veprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit 2000, ky është Raporti i dytë që përgatit Avokati i Popullit. Në mënyrën se si është konceptuar, mund të merret një informacion i plotë për metodën e përdorur dhe fushat e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, duke përfshirë dhe të dhëna statistikore. Një vend të veçantë në Raport zënë veprimtaritë e zhvilluara nga Institucioni, mbështetja ndërkombëtare, opinionet për situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri si dhe opinione për zhvillimin e mirëadministrimit të punëve në Shqipëri. Gjithashtu vend të veçantë në Raport zënë dhe marrëdhëniet publike të Institucionit me Mediat. Bashkëpunimin me Mediat e kemi parë si mjetin më efikas për të siguruar aksesin e nevojshëm në publik dhe krijimin e individualitetit të domosdoshëm të Institucionit, për ushtrimin e funksionit sipas Kushtetutës dhe Ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Ky raport ilustron punën e organeve dhe autoriteteve publike (përfshirë ato qëndrore dhe vendore) në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut dhe prezanton mjetet për zgjidhjen e rasteve, për të cilat mendojmë se duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për veprimet e organeve përgjegjëse të administratës në situata të ngjashme.

Raporti përmban gjithashtu rekomandime dhe propozime për eliminimin e të metave dhe “padrejtësive”, të cilat janë identifikuar gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura tek Avokati i Popullit.

Në këtë Raport kemi përfshirë me shumë analiza të detajuara në ato fusha që sipas këndvështrimit tonë përbëjnë një element kyç, dhe të cilave në të ardhmen do t’u kushtojmë më shumë vëmendje.

Ashtu si dhe vitin e kaluar, në këtë Raport gjejnë pasqyrim edhe strategjitë dhe objektivat për të ardhmen e Institucionit të Avokatit të Popullit në Republikën e Shqipërisë.

KREU I PARË

1. Institucioni i Avokatit të Popullit dhe e drejta e mirëadministrimit e Bashkimit Evropian.

Duke patur parasysh që shteti ynë ka aplikuar dhe ndodhet pranë një objektivi madhor, sikundër është nënshkrimi i Marrëveshjes së Asocimit Stabilizimit me Bashkimin Evropian, është e natyrshme që edhe veprimtaria e Avokatit të Popullit në Shqipëri të fokusohet në krijimin dhe ruajtjen e standarteve të larta të mirëqeverisjes dhe mirëadministrimit të punëve të shtetit.

Me vizionin se tashme në demokraci, graviteti i kahjes së mbrojtjes së të drejtave të njeriut ka ndryshuar nga shteti tek qytetari, Institucioni i Avokatit të Popullit synon që me precedentet e krijuar, qoftë edhe me zgjidhjen e ankesave me të thjeshta, të arrijë të krijojë tek qytetari bindjen se nepunesi civil apo autoriteti publik tashme paguhet nga taksat e tij për t'i shërbyer atij, pra qytetarit. Nga ky këndvështrim, sa qytetar, aq edhe politik, pozicioni social dhe mentaliteti i qytetarit shqiptar nuk ka se si të mos ridimensionohet dhe përafrohet me atë të qytetarit Evropian.

Për sa me sipër, garanci janë Kushtetuta e re e vitit 1998, kuadri ligjor që derivon prej saj, pershtatshmeria e tyre me Konventat dhe Kartat Nderkombetare. Ngritja dhe funksionimi i institucioneve të reja, krahas atyre ekzistuese, reformimi dhe zhdergjelltesimi i të cilave është dhe mbetet detyrë e vazhdueshme e çdo ekipi qeverisës, pavaresisht nga ngjyrat partiake.

Procesi i përafrimit me BE-në bashkeshoqerohet natyrshëm me një impakt disiplanesh, që pritet të ndikojë si në përfaqësimin e detajuar të legjislacionit kombëtar me atë të së drejtës Evropiane, ashtu edhe me angazhimin praktik të administratës publike shqiptare për ta zbatuar atë me korrektesë. Dhe kjo vlen për të tre pushtetet, pa përjashtuar edhe marrëdhëniet e këtyre të fundit me institucionet e shoqërisë civile si dhe individët në raport me strukturat e shtetit të tyre.

Korpusi i deritanishëm ligjor në Shqipëri është produkt i angazhimit të juristëve shqiptarë dhe asistencës dhe ekspertizës së marrë kryesisht nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Statusi i vendeve anëtare, me të cilat

Shqipëria synon të bashkohet kushtezon që, administrata shqiptare dhe sistemi i drejtësisë të krijojnë dhe respektojnë ato standarte të mirëadministrimit, që do të justifikonin përshtatjen e tyre me sistemin ligjor të BE-së në kushtet e anëtarësimit të plotë. Kjo parakupton që si ligjvënësi, (Kuvendi) ashtu edhe administrata dhe gjyqsori gjatë gjithë veprimtarisë së tyre të kenë parasysh dhe, kur është rasti, të zbatojnë konventat, kartat dhe standartet jo vetëm të Këshillit të Evropës, por tashmë edhe të Bashkimit Evropian.

Standartet e mirëqeverisjes që Bashkimi Evropian ka përcaktuar për t'u arritur, bazohen në parime të tilla si, respektimi i lirisë, demokracisë, shtetit të së drejtës dhe i të drejtave të njeriut. Në pikën 7 të Deklaratës së Kopenhagenit të vitit 1993 kërkohet qartë “ngritja dhe respektimi i institucioneve kombëtare, garante të demokracisë”, sikundër është edhe Institucioni i Avokatit të Popullit (Ombudsmani). Mirëfunksionimi i Avokatit të Popullit parakupton ndikimin në mirëqeverisje, pikësëpari në mbështetje të parimeve që përmendëm më lart. Kjo merr një rendësi edhe më të madhe, po të kemi parasysh që qëndrimi i administratës publike ndaj këtyre parimeve themelore është kusht si për t'u pranuar, ashtu edhe pezulluar nga të drejtat që të jep statusi i një shteti anëtar i BE-së.

Karta e të Drejtave të Njeriut të vendeve të Bashkimit Evropian, e miratuar në Samitin e Nisës në dhjetor 2000 është teksti i parë zyrtar në botë në fushën e të drejtave të njeriut që sanksionoi zyrtarisht të drejtën e mirëadministrimit, si të drejtë themelore të njeriut. Përcaktimi në këtë Kartë i të drejtës së mirëadministrimit (neni 41), të drejtës së aksesit në dokumentet zyrtare (neni 42), të Institucionit të Ombudsmanit (neni 43), janë një zhvillim i ri dhe i konsiderueshëm në zhvillimin e të drejtave të njeriut në gjirin e Komunitetit Evropian.

Duke qenë pra se, tashmë, e drejta e një populli për t'u mirëqeverisur, konsiderohet si një nga të drejtat e njeriut, në shumë shtete, parimet e mirëadministrimit janë përmbledhur në mënyrë eksplicite në një Kod të Procedurave Administrative. Përmbajtja e këtij Kodi përfshin minimalisht disa parime, si: arsyetimi i vendimeve të marra; procedurat e drejta dhe e drejta e mbrojtjes; menjanimi i diskriminimit; mbajtja parasysh e të gjitha konsideratave që kanë lidhje me çështjen dhe përjashtimi i atyre që nuk kanë lidhje; ruajtja dhe mirëmbajtja e dokumenteve; menjanimi i vonesave të panevojshme; sigurimi i informacionit në formë të qartë e të kuptueshme; dhënia e këshillave korrekte; zbatimi i rregullave dhe procedurave të vendosura; dhënia e informacionit për të drejtën për apelim ndaj një vendimi të pafavorshëm për qytetarin; njohja me, dhe përgjigjet ndaj letrave; dërgimi i letrave (ankesave) pranë organit ose shërbimit

kompetent; të kërkuarit ndjesë për gabimet; funksionimi i një sistemi të përshtatshëm për të trajtuar ankesat etj.

Në vendet e Bashkimit Evropian ky quhet Kodi i Sjelljes së Mirë (Mirësjelljes) Administrative, kurse në Shqipëri quhet Kodi i Proçedurave Administrative.

Është e kuptueshme se nga zbatimi i këtij Kodi ka përfitime si për administratën, ashtu edhe për qytetarët, për më tepër se, sikundër shihet edhe më lart, ai përmban parime dhe dispozita tejet të sakta dhe konkrete. Duke i njohur zyrtarët ose punonjësit e shërbimit civil me këto parime dhe norma sjelljeje, rritet ndjeshëm cilësia e administrimit dhe shërbimit ndaj qytetarëve si dhe do të ruhet koherenca midis institucioneve të ndryshme. Për sa i përket qytetarëve, ata do të kenë një përparësi tjetër, atë të të bërit transparent të shërbimit publik, që ata gëzojnë të drejtën ta kenë nga kontrata sociale, që kanë nënshkruar me shtetin e tyre.

Sikundër del nga analizat që bëhen për kushtet që duhet të plotësojë Shqipëria në prag të procesit të parapranimit në BE, një ndër to ka qenë dhe mbetet ngritja dhe konsolidimi i Institucionit të Ombudsmanit.

Tashmë që ky institucion është ngritur dhe funksionon që nga muaji Qershor 2000, duhet që të ketë edhe një administratë publike me ndjenjë përgjegjësie. Kjo do të thotë një administratë që të jetë e hapur ndaj ndryshimit dhe që e di se Avokati i Popullit ka detyrë të futet në dialog me administratën, të bëjë kritikë konstruktive dhe të japë këshilla. Po ashtu, kërkohet që legjislativi të pranojë rekomandimet e Avokatit të Popullit për ndryshime ligjore ose nisma të reja legjislative. Kjo kërkon një kuptim dhe pranim të rolit të Avokatit të Popullit, si nga ana e administratës publike, ashtu edhe nga Kuvendi (legjislativi), gjë që s'mund të arrihet menjëherë, por që ka rëndësi të madhe të kuptohet nga të gjitha palët. Për këtë mire-kuptim ka punuar dhe do vazhdojë të punojë Avokati i Popullit në Shqipëri.

2. Kushtetuta dhe ligji shqiptar “Për Avokatin e Popullit” reflektojnë dhe pasqyrojnë përvojën ndërkombëtare dhe Rekomandimet e këshillat e Komunitetit Ndërkombëtar për këtë Institucion.

Këshilli i Evropës ka një përvojë afro 20-vjeçare pune me institucionet e Ombudsmanit. Komiteti i Ministrave ka nxjerrë Rekomandime dhe Rezoluta në vitet 1985 dhe 1997, që përmbajnë këto direktiva: Rekomandimi (85) 13 për emërimin e institucionit të ombudsmanit, kompetencat e tij dhe forcimin e pushteteve të ombudsmanit; Rezoluta (85) 8 për bashkëpunimin

midis ombudsmanëve të shteteve anëtare dhe midis tyre dhe Këshillit të Evropës; Rekomandimi (97) 14 për krijimin e institucioneve të pavarura për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe Rezoluta (97) 11 për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të shteteve anëtare si dhe midis tyre dhe Këshillit të Evropës. Këto dokumente të Këshillit të Evropës për Ombudsmanin tregojnë rëndësinë e këtij organi, të cilit i kanë dhënë kompetenca për të shqyrtuar ankesat individuale për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut etj.

Gjatë këtyre 10 vjetëve të fundit, Këshilli i Evropës i është përkushtuar tërësisht ngritjes dhe mbështetjes së institucionit të Ombudsmanit në shtetet e reja anëtare. Kjo mbështetje ka të bëjë si me hartimin e legjislacionit përkatës për këto institucione, ashtu edhe me dhënien e ekspertizës dhe të ndihmesës në zyrat e porsahapura. Ndër vendet ku ka dhënë ndihmë konkrete dhe projekte bashkëpunimi përfshihet edhe Shqipëria. Këshilli i Evropës sot drejton bashkërendimin e Projekteve të Paktit të Stabilitetit në Evropën Juglindore për institucionet kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe institucionin e Avokatit të Popullit në Shqipëri.

Ndër të tjera, Këshilli i Evropës ka përcaktuar edhe kushtet e domosdoshme për të përvijuar tiparet kryesore të Institucionit të Avokatit të Popullit (Ombudsmanit).

Ato përbëhen, së pari, nga një bazë ligjore kushtetuese që të parashikojë ngritjen e funksionimin e Institucionit dhe zgjedhjen e kandidatit të përshtatshëm në një mjedis me pikëpamje politike të ndryshme, për t'i garantuar Ombudsmanit si pavarësinë, ashtu edhe patundshmërinë në detyrë, brenda mandatit kohor.

Së dyti, nevoja për ta pajisur Ombudsmanin me burime të mjaftueshme financiare për të kryer mandatin e vet.

Së treti, institucioni i Ombudsmanit nuk zëvendëson gjykatat, pra nuk është zëvendësues i një sistemi gjyqësor që duhet të jetë efektiv dhe i pavarur. Ai përbën një pjesë të makinerisë së të drejtave të njeriut, me të cilën duhet të pajisen të gjitha shtetet demokratike, duke mos mbajtur as anën e administratës e as atë të individit, por duke punuar për kulturën e mirëqeverisjes dhe për mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të njeriut.

Në një shoqëri, ku funksionon shteti i së drejtës, gjykatat mbeten natyrshëm mjeti kryesor për mbrojtjen e të drejtave të individit. Ombudsmani ose Institucioni i Avokatit të Popullit është një institucion jogjyqësor, diçka ekstra, që i ndihmon qytetarët, kur këta të fundit ndeshin vështirësi në raportin e tyre me administratën.

Sipas nenit 60 të Kushtetutës dhe nenit 2 të ligjit përkatës, Avokati i Popullit në Shqipëri mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike ose të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Pra juridiksioni i tij përfshin Qeverinë, ministritë, institucionet e tjera qëndrore siç janë Komitetet shtetërore të Kthimit të Pronave etj; Shërbimet Sekrete, Bankën Kombëtare dhe Bankat me pjesëmarrje kapitali shtetëror etj; organet e pushtetit lokal ku përfshihen Prefekturat, Qarqet, Bashkitë dhe Komunat si dhe ato institucione apo autoritete publike që veprojnë për llogari të këtyre organeve të administratës publike dhe institucionet në varësi të tyre në qendër dhe rrethe. Ashtu si ligjet e mjaft shteteve të tjera që e kanë këtë institucion, edhe ligji shqiptar nuk i ka dhënë Avokatit të Popullit fuqi vendimmarrëse në raport me organet e administratës, por vetëm të drejtën e rekomandimeve përkatëse. Kjo nuk do të thotë se Avokati i Popullit nuk ka mjete për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e njerëzve. E drejta e tij për t'i ndjekur çështjet shkallë-shkallë, sipas hierarkisë së administratës, deri në dërgimin e çështjes në Kuvend, si dhe transparenca, në punën e tij, bashkëpunimi i ngushtë me OJQ-të dhe Median garantojnë suksesin në detyrën që i është caktuar atij.

Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij. Kjo pavarësi shprehet në disa elemente si: Mospasja e lidhjeve të varësisë me Institucionet e tjera Kushtetuese të vendit si Presidenti, Qeveria, Gjykatat etj; qenia jashtë politikës, jashtë partive dhe veprimtarive të tyre politike, disponimi i një buxheti të veçantë, përzgjedhja prej Avokatit të Popullit e Komisionerëve dhe ndihmësve të tyre brenda një strukture dhe organike të përcaktuar prej atij vetë, përcaktimi i Rregullores së Brendëshme, Kodit Etik etj. Është e rëndësishme dhe vlen të raportohet se kjo pavarësi ka qenë dhe është reale, tipike, për veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri dhe pavarësisht nga kritikrat e shprehura apo të pashprehura publike, kjo pavarësi nuk do të lejohet të cënohet nga ndikimi i asnjë force politike apo Institucioni tjetër shtetëror.

Çdo individ, grup individësh ose organizata joqeveritare që pretendojnë se të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme, u janë shkelur nga një akt, nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës qëndrore e vendore apo të ndonjë organi tjetër të veshur me autoritet publik, mund të paraqesin ankesa, kërkesa apo njoftime tek Avokati i Popullit për shqyrtimin e çështjes. Ai mundet gjithashtu që, për raste të veçanta të bëra publike, të fillojë procedurën e shqyrtimit me nismën e vet, por gjithmonë duhet të marrë më pas pëlqimin e të interesuarit apo të dëmtuarit.

Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga organet e Administratës çdo informacion apo dokument që lidhet me çështjen që ndjek, ose të kryejë hetime të pavarura në vend, të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin e tij, të marrë në pyetje çdo person, që sipas tij, është i lidhur me çështjen në hetim ose të kryejë ose të kërkojë ekspertiza.

Ai ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente të klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror. Avokati i Popullit s'mund të ndalohej të hyjë në çdo zyrë të organeve të administratës të përmendura më sipër; në burgjet dhe vendet e tjera të paraburgimit ose institute të tjera ku të drejtat e individëve janë të kufizuara. Ai gjithashtu s'mund të ndalohej të bisedojë privatisht me personat që mbahen në këto institute. Këto të drejta dalin nga interpretimi i Kushtetutës dhe ligjit "Për Avokatin e Popullit" si dhe nga praktikat ndërkombëtare të punës së Ombudsmanit, por do të ishte mirë që, në rast të plotësimit të ligjit "Për Avokatin e Popullit", të vendosen shprehimisht në këtë ligj, për të mos ngjallur shfaqjet e keqinterpretimeve dhe vendosjes së kufizimeve të padrejta për Institucion tonë.

Sipas nenit 22 të ligjit, organi të cilit Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ.

Në rast se Avokati i Popullit nuk i quan të mjaftueshme përgjigjet ose masat e ndërmarra nga organi, ai ka të drejtë ta ndjekë çështjen tek organi më i lartë në hierarki. Në rastet e përsëritura, si dhe kur organi përkatës nuk reagon ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ky i fundit mund t'i drejtohet edhe Kuvendit me një raport, duke propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur.

E drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legislative, është një mjet shumë i rëndësishëm dhe efektiv për të ndaluar shkeljen e të drejtave të njeriut.

Kur Avokati i Popullit vëren, se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ai ka të drejtë:

a. t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve;

- b. t'u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore;
- c. t'i rekomandojë Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e akteve të tilla.

Institucioni i Avokatit të Popullit i jep rëndësi të veçantë kontakteve me ankuesit, pasi ai është krijuar për të ndihmuar në zgjidhjen e nevojave të individëve. Detyra e tij është të parandalojë apo të zbulojë shkeljet e të drejtave dhe lirive të individit, me qëllim ndreqjen e pasojave që rrjedhin nga e drejta e shkelur. Megjithatë është shumë e rëndësishme që ky Institucion të jetë i hapur dhe i gatshëm për këdo që kërkon ndihmë nga ai. Çdo qytetar shqiptar ose i huaj mund të vijë në çdo kohë gjatë orarit zyrtar nga ora 8⁰⁰ deri 16⁰⁰ dhe të kontaktojë me një punonjës të Zyrës, i cili merr dhe jep informacion. Avokati i Popullit dhe Komisionerët organizojnë takime me të interesuarit, sipas rastit. Për ankesa, kërkesa, shpjegime, këshilla dhe informacion në fushën që paraqitet ankimi tashme është vendosur një linjë telefonike pa pagesë, duke ua mundësuar këtë shërbim të burgosurve, të ndaluarve apo të arrestuarve.

Qytetarët mund t'i drejtohen Avokatit të Popullit në mënyra të ndryshme. Sipas procedurës që kemi caktuar, ankesa i paraqitet Avokatit të Popullit me shkrim. Në raste urgjente, ankesa mund të bëhet dhe me telefon por, shumë shpejt ajo duhet të paraqitet edhe me shkrim, pasi në të kundërt procedura për shqyrtimin e çështjes ndërpritet. Nuk pranohen ankesa ose kërkesa anonime.

Në rastet, kur ankesa e paraqitur nuk është e plotë, pasi i mungojnë dokumentet e nevojshme, Avokati i Popullit kërkon që ajo të plotësohet ose bën kërkitime të drejtpërdrejta tek organi, ndaj të cilit është bërë ankesa, kur një gjë e tillë është e dukshme në ankesë. Në shumë raste, biseda me ankuesin është e nevojshme për t'a paraqitur siç duhet rastin që shqyrtohet, veçanërisht kur ai është i komplikuar dhe kërkon shumë shpjegime.

Avokati i Popullit dhe stafi i tij zhvillojnë takime edhe jashtë zyrës së tij, në rrethe të ndryshme të vendit. Emërimi i përfaqësuesve të Avokatit të Popullit nëpër rrethe është një mundësi, që ne kemi planifikuar ta realizojmë këtë vit në Shkoder dhe në një rreth tjetër.

Disa nga ankesat e paraqitura mund të mos jenë në juridiksionin e Avokatit të Popullit, ose mund të mos përmbushin kushtet për t'u trajtuar nga zyra e Avokatit të Popullit. Në raste të tilla, ankuesi do të marrë përgjigjen e Avokatit të Popullit sa më shpejt që të jetë e mundur, brenda afatit 1 muaj, duke e këshilluar atë se çfarë lipset të bëjë, cilat janë mundësitë që i kanë mbetur akoma, ose cilat janë mjetet ligjore që duhet të përdoren përpara se ankesa të trajtohet nga Avokati i Popullit.

Si rregull, fillimisht Avokati i Popullit u dërgon organeve përkatëse një përshkrim të shkurtër të problemit të ngritur, dhe kërkon shpjegime të hollësishme rreth tij. Në të njëjtën kohë, Avokati i Popullit fikson dhe afatin, brenda të cilit pret përgjigje nga organi të cilit i është drejtuar kërkesa. Ky afat varet nga urgjenca e problemit dhe nga shkalla e vështirësisë së tij. Megjithatë, afati nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë. Nganjëherë, kur natyra e problemit të paraqitur është e tillë, sa afati kohor nuk mund të zgjasë shumë, Avokati i Popullit mund të bëjë verifikimet e tij nëpërmjet telefonit ose faxit.

Pas kryerjes së hetimit për një çështje të caktuar, Avokati i Popullit përpilon një raport për çështjet dhe konkluzionet e arritura, dhe mund t'ua paraqesë atë palëve që kanë të bëjnë me çështjen. Ky raport përmban gjykimin e Avokatit të Popullit mbi faktet dhe rrethanat e çdo rasti, duke treguar se cilat nga të drejtat dhe liritë e individit janë shkelur, si janë shkelur ato dhe cilat janë personat përgjegjës që kanë kryer shkeljet. Në të njëjtën kohë, Avokati i Popullit mund të propozojë rrugën për të rivendosur të drejtën e shkelur. Ai, gjithashtu, mund të propozojë kompensime përkatëse për dëmin e shkaktuar individit nga shkelja e së drejtës që i është bërë. Avokati i Popullit mund të kërkojë që, organi që ka kryer shkeljen e së drejtës së individit, t'i kërkojë këtij të fundit falje për veprimin e kryer.

Avokati i Popullit i paraqet çdo vit Kuvendit një raport vjetor për punën e tij. Një kopje e këtij raporti i dërgohet Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Këshillit të Ministrave. Ky raport që keni në duar përmban veprimtarinë e Institutionit tone nga 1 Janari deri më 31 Dhjetor 2001.

Raporti vjetor dhe raportet e veçanta bëhen publike dhe duhet të botohen jo më vonë se një muaj nga data e diskutimit në Kuvend. Një kopje e tij në Anglisht publikohet dhe u shpërndahet nga zyra e Avokatit të Popullit institucioneve homologe të vendeve të huaja si dhe institucioneve ndërkombëtare që kanë lidhje me këtë Institucion.

Duke patur parasysh se çfarë parashikon legjislacioni shqiptar, duke patur parasysh edhe përputhshmërinë e këtij të fundit me legjislacionin Evropian, duke patur parasysh edhe angazhimet e marra nga Shqipëria për t'u asociuar dhe integruar në Bashkimin Evropian, Avokati i Popullit gjen rastin të rikujtojë si gjithmonë obligimin e administrates publike shqiptare për të bashkëpunuar dhe mirëkuptuar çdo rekomandim të Avokatit të Popullit, tek i cili individët mund të drejtohen me ankesat e tyre, zgjidhja e drejtë e të cilave, në fund të fundit, rrit besimin e qytetarit tek shteti i tyre.

3. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit

Një nga parimet bazë të Institucionit të Avokatit të Popullit, është Pavarësia e tij.

Sipas praktikave të Institucioneve të këtij lloji në të gjithë botën, një nga shprehjet e parimit të pavarësisë është edhe lënia në dorën e Ombudsmanit të së drejtës së përcaktimit të strukturës, të numrit të personelit, cilësive specifike si dhe të shpërblimit të tyre, brenda buxhetit të miratuar nga Parlamenti.

Në Shqipëri është gjetur një rrugë e mesme, e cila nuk e prek pavarësinë e këtij Institucioni. Kështu, duke qenë se ligji “Për Avokatin e Popullit”, në nenin 31, ka caktuar tre seksionet e specializuara, Avokati i Popullit, mbi bazën e ligjit nr.8600, dt.10.04.2000, ka përcaktuar pjesët e tjera të strukturës organizative dhe numrin e personelit të zyrës. Sipas strukturës organizative të miratuar, Zyra e Avokatit të Popullit përbëhet nga tre seksione të specializuara, që ndjekin çështjet e ankesave dhe kërkesave, përkatësisht:

Seksioni i Parë, për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, që drejtohet nga zoti Agron Çausi;

Seksioni i Dytë, për policinë, shërbimin sekret, burgjet, forcat e armatosura dhe pushtetin gjyqësor, që drejtohet nga zoti Jorgo Dhrami;

Seksioni i Tretë trajton çështjet që nuk përfshihen në dy seksionet e para si dhe bashkëpunon me organizatat joqeveritare. Ky seksion ka detyrë të kryejë edhe studime për veprimtarinë në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe drejtohet nga zonja Florina Nuni.

Veç 3 seksioneve të specializuara, funksionon edhe Kabineti, në përbërje të të cilit janë Këshilltarët e Avokatit të Popullit. Sektori i pritjes dhe rregjistrimit të ankesave, financa, personeli, marrëdhëniet me jashtë dhe administrata, janë sektorë ndihmës për realizimin e detyrave kryesore që ka Institucioni. Duke përjashtuar Kabinetin, të gjithë këto organizma ndihmës, janë nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Institucionit, zotit Gëzim Lleshi.


Institucioni i Avokatit të Popullit ka gjithsej 47 punonjës, numër ky i miratuar nga vetë Avokati i Popullit, në zbatim të nenit 35 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”. Nga këta 47 punonjës, vetëm 19 prej tyre, përfshirë edhe vetë Avokatin e Popullit, merren direkt me zgjidhjen e ankesave. Duke patur parasysh numrin e ankesave të ardhura gjatë vitit 2001, ky numër punonjësish është i justifikuar dhe i mbuluar në punë. Por në qoftë se gjatë vitit 2002 e në vazhdim ankesat do të rriten, numri i

ndihmëskomisionerëve (personave që merren direkt me ankesat), mund të jetë i nevojshëm të rritet, si dhe struktura mund të përmirësohet.

Për Organikën dhe numrin e Personelit të Institucionit tonë janë patur parasysh institucionet homologe në Slloveni, Danimarkë, Hungari dhe Rumani, si dhe përvoja e Institucioneve analoge shqiptare.

Përsa i përket cilësive profesionale të personelit të Zyrës sonë, vëmë në dukje se Avokati i Popullit dhe Komisioneri, zoti Jorgo Dhrami, mbajnë gradën “Doktor i Shkencave Juridike”. Veç këtyre, 4 të tjerë aktivizohen për mësimdhënie si pedagogë të jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë ose në Shkollën e Magjistraturës. Nga 34 specialistë me arsim të lartë që ka Institucioni, disa kanë kryer studime pasuniversitare në Perëndim, kurse 20 prej tyre zotërojnë dhe përdorin lirisht një ose më shumë gjuhë të huaja. Kjo gjendje ka krijuar mundësinë që, në kuadrin e trajnimeve që ka ofruar programi Danida dhe Këshilli i Evropës, Institucioni ynë të ketë mundësi të përfitojë përvojë bashkëkohore gjithnjë e në rritje.

STRUKTURA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT



Pasqyra Nr.2

ORGANIKA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

Nr.	EMËRTIMI	NËPUNËS
I	AVOKATI I POPULLIT	(1)
II.	KABINETI Shefi i Kabinetit Këshilltari i Avokatit të Popullit Këshilltar, Zëdhënës i Avokatit të Popullit Sekretare e Avokatit të Popullit	(4) 1 1 1 1
III	SEKSIONI I ORGANEVE TË ADMINISTRATËS QENDRORE DHE VENDORE Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + Rregjistruese	(7) 1 5 1
IV	SEKSIONI I SHËRBIMEVE TË VEÇANTA Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese	(7) 1 5 1
V	SEKSIONI I PËRGJITHSHËM Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese	(7) 1 5 1
VI	SEKRETARI I PËRGJITHSHËM	(1)
VII	DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË Drejtor Inspektor + (përkthyes, bibliotekar)	(2) 1 1
VIII	DREJTORIA E PERSONELIT Drejtor	(1) 1
IX.	SEKTORI I FINANCËS Shef Sektori Llogaritar i parë, Arkëtar	2 1 1
X.	SEKTORI I PRITJES SË POPULLIT Shef Sektori	1 1
XI.	SEKTORI I ADMINISTRATËS Shef Sektori (Inspektor) Specialist kompjuteri, inxhinier Arkivist + rregjistruse Protokollist Magazinier Shofer Pastrues	(14) 1 1 1 1 1 7 2

Institucioni i Avokatit të Popullit ka gjithsej, 47 punonjës.

4. Krijimi dhe vënia në funksionim e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri

Në zbatim të Rekomandimeve të Këshillit të Evropës dhe sipas modelit të mjaft shteteve Evropiane, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998, parashikoi krijimin e një Institucioni të veçantë që do të merrej me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve – Avokatin e Popullit. Roli dhe funksioni i tij u përcaktuan në Ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”. Në 16 shkurt 2000, Parlamenti Shqiptar, zgjodhi Avokatin e Popullit, z. Ermir Dobjani. Prej tij u propozuan 3 komisionerët. Në datën 30 mars 2000 u zgjodhën si komisionerë Agron Çausi, Florina Nuni dhe Jorgo Dhrami. Më datën 10 Prill 2000, Kuvendi miratoi një shtesë në Ligjin “Për Avokatin e Popullit”, me anë të së cilës, Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë strukturën dhe organikën e institucionit. Kjo shtesë e ligjit i shërbeu forcimit të pavarësisë së Institucionit. Pas kësaj, për vënien në funksion të Institucionit, u përcaktua struktura dhe organika. Në përputhje me Ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999, “Për Statusin e Nëpunësit Civil”, në Qershor-Korrik të vitit 2000 u organizua dhe përfundoi konkursi dhe procesi për marrjen në punë të specialistëve, ndihmëskomisionerëve dhe personelit tjetër ndihmës.

Me qëllim që Institucioni të ndërtohej e funksiononte mbi baza ligjore, u hartuan dhe miratuan Rregullorja e Brendshme dhe Kodi Etik i Institucionit të Avokatit të Popullit. Ndonëse fillimisht kushtet dhe ambientet e punës ishin të pamjaftueshme e të papërshtatshme, nisëm nga puna në Qershor 2000, për verifikimin dhe zgjidhjen e ankesave. Mbi bazën e një strategjie të saktë, mbasi identifikuam nevojat, pa humbur kohë u bë rehabilitimi fizik i ambienteve, i cili filloi në fund të nëntorit 2000 dhe përfundoi në shkurt të vitit 2001.

Krahas rehabilitimit dhe paisjeve të zyrave, u mendua dhe për ngritjen, stabilizimin dhe konsolidimin e sistemeve administrative e menaxhuese të institucionit, vendosjen e politikave e procedurave lidhur me shërbimin kundrejt ankuesve, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe kualifikimin e tyre të mëtejshëm. Në këtë kuadër, në Zyrën tone ka përfunduar implementimi i një sistemi modern menaxhimi të rasteve (DOCULIVE), nëpërmjet të cilit mundësohet që informacioni i nevojshëm për çështjet e ankuesve, të regjistrohet në kompjuter. Sipas një procedure që nënkupton një soft të caktuar, informacioni i regjistruar nga personat në proces, ka mundësi të shkëmbehet, kontrollohet e raportohet nëpërmjet kompjuterave.

Me anë të këtij sistemi të punës, në vitin 2002 e në vazhdim, do të jetë i mundur një menaxhim efektiv i kohës së punës, lehtësim dhe orientim i drejtpërdrejtë në morinë e madhe të çështjeve të ankuesve të paraqitura në Zyrën tonë. Ky sistem i vendosur ka siguruar një mirëfunksionim të Institucionit dhe garanton një nivel në rritje të shërbimeve ndaj ankuesve nga Zyra.

Aktualisht po punohet për hartimin e një manuali të politikave dhe procedurave të Zyrës, në të cilin përshkruhet misioni i Institucionit, strukturat përkatëse organizative, menaxhuese e administrative, termat e referencës së tyre, politikat e Zyrës për personelin, trajnimet e përfitimet përkatëse, politikat në lidhje me ankuesit, standartet e përgatitjes së dokumentacioneve përkatëse, procedurat e përdorimit të teknologjisë së Zyrës etj.

Krahas kësaj, për të bërë të mundur njohjen në shoqërinë shqiptare të rolit të Avokatit të Popullit, për të bërë publik informacionin e grumbulluar, dhe për të analizuar zgjidhjet e rekomandimet përkatëse si dhe për gjetjen e mënyrave e mjeteve të duhura për promovimin e përmirësimeve në legjislacion, është hartuar një strategji e marrëdhënieve me publikun (marketing & lobbying). Po kështu, u hartuan dhe strategjitë lidhur me veprimtari të tjera me karakter edukues për komunitetin dhe politika të influencimit, duke përfunduar fazën e ngritjes dhe forcimit të Institucionit. Në funksion të kësaj u konceptua dhe realizua një rrjet promocional që përfshin një komunikim viziv të ri, me qëllim që të zgjerohet kapaciteti i përfitimit të njohurive të publikut të gjerë në lidhje me rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit. Kështu bëhet më i mundur krijimi i një kontakti më të ngushtë të Institucionit të Avokatit të Popullit me Administratën dhe publikun, në një kuadër reciprok.

Institucioni ynë synon që të shërbejë për një zgjidhje profesionale, të shpejtë e objektive të ankesave që parashtrihen tek ai. Kështu që përveç ngritjes, stabilizimit, forcimit e menaxhimit efektiv të kapaciteteve administrative në Institucion, vëmendje prioritare i është kushtuar rritjes së besimit të tij në popull nëpërmjet shërbimit që ofrojmë.

5. Mbështetja ndërkombëtare

Një rëndësi të veçantë ka mbështetja ndërkombëtare e Institucionit, i cili është nën mbikqyrjen koordinuese të OSBE, me asistencën e vazhdueshme të Këshillit të Evropës, Grupit të Miqve të Avokatit të Popullit si dhe nën mbështetjen financiare të Mbretërisë së Danimarkës.

Kjo mbështetje ka qenë konkrete, tepër e pranishme dhe mjaft efiçente. Në grupin e quajtur Miqtë e Avokatit të Popullit, bëjnë pjesë Përfaqësitë e Këshillit të Evropës dhe të OSBE në Tiranë, Ambasadat e Mbretërisë së Danimarkës dhe të SHBA, organizata si USAID, Banka Botërore, ABA-CEELI, CAFOD, QSHDNj etj.

Grupi i Miqve të Avokatit të Popullit, në mënyrë periodike mbledhet në zyrën e Avokatit të Popullit dhe qysh nga fillimi ka ndjekur hap pas hapi ngritjen, forcimin, konsolidimin dhe veprimtarinë praktike të Institucionit, duke dhënë një ndihmë e kontribut të çmuar për mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore si dhe forcimin e demokracisë në vendin tonë. E themi këtë, sepse duke ndihmuar Institucionin tonë, në mënyrë direkte ata, institucionet dhe shtetet që përfaqësojnë, kanë ndihmuar proceset demokratike dhe institucionet e reja që janë garante të demokracisë.

Këshilli i Evropës, si me anë të personelit të zyrës së tij në Shqipëri, ashtu edhe direkt ka dhënë një kontribut të madh, nëpërmjet ftesave për të marrë pjesë në aktivitete të organizuara me temë të drejtat e njeriut, dërgimit të ekspertëve për ekspertiza, mbështetjes financiare etj. Kontribut në këtë drejtim ka dhënë edhe Aba Celli, si dhe Ambasada Amerikane, nëpërmjet përfaqësuesit të saj në Grupin e Miqve. Natyrisht, mbështetjen më të madhe financiare e ka dhënë dhe vazhdon ta japë Mbretëria e Danimarkës, me anë të projektit Danida dhe pjesëmarrjes aktive në Grupin e Miqve të Këshilltarit të Ambasadës, zotit Soren Knudsen. Zyra e Ombudsmanit Danez ka kontributin më të madh në asistencën e saj me dhënien e përvojës dhe trajnimin e stafit tonë.

Kemi përmendur edhe ne raportin e vitit të kaluar ndihmen vendimtare të Ambasadës së Mbretërisë së Danimarkës në vendin tonë, e cila nëpërmjet projektit Danida, në kuadër të marrëveshjes së dy qeverive tona, të nënshkruar në Kopenhagen në korrik 1999, ka përballuar një pjesë të madhe të kostos financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri. Në bazë të Projekt Dokumentit të nënshkruar “Për “Ngritjen, forcimin dhe konsolidimin e kapaciteteve administrative, menaxhuese dhe profesionale të Institucionit të Avokatit të Popullit”, procesi i asistencës do të vazhdojë deri në Qershor 2002. Këshilli i Evropës, nga ana e tij ka shprehur angazhimin e vet për mbështetjen financiare dhe me ekspertize të institucionit tone, duke synuar që Avokati i Popullit të zërë sa më shpejt vendin e vet brenda administratës shqiptare.

Prezenca e OSBE në Grupin e Miqve ka luajtur rolin e saj pozitiv, në planin politik, për të ndihmuar, monitoruar dhe vlerësuar institucionin tonë qysh në hapat e para, rol i cili është mirëpritur dhe vlerësohet nga ana jonë.

6. Buxheti i Institucionit për vitin 2001

Për të krijuar, ndërtuar e funksionuar me efikasitet një institucion të ri, siç është Avokati i Popullit, kërkohet jo vetëm mbështetje politike, institucionale, potenciale njerëzore, por edhe financiare.

Nga kjo pikëpamje, mbështetja financiare për Institucionin tonë nga Komuniteti Ndërkombëtar dhe sidomos nga Qeveria Daneze, nëpërmjet projektit Danida, ka qënë prezente, konkrete dhe efektive. Kjo ndihmë ka mundësuar ngritjen dhe forcimin e Institucionit dhe krijon mundësinë për realizimin e detyrave .

Një konceptim i drejtë ka ekzistuar edhe nga Qeveria Shqiptare, e cila për vitin 2000 miratoi një buxhet prej 36.500.000 lekë ose rreth 250.000 USD, kurse për vitin 2001 Kuvendi miratoi buxhetin në shumën 83.567.000 leke ose 584.385 USD, i cili për periudhën objekt raportimi është konsumuar në masën 80% e konkretisht:

Nr . Llog	Emertimi.	Plan leke.	Realizim leke.	Realizim %
600	Pagat	25.000.000.	23.866.552	95.4 %
601	Sigurim Shoqëror	5.730.000	3.979.959	69.4 %
602	Shp operative	42.635.000	29.105.599.	68.2 %
605	Kuotë antarësie	200.000	179.177	89.5 %
231	Investime	10.000.000	9.641.847	96.4%
	Totali	83.567.000	66.773.134	80 %

Përsa u përket shpenzimeve të buxhetit, ato janë përdorur kryesisht për pagat e punonjësve, dieta brenda dhe jashtë vendit, blerje kancelarie, materialesh e mjetesh pune, karburante, shpenzime për energji elektrike, impulse telefonike, pritje të delagacioneve të huaja etj. Gjithashtu, kemi paguar kuotat e antarësisë në Institutin Evropian të Ombudsmanëve, Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanëve, dhe Shoqatën e Ombudsmanëve Frankofonë. Kjo pagesë ka qënë rreth 1.200 USD në vit.

Me mbështetjen financiare të Projektit Danida, gjatë vitit 2000 dhe 2001, Institucioni i Avokatit të Popullit ka përfunduar rikonstruksionin e zyrave, blerjen e pajisjeve dhe të një sistemi mjaft të përparuar kompjuterik si dhe ka realizuar mjaft specializime tekniko profesionale të stafit. Vlera totale e ndihmës Daneze deri në fund të viti 2001 ka qënë rreth 600.000 USD.

Mbështetja financiare për Institucionin tonë besojmë se do vazhdojë. Siç është theksuar në konkluzionet e Konferencës së Lubjanës, organizuar nga Këshilli i Evropës në nëntor 2001:

“Është e rëndësishme të mbahet e të forcohet pozicioni i pavaruar i Ombudsmanit në lidhje me degët e tjera të pushtetit. Në lidhje me këtë,

pavarësia financiare e Ombudsmanit nuk është më pak e rëndësishme, meqënëse në disa vende, puna efektive e Ombudsmanit është bërë e pamundur nga kufizimi i fondeve. Kështu pra, është e rëndësishme për Ombudsmanin që ai të mund të propozojë në mënyrë të pavaruar buxhetin e tij. Dispozitat ligjore për përcaktimin e parimeve të shpërndarjes së buxhetit, duke përfshirë edhe rrogën e Ombudsmanit, duhet të përfshihen në ligjin mbi Ombudsmanin, për garantimin e stabilitetit të institucionit”.

7. Vështirësitë e Institucionit dhe shkaqet e tyre

Në kushtet e një vendi në tranzicion dhe pa traditën e institucioneve demokratike, institucione të tilla kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç është ai i Avokatit të Popullit, kanë ndër të tjera detyrën e vështirë të krijimit të legjitimitetit të tyre si për Qeverinë dhe autoritetet, ashtu edhe për publikun.

Në këtë këndvështrim janë parë dhe vështirësitë që ka hasur Institucioni ynë gjatë ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tij. Ndër vështirësitë kryesore do të veçonim:

1- Mospërshtatjen në shkallën e duhur të Administratës Publike me rekomandimet e Avokatit të Popullit, të cilat për nga natyra, janë parashikuar të jenë sfiduese të vendimeve të saj.

2- Mosndërgjegjësimi sa duhet i Administratës Publike Shqiptare për t’u angazhuar seriozisht në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

3- Mungesën e familjarizimit të Institucioneve Shtetërore tradicionale ekzistuese me praninë dhe veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit, si organ kontrolli të jashtëm, në rastet e shkeljes së të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në Shqipëri.

4- Mosvendosjen e kontakteve të rregullta të bashkëpunimit ndërmjet hallkave përkatëse të të gjitha niveleve të Zyrës së Avokatit të Popullit me zyrat e organeve dhe autoriteteve publike.

5- Legjislacioni vazhdon të jetë shumë dinamik dhe kjo ka bërë që të ketë vështirësi në implementimin e ligjeve të reja, ku do të veçonim Ligjin nr. 8485 dt. 05.12.1999 “Për Kodin e Procedurave Administrative”, Ligjin nr. 8549 dt. 11.11.1999, “Për Statusin e Nëpunësit Civil”, Ligjin nr. 8503, dt. 30.06.1999, “Për të Drejtën e Informimit me dokumentet zyrtare”. Nuk është insistuar sa duhet për probleme shumë të rëndësishme, si ato të rregullimit ligjor të pronës dhe kompesimit të saj, të cilat prekin një numër të madh të qytetarëve.

6- Boshllëqet ligjore, që pengojnë Avokatin e Popullit, në zgjerimin e sferës së juridiksionit të tij, fjala vjen, mungesa e së drejtës për të kryer inspektime në vende ku të drejtat e njeriut çënohen eventualisht më shumë, si burgje, komisariate policie, spitale psikiatrike etj.

8. Ku i mbështesim arritjet e deritanishme të Institucionit

1-Pavarësia e garantuar nga Kushtetuta dhe parimet ndërkombëtare të punës së Ombudsmanit si dhe paaësia në ushtrimin e funksioneve të Avokatit të Popullit kanë krijuar parakushtet që të rritet besueshmëria si para publikut, ashtu edhe tek autoritetet e Administratës Publike.

2-Mbështetja e deritanishme nga ana e të gjitha Institucioneve Qeveritare Shqiptare për nevojat dhe veprimtarinë e Institucionit tonë, që e dijnë mire se një nga kushtet e Kartës së Kopenhagenit për anëtarësim ose pezullim nga Bashkimi Evropian është “respektimi dhe stabiliteti i institucioneve garantuese të demokracisë, të sundimit të ligjit, të të drejtave të njeriut dhe të mbrojtjes së pakicave”. Dhe Avokati i Popullit është një institucion që garanton demokracinë, pasi ai ndihmon për forcimin e konceptit të një shteti të së drejtës.

3-Duke qenë se Institucioni i Avokatit të Popullit në Shqipëri është ideuar dhe rekomanduar të përfshihet në Kushtetutën e Shqipërisë nga Faktori Ndërkombëtar, mbështetja ndërkombëtare që është bërë dhe vazhdon të bëhet për këtë institucion, është një avantazh me peshë të madhe.

4-Cilësitë profesionale të stafit, kërkesat në rritje për standarte më të larta në punën tonë, përkushtimi total për të treguar se “dijmë të ndërtojmë një institucion demokratik nga fillimi”.

9. Sfidat, objektivat e Institucionit për vitin 2002 e në vazhdim

Që në fillim të ushtrimit të veprimtarisë sonë, kemi synuar të ngrejmë një institucion të pavarur shërbimi për qytetarët, të drejtat e të cilëve janë shkelur nga Administrata Publike, duke ndjekur çështjet rast pas rasti, rekomanduar masa administrative dhe dhënë opinione për parandalimin e shkeljeve nga Administrata Publike në të ardhmen. Disa nga drejtimet e punës që ne kemi zbatuar për të realizuar sa më sipër kanë qenë: dhënia e ndihmës ligjore nëpërmjet rekomandimeve dhe këshillave në rastet e konflikteve midis administratës dhe publikut, zbulimi i defekteve të administratës, denoncimi i sjelljeve të këqia të nëpunësve kundrejt qytetarëve, presioni për ndryshimin e procedurave të rënduara dhe të paqarta të Administratës Publike, krijimi i kushteve që qytetarët të

gëzojnë liritë e tyre në marrjen e informacioneve të nevojshme nga Administrata Publike, si dhe nxitja e transparencës së kësaj të fundit në veprimtarinë e saj.

Në funksion të këtij synimi, mendojmë se në të ardhmen duhet t'i kushtojmë vëmendje të veçantë ndër të tjera:

1-Konsolidimit të arritjeve të deritanishme, me synim rritjen e shifrës së efektshmërisë së ndërhyrjeve të Institucionit tonë për zgjidhjen e ankesave të qytetarëve.

2-Bashkëpunimit më efikas me Parlamentin për të bërë ndryshimet e nevojshme ligjore, që do të sillnin një efikasitet më të madh të Zyrës së Avokatit të Popullit.

3-Vendosjes së kontakteve më të rregullta dhe më të ngushta me nëpunësit e Administratës Qëndrore dhe Vendore. Për këtë të fundit do të shërbejë edhe caktimi i përfaqësuesve vendorë në Shkodër etj.

4-Vazhdimin të fushatës njohëse në rrugë dhe forma të tjera, si psh. pritje të ankesave në Bashki dhe Komuna, siç u veprua në fshatin Lazarat.

5-Kërkimit dhe justifikimit të vazhdimësisë së mbështetjes, si financiare, ashtu dhe politike, përmes lobimit nga ana e Grupit të Miqve të Avokatit të Popullit, pranë instancave më të larta të shtetit shqiptar.

6-Ndikimit për respektimin dhe stabilitetin e institucioneve shqiptare, që sigurojnë demokracinë dhe prosperitetin, sidomos të paanësisë së gjyqësorit.

7-Bërjes së njohur publikisht të problemeve kryesore të evidentuara në fushën e të drejtave të njeriut nga shkeljet e Administratës Publike, si dhe ushtrimin të një "presioni pozitiv" ndaj Qeverisë e Parlamentit Shqiptar për përmirësime të legjislacionit dhe zbatimit më të mirë të tij.

10. Strategjia për të ardhmen e Institucionit

Ne konstatojmë se ekziston dhe do të vazhdojë angazhimi politik dhe financiar i Parlamentit dhe Qeverisë Shqiptare për të mbështetur Avokatin e Popullit, si një institucion i tipit modern, që luan një rol të rëndësishëm në proceset demokratike në vend.

Gjatë dy viteve të veprimtarisë nuk kemi konstatuar të ketë patur kritika të drejta për njëanësi partiake, sepse po nuk u ruajt paanësia, mund të bëhemi objekt i kundërshtive politike. Me profesionalizëm dhe vlerat e larta etike, ne do vazhdojmë të shmangim këtë, duke mbajtur kështu paanësinë politike. Por paqëndrueshmëria politike e vendit mund të jetë një rrezik për Avokatin e Popullit dhe stafin e tij,

Moskryerja në kohë e aktiviteteve për rritjen e kualifikimit të stafit mund të ulë moralin e stafit e në rastin më të keq mund të sjellë largimin e tij. Për këtë arsye, planet tona po i rishikojmë, ato duhen vazhduar, me qëllim që të rriten standartet bashkëkohore të drejtimit të institucionit.

Është evidente se është rritur shumë në vitin 2001 numri i qytetarëve që kanë kërkuar shërbimin e Avokatit të Popullit. Praktikrat pozitive dhe mesazhet e mira të shpërndara në popull, kanë krijuar atmosferën dhe ndërgjegjësimin e nevojshëm, që qytetarët shqiptarë të përdorin mekanizmin tonë për mbrojtjen e të drejtave të tyre nga shkeljet e Administratës Publike.

Me anë të një dialogu midis Institucionit të Avokatit të Popullit, organizatave të të drejtave të njeriut dhe Parlamentit e Qeverisë e Shqiptare, ne do vazhdojmë të inkurajojmë autoritetet për të ndër marrë përmirësime të legjislacionit dhe zbatimit të tij. Kjo nxjerr në pah rolin e rëndësishëm të Avokatit të Popullit në fushën e transformimeve demokratike dhe justifikon nevojën për ekzistencën e një institucioni të tillë për një kohë të gjatë. Gjithashtu do të inkurajojmë autoritetet për disa plotësime në Ligjin “Për Avokatin e Popullit”, me qëllim që t’i vijmë më tepër në ndihmë publikut.

Strategjia për jetëgjatësinë bën pjesë në procesin e forcimit dhe rritjes së Institucionit, rolin e impakteve të tij në shoqëri. Mirëmbajtja e burimeve të brendshme, përdorimi i tyre në bazë kriteresh të drejta, kujdesi për trajnimin e vazhdueshëm e motivimin e stafit dhe mirëadministrimi formojnë një bazë të mirë për jetëgjatësinë dhe suksesin e Institucionit.

Natyrisht, jemi të vetëdëshëm se kemi edhe mjaft të meta e mangësi, se punojmë në një fushë të re, pa përvojë, prandaj do të përpiqemi të përmirësojmë metodën e veprimtarisë, të zbatojmë me kujdes vërejtjet e sugjerimet që do të na bëhen, për të zgjidhur sa më drejt ankesat dhe kërkesat e njerëzve, duke mbrojtur kështu të drejtat dhe liritë e tyre themelore.

Krahas objektivave që kemi prezantuar dhe në Raportin e vitit 2000, të cilat janë afatgjatë, këtej e tutje vëmendja dhe burimet intelektuale të Zyrës sonë, do të përqendrohen tek disa strategji preventive, ndër të cilat më efektivet janë edukimi dhe trajnimi në fushën e të drejtave të njeriut. Kjo shprehet në një sërë veprimesh që ne kemi bërë e do të bëjmë si: përhapje informacioni, zbatim programesh trajnimi, seminare me grupe të ndryshme të interesit, si dhe me përfaqësues të administratës, OJQ-ve. Njëkohësisht, nuk do të lëmë mënjanë dhe zhvillimin e strategjive praktike për një edukim efektiv në sfera të tilla kritike, siç janë trajnimet për policinë, burgjet, forcat ushtarake etj.

KREU I DYTE

1. Statistika përmbledhëse e vitit 2001

(Rastet sipas fushave përkatëse dhe mënyra e përfundimit të tyre)

Avokati i Popullit ka zhvilluar normalisht dhe me efektivitet veprimtarinë e tij, duke krijuar ndër të tjera dhe një sistem të gjerë statistikor. Të dhënat statistikore kanë krijuar infrastrukturën e informacionit për të gjithë Zyrën e Avokatit të Popullit. Ne jemi udhëhequr nga parimi se pa statistika të plota e të sakta, nuk mund të ketë organizim dhe drejtim shkencor të punës dhe si rrjedhojë as objektivitet dhe perspektiva për Institucionin.

Është thënë dhe më parë se efektiviteti i ngritjes dhe funksionimit të një Institucioni të ri matet në rradhë të parë me volumin e punës për kryerjen e detyrës së tij kryesore: Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të individit, grupeve të individëve apo organizatave joqeveritare ndaj veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme apo të parregullta të organeve të Administratës Publike Shqiptare. Detyrë e rëndësishme për Avokatin e Popullit ka qenë të ndërtojë brenda Institucionit një sistem të atillë që të jetë i gatshëm në çdo kohë e pa pengesa për qytetarët që vijnë për ankesa apo kërkesa dhe t'i bëjë ata të ndjehen të mirëpritur, siç duhet dhe të përfitojnë aty për aty ato çfarë kanë të drejtë të presin prej administratës. Për këtë, janë adoptuar prej nesh modele të zyrave të tjera homologe në Evropë, për të rritur shërbimin ndaj qytetarëve në zyrën tonë. Kështu që në qershor 2001, ka filluar funksionimin Zyra e Pritjes së Popullit, ku qytetarët në çdo orë të ditës, gjatë orarit zyrtar, mund të paraqesin ankesat apo kërkesat e tyre dhe të marrin sqarimet e nevojshme nga një ekspert i zyrës. Këtë sistem e kemi adoptuar sipas modelit të Zyrës së Ombudsmanit të Provincës së Katalonjës, në Spanjë. Një punë e tillë ka bërë që të ulet numri i ankesave që janë jashtë juridiksionit dhe kompetencës së Avokatit të Popullit.

Gjatë periudhës 1 janar 2001 – 31 dhjetor 2001, janë trajtuar nga Zyra e Avokatit të Popullit 2194 ankesa dhe 245 kërkesa (duke shtuar ato të Zyrës së Pritjes së Popullit), nga të cilat 209 kanë qenë të mbartura nga viti 2000 dhe janë raportuar si të tilla në Raportin Vjetor 2000. 435 ankesa, ose

20 % e tyre, vazhdojnë të jenë akoma në shqyrtim. Duke krahasuar numrin e ankesave dhe kërkesave të trajtuara në vitin 2001, shihet një rritje rreth 2.5 herë më shumë se viti 2000. (Për saktësi përmendim se në vitin 2000 kemi pritur ankesa vetëm 7 muaj, duke filluar nga qershori 2000). Është e kuptueshme se në rritjen e numrit të ankesave e kërkesave të trajtuara nga Zyra jonë, një rol të rëndësishëm ka luajtur dhe fushata e njohjes dhe sensibilizimit të Institucionit të Avokatit të Popullit, e cila është përshkruar në kapitullin përkatës të këtij Raporti.

Kështu, nga trajtimi i ankesave ka rezultuar se 710 prej tyre, ose 40 % kanë qenë jashtë juridiksionit dhe qytetarët janë sqaruar për rrugën që duhet të ndjekin për zgjidhjen e problemit që ata kanë prezantuar tek ne. Nga ankesat që kanë qenë brenda juridiksionit dhe kompetencës së Avokatit të Popullit, 617, ose 35 % e tyre janë gjetur të padrejta dhe 432, ose 25 % e tyre janë gjetur të bazuara. Për këto të fundit janë bërë dhe rekomandimet përkatëse, drejtuar autoriteteve publike me qëllim që të rritet cilësia e administrimit publik dhe të sigurohen standarte të mirëqeverisjes. Për saktësi sqarojmë se ndër 432 rastet e zgjidhura pozitivisht, jo për të gjitha këto janë bërë rekomandime me shkrim, sepse shpesh herë zgjidhjet pozitive janë arritur që në fazën e marrjes së shpjegimeve apo pas ndërmjetësimit tonë verbal me organet e Administratës Publike, të cilat në këto raste kanë kuptuar gabimet e tyre dhe janë tërhequr nga qëndrimet e para negative. Kuptohet që politikat e drejta duan një bazë të mirë informacioni dhe kjo është patur parasysh nga Avokati i Popullit gjatë administrimit të të dhënave të mësipërme.

Në këtë Raport Vjetor do të prezantojmë rastet e trajtuara nga Zyra e Avokatit të Popullit, të ndara sipas Ministrive përkatëse, dhe organeve apo enteve të tjera të Administratës Publike Shqiptare në vartësi të tyre, ndaj të cilave është drejtuar ankesa apo kërkesa.

Nga ana tjetër, në zbatim të Rekomandimit Nr. R(85) 13 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës, “Mbi Institucionin e Ombudsmanit”, duke marrë në konsideratë që, opinionet e Ombudsmanit mund të bëhen një faktor kryesor në zhvillimin e parimeve dhe normave të përgjithshme që rregullojnë funksionimin e administratës dhe sjelljen e punonjësve publikë, ne shpesh kemi shprehur edhe opinione për fushat përkatëse.

Numri i ankesave, kërkesave dhe njoftimeve të trajtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2001, ka qenë si më poshtë:

1. Këshilli i Ministrave	130	nga të cilat për:
a- Grupin Mbikqyrës të Firmave Piramidale-	17	
b- Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	- 31	
c- Komisionet e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave	- 82	
2. Ministria e Drejtësisë	- 702	nga të cilat për
a- Burgjet	- 126	
b- Zyrat e Përmbarimit	- 104	
c- Gjykatat	- 372	
d- Prokurorinë	- 100	
3. Ministria e Rendit Publik	- 198	
4. Ministria e Mbrojtjes	- 190	
5. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	- 271	nga të cilat për
Vetë ministrinë	- 77	
Organet e pushtetit vendor	- 194	
6. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale-	131	nga të cilat për
a- Institutin e Sigurimeve Shoqërore	- 118	
b- Administrata e Ndihmës Sociale	- 11	
c- Instituti i të Përndjekurve Politikë	- 2	
7. Ministria e Punëve Publike dhe Regullimit të Territorit	- 94	nga të cilat për
- Policinë Ndërtimore	- 71	
8. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimeve	- 69	nga të cilat për
- Vetë Ministrinë	- 20	
- Agjensia Kombëtare e Privatizimit	- 22	
- Korporata Elektroenergjitike	- 21	
- Telekom-in	- 6	

9. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	- 59
10. Ministria e Financave	- 40
11. Ministria e Arsimit	- 26
12. Ministria e Shëndetësisë	- 17
13. Ministria e Punëve të Jashtme	- 10
14. Ministria e Transporteve	- 6
15. Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë	- 2
16. Shërbimet Sekrete	- 12
Të tjera	- 237
TOTALI	- 2194 ankesa

Shih pasqyrat në ankesat e Raportit.

Siç konstaton Raporti i Departamentit të Shtetit të SHBA, për gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri, publikuar më datën 05.03.2002 “Ngarkesa e punës së Avokatit të Popullit vazhdon të jetë në rritje. Kjo sepse publiku është bërë më i ndërgjegjshëm për shërbimet që i kryhen nga ky institucion”.

2. Avokati i Popullit dhe Kuvendi i Shqipërisë

I. Avokati i Popullit e ka të qartë pozitën e tij se si Institucion është krijuar me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë dhe që si person (individ), është votuar po nga ky Kuvend. Por, njëkohësisht e ndjen veten, ashtu siç ka thënë Kryetari i Parlamentit të Mbretërisë së Danimarkës në një intervistë ekskluzive për Televizionin Shqiptar, në vjeshtë 1999 "...krahu i zgjatur i Parlamentit mbi Administratën Publike, me qëllim që gjatë zbatimit të ligjit, të punojë që të arrihen qëllimet e ligjvënësit".

Institucioni i Avokatit të Popullit që nga krijimi i tij dhe në vazhdimësi ka ndjerë kujdesin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për forcimin dhe konsolidimin e tij. Kjo është konstatuar edhe në rastin e miratimit të Ligjit Nr. 8600, datë 10.04.2000 "Për një shtesë në Ligjin për Avokatin e Popullit", i cili përforcoi parimin e rëndësishëm kushtetues të pavarësisë së Institucionit. Gjithashtu, Komisioni i Financës ka mirëkuptuar kërkesat tona për akordimin e një buxheti financiar që të garantojë funksionimin normal të veprimtarisë sonë.

II. Në këtë Raport, ne i bëjmë të ditur Kuvendit se në tre raste i kemi Rekomanduar Qeverisë që të marrë masa për të përgatitur ligje e akte të tjera për të plotësuar detyrime që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

1-Për zbatimin e nenit 181/1 të Kushtetutës për rregullimin e drejtë të çështjeve që lidhen me pronat.

2-Për lidhjen e marrëveshjeve me bashkësitë fetare, siç kërkon neni 10 i Kushtetutës.

3-Për nxjerrjen e ligjit për rehabilitimin apo zhdëmtimin nga aktet apo veprimet e paligjshme të organeve shtetërore, siç i kërkon neni 44 i Kushtetutës.

Gjithashtu kemi kontribuar për ndryshimet e Ligjit "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë, të bëra nga Kuvendi me Ligjin nr. 8840, datë 11.12.2001, që ka rregulluar tre çështje të ngritura nga ne.

Më hollësisht për këto çështje flitet në pjesët përkatëse të këtij Raporti.

Avokati i Popullit ka informuar herë pas here mbi veprimtarinë e tij Kryesinë e Kuvendit. Ka marrë pjesë, kur është ftuar, në diskutime të projektligjeve të ndryshme, si dhe ka dërguar edhe rekomandime për çështje të ndryshme, duke sugjeruar që deputetët e komisioneve parlamentare jo vetëm të informohen për veprimtarinë e opinionet tona por

edhe që të ndërmarrin inisiativën legjislative për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve.

Në këtë drejtim, ne i kemi propozuar me shkrim Komisionit Parlamentar të Ligjeve dhe Çështjeve Kushtetuese në disa raste që të ndërmarrë inisiativën legjislative për ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Procedurës Civile; për ndryshimin e Ligjit “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, për ndryshimin e Ligjit “Për shpalljen e Moratoriumit dhe detyrimeve të pashlyera të ish ndërmarrjeve të tregtisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë kundrejt kreditorëve të huaj” etj.

Rekomandimet apo sugjerimet për këto ligje, sipas rastit, në të njëjtën kohë, ja kemi dërguar edhe Komisioneve të Drejtave të Njeriut dhe Komisionit të Financës dhe Ekonomisë. Gjithashtu i kemi drejtuar edhe Komisioneve për Rendin dhe atij të Mbrojtjes për Ligjin e Gardës së Republikës dhe Ligjin e Sigurimeve Shoqërore Suplementare të Ushtarakëve. Megjithatë del si detyrë për ne që, në të ardhmen, të informojmë më tepër Kuvendin për veprimtarinë tonë, për gjendjen e ligjshmërisë dhe të zbatimit të drejtave të njeriut nga ana e administratës publike shqiptare. Gjithashtu të shfrytëzojmë më tepër mundësinë për të rekomanduar direkt në komisionet parlamentare realizimin e inisiativës së tyre legjislative, në interes të mbrojtjes së drejtave dhe lirive themelore të njerëzve në Shqipëri.

Me këtë rast më lejoni që të vë në dukje se ka patur vend që Komisioni i Ligjeve të vlerësonte më tepër mendimin e Avokatit të Popullit në rastin e diskutimit të ligjit “Për Prokurorinë”, që u miratua në shkurt 2001. Avokati i Popullit theksoi se nuk duhej mohuar në atë ligj e drejta e ankimit që mund të bënte një prokuror, kur ai largohej nga detyra me dekret të Presidentit të Republikës. Ky ishte një kufizim i padrejtë, në kundërshtim me nenin 13 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe aktet e tjera ndërkombëtare. Kështu që kur një prokuror në vitin 2001 u ankua në një gjykatë ndaj largimit të tij nga puna, ajo Gjykatë e përcolli çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese e shfuqizoi dispozitën e lartpërmendur të ligjit për Prokurorinë pikërisht me arsyetimin se shkel rëndë të drejtën themelore të njeriut për t’u ankuar ndaj çdo akti apo vendimi që e konsideron të padrejtë.

III. Gjatë punës praktike të Zyrës së Avokatit të Popullit, ashtu siç doli edhe gjatë seancës parlamentare të datës 1 mars 2001, kur u diskutua rreth Raportit vjetor të këtij Institucioni, kanë dalë disa probleme që bëjnë të nevojshme dhe të domosdoshme disa shtesa e ndryshime në Ligjin “Për Avokatin e Popullit”.

Kështu duhet caktuar një afat 1 ose 2 vjeçar nga ndodhja e shkeljes ose data e vendimit të gabuar të organit të administratës, para mbarimit të të cilit Avokati i Popullit të mund të fillojë procedurën e shqyrtimit, sepse ka ndodhur që Avokatit të Popullit i janë dërguar ankesa që rrjedhin që nga viti 1945.

Gjithashtu duhet rregulluar me ligj të shprehur e drejta e Avokatit të Popullit të hyjë pa autorizim paraprak në vendet ku ka të dhëna se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave të njeriut, si në burgje, spitale psiqiatrike, reparte ushtarake etj. Po kështu, kjo e drejtë është e nevojshme në raste studimesh apo inspektimesh. Vënia e afateve për përgjigjet që duhet t'i jepen Avokatit të Popullit apo pezullimi i akteve në rast se rekomandimet e tij nuk merren në shqyrtim, forcojnë pozitën e Avokatit të Popullit dhe bëjnë më të qartë detyrimin që kanë organet e administratës karshi rekomandimeve të tij. Gjithashtu është i nevojshëm edhe caktimi i masave ndëshkimore kur nxirren pengesa për veprimtarinë e Avokatit të Popullit. Mbase me ligj mund të rregullohet edhe afati i paraqitjes së Raportit Vjetor në Kuvend nga Avokati i Popullit etj.

Këto ndryshime të domosdoshme janë bazuar tek legjislacionet dhe praktikat e punës së Ombudsmanit në Danimarkë, Slloveni, Portugali, Kosovë, Maqedoni, Hungari etj, dhe janë të nevojshme për të forcuar punën e Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njerëzve.

Pikërisht, për këtë qëllim, në Prill 2001, deputetët Pavli Zëri, Ejup Tabaku, Fatri Sinani, Pal Dajçi dhe Banush Gozhdari paraqitën një projektligj “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin “Për Avokatin e Popullit”. Projekti u vu në rendin e ditës për seancat plenare të Kuvendit, për datën 14 maj 2001, por nuk arriti të shqyrtohej për shkak të përfundimit të mandatit të Kuvendit.

Prandaj, duke përfituar nga rasti, Avokati i Popullit ju shpreh falenderimet deputetëve të mësipërm dhe thekson se do të mirëpriste përsëritjen e nismës legjislative për të bërë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme të ligjit tonë.

Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me Kuvendin e Shqipërisë do të vazhdojnë të mbeten prioriteti ynë. Ne besojmë se, ashtu siç është shprehur Kryetari i Parlamentit Danez, Institucioni ynë “do vazhdojë të mbështetet me gjithë zemër, nga të gjitha Partitë politike, që të bëhet një institucion i fortë dhe jo si top pingpongu në dorën e Partive politike...”.

3. E drejta e mirëqeverisjes në shtetin e të drejtës

Sundimi i ligjit ose “rule of law” është një ide shumë popullore sot kudo në botë. Gjithë anëtarët e komuniteteve ndërkombëtare, nënvizojnë rëndësinë që ka kjo ide në shumë fjalime dhe në mbledhje të ndryshme politikanësh, duke e përmendur atë gati çdo ditë dhe duke e bërë si hymnin e tyre. Por gjithsesi shumë pak anëtarë të këtij komuniteti mund të shpjegojnë saktë se çfarë do të thotë sundim i ligjit (rule of law) dhe akoma më shumë të tjerë duket se nuk kanë reflektuar në rëndësinë e zbatimit (implementimit) të këtij parimi.

(Rule of law) duhet të jetë baza kryesore e demokracisë. Pa këtë koncept, fjalët e ëmbla mbi liritë themelore të shtetasve do të ishin të pashijuara në jetën e përditshme. Pa këtë koncept të drejtat dhe liritë themelore nuk do të jenë objekt implementimi dhe shkeljet apo dhunimi i tyre nuk do të jenë të parashikuara për t’u ndëshkuar asnjëherë.

(Rule of law) do të thotë se ligji duhet të udhëheqë, të sundojë mbi pushtetin. Ky është një interpretim i arsyeshëm që ligji të mund të udhëheqë shoqërinë tonë dhe aktivitetin e çdo nëpunësi civil, përfshi këtu çdo Ministër, gjyqtar ose edhe një nëpunës të thjeshtë të administratës. Këta të gjithë duhet që të respektojnë dhe të zbatojnë me korrektësi ligjin. Dhe në qoftë se Ligji është i keq, ai duhet të ndryshohet menjëherë.

Shtresa e popullsisë me nivel të lartë jetese, të pasurit që synojnë edhe pushtetin, dhe që përpiqen të menaxhojnë shtetin pa ndjekur parimin e sundimit të ligjit, dihet se mund të jenë gjithmonë të gatshëm të promovojnë vetëm interesat e tyre. Por parimi i sundimit të ligjit mbron në veçanti popullin e thjeshtë, me nivel të ulët, dhe ju ofron atyre një jetë të rregullt dhe të qytetëruar.

Nëpunësi publik, nuk duhet të ndjekë këshillat e asnjërës nga palët ose rregullat e miqësisë, por duhet që mbi gjithcka që ai kryen të sundojë ligji. Gjithashtu nëpunësi nuk mund e nuk duhet të hiqet si epror ose bos i askujt, sepse ai në detyrë është vetëm për t’ju shërbyer qytetarëve, duke u mbështetur në ligj.

(Rule of law) do të thotë rregull dhe stabilitet në shoqëri. Do të thotë bindje e arsyeshme ndaj vendimeve të autoriteteve. Do të thotë vendime të qëndrueshme dhe të forta. Do të thotë kujdes i përhershëm ndaj diskrecionalitetit që nuk bazohet në ligj. Kjo ka të bëjë edhe atëherë kur një investitor heziton të investojë paratë e tij në një vend, sepse nuk ndihet i sigurtë nëse një shkelje kontrate është parashikuar siç duhet ose jo në ligjin e vendit ku do investojë.

(Rule of law) është simboli i demokracisë moderne evropiane, ku çdo kush është i barabartë përpara ligjit, ku askush nuk mund të jetë mbi ligjin, dhe ku çdokush detyrohet të zbatojë ligjin.

Republika e Shqipërisë, si popull, shtet dhe shoqëri ka shprehur prej vitesh dëshirën për t'u bërë pjestare në familjen e vendeve të Bashkimit Evropian. Tashmë, këtë vit, më tepër se kurrë ndonjëherë, vendi ynë është afruar pranë momentit të nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit (MSA/SAA) me Bashkimin Evropian. Por në listën e Librit të Bardhë dhe në Deklaratën e Kopenhagenit, demokracia, shteti i së drejtës, masat antikorrupsion, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave janë të parat. Bashkë me këto edhe ekzistenca e Institucionit të Ombudsmanit për të ndikuar në mirëqeverisje, për të kërkuar të zbatohet Kodi Evropian i Sjelljes së mirë Administrative. Pikërisht për këtë arsye, Avokati i Popullit bën të njohur se Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian që u shpall në samitin e Nisës, në dhjetor 2000. përmbledh edhe të drejta të tilla themelore për qytetarët, si e drejta për administrim të mirë dhe e drejta për t'u ankuar tek Ombudsmani Evropian ndaj keqadministrimit.

Më 6 shtator 2001, Parlamenti Evropian adoptoi një rezolutë, duke aprovuar Kodin e Sjelljes së Mirë Administrative, të cilin institucionet dhe organizmat e Bashkimit Evropian, administratat dhe zyrtarët e tyre, duhet t'a respektojnë në marrëdhëniet e tyre me publikun.

Kodi ka për qëllim të shpjegojë më në detaje se çfarë kupton në praktikë, Karta e të Drejtës për Administrim të Mirë.

E drejta për administrim të mirë, ndër të tjera parashikon që:

a. Çdo person ka të drejtën për një trajtim të çështjeve të tij apo të saj, në mënyrë të paanshme, të ndershme dhe brenda një kohe të arsyeshme nga institucionet dhe organet e BE-së.

b. Kjo e drejtë përfshin:

-të drejtën e çdo personi për t'u dëgjuar, përpara marrjes së çdo mase individuale, që do të prekë interesat e tij.

-të drejtën e çdo personi për të patur akses në dosjen e tij, duke respektuar ndërkohë interesat legjitime të konfidencialitetit, të profesionalitetit dhe të sekretimit të biznesit.

-obligimin e administratës për të dhënë arsyet për vendimet e saj.

c. Çdo person ka të drejtën e zhdëmtimit nga Komuniteti, ndaj çdo dëmi të shkaktuar nga institucionet e tij ose nga nëpunësit e tij në kryerjen e detyrave të tyre, në përputhje me principet e përgjithshme të ligjeve në shtetet anëtare.

d. Çdo person mund t'i shkruajë institucioneve të BE-së, në një prej gjuhëve të Traktateve dhe duhet të marrë një përgjigje, në të njëjtën gjuhë.

Çdo qytetar i BE-së dhe çdo person fizik apo juridik që ka rezidencën apo ka zyrën e tij të regjistruar në një Shtet Anëtar, ka të drejtën t'i referojë Ombudsmanit të BE-së, çështjet e keqadministrimit në veprimtarinë e institucioneve apo organeve të BE-së, me përjashtim të Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së shkallës së parë, kur këto janë në veprim të rolit të tyre gjyqësor.

Përkufizimi i Ombudsmanit Evropian, për keqadministrimin është se: “.....keqadministrimi ndodh kur një organ publik nuk vepron në përputhje me rregullat dhe ligjet, apo me principin, i cili është i detyrueshëm për të”. Ky përkufizim është aprovuar nga Parlamenti Evropian.

Duke bërë të njohur sa më sipër, nga Raporti ynë mund të nxirret konkluzioni se sa janë të gatshme e të përgatitura organet dhe autoritetet e administratës sonë publike për zbatimin e Kodit të Sjelljes së mirë Administrative.

Autoritetet publike duhet të arrijnë standartet më të larta të aktivitetit të tyre gjatë ushtrimit të detyrës në marrëdhënie me njerëzit. Për t'i bërë sa më të prekshme këto standarte, ata duhet t'i sigurojnë ata se aktiviteti i tyre është i ndershëm dhe i paanshëm ndaj tyre. Në pikat e pasqyruara më poshtë parashtrohet një përmbledhje e udhëzimeve për praktikimin sa më të mirë të detyrës nga të gjithë ata nëpunës, të cilët janë të gatshëm të ushtrojnë një shërbim sa më të mirë ndaj publikut.

Të kesh marrëdhënie korrekte gjatë ushtrimit të detyrës me njerëzit do të thotë të kesh marrëdhënie:

-Të drejta, korrekte dhe pa asnjë zvarritje.

-Rigorozisht të bazuara në ligjet dhe në aktet nënligjore, që përbëjnë bazën ligjore të funksionit që kryen.

-Ndjeshmëri ndaj qytetarëve, duke pasur në konsideratë moshën, aftësitë e tyre për të kuptuar, problemet private që ata kanë dhe ndonjë pamundësi tjetër shëndetësore.

-Të jesh i gatshëm për të ndihmuar, duke thjeshtëzuar procedurat, si në anën formale, ashtu edhe në informacionin që jep për detyrën që kryen, s duke respektuar gjithmonë afatet për detyrat.

-Të kesh përgjegjësi për të mos adoptuar praktika të tilla gjatë punës së tyre, të cilat do të mund të sillnin situata të papëlqyeshme me qytetarin.

Të kesh marrëdhënie të ndershme me qytetarin do të thotë:

-Të trajtosh shtetasit që kanë kushte të ngjashme me të njëjtat mënyra.

-Në rregulloret dhe rregullat që kanë rëndësi për të sanksionuar ndershmerinë në kryerjen e detyrës, të mos aplikohen elemente strikte dhe infleksibël, të cilët mund të krijojnë pabarazi.

-Të evitosh dënime të caktuara, të cilat nuk diktohen nga proporcionaliteti, për të siguruar bindjen me ndërgjegje për zbatimin e dënimeve.

-Të jesh i përgatitur për rishikimin e rregullave dhe procedurave me qëllimin për t'i ndryshuar ato, në qoftë se është e nevojshme.

-Të japësh njoftime të menjëhershme përpara se të ndryshosh rregullat në mënyrë që të vihet në dijeni i interesuari.

-Të kesh një sistem rishikimi të brendshëm (e drejta e Apelimit), me qëllim që vendimet e marra të mund të shqyrtohen përsëri nga persona, të cilët nuk kanë marrë pjesë në vendimin e parë.

-Duhet informuar personat për mënyrën e apelimit, pjesëmarrjen e tyre gjatë këtij procesi etj.

Të kesh marrëdhënie të paanshme me shtetasit do të thotë:

-Të marrësh vendime të bazuara në ligj dhe rregulla dhe jo në fakte që nuk bazohen në to.

-Të shmangësh paragjykimet për personat me ngjyrë, seksin, racën, statusin e tyre, origjinën, gjuhën, kulturën, besimin e tyre etj.

-Të jesh i kujdesshëm në kontrollin e paragjykimeve, për të mos i bërë faktorë në vendimmarrje.

-Të sigurohesh se nëse shërbimet kërkojnë shpejtësi, bazuar në sistemin e prioritetit, gjithë procesi i shërbimit të jetë i hapur dhe transparent.

Duke shqyrtuar Raportin tonë, mund të bëhet krahasimi se si zbatohen këto parime dhe rregulla nga Administrata Publike Shqiptare.

Në rast se do të krahasojmë rregullat e Kodit Evropian të Sjelljes së Mirë Administrative me Kodin tonë të Procedurave Administrative, arrijmë në konkluzionin se ky Kod tashmë ka standartet e duhura për të siguruar një qeverisje të mirë, sa më transparente dhe më afër publikut. Nga kjo, ne kemi theksuar dhe theksojmë se ky kod duhet të njihet në mënyrë që të sigurohet zbatimi i tij dhe si pasojë veprimtaria e organeve të administratës të karakterizohet nga parimet e mirëadministrimit.

4. Avokati i Popullit dhe Antikorrupsioni

Korrupsioni i çdo segmenti të pushtetit është pengesa kryesore për demokratizimin dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve, prandaj Avokati i Popullit, duke ndikuar në mirëqeverisje, vepron njëkohësisht si faktor parandalues i sjelljes korruptive të administratës ose autoritetit publik.

Këndvështrimi i Avokatit të Popullit është se korrupsioni shprehet në çdo veprim apo mosveprim të nëpunësit civil, mjaft që këto sjellje të bien ndesh apo të shprehin indiference ndaj zbatimit të ligjit, në favor të krijimit të përfitimeve personale apo për llogari të të tretëve.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se shërbimet publike ndaj qytetarëve shpesh janë monopole, në kuptimin që qytetari, në shumë raste, nuk ka zgjidhje tjetër, vetëm se t'i drejtohet Administratës për të marrë shërbimin që ka nevojë, por që autoriteti publik paguhet për t'ia ofruar.

Avokati i Popullit disa herë ka kërkuar publikisht dhe institucionalisht që ligje të tilla, si Kodi i Procedurave Administrative dhe Ligji për Informimin lipset të jenë Bibla në punën e përditshme të administratës shqiptare. Çdo sistem antikorrektiv s'mund të konceptohet ndryshe, veçse mbi bazën dhe duke kërkuar për zbatim këto dy ligje.

Në funksion të një mirëqeverisjeje sa më transparente dhe të hapur për publikun, Avokati i Popullit, qysh në fillimet e tij, i ka kushtuar një rëndësi të madhe zbatimit të Ligjit për të Drejten e Informimit. I veshur me cilësinë e kujdestarit të këtij ligji, Avokati i Popullit u ka dërguar një rekomandim të gjitha organeve të administratës qendrore dhe vendore, përmes të cilit kërkon nxjerrjen dhe afishimin e rregulloreve përkatëse, në zbatim të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Ne kemi përcaktuar si prioritare për këtë vit, angazhimin tonë për rritjen e shërbimeve publike dhe kujdesin për zbatimin sa më efikas në praktikë të Ligjit për të Drejtën e Informimit. Kodi i Procedurave Administrative dhe ky ligj janë dy ligje të rëndësishëm që plotësojnë njëri tjetrin, sepse mundësojnë që qytetari të ndërgjegjësohet për shërbimet që pret nga administrata, sikundër kjo e fundit të ndërgjegjësohet se e ka për detyrë dhe madje shkel ligjin, nëse nuk ja ofron ato qytetarit.

Ne jemi të ndërgjegjshëm dhe realistë për vështirësitë që dalin kur flitet për vërtetimin e korrupsionit si vepër penale, kur rastet i marrin prokuroria apo gjykatat. Megjithatë, Avokati i Popullit ka ndërhyrë me rekomandimet e tij në ato raste, kur nga shqyrtimi i ankesave apo kërkesave ka dyshime të bazuara se ka elemente korrupsioni.

Disa rekomandime, që Zyra e Avokatit të Popullit ka bërë lidhur me ankesa, verifikimi i të cilave ka ngjallur dyshimin për praninë e elementeve korruptive, po i japim si më poshtë:

1. Rekomandimi i datës 04.05.2001, drejtuar Prokurorit të Rrethit Sarandë, dhe më pas edhe Prokurorit të Përgjithshëm, për fillimin e hetimit të çështjes penale në ngarkim të shtetasit H. H., përgjegjës i INSIG-ut, Dega Sarandë, për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare, e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Ankesa është bërë nga shtetasi R. T., nga Saranda. Rekomandimi është pranuar dhe çështja është në hetim.

2. Rekomandimi i datës 03.07.2001, për fillimin e hetimit në ngarkim të Drejtorit të Ndërmarrjes Komunale Banesa Tiranë, për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Rekomandimi është pranuar, çështja është në hetim.

3. Rekomandimi i datës 10.10.2001, drejtuar Prokurorit të Rrethit Përmet, për fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit E. Th., ish Kryetar i Këshillit të Rrethit Përmet, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ankesa është bërë nga shtetasi M. F., nga Përmeti. Rekomandimi nuk është pranuar, sepse Prokuroria e Rrethit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi mendon se mungon dëmi ekonomik. Vendimin e saj e kemi ankimuar tek Prokurori i Përgjithshëm.

Në rastet e mësipërme, prania e elementeve korruptive është konstatuar sidomos në zvarritjet dhe falsifikimet, nga të cilat del qartë tendenca për të ndryshuar tërësisht thelbin e fakteve, në favor të personave të tyre dhe në dëm të qytetarëve, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat. Është e qartë ligjërisht se Avokati i Popullit nuk mund të prezumojë fajësinë ose pafajësinë e personave të përmendur në rekomandimet e tij. Kjo është një e drejtë ekskluzive e gjyqësorit. Avokati i Popullit, në rastet e mësipërme, vetëm se ka shprehur dyshimet e bazuara të tij, që kanë rezultuar pas investigimit përkatës të rasteve dhe mbledhjes së provave, me qëllim rivendosjen e të drejtës së shkelur të qytetarëve.

Në kuadrin e angazhimeve që shteti dhe shoqëria shqiptare kanë marrë përsipër në luftën kundër korrupsionit, Avokati i Popullit ka dhënë kontributin e tij modest, si në kuadrin e Aleancës Antikorrupsion, e sponsorizuar nga USAID, ashtu edhe duke marrë pjesë si vëzhgues në Bordin e Njësisë Permanente Antikorrupsion, të ngritur pranë Qeverisë shqiptare.

Duke qenë një instancë kombëtare, me rol ndërmjetësues midis administratës publike dhe shoqërisë civile, Avokati i Popullit është munduar që, minimalisht, të luajë rolin e enës komunikuese midis tyre.

Nga njëra anë, kemi mbajtur kontakte institucionale me përfaqësuesit e USAID-it, në kuadrin e bashkëpunimit me Grupin e Miqve, ç'ka do të thotë i kemi marrë shqetësimet e tyre, duke ndërhyrë me opinionet dhe rekomandimet përkatëse. Këtë e kemi bërë edhe me rastin e tenderimeve apo privatizimeve të mëdha, për të cilat kemi sugjeruar dhe vazhdojmë të sugjerojmë domosdoshmërinë e rritjes së transparencës gjatë procesit në vazhdim.

Nga ana tjetër, kemi dhënë kontributin tonë pranë Njesisë Permanente Antikorrupsion, si në përmirësimin e Matrices Antikorrupsion, ashtu edhe në kuadrin global të kësaj lufte (legjislacionit, institucioneve, mekanizmave etj), tashmë të pasqyruara edhe në pyetësin që Njesia e Monitorimit të Antikorrupsionit ka përgatitur në kuadrin e GRECO-s, (Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit, në kuadrin e Këshillit të Evropës).

Pavarësisht nga legjislacioni i miratuar dhe strukturat përkatëse për zbatimin e tij, Avokati i Popullit është i ndërgjegjshëm se, kur vjen problemi në praktikë, vazhdimisht ka dhe do të ketë hapësira për veprime korruptive. Sikundër thotë një fjalë e urtë angleze: “Ne mund ta dërgojmë kalin tek lumi, por nuk e kemi në dorë, nëse ai do të pijë ujë”. Në këtë kuptim, ne mendojmë se konsolidimi i sistemit të karrierës dhe stimulimi ekonomik i nëpunësve civilë janë faktorë stimulues për rritjen e përgjegjësisë së Shërbimit Civil. Nga ana tjetër, Avokati i Popullit ndan mendimin se i tërë makrosistemi i funksionimit të gjërave në një shtet nuk mund të realizohet pa funksionimin e dhjetra mikrosistemeve të veprimtarisë administrative. Në këtë kuptim, sugjerojmë se korrupsioni luftohet më mirë qysh në zanafillën e tij, duke konsideruar dhe përmiresuar fillimisht e në vazhdimësi, fjala vjen, sistemin e blerjes së pajisjeve, sistemin e ngritjes në detyrë, etj, pa folur më pas për sistemet e mëdha, sikundër paraqiten procedurat për privatizimet e ndërmarrjeve të mëdha ose strategjike, si Telekom, KESH etj, ku kontrolli parlamentar mendojmë se është i pazëvendësueshëm. Më konkretisht, për këta duam të sugjerojmë që, për kontratat e mëdha të këtyre objekteve për privatizim, sipas përvojës pozitive botërore, Parlamenti nuk duhet të lërë asnjë klauzolë të bardhë. Pra, e thënë më qartë, nuk duhet t'i lërë në dorë ekzekutivit të përcaktojë asnjë kusht të kontratës. Natyrisht, Qeveria bën propozimet, por miratimin e tyre ta bëjë Parlamenti. Transparenca e Parlamentit nuk lejon asnjë shfaqje apo tendencë që korrupsioni të fitojë terren, mbi të cilin zyrtarët, sado të besuar apo lart të jenë, të mund të shesin për të mbushur xhepat e tyre. Shfaqjet e vitit 2001, kur lufta kundër korrupsionit u spostua në “vathën e tjetrit”, mendojmë se tregoi që anëtarët e Kuvendit të Shqipërisë

nuk mund të bien lehtë pre e fushatave moralizuese, por kërkojnë që lufta të fillojë në “vathën tënde”.

Përfundimisht dhe në shprehje të angazhimit tonë të vazhdueshëm në luftë kundër korrupsionit, ne konkludojmë se, nëse korrupsionin banal e të sipërfaqshëm të faturistëve të energjisë elektrike, policëve të trafikut, doganierëve etj, mund ta godasim me masa ndëshkimore të reagimit të shpejtë (zhdëmtim civil, dënime penale apo administrative), korrupsionin që zë shtetin duhet ta luftojmë që në rrënjët e tij në sistem. Ajo që mbetet jashtë çdo lloj moralizimi është se korrupsioni nuk luftohet me fushata. Nëse nuk ka vend për ndonjë shenjë kompromisi në një luftë, kjo është lufta kundër korrupsionit, e cila vazhdon sa të jetë shteti.

Zoti Daniel Jacoby, Sekretar i Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit në një konferencë për të ardhmen e Ombudsmanit, ka deklaruar: “Ombudsmani mund të ketë për mision, nëse nuk ekzistojnë institucione të specializuara në vendin e tij, të luftojë korrupsionin, frenuesin më të madh të demokracisë dhe të respektimit të të drejtave të njeriut. Nëse në vendin e tij egziston tashmë një institucion, i cili e ka këtë mandat, ai atëherë duhet të sigurohet nëse ky institucion po e luan me efektshmëri rolin e tij dhe është i pajisur me pushtetin dhe mjetet e nevojshme”.

Avokati i Popullit në Shqipëri i ka përcaktuar detyrat e tij në luftën kundër korrupsionit mbi bazën e këtyre ideve dhe problematikës shqiptare.

5. Avokati i Popullit dhe Gjykata Kushtetuese

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ndër subjektet që kanë të drejtë të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese përfshihet edhe Avokati i Popullit.

Por, sipas nenit 134 të Kushtetutës, subjektet që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese ndahen në dy grupe: në subjekte që mund të ushtrojnë kërkesë në mënyrë të pakushtëzuar dhe në subjekte, që mund të ushtrojnë kërkesë të kushtëzuar “vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre”. Ky dallim, del nga përmbajtja e pikës 2, të nenit 134 të Kushtetutës dhe në këtë kategori subjektësh që mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë të kushtëzuar, përfshihet edhe Avokati i Popullit.

Përcaktimi nëpërmjet interpretimit, të rrethit të çështjeve që përbëjnë “interesa të Avokatit të Popullit”, në momentin kur sapo filluam punën, paraqiste rëndësi për funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit. Prandaj në muajin qershor 2000 ju drejtuam Gjykatës Kushtetuese me

kërkesë për të bërë interpretimin se çfarë kuptohet me “çështje që lidhen me interesat e Avokatit të Popullit”.

Në përputhje me kompetencat e saj, Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.49, dt.31.07.2000, vendosi që “Avokati i Popullit ka të drejtë të parashtojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, për pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën, dhe për interpretimin e Kushtetutës, gjithnjë kur çështja lidhet me interesat e tij. Gjithashtu Avokati i Popullit mund të bëjë kërkesë për çështje që lidhen me funksionin e tij në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, kur këto janë shkelur nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike e të konstatuara nga Avokati i Popullit, si dhe kur janë cënuar rregullat kushtetuese për organizimin dhe funksionimin e institucionit të tij”.

Ne jemi të kënaqur me këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese sepse nuk e kufizon të drejtën tonë për të realizuar detyrën për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut. Këtë të drejtë për t’ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese e parashikon edhe gërma “c” e nenit 24 të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, e cila përcakton se “Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, Avokati i Popullit ka të drejtë:.....

c) T’i rekomandojë Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e akteve të tilla”.

Ne e kemi zbatuar të drejtën tonë në tre raste për të bërë kërkesa në Gjykatën Kushtetuese. Rasti i çështjes së mëposhtme, është pasqyruar në Raportin e vitit 2000, por vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i vitit 2001.

a. Një shtetas shqiptar, ish pronar trualli, me anë të letrës së tij, është ankuar se VKM nr.119 datë 18.03.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë” i ka kufizuar atij dhe ish pronarëve të tjerë, në kushte të barabarta me të, një nga të drejtat themelore të njeriut, atë të ushtrimit të së drejtës së pronës së tij të ligjshme.

Gjykata Kushtetuese, pasi e shqyrtoi këtë kërkesë, me vendimin nr.26, datë 24.04.2001, vendosi pranimin e kërkesës sonë dhe shfuqizimin si antikushtetues të pikës 1, shkronja “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive që veprojnë në

sektorët jo strategjikë”, si dhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.438, datë 14.08.1995 “Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare”, vetëm për pjesët ku ato shprehen: E para, “dhe çmimit të truallit të përcaktuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.06.1994” dhe e dyta, “... në përpjestime që i përgjigjen çmimit të truallit të njohur në bazë të Vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.06.1994”.

Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese është përshëndetur nga opinioni publik, sidomos nga ana e ish pronarëve të trojeve ku janë ngritur objektet shtetërore që po privatizohen. Nga ana tjetër, ky vendim ka rëndësi sepse përbën një bazë kushtetuese për gjithë legjislacionin që duhet të ndryshohet nga Kuvendi i Shqipërisë, për të zbatuar pikën 1 të nenit 181 të Kushtetutës që e detyron Kuvendin që “brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, të nxjerrë ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41”. (Garancitë për mbrojtjen e të drejtës së pronës private).

Ministria e Ekonomisë dhe Privatizimit na dërgoi një projekt vendim të Qeverisë për rregullimin e problemeve sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Mendimi ynë është se ka edhe Vendime të tjera të Qeverisë që duhen rregulluar në frymën e këtij Vendimi të Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu shpresojmë që edhe projektligjet që ka përgatitur Qeveria, në zbatim të nenit 181/1 të Kushtetutës, të miratohen duke patur parasysh këtë frymë për respektimin deri në fund të të gjitha të drejtave themelore të asaj shtrese të madhe të njerëzve që përbëjnë ish pronarët.

b. Siç kemi parashtruar në pjesën për ankesat ndaj Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, ne paraqitëm një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për të shfuqizuar si antikushtetues një pjesë të ligjit nr.8377, datë 22.07.1998 “Për shpalljen e moratoriumit për detyrimet e pashlyera të ish ndërmarrjeve të Tregësitë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë kundrejt kreditorëve të huaj”.

Për fat të keq, Gjykata Kushtetuese nuk ju fut themelit të çështjes, për të shqyrtuar pretendimin tonë se ky ligj shkel të drejtat e subjekteve juridike (që vlejné njëlloj si për ato të njerëzve, për aq sa përputhen, sipas nenit 16/2 të Kushtetutës sonë). Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.178 datë 08.11.2001 nuk pranoi kërkesën tonë për “mungesë legjitimiteti”.

Avokati i Popullit i zbaton vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por kjo bindje nuk ja heq të drejtën që të shfaqë mendimet e tij për elementet juridike të çfarëdolloj ligji apo vendimi gjyqësor, në kuadrin e diskutimit akademik. Këto opinione ne vlerësojmë se duhet t’i themi edhe në zbatim

të Rekomandimit nr. R(85) 13 të Komitetit të Ministrave të shteteve anëtarë të Këshillit të Evropës “Mbi institucionin e Ombudsmanit”, i cili “duke marrë në konsideratë që opinionet e ombudsmanit mund të bëhen një faktor kryesor në evolucionin e parimeve dhe rregullave të përgjithshme që rregullojnë funksionimin e administratës dhe sjelljen e punonjësve publikë, u Rekomandon qeverive të shteteve anëtare, (b) të marrin në konsideratë kur është rasti, veshjen e Ombudsmanit me kompetencat, brenda kompetencës së tij të përgjithshme, për t’u dhënë konsiderata të veçanta çështjeve të të drejtave të njeriut nën vëzhgim të tij dhe të fillojë hetime dhe të japë opinione kur kemi një përfshirje të problemeve mbi këto çështje... dhe (c) të marrin në konsideratë zgjerimin dhe forcimin e pushteteve të ombudsmanit në mënyra të tjera që të inkurajojnë një vëzhgim efektiv të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në funksionimin e administratës”.

Pra, opinioni ynë është se Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.178 datë 8.11.2001 ka vepruar në kundërshtim me vendimin e saj nr.49, datë 31.07.2000 me anë të të cilit ka interpretuar pikën 2 të nenit 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Siç kemi theksuar në Raportin e vitit 2000, por edhe në këtë Raport, Vendimi nr.49, datë 31.07.2000 është përshëndetur për hapësirat që krijoi për Avokatin e Popullit që të kryejë realisht detyrën për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve në Shqipëri, të cilat kanë përbërë dhe përbëjnë thelbin e interesave të këtij Institucioni. Edhe konkluzionet e Konferencës së Lubjanës, të organizuar nga Këshilli i Evropës me institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut theksojnë ndër të tjera për vendet në tranzicion se “... është e rëndësishme për ombudsmanët që të kenë aftësinë të parashtrojnë një vlerësim të aspektit ligjor dhe kushtetues të rregullave dhe ligjeve përpara Gjykatës Kushtetuese”.

c. Tashmë Gjykata Kushtetuese ka në shqyrtim një kërkesë tjetër të Avokatit të Popullit, për shfuqizimin si antikushtetuese të pikave 3 dhe 5 të nenit 289 të Kodit Doganor, të cilat sipas mendimit tonë shkelin nenin 13 të Konventës Evropiane të të drejtave të njeriut dhe nenin 8 të Deklaratës Universale të të drejtave të njeriut “Për një ankim efektiv”.

Të shpresojmë se Gjykata Kushtetuese do të marrë një vendim sa më të drejtë, për të mos ngushtuar hapësirën e Avokatit të Popullit për të kërkuar pranë saj shfuqizimin e ligjeve që krijojnë kushte apo mundësi për shkeljen e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

6. Opinione të përgjithshme rreth situatës të të Drejtave të Njeriut në Shqipëri.

Të drejtat e njeriut kanë të bëjnë kryesisht me marrëdhëniet midis individëve dhe shtetit. Ato kontrollojnë dhe rregullojnë ushtrimin e fuqisë së shtetit mbi individin, garantojnë liri për individët në marrëdhënie me shtetin dhe i kërkojnë këtij të fundit të plotësojë nevojat bazë të njerzve, brenda juridiksionit të tij. Këto janë të kuptueshme më së miri dhe të shprehura në tekstet ndërkombëtare (instrumentat), për të cilat shtetet kanë rënë dakort dhe mbi të cilat janë shtrirë standartet e të drejtave të njeriut. Mbi këto principe është shkruar dhe Kushtetuta Shqiptare e vitit 1998, e cila përforcoi garancitë kushtetuese në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Kapitulli kushtetues mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut përfshin gjithë të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat bazohen në standartet më të larta ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Në vendin tonë nocioni i mbrojtjes me transparencë të të drejtave të individëve, nga fuqia e abuzimit të shtetit është i ri. Përmirësimi i mëtejshëm i gjëndjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri, varet gjerësisht nga njohja dhe respektimi i shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut.

Duhet thenë se legjislacioni i të drejtave të njeriut në Shqipëri, është modern, si rezultat i bashkimit (shkrirjes) të të gjitha standarteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Në Kushtetutë është parashikuar se normat dhe parimet e njohura nga e drejta ndërkombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare të njohura prej Shqipërisë janë pjesë përbërse e sistemit ligjor të vendit si dhe këto norma kanë prioritet në krahasim me legjislacionin e vendit. Megjithatë për aplikimin direkt nga gjyqësori dhe administrata publike të standarteve ndërkombëtare për mbrojtjen reale të të drejtave të njeriut në Shqipëri, ka akoma shumë për të bërë.

Duke patur si bazë rekomandimin Nr. (85)13 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anetare mbi institucionin e Ombudsmanit, ne përfitojmë nga rasti për të dhene konsiderata të veçanta për çështje të të drejtave të njeriut. Në lidhje me gjëndjen e të drejtave dhe lirive të individëve në Shqipëri jemi shprehur gjate këtij raporti, kur kemi analizuar fusha të caktuara, por për problemet që prezantojme më poshtë nuk jemi bazuar vetëm në ankesat e paraqitura tek Institucioni ynë, por dhe në informacionet, dhe sondazhet e publikuara në Mediat shqiptare, të cilat natyrisht paraqesin një shkallë besueshmërie, që për të qenë brenda, po themi mesatare. Natyrisht janë mbajtur parasysh edhe raporte të organizmave dhe institucioneve prestigjioze për Shqipërinë, siç janë ato të

Këshillit të Evropës, Bashkimit Evropian dhe në veçanti Raportet e Departamentit të Shtetit të SHBA për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri.

Konferenca kombëtare për të drejtën e jetës ka analizuar me hollësi këtë të drejtë themelore të njeriut, dhe në këtë Raport flitet në veçanti. Armët që ndodhen në duart e popullsisë civile, që pas ngjarjeve tragjike të vitit 1997 vazhdojnë të jenë mjetet më të përdorshme për të marrë jetën e shumë njerëzve. Ligji për mbledhjen e armëve nuk ka dhënë rezultatet e pritshme. Mbase duhet ndryshuar ligji që fillimisht armët të deklarohen dhe legalizohen dhe pas një kohe të mëvonshme, ato do të mblidhen.

Është fakt se gjendja e *Lirive dhe të Drejtave Vetjake* si liria e shprehjes, e shtypit, medias e televizionit, liria e ndergjegjes dhe e fese, liria individuale, paprekshmeria e banesës, liria e fshehtesia e korrespondences janë të garantuara me ligj. Ka dhe do të ketë ankesa apo dhe mbrojtje të tyre me ane të proceseve gjyqesore, por mendimi ynë është se këto respektohen, dhe janë ndëshkuar shkaktarët, kur janë vërtetuar shkelje të tyre nga individë të veçantë që ju janë cënuar këto të drejta.

Megjithatë lidhur me lirine e *shtypit, medias e televizionit*, duhet thënë se ka patur raste kur kjo liri është tejkaluar. Nga gazetare të ndryshëm nuk janë patur parasysh parashikimet e ligjit nr. 8517, date 22.07.1999, “Për Mbrojtjen e të Dhenave Personale”. Nuk janë të pakta rastet kur në Mediat tona jepen me hollësi të dhëna personale që shkelin të drejtën e privacisë sipas ligjit të cituar. Më e theksuar është kjo kur ka akuza për vepra penale dhe, aq më tepër, kur janë të akuzuar dhe të dëmtuar fëmijet (të miturit).

Liritë dhe të Drejtat Politike, si e drejta e zgjedhjeve, e organizimit dhe tubimit, janë të garantuara me ligj dhe në përgjithësi respektohen. Është e njohur tashmë se në klimën politike shqiptare ka opinione shumë antagoniste në lidhje me procesin zgjedhor për Parlamentin, të zhvilluar në verën e vitit 2001. Ne, kemi zbatuar dhe jemi mbështetur fort në parimin e paanësisë, për të mos u komprometuar në pakënaqësitë e natyrshme të politikës, që gjithmonë shoqërojnë garat për të marrë pushtetin. Prandaj Avokati i Popullit shprehet se është plotësisht dakort me vlerësimet dhe se të gjithë duhet të punojmë për të zbatuar Rekomandimet e ODIHR-it, për respektimin e së drejtës themelore të votës së lirë për çdo qytetar të Republikës së Shqipërisë.

Konstatohet se mjaft të drejta dhe liri të tjera shkelen apo nuk realizohen. Rezulton që shume të rinj emigrojnë ilegalisht për një të ardhme me të mire; puna e fëmijeve është përhapur shume; kerkesat për arsim 8-vjeçar të detyrueshem janë duke mos u marre parasysh; numri i

femijeve që kanë braktisur shkollen është rritur. Sipas sondazheve të publikuara, ka fshatra dhe krahina të tera, ku rreth 70% e femijeve, të nxitur nga shkaqet ekonomike, braktisin shkollat. Veç kësaj ka mjaft raste kur femijet perdoren “si skllever” për të lypur apo prostitucion. Ne veri të vendit ka shume femije që jane të rrezikuar nga gjakmarrja dhe gjendja e tyre është vertete e mjerueshme. Po keshtu nga media është bere publik fakti se shume femije të shtepive të femijes mbahen “peng” nga këto të fundit, duke mos respektuar procedurat ligjore për deklarimin e tyre të braktisur si dhe mosdhenien e mundesive të tyre për t’u biresuar ne perputhje me ligjin, sepse drejtuesit e këtyre institucioneve duan që të justifikojnë mbajtjen hapur të këtyre të fundit.

Konventa për të drejtat e femijeve është ratifikuar nga vendi yne me dekret të Presidentit ne vitin 1992. Ne vitin 1994, shteti yne, ne baze të kësaj Konvente ishte i detyruar të paraqiste prane Komitetit për të drejtat e femijeve ne O.K.B. nje raport për gjendjen e të drejtave të femijeve, raport i cili duhet të pergatitet çdo 5 vjet. Deri tani nuk rezulton të jete paraqitur ndonje Raport Zyrtar për zbatimin e kësaj Konvente.

Mendojme se është e domosdoshme që për mbrojtjen e të drejtave të fëmijeve të hartohet një ligj për të drejtat e femijeve. Po keshtu mendojme se akoma nuk funksionon nje sistem gjyqesor i veçantë për minorenët. Vlen të përmendet moskrijimi i qendrës për edukimin e minorenëve, (duke u përqëndruar në veçanti në krijimin e burgut të veçantë për minorenët).

Të rënda janë dhe shkeljet e të drejtave të Grave. Mediat japin shifra të ndryshme për numrin e vajzave shqiptare që janë bërë subjekt i trafikimit dhe prostitucionit në të gjithë Evropën, sidomos ne Itali e Greqi. Organizatat Jo Qeveritare të ndryshme japin të dhëna të ndryshme, kurse nga ana tjetër strukturat përkatëse të shtetit nuk e njohin gjendjen me shifra të sakta zyrtare. Në një raport të “Save Children”, thuhet se është vërejtur se 60% e vajzave të trafikuar kanë qenë minorene. Problemi i trafikimit të grave për qëllime prostitucioni mbetet serioz. Problemi trajtohet në termat e krimit të organizuar, qoftë ky dhe transnacional, por sidoqoftë duket sikur barra e suksesit apo e dështimit i ngelet vetëm organeve shtrënguese të ligjit, policisë, prokurorisë, gjykatës etj. Edhe nismat rajonale në këtë drejtim, nuk kanë shanse t’i japin zgjidhje perfundimtare fenomenit, pasi dhe shkaqet që çojnë në të, janë të natyres politike, sociale, kulturore, ekonomike e kështu me radhë.

Në këto kushte është i rëndësishëm forcimi i legjislacionit, miratimi i programeve dhe politikave, por dhe monitorimi i këtij procesi nga organizmat përkatëse, të percaktuara ne strukturat qeveritare, enkas për këtë drejtim pune. Trajtimi i këtij problemi duhet bërë edhe nga

këndvështrimi i respektimit të të drejtave civile, kulturore, ekonomike, politike e sociale. Kjo në të gjitha fushat si arsim, shëndetësi, sigurime shoqërore, punësim, zbutje e varfërisë, të gjitha këto me filozofinë e mosdiskriminimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të viktimave, por të mbajturit parasysh të statusit të tyre social si dhe raportin e tyre me qendrat rehabilituese në vend. Duhet thenë se shpesh viktimat e trafikut bëhen objekt ndjekjesh penale me shume se vetë trafikantët. Akoma nuk është arritur sigurimi i një asistence minimale për viktimat e trafikut. Riintegrimi i grave të trafikuar është problematik. Vetëm disa OJQ janë angazhuar në një gjë të tillë, por hapa ka bërë edhe policia në Fier.

Çështje që kanë të bëjnë me keqtrajtimin bashkëshortor apo dhunën ndaj grave janë publikuar shpesh në shtyp. Akoma nuk është miratuar Kodi i ri i Familjes, ndonëse ka rreth 6-muaj që është paraqitur nga Qeveria në Kuvend.

Kujdesi i ulët shëndetësor paraqet probleme të rëndësishme për shumë persona me paaftesi. Trajtimi i të sëmurëve mendorë në spitalet tona psikiatrike vazhdon të jetë problem shqetësues. është shkruar shpesh në shtypin shqiptar për kushtet e rënda të higjenes, ushqimit, ngrohjes, fjetjes etj. Një gjë e tillë është publikuar dhe në Raportin tonë të vitit 2000. Inspektimet e CPT të Këshillit të Evropës gjatë vitit 2001 vazhdojnë ta paraqesin situatën shumë të rëndë. Qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë duhet t'i vlerësojnë me tepër Rekomandimet e CPT për drejtimit e saj.

Kuptohet që jo të gjitha të drejtat ekonomike dhe sociale mund të garantohen plotësisht. Por Qeveria duhet të lëvizë drejt realizimit të tyre dhe jo të shkojë mbrapa. Ndonëse mund të jetë e pamundur për çdo njeri të ketë një punë, Qeveria duhet të përpiqet maksimalisht për të krijuar mundësira punësimi, shanse të barabarta dhe një mjedis të përshtatshëm për të punuar. Për këtë duhet të përpunohen strategji konkrete nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, e cila duhet të dijë me saktësi numrin e personave të aftë për punë dhe t'i bëjë të ditur herë pas here Qeverisë gjendjen reale, duke propozuar masat konkrete për të dalë nga kjo gjendje.

Korrupsioni është i përhapur gjerësisht si në administratë, ashtu edhe në gjyqësor. Për këtë aspekt në Raport kemi përgatitur disa konstatime dhe Rekomandime të veçanta, por për gjyqësorin dhe prokurorinë do theksojmë se jo rrallë kemi patur ankesa për veprime në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Ka patur raste kur janë mbajtur për një periudhë 5-6 muaj deri në 1 vit, persona të paraburgosur pa u kryer asnjë veprim me ta, gjë që ka bërë që të paraburgosurit të futen në greve urie. Prandaj mendojme se duhet ndryshuar Kodi i Proçedurës Penale në lidhje me afatet e hetimit paraprak, që shkojnë deri 3 vjet, për t'i zvogëluar afatet e mbajtjes së njerëzve në

dhomat e izolimit, pa i nxjerrë në gjykatë për gjykim të themelit të akuzës. Po kështu duhet parashikuar e drejta e familjarëve të viktimave nga krimet që të mbrojnë direkt me avokatët e tyre të drejtat e tyre në gjyqet penale. Kështu parandalohet edhe korrupsioni i prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe realizohen plotësisht të drejtat e njerëzve të prekur nga krimet, sepse vendimet që do merren për akuzat dhe masat e dënimit do të mund të apelojnë edhe nga të interesuarit, pa u lënë apeli në diskrecionin vetëm të prokurorit.

Për të siguruar më mirë të drejtën e jetës dhe të drejtat dhe liritë private të njeriut propozojmë që të studjohet edhe përgatitja e një ligji për Investigatorin privat, siç e kanë edhe shumë vende të tjera të botës së qytetëruar. Për të parandaluar vonesat në gjykime dhe korrupsionin duhen ndryshuar Kodet e Proçedurave Penale e Civile, me qëllim që çështjet në shkallë të parë të gjykohen vetëm me një gjykatës. Kjo do të rriste shpejtësinë e gjykimeve, përgjegjësinë e gjyqtarëve, por edhe buxheti i shkurtuar mund të përdoret për të rritur pagat e gjyqtarëve që mbeten. Procesi i trajnimit dhe testimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet vazhduar, por me kritere e kontroll të rreptë për aftesitë e tyre profesionale.

Është e rëndësishme të theksohet në këtë Raport fakti se, ka disa Konventa dhe Akte të tjera ndërkombëtare që janë nënshkruar nga vendi ynë prej vitesh, por që disa prej tyre nuk janë ratifikuar akoma nga Kuvendi i Shqipërisë.

Kështu, sipas të dhënave të marra në Ministrinë e Jashtme, nga rreth 82 Konventa, Marrëveshje, Amendamente apo Protokolle shtesë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara që ka nënshkruar vendi ynë, janë akoma të paratifikuar nga Kuvendi rreth 8 prej tyre.

Gjithashtu, nga rreth 51 Konventa dhe Protokolle të Këshillit të Evropës, janë akoma të paratifikuar nga Kuvendi 8 prej tyre.

Nga këto theksojmë se, është e paratifikuar akoma Karta Evropiane e të Drejtave Sociale, e nënshkruar që në vitin 1998. Kjo Konventë është mjaft e rëndësishme.

Është e vërtetë se kohët e fundit Qeveria i ka dërguar mjaft marrëveshje dhe Akte ndërkombëtare Parlamentit për ratifikim.

Çështja tjetër e rëndësishme është se për këto Konventa etj, të nënshkruara dhe të ratifikuara, vetëm për në një rast, dhe konkretisht për Konventën kuadër “Për mbrojtjen e minoriteteve” është dorëzuar një Raport nga Qeveria shqiptare në Këshillin e Evropës në korrik 2001. Ndonëse edhe për aktet e tjera Qeveria ka detyrimin që në periudha periodike t’i dërgojë raporte O.K.B.-së dhe Këshillit të Evropës, nuk rezultojnë që ta ketë realizuar këtë detyrim.

Sipas nenit 116/1 b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara kanë fuqi në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe njëkohësisht, sipas nenit 117/3, ato duhet të shpallen dhe të botohen në Fletoren Zyrtare, me qëllim që të marrin fuqinë juridike.

Në këtë kuadër, rezulton se, nga tërësia e rreth 120 akteve ndërkombëtare të ratifikuara, vetëm 8 prej tyre janë botuar në Fletoren Zyrtare. Është fjala jo për botimin e ligjit të ratifikimit, por për mosbotimin e tekstit të tyre zyrtar.

Këtu ka dhe një problem tjetër të madh, sepse këto tekste akoma nuk janë në përdorim të të gjitha institucioneve zyrtare të interesuara dhe në veçanti të gjykatave shqiptare.

Pra, si mund të zbatohen këto tekste, në qoftë se ato fizikisht nuk ndodhen në dispozicion të organeve që duhet t'i zbatojnë ato?

Këtë mangësi e theksoi edhe Konferenca e 4-të e Këshillit të Evropës "Mbi reformën gjyqësore në Shqipëri", organizuar nga Këshilli i Evropës në Strasburg, më 28-29 janar 2002.

Si përfundim theksojmë se, siç është e qartë për të gjithë, përgjegjëse për gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në çdo vend janë Parlamenti dhe Qeveritë që dalin prej tij. Në këtë kuadër secili duhet të bëjë punën e tij. Avokati i Popullit e ka të qartë rolin dhe ka bërë dhe do të vazhdojë të bëjë vetëm detyrën e tij për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Shqipërisë.

7. Veprimtaria e Avokatit të Popullit në marrëdhëniet me publikun

Pavarësisht mangësive që ekzistojnë në çdo rast kur bëhet fjalë për për institucion që është i ri, praktika e deritanishme, ka evidentuar problematikën që ne e kemi bërë publike në media dhe është pasqyruar në tabelat e pasqyrit të punës që shoqërojnë këtë raport.

Duke ndjekur median, ne njëkohësisht jemi njohur me ankimet e mjaft njerëzve, por dhe me prioritetet e qeverisë shqiptare. Kështu, jemi munduar që vektorët e punës tonë t'i adresojmë për të goditur dhe krijuar precedentë në ato sektorë të qeverisjes, tek të cilët kërkohet krijimi dhe rritja e standarteve për shërbimet publike, zbatimin e të drejtës së informimit, (transparencës) e ruajtjen e të dhënave personale, në veprimtarinë e policisë dhe fusha të tjera që janë pasqyruar në kreun përkatës sipas rasteve.

Bashkëpunimin me median ne e kemi parë si mjetin më efikas për të siguruar aksesin e nevojshëm në publik si dhe krijimin e integritetit të domosdoshëm për ushtrimin e funksionit të parashikuar, si nga Kushtetuta, ashtu edhe nga ligji “Për Avokatin e Popullit”.

Organeve të medias dhe shtypit, qysh në fillim, u kemi dërguar një njoftim ku u kërkohet akreditimi i një gazetari për të patur raporte të përhershme me institucionin e Avokatit të Popullit. Për këtë, komisionerët përgatisin një herë në muaj statistika për punën e secilit seksion. Me porosi të Avokatit të Popullit, këto të dhëna vihen në dispozicion të Zëdhënësit, për t’i pasqyruar më pas në shtyp, sipas rastit. Në praktikën tonë kemi përdorur metodën e kontaktimit të gazetarëve me, së paku, tre persona të stafit tonë. Kjo, për të sqaruar më mirë problemin që do të trajtohet në shtyp, si dhe për të transmetuar në media atë ide, që ne synojmë të përcjellim tek lexuesi, me synim edukimin e tij me praktikën e drejta ligjore.

Larminë e problematikës, të cilën kemi përdorur për t’u prononcuar në shtyp e kemi pasqyruar pa komente në tabelat përkatëse që tregojnë statistikat e mbulimit mediatic. Në një farë mënyre, duke u nisur qoftë edhe nga titujt e informacioneve nga ne dhe për ne, aty bëhet e qartë edhe veprimtaria që kemi bërë.

Informacionet nga shtypi përbëjnë bazën e një drejtimi të rëndësishëm të punës tonë, sikundër është vënia në lëvizje edhe me iniciativë. I gjithë spektri i shtypit të përditshëm, por edhe atij periodik shqiptar, filtrohet posaçërisht çdo ditë në zyrën tonë.

Informacionet që paraqesin interes për objektin e punës sonë, u shpërndahen seksioneve, sipas problematikës, të cilët më pas bëjnë verifikimet përkatëse dhe, sipas rastit, ose nisin investigimin ose i mbajnë në evidencë për arsye studimore.

Në strategjinë e mbulimit mediatic janë patur parasysh si ndërgjegjësimi i publikut, ashtu edhe efekti edukativ i informacionit si për qytetarët, ashtu edhe për administratën. Dhe kjo është bërë me pasqyrimin e vazhdueshëm në shtyp të të gjitha rasteve, kur administrata na ka mirëkuptuar, duke rivendosur të drejtën e shkelur të qytetarit. Veç kësaj, shtypi na ka ndihmuar edhe me rolin e tij si mjet presioni, qoftë mbi ne, qoftë edhe mbi administratën apo personat e veshur me autoritet publik, kur këta të fundit e kanë bërë veshin të shurdhër përballë rekomandimeve tona.

Mjetet që kemi përdorur kanë qenë ato të parashikuara në strategjinë që kemi formuluar që në fillim të veprimtarisë sonë, njohëse dhe sqaruese me grupe të ndryshme të komunitetit. Vitin e kaluar ne arritëm të nxirrnim nga shtypi pesë fletëpalosje të reja, një kalendar me tematikë nga fusha e të

Drejta të Njeriut, si dhe prodhuam një dokumentar njohës dhe promovues për Institucionin e Avokatit të Popullit. Gjithashtu ribotuar edhe një broshurë, në gjuhën angleze, sikundër prodhuam pesë spote institucionale, me qëllim informimin e publikut për shërbimet që ne ofrojmë dhe rrugët e përfitimit të këtyre shërbimeve. Këto forma pune do të vijnë duke u pasuruar edhe në të ardhmen. Instalimi i teknologjisë informative na ka mundësuar që të kemi në proces krijimin e faqes së Internetit, ku të interesuarit pritet të gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me zyrën tonë dhe aktivitetin që kryen ajo.

Është e kuptueshme që mbulimi mediatik është gjithmonë në përshtatje me problematikën dhe intensitetin e punës që institucioni kryen. Me kalimin e kësaj faze të parë, ne e ndjejmë se tani fillon një fazë e dytë, ku krahas konsolidimit të institucionit, ka ardhur duke u forcuar edhe autoriteti i tij publik. Synimi ynë është që rekomandimi i Institucionit të Avokatit të Popullit të realizojë edhe më shumë impaktin pozitiv të pritshëm mbi administratën dhe opinionin publik. Ne mendojmë se, pa neglizhuar për asnjë moment vëmendjen ndaj ankesave të përditshme të qytetarëve, Institucioni ynë do të dijë të orientohet për të ndikuar pozitivisht edhe në mekanizmin administrativ, të cilit i ka rënë njëkohësisht fati dhe barra të përballojë sfidat që Shqipëria, domosdoshmërisht, lipset të përballojë si shtet në proceset integruese, sikundër është nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit me Bashkimin Evropian.

Avokati i Popullit ka patur gjithmonë vizionin se Marrëdhëniet Publike nënkuptojnë jo vetëm komunikimin përmes medias me publikun, por edhe transparencën për raportet institucionale mes tij dhe Parlamentit, Qeverisë, Pushtetit Lokal, OJQ-ve, pra gjithçka që institucioni krijon dhe realizon në fushëveprimin e juridiksionit të tij, duke përdorur kompetencat që i njeh ligji.

Duke bërë herë pas here një analizë të secilit seksion për punën e kryer, ne kemi punuar paralelisht edhe për zbatimin e pikave bazë të strategjisë sonë në fushën e marrëdhënieve me publikun, sidomos përmes Medias. Në tërësinë e saj, kjo **Strategji** e mbulimit mediatik, si pjesë e rëndësishme e **Marrëdhënieve me Publikun** ka konsistuar si më poshtë:

Objektivi: Njohja dhe promovimi i mëtejshëm në media i rolit, detyrave dhe funksionimit të Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri, me synim ndërgjegjësimin e publikut, ruajtjen e kontaktit të rregullt me publikun, njohjen e administrates me ankesat e qytetarëve, ushtrimin e presionit dhe stimulimin e administratës publike për të pranuar rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Tematika bazë:

a-Roli i Avokatit të Popullit, të drejtat dhe detyrat e tij kushtetuese.

b-Procedimi me kërkesat dhe ankesat e qytetarëve ndaj shkeljeve të administratës shtetërore në të gjitha nivelet.

c-Raporti që krijon ky Institucion me organet e tjera të shtetit.

d-Përparësitë e adresimit të ankesave të njerëzve pranë Institucionit të Avokatit të Popullit.

e-Raporti i Shoqërisë Civile me shtetin e së drejtës, dhe si kontribuon Avokati i Popullit në ruajtjen e kohezionit të atyre institucioneve që përbëjnë alternativa vetregulluese brenda shtetit demokratik.

f-Si depozitohen kërkesat dhe ankesat pranë Avokatit të Popullit. Afatet e shqyrtimit të ankesave për të drejtën e shkelur, shkallët e angazhimit të këtij institucioni për rivendosjen e kësaj të drejte. Cili është çmimi që paguan administrata për moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me shkeljet e së drejtës së qytetarit ose nëpunësit.

Grupi i synuar: Opinioni publik, administrata publike, përfaqësuesit e OJQ-ve, si dhe Shoqëria Civile në tërësi.

Vizioni: Bashkëpunimi me median është baza e marrëdhënieve publike dhe mjeti më efikas për të siguruar aksesin e nevojshëm në publik si dhe krijimin e integritetit të domosdoshëm për ushtrimin e funksionit të parashikuar nga ligji kushtetues. Transparenca dhe media kanë qenë, janë dhe do jenë aleatët e shpallur dhe të sigurtë të Avokatit të Popullit.

Mjetet e realizimit:

a-Media elektronike dhe e shkruar.

b-Takime njohëse dhe sqaruese me grupe të ndryshme të komunitetit.

c-Hapja e një faqe Interneti.

d-Botim fletëpalosjesh, posterash, kalendarësh dhe broshurash.

e-Prodhim spotesh televizive dhe dokumentarësh, duke siguruar shpërndarjen e tyre, si përmes mediave elektronike, ashtu edhe nëpër institucione të ndryshme, si zyra, shkolla etj, në zona të ndryshme të vendit.

f-Prodhim i materialeve të ndryshme promocionale, si stema, statueta etj, me logon e institucionit.

g-Kontakte të përditshme me shtypin si dhe Deklarata për shtyp për çështje të rëndësishme me impakt të gjerë në mirëqeverisje.

Elementët përbërës për çdo mjet të realizimit.

a-Kontakti me media realizohet me:

1.Intervista (të programuara ose jo të programuara).

2.Biseda-show, pyetje – përgjigje direkte.

3. Deklaratë për shtyp.

4. Kontakte të drejtpërdrejta me gazetarët për t'i njohur me rastet tona, duke filluar nga eksperti, zëdhënësi, komisioneri deri tek Avokati i Popullit.

5. Fushatë promovionale (video klipe 10-20 sek) në TV dhe në Radio, duke zgjedhur si logo, fjali goditëse si p.sh. “E drejta juaj – misioni ynë”, “Avokati i Popullit – Një derë e hapur për Ju” etj.

6. Cikël emisionesh televizive dhe radiofonike sipas problematikës së ankesave pranë Avokatit të Popullit.

b-Takimet me popullin janë të rëndësishme, pasi vendosin kontaktin fizik me zyrën dhe e bëjnë atë më të prekshme. Kjo realizohet duke kryer:

1-Biseda në shkolla dhe universitete.

2-Biseda në qytete të ndryshme.

3-Biseda me administratën, sipas sektorëve që ne mbulojmë.

4-Seminare me përfaqësues të administratës, gjyqësorit, legjislativit dhe shoqërisë civile (OJQ).

c-Faqe Interneti dhe sigurim i lidhjeve me institucionet e ndryshme, sidomos me qendra të tjera për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, brenda dhe jashtë vendit.

d-Informacion për zyrat homologe me statistika dhe përmbledhje të rasteve të zgjidhura në favor të qytetarëve.

Sidomos, brezi i ri priret për të vjelur informacionin e mëposhtëm:

1-Faqja e Internetit të ketë pjesët e Kushtetutës dhe Ligjin “Për Avokatin e Popullit”.

2-Strukturën e Zyrës së Avokatit të Popullit.

3-Biografi profesionale e Avokatit të Popullit dhe Komisionerëve.

4-Mesazh-logo nga Avokati i Popullit.

5-Raport mbi veprimtarinë e Zyrës (Pjesë nga raportet vjetore ose raportet specifike).

6-Formularin tip për ankesat e qytetarëve.

7- Adresë e-maili për të kontaktuar me Avokatin e Popullit.

8-Adresa postare dhe telefonike.

d-Fletëpalosje për veprimtarinë e Avokatit të Popullit; si funksionon, si kontaktohet, raste të ndryshme ose me tematika të ndryshme, sipas problematikës së seksioneve përkatëse, duke punuar në grup brenda Zyrës apo konsultuar edhe me Grupin e Miqve të Avokatit të Popullit.

e-Zëdhënësi i drejtohet mediave për probleme të Zyrës, për të shpallur qëndrime apo statistika, apo sqaruar opinionin për raste të caktuara etj.

Format dhe mënyrat e realizimit në Radio e Televizion mund të jenë:

a. Biseda të drejtpërdrejta, kohëzgjatja e të cilave të shkojë e shumta një orë në studio.

b. Intervista të regjistruara në ambiente të caktuara, duke biseduar me gazetarin intervistues; biseda të përgjithshme nga 15-20 minuta dhe më pas lidhje telefonike me shikuesit.

c. Pyetje-përgjigje të përgatitura nga vetë Komisionerët dhe Zëdhënësi dhe pastaj këto të transmetohen një herë në javë në një cikël “Të njohim Institucionin e Avokatit të Popullit” në Radio Tirana.

d. Biseda të drejtpërdrejta në radio të titullarëve ose edhe të ekspertëve lidhur me çështje konkrete dhe spontane të ngritura nga dëgjuesit.

Metodologjia.

a. Intensiteti i prononcimit të jetë në progresion të shkallë-shkallshëm. Ideja është të ruhet një fare hierarkie, në kuptimin që interesi për atë që flet më pas të vijë në rritje dhe jo në zvogëlim.

b. Fillimisht në shtyp mund të dilet me ndonjë shkrim të përgjithshëm, jo drejtpërdrejt, por duke iu referuar apo cituar Zëdhënësin.

c. Më pas angazhohen drejtpërdrejt dhe njëri pas tjetrit Komisionerët, deri sa ngrihet shkalla e prononcimit me Avokatin e Popullit.

d. Zëdhënësi mund të prononcohet për çështje nga më të ndryshmet dhe sa herë që Titullari gjykon nëse duhet dhe si mund të reagojmë për një çështje të caktuar, duke shprehur qëndrimin zyrtar të Institucionit.

e. Takimet dhe vizitat e ndryshme zyrtare dhe protokollare, apo edhe aktivitetet e Zyrës si seminare apo konferenca shtypi mund të bëhen publike sipas rastit, përmes njoftimeve me shkrim, dërguar TVSH-së si dhe organeve të ndryshme të shtypit.

Mjetet për realizim:

Funksionimi i Teknologjisë Informative dhe softet përkatëse të sistemit internet dhe intranet. Skaner, diktofon, aparat fotografik, kamera.

Krijim aftësish:

Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare për t’u përditësuar me problematikat dhe stilin e punës, si dhe për t’u trajnuar dhe shkëmbyer eksperiencë.

Burimi i financimit:

Buxheti i Institucionit ose donacionet e huaja (programi DANIDA ose Këshilli i Evropës), mbi bazën e projekteve që do të miratohen sipas kriterëve profesionale dhe rregullave administrative e financiare të shtetit shqiptar. Fondet do të alokohen sipas projekteve të përbashkëta me grupe produktioni private ose nga TVSH.

Sa më sipër mbetet objekt ndryshimesh dhe përmirësimesh sipas angazhimit të personave konkrete, mundësive financiare që Zyra do të ketë në dispozicion apo kushteve të tjera të paparashikueshme.

Në mënyrë më të detajuar, strategjia e mësipërme u është bërë e njohur edhe përfaqësuesve të Grupit të Miqve, të cilët, ashtu si deri tani, janë shprehur të gatshëm për të mundësuar financiarisht të gjitha aktivitetet tona në këtë drejtim.

Sidoqoftë, aktivitetet bazë, pavarësisht nga koha e realizimit të tyre, kanë qenë dhe mbeten bisedat njohëse dhe tematike në Radio-televizionet kombëtare dhe lokale, me të cilat Zyra tashmë i ka vendosur pikat e kontaktit.

Këto veprimtari të përcaktuara në këto Strategji do të kryhen në vazhdimësi.

Ne kemi konkluduar se veprimtaria jonë në lidhje me publikun ka ndikuar që të rritet ngarkesa e punës, gjë të cilën e përmend edhe Raporti i Departamentit të Shtetit, publikuar më 05.03.2002.

8. Marrëdhëniet me Jashtë

Marrëdhëniet me jashtë kanë patur një rritje të ndjeshme në veprimtarinë tonë për vitin 2001. Këto marrëdhënie janë mjaft të rëndësishme për institucionin tonë për shkak se ky është një institucion tepër i ri dhe nuk ka homologë apo të ngjashëm në Shqipëri. Siç ka thënë, ndër të tjera zoti Daniel Jacoby, Sekretar i Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit... “forma më e mirë e rritjes së ombudsmanëve dhe mediatorëve është pjesëmarrja në simpoziume dhe konferenca. Në fakt ombudsmani në vendin e tij është një i vetëm, gjë që e bën atë një person unik e në të njëjtën kohë i lë atij pak mundësi shkëmbimesh me kolegë dhe ekspertë. Komuniteti i Ombudsmanëve është në fakt më shumë ndërkombëtar se kombëtar”.

Më poshtë paraqitet në mënyrë analitike gjithë aktiviteti i marrëdhënieve të Zyrës me Jashtë për vitin 2001.

I. Aktivitete të organizuara nga Këshilli i Evropës

a. Mbledhja e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, përfshirë edhe Ombudsmanët e vendeve të përfshira në Paktin e Stabilitetit.

Kjo mbledhje u mbajt në Strasburg më 21-22 Maj 2001 dhe u quajt takim rishqyrtues, duke patur parasysh fazën e dytë të zhvillimeve brenda Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe në veçanti e Tavolinës së parë të Punës (*të drejtat e Njeriut dhe Demokratizimi*), me synimin për të përcaktuar prioritetet dhe strategjinë e ardhshme për Konferencën e Fondeve të programuar për në Vjeshtë 2001.

Ky takim, i cili i bë i mundur nëpërmjet kontributit vullnetar të autoriteteve Franceze, ishte një rast i shkëlqyer 18 muaj pas nisjes së Projektit në Takimin e Budapestit, mbajtur në 13-14 Dhjetor 1999, (*takim Rajonal mbi Institucionet e pavarura për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, duke përfshirë institucionin e Ombudsmanit*) për të analizuar me aktorët dhe partnerët kryesorë të Projektit, përparimin e mekanizmave kombëtare të pavarur për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në të vërtetë, ishte e rëndësishme që këta aktorë dhe partnerë të vlerësonin, masën në të cilën veprimtaritë e kryera në projekt u janë përgjigjur nevojave reale ose të mundshme të rajonit si edhe të përcaktonin prioritetet dhe strategjitë e së ardhmes për mirë qeverisjen.

Në lidhje me Shqipërinë u vu në dukje se kishte miratuar një ligj për Avokatin e Popullit dhe në përputhje në Kushtetutën, në shkurt të vitit 2000 ishte zgjedhur në parlament Avokati i parë i Popullit. Pasi u përshkruan masat për ngritjen e Institucionit, e për forcimin e tij, u përcaktuan fushat e asistencës dhe të trainimit të stafit të Zyrës. Mbledhja gjithashtu përpiloi Rekomandimet e saj, ndër të cilat një vend të rëndësishëm zënë ato për nevojën e infomimit të publikut dhe të edukimit të tij për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe rolin e Institucioneve Kombëtare të Mbrojtjes së tyre nëpërmjet mjeteve jogjyqësore.

Këto Rekomandime janë përfshirë në objektivat e Institucionit tonë dhe për zbatimin e tyre informohet herë pas here Këshilli i Evropës.

b. Mbledhja e Ombudsmanëve të Evropës Qëndrore dhe Lindore me Komisionerin e të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës

Mbledhja u mbajt në Varshavë 28-29 Maj 2001, me iniciativë të z. Alvaro Gil Robles, Komisioneri i të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës, në bashkëpunim me Ombudsmanin Polak, z. Zoll.

Kishte pjesëmarrje të ombudsmanëve apo zëvendësave të tyre nga 14 shtete të Evropës Qëndrore dhe Lindore.

Pjesëmarrësit shkëmbyen pikëpamjet e tyre në të tëra fushat e aktivitetit të tyre, mbi të gjitha për bashkëveprimin me Këshillin e Evropës si dhe bënë një analizë të konkluzioneve të mbledhjes së mbajtur në Budapest një vit më parë.

Në mënyrë të veçantë u theksua nevoja për të vazhduar nxitjen për ndërtimin dhe konsolidimin e institucionit të ombudsmanit në vendet anëtare të Këshillit të Evropës, sidomos që zyrat e reja të ombudsmanit të ndërtohen në bazë të votimit parlamentar, t'i garantohet pavarësi e plotë dhe të pajisen me burimet e domosdoshme financiare dhe njerëzore për të kryer detyrën.

Mbledhja mori në shqyrtim edhe dy tema specifike: çështjen e Romëve dhe imigrimin e tranzitimit ilegal të njerëzve.

Për çështjen e mbrojtjes së të drejtave të Romëve, z. Jenó Kaltenbach, Komisioner Parlamentar i Hungarisë për minoritetet Kombëtare dhe Etnike, prezantoi problemet e integritetit që përballen Romët e Evropës Lindore, sipas këndvështrimit të një ombudsmani për minoritetet. Kurse Ombudsmani i Polonisë, z. Andrej Zoll, prezantoi diskutimin mbi problemet e imigrimit dhe tranzitimit ilegal.

Pjesëmarrësit vunë në dukje format e ndryshme të diskriminimit racial të Romëve në vendet e tyre si në arsim, tregun e punës, në shërbimet publike dhe në marrëdhëniet midis Romëve dhe policisë. Ombudsmanët e konsideruan të rëndësishme që për Mbrojtjen e Romëve t'i referoheshin dhe të zbatonin pa hezitim Kuadrin e Konventës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, që ka hyrë në fuqi në vitin 1998. Ata e konsideruan shumë të rëndësishme që qeveritë kombëtare të zhvillojnë projekte speciale arsimimi, strehimi dhe punësimi, për Romët.

U rekomandua që Ombudsmanët të shikojnë mundësinë që të angazhojnë në zyrat e tyre një person të specializuar për çështjet e Romëve dhe nëse do ishte e mundur ky person të ishte pjesëtar i këtij Komuniteti.

Mbledhja preku edhe çështjen e të huajve dhe të punësimit ilegal, të trafikimit të grave dhe prostituimit, kalimin e kufijve dhe leje qëndrimit, duke theksuar nevojën e respektimit të të drejtave të imigrantëve legalë, të respektimit të zakoneve dhe gjuhës së tyre. Gjithashtu u theksua se rastet e dëbimeve, të huajt duhet të kenë gjithmonë mundësinë e të drejtës efektive për të apeluar vendimet, për të respektuar të drejtat dhe dinjitetin njerëzor të njerëzve në fjalë.

Ashtu si Ombudsmanët e tjerë, edhe Avokati i Popullit shqiptar theksoi nevojën e mbrojtjes së bashkëkombësve tanë që emigrojnë në

vendet e Komunitetit Evropian, me qëllim që ata të mos keqtrajtohen dhe diskriminohen, sidomos në shtetet fqinje me Shqipërinë, si dhe të respektohet e drejta e tyre për bashkimin e familjeve.

c. Mbledhja e Lubjanës-Sloveni

Përfaqësuesit e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, duke përfshirë Institucionet e Ombudsmanëve, u mbledhën më 12 dhe 13 nëntor 2001 në Lubjanë, në Konferencën mbi “Marrëdhëniet ndërmjet Ombudsmanëve dhe organeve gjyqësore”, organizuar nga Këshilli i Evropës dhe zyra e Ombudsmanit Slloven.

Aty u këmbyen përvojat dhe pikëpamjet mbi rolin e ombudsmanit në lidhje me organet gjyqësore, i cili është i një rëndësie të veçantë për vendet në tranzicion, siç është edhe Shqipëria, me pak traditë në pavarësinë e gjyqësorit dhe në procesin e reformës në organet shtetërore.

Mbledhja theksoi se politika e shtetit në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga mekanizmat gjyqësore dhe jogjyqësore duhet të zhvillohet në përputhje me rekomandimet e Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës për Institucionin e Ombudsmanit, si dhe në përputhje me rekomandimet mbi pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve dhe me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në konkluzionet e mbledhjes ndër të tjera, u përcaktua se:

1. Në vendet me një traditë të re demokracie dhe shteti ligjor, në lidhje me funksionimin e gjykatave, përkrah respektimit të plotë të pavarësisë, mund të nevojitet përmirësimi i efikasitetit të tyre. Kjo mund të kontribuojë në rritjen e besimit të publikut tek gjyqësori, por ndihmesa e institucioneve të tilla si Ombudsmani, të cilat janë jashtë pushtetit gjyqësor, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë çështje.

2. Ombudsmanët janë aleatë të gjykatave, meqenëse ata mund të ndihmojnë në rritjen e sensibilizimit për çështjet e të drejtave të njeriut dhe për përmirësimin e efikasitetit të administratës së drejtësisë.

3. Pushtetet e Ombudsmanit në lidhje me gjyqësorin mund të jenë vetëm të tilla që nuk e rrezikojnë pavarësinë e gjyqtarëve dhe paanësinë e tyre në dhënien e vendimeve gjyqësore. Kur e lejon ligji, ndërhyrja e Ombudsmanit për një çështje të trajtuar nga një gjykatë, duhet të respektojë pavarësinë e plotë të gjykatës nga çdo ndikim i jashtëm, por Ombudsmani mund të shqyrtojë aspektet proceduriale të administrimit të rasteve në veçanti. U çmua si pozitive që në disa vende, ombudsmanët kanë

mundësinë të paraqiten në gjykata me opinionet e tyre në rolin e “amicus curiae”.

4. Në rastet kur ligji nuk i siguron ndonjë pushtet të veçantë ombudsmanëve në lidhje me gjykatat, Ombudsmanët megjithatë munden që, me kompetencat e tyre të përgjithshme, të shprehin pikëpamjet në lidhje me funksionimin e sistemit gjyqësor.

5. Nuk është detyra e Ombudsmanit që të veprojë në gjykatë në emër të një individi. Duhet pikësëpari që vetë individi i prekur të kalojë nëpër rrugëzgjdhjet ligjore. Megjithatë, kur një individ për cilëndo arsye nuk ka aksesin e duhur në këto rrugëzgjdhje, është e përshtatshme për Ombudsmanin të ketë aftësinë për të verifikuar nëse ka pasur ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut. Një mundësi e tillë në disa vende sigurohet nga një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

6. Në vendet në tranzicion, të cilat mund të përballen me rregulla (*ligje*), të vjetëruara, të mangëta dhe të paharmonizuara, ashtu si dhe në vendet me demokraci të forte, është e rëndësishme që ombudsmani të mund të kontribuojë gjithashtu në zhvillimin e rendit ligjor. Për këtë arsye është e rëndësishme për ombudsmanët që të kenë aftësi të propozojnë një vlerësim të aspektit ligjor dhe kushtetues të ligjeve përpara Gjykatës Kushtetuese. Në këtë mënyrë Ombudsmani mund të ndihmojë në eliminimin e mangësive në rregullore apo ligje, mangësi të cilat mund të ndikojnë negativisht apo madje të shkelin të drejtat e individëve.

Këto konkluzione janë shumë me vlerë aktualisht për vendin tonë, sepse ka një tendencë për të shmangur rolin e Avokatit të Popullit nga aksesin i tij në organet gjyqësore dhe në Gjykatën Kushtetuese.

d. Mbledhja e Ombudsmanëve në Strasburg me Komisionerin e të Drejtave të Njeriut në Këshillin e Evropës.

Mbledhja u mbajt në Strasburg me iniciativë të Z. Alvaro Gil Robles, Komisioner i të Drejtave të Njeriut, më 19 dhe 20 Nëntor 2001.

Në mbledhje morën pjesë Ombudsmanë të vendeve të Evropës Juglindore dhe u diskutua përsëri në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të romëve (gipsy). Gjithashtu u diskutua për Kartën Sociale Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe detyrat e ombudsmanëve në lidhje me këtë Kartë.

Nga ana e Avokatit të Popullit u vu në dukje, gjendja e romëve në Shqipëri dhe veprimtaria e këtij Institucioni për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Gjithashtu u vu në dukje se Karta Sociale Evropiane e të Drejtave të

Njeriut është nënshkruar nga Qeveria Shqiptare që në vitin 1998, por ajo ende nuk është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Mbledhja theksoi se në këto raste Ombudsmanët duhet t'ja parashtrojnë parlamentarëve të tyre nevojën e ratifikimit të kësaj Karte, si një dokument shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

e. Mbledhja e Tabilinës së Shtatë me Ombudsmenët e të gjitha vendeve të Evropës.

Kjo mbledhje u organizua nga Këshilli i Evropës dhe Shoqata Zvicerane e Ombudsmenëve Parlamentarë, nga data 21-23 Nëntor 2001 në Zyrih.

Në këtë mbledhje u trajtuan temat:

- Principet e mirëqeverisjes në kuadrin e çështjeve në shqyrtim nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e në veçanti neni 6 i Konventës për të Drejtat e Njeriut.

- Respektimi i të drejtave të njeriut nga Policia;
- Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit midis Ombudsmenëve të shteteve anëtare, dhe midis tyre dhe Këshillit të Evropës.

Për temat e mësipërme, Avokati i Popullit referoi duke paraqitur veprimtarinë e Institucionit tonë.

II. Aktivitete të organizuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB)

a. Konferenca Botërore kundër Racizmit, diskriminimit racial, ksenofobisë dhe intolerancës.

Konferenca Botërore kundër Racizmit, i zhvilloi punimet nga 31-gusht 2001 deri në 8 shtator 2001 në Durban të Afrikës së Jugut. Kjo konferencë ishte aktiviteti më i madh i zhvilluar pas heqjes së regjimit të aparteidit në Afrikën e Jugut (1994).

Në konferencë morën pjesë delegacione shtetërore të nivelit të lartë të rreth 160 vendeve, me pjesëmarrjen dhe të përfaqësuesve të Institucioneve Kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe të OJQ-ve.

Konferenca me rreth 12 000 pjesëmarrësit e saj, u ndoq nga rreth 600 gazetarë nga vende të ndryshme të botës.

Problematika e konferencës ishte përpunuar në seancat e mëparëshme të zhvilluar në Gjenevë. Kështu që Konferenca vetëm se pritej të vinte pikat mbi “T” si dhe të vinte vulën, përmes miratimit, në Deklaratën Përfundimtare dhe në Programin e Veprimit. Këto dy dokumente shumë të rëndësishme, normalisht do të përcaktonin politikat shtetërore për problemet e racizmit si dhe angazhimin e shoqërisë civile dhe të shtypit në secilin vend, për realizimin e tyre në praktikë.

Veç këndvështrimit politik që dominoi Konferencën, në seanca të veçanta të saj u trajtuan edhe probleme të refugjatëve, të punëtorëve emigrantë, të pakicave të tilla si romët, apo edhe fusha të tjera ku shprehet diskriminimi si ato të gjinisë, të orientimit seksual, të fëmijëve, të personave me aftësi të kufizuara etj.

Kryetari i delegacionit Shqiptar, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë Z.Eduart Sulo, në fjalimin e tij, ndër të tjera theksoi *“praninë tashmë në Shqipëri edhe të Institucionit të Ombudsmanit, i cili funksionon me kapacitet të plotë, duke garantuar kështu edhe një mundësi tjetër për të adresuar problemet që njerëzit kanë në raport me administratën, qofshin këto probleme të lidhura edhe me racizmin, diskriminimin dhe keq-qeverisjen”*.

Lidhur me problemin e romëve, Z.Sulo vuri në dukje se edhe në Shqipëri, *“kjo shtresë ka të njëjtat probleme, si edhe vendet e tjera të rajonit”*.

Konferenca sensibilizoi opinionin botëror për problemet e racizmit, ksenofobisë dhe të diskriminimit racial, por rezultatet apo dështimet e saj do të shihen në të ardhmen nga angazhimi i shteteve. Sa kohë që prirje të tilla zhvillimi si globalizmi (*amerikanizmi*), nga vendet e varfra u cilësuan si neo-imperializëm, perspektiva nuk duket e ndritur.

Sidoqoftë, nismat për të iniciuar programe të afirmimit pa diskriminim të të gjitha shtresave të shoqërisë, duket se do të kenë një farë perspektive. Të gjitha këto, me parakusht dhe njëkohësisht sfidë paqen, duket se janë disa nga piketat e rendit të ri botëror në mileniumin e tretë.

Dokumentet përfundimtare të Konferencës nuk na janë dërguar akoma.

b. Konferenca Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Demokratizimin

Konferenca u zhvillua në Dubrovnik të Kroacisë më 8-10 Tetor 2001 dhe kishte si qëllim një angazhim të vendeve të rajonit tonë në drejtim të veprimtarive pas Konferencës së Durbanit. Në të pati vlerë më shumë

këmbimi i mendimeve nga përfaqësues të vendeve të ndryshme përsa i përket problematikës që përmbledhin të drejtat e njeriut.

Një nga temat ishte edhe kulturalizmi në kuadrin e tolerancës, në kushtet e një rendi demokratik dhe të shoqërisë civile.

Zyra e Komisionerit të Lartë e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut ishte sponsori kryesor i këtij aktiviteti.

Zj.Meri Robinson në takimin që pati me përfaqësuesit e Institucioneve Kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë *Ombudsmanët* i garantoj ata se në çdo nismë do të gëzonin përkrahjen e plotë të saj dhe, të zyrës që ajo drejton, si Komisionere e Lartë e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.

Një problem që u ngrit për Ombudsmanin ishte se ky Institucion nuk duhet të trajtohet si figurë dekorative që qeveritë të krenohen përpara Këshillit të Evropës, por ai duhet përkrahur, mbështetur, krijuar pavarësi sa më e plotë dhe dëgjuar në Rekomandimet e tij.

Pjesëmarrja në Konferencë edhe e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës Z.Schvimer si dhe Drejtorit të ODHIR-it, Z.Stoudman i dha rëndësinë përkatëse Konferencës. SHBA kishte dërguar Ambasadorin e tyre në Zagreb. Të gjithë keta në fjalën e tyre nuk lanë pa përmendur edhe sulmin terrorist kundër SHBA-së dhe kontekstin e tij e cilësuan "*si luftë jo midis qytetërimeve, por midis vlerave universale dhe antivlerave*". Në këtë kuptim, sikundër u theksua nga Z.Schvimer, "*Investimi në të drejtat e njeriut është një investim për të gjithë ne*".

Si kushte për luftën kundër terrorizmit u cilësuan promovimi i të drejtave të njeriut dhe parandalimi i konflikteve etnike.

Lidhur me trafikun e qënieve njerëzore u vlerësua se ky është një pjesë e krimit të organizuar, madje shprehet si lidhje midis politikës dhe krimit të organizuar.

Ditën e dytë të Konferencës foli edhe përfaqësuesi i Avokatit të Popullit. Pasi u evidentua si pozitive edhe shpresëdhënëse veprimtaria e deritanishme e Avokatit të Popullit, ndër të tjera u përmend ideja e Ombudsmanit Shqiptar për ngritjen e rrjetit rajonal të Ombudsmanëve, që lipset të trajtohet në një të ardhme jo shumë të largët.

Duke theksuar parimin se një e drejtë e individit përbën një detyrim për çdo qeveri, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit deklaroi më tej se liria e njerëzve konsiston para së gjithash në krijimin e mundësive që njerëzit t'i gëzojnë të drejtat e tyre pa diskriminim dhe se ky është edhe qëllimi final i mirëqeverisjes.

c. Konferenca e dytë Mesdhetare e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut.

Konferenca Mesdhetare e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut u mbajt në Athinë nga 1 deri në 3 Nëntor 2001 dhe u organizua nga Komisioni Grek për të Drejtat e Njeriut dhe Misioni i OKB-së ,Gjenevë.

Në fund të Konferencës pjesëmarrësit miratuan një Deklaratë nëpërmjet së cilës inkurajojnë krijimin e Institucioneve të tjera dhe forcimin e Institucioneve Kombëtare ekzistuese për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut brenda rajonit EuroMesdhetar, në përputhje me minimumet e standarteve ndërkombëtare të miratuara.

Institucionet Kombëtare u zotuan të promovojnë dhe mbikqyrin implementimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në kuadrin e këtij partneriteti, në përputhje me detyrimet e marra nga shtetet përkatëse, sidomos në lidhje me Migracionin, Emigracionin dhe Azilin.

Institucionet Kombëtare theksuan:

Së pari, se të gjitha shtetet, njëkohësisht ata dërgues e ata pritës duhet të përtërijnë përpjekjet e tyre për krijimin e kushteve të favorshme, veçanërisht lidhur me zhvillimin ekonomik dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të cilat çojnë në uljen e shkallës shqetësuese të lëvizjeve migruese.

Së dyti, ata kujtuan parimet e parashtruara në Deklaratën e Marakechit dhe veçanërisht të nxisin edhe një herë shtetet e tyre për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare mbi Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë punëtorëve Imigrantë dhe familjeve të tyre (1990).

Së treti, Institucionet Kombëtare të nxisin Shtetet e tyre që kur ato përcaktojnë politikat e tyre të imigracionit, të frymëzohen nga konsideratat e mëposhtëme:

a) Imigracioni në shtetin pritës pasuron jetën ekonomike, shoqërore, shkencore dhe kulturore të shtetit pritës;

b) Imigrantët duhen të trajtohen në një mënyrë, e cila të përputhet me vlerat humanitare dhe ligjet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me parimin e jo-diskriminimit;

c) Shtetet duhet të përcaktojnë kapacitetet e tyre pritëse, duke marrë në konsideratë gjithashtu arsyet pse imigrantët kërkojnë kushte më të mira jetese.

Gjithashtu, Institucionet Kombëtare t'u kërkojnë shteteve të vënë në jetë të gjitha parimet dhe masat e parashtruara në Deklaratën dhe në Programin e Veprimit të Konferencës Botërore kundër racizmit, diskriminimit racial, ksenofobisë dhe intolerancës.

Institucionet Kombëtare të mbledhura në Athinë, gjithashtu shprehën indinjatën e tyre për aktin terrorist të 11 Shtatorit 2001, i cili shkaktoi

vdekjen e mijërave njerëzve të pafajshëm dhe me të drejtë, provokoi reagimin e tërë komunitetit ndërkombëtar. Por gjithashtu u theksua se Institucionet Kombëtare duhet të jenë shumë vigjilente që masat e marra, për të luftuar terrorizmin në vendet e tyre, në vijim të atij sulmi, të mos shkelin të drejtat dhe liritë themelore nëpërmjet kufizimeve që mund të jenë në disproporcion me qëllimet. Ata duhet gjithashtu të jenë vigjilentë që këto masa të mos zbatohen në mënyrë diskriminuese, e veçanërisht mbi baza fetare dhe raciale.

Duke qënë se Shqipëria është një vend mesdhetar që ka rreth gjysëm milion shtetas të saj të emigruar vetëm në Greqi dhe Itali, është e qartë se sa me interes është për Institucionin tonë pjesëmarrja në këtë Konferencë, nxitja dhe ndjekja e angazhimeve të ndërmara nga Institucionet Kombëtare të shteteve të tjera EuroMesdhetare për të kërkuar para Qeverive të tyre respektimin e të drejtave të emigrantëve dhe në veçanti atyre Shqiptare.

d. Konferenca Ndërkombëtare Konsultative mbi Edukimin në Shkollë me Lirinë e Fesë ose Besimit, Tolerancës dhe Mos-Diskriminimit

Konferenca u mbajt në Madrid prej 23 deri më 25 Nëntor 2001, me rastin e 20 vjetorit të Deklaratës mbi eliminimin e të gjitha formave të Intolerancës dhe Diskriminimit mbi bazën e Fesë ose Besimit, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me 25 Nëntor 1981. Në këtë Konferencë morën pjesë delegacione dhe përfaqësues të shteteve që përfaqësonin Qeveritë, institucione Kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe organizata joqeveritare që merren me liritë dhe të drejtat e Njeriut. Në fund u miratua një dokument përfundimtar, ku u theksua se:

Të drejtat njerëzore janë universale, të pandashme dhe të ndërvarura, dhe duhet të respektohen, ashtu siç parashikohen në Kartën e Kombeve të Bashkuara, Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut, Marrëveshjet Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racial dhe Deklaratën mbi eliminimin e të gjitha formave të Intolerancës dhe të Diskriminimit mbi bazën e Fesë ose Besimit, të cilat përcaktojnë të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit, dhe bëjnë thirrje për mirëkuptim, respekt, tolerancë dhe mos-diskriminim.

Duke vërejtur që ekziston në shkallë serioze intoleranca dhe diskriminimi për shkak të fesë ose besimit në shumë vende të botës, u nënvizua nevoja urgjente e promovimit nëpërmjet edukimit, të mbrojtjes dhe të respektimit të lirisë së fesë ose të besimit. Kjo të bëhet me synimin e forcimit të paqes, mirëkuptimit dhe tolerancës ndërmjet individëve,

grupeve dhe kombeve, sidomos që gjeneratat e reja të rriten me shpirtin e paqes, tolerancës, mirëkuptimit të shumanshëm dhe respektit mbi të drejtat e njeriut, dhe veçanërisht, me respektin për lirinë e fesë apo të besimit të tjetrit, me qëllim që të parandalohet ushtrimi i fesë apo besimeve për qëllime që nuk përputhen me Aktet Ndërkombëtare të mësipërme.

Konferenca kërkoi që, çdo shtet, në nivelet përkatëse qeverisëse, duhet të promovojë dhe respektojë politika edukative me synim forcimin e promovimit dhe të ruajtjes së të drejtave të njeriut, duke eliminuar paragjykimet dhe konceptet që nuk përshtaten me lirinë e fesë ose të besimit, si dhe për të siguruar të drejta të barabarta për gratë dhe burrat në fushën e edukimit dhe lirisë së fesë apo të besimit. Kjo në veçanti për mbrojtjen e të drejtës së vajzave për edukim, sidomos për ato që rrjedhin nga grupet vulnerabile.

Gjithashtu u kërkua që të dënohen të gjitha format e intolerancës dhe diskriminimit të bazuara në fenë dhe besimin që nxisin urrejtjen, racizmin ose ksenofobinë, dhe të marrin masat përkatëse kundër atyre që manifestojnë shfaqje të tilla në kurrikulën e shkollës, në tekstet shkollore dhe metodat e mësimdhënies si dhe në ato të ezazuara nga media dhe teknologjia e re informative, përfshirë Internetin;

Për të realizuar këto u konsideruan të favorshme objektivat për inkurajimin e personave që merren me mësimdhëniet për të kultivuar respektin për fetë ose besimet, duke promovuar mirëkuptimin dhe tolerancën e gjithanshme; solidaritetin ndërkombëtar dhe shanse të barabarta për burrat dhe gratë;

Shtetet, në nivelet përkatëse qeverisëse, duhet të promovojnë si në edukimin shkollor dhe në atë jashtëshkollor, veprimtaritë e organizuara nga institucionet edukative të çdo natyre, parimet dhe objektivat e këtij dokumenti, veçanërisht atë të mosdiskriminimit dhe tolerancës, në vështrim të faktit që sjelljet ndikohen shumë nga faza e shkollimit fillor apo sekondar.

Pa mënjanuar rolin e prindërve, e familjeve, si një faktor thelbësor për edukimin e fëmijëve në fushën e fesë apo të besimit; me tolerancën dhe mosdiskriminimin, u rekomandua që Shtetet në nivelet përkatëse qeverisëse dhe në përputhje me sistemet e tyre edukative, të marrin parasysh sidomos motivimin e mësuesve në veprimtarinë e tyre. Të përgatiten mësuesit që të edukojnë fëmijët me një kulturë respektimi për çdo qenie njerëzore, tolerance dhe mos-diskriminimi; Të inkurajohen gjithë organet dhe institucionet shtetërore, organizatat joqeveritare dhe pjesëtarët e shoqërisë civile që të bashkojnë përpjekjet, duke përdorur me përparësi Mediat dhe

mjetet e shumëanshme të arsimimit dhe edukimit për të luftuar çdo shfaqje intolerance dhe diskriminimi etj.

Konkluzionet dhe rekomandimet e kësaj Konference janë konsideruar mjaft të rëndësishme dhe aktuale edhe për shoqërinë dhe shtetin Shqiptar dhe kanë shërbyer si nxitje për Rekomandimin që i kemi dërguar Kryeministrit, për lidhjen e marrëveshjeve me bashkësitë fetare, në zbatim të pikës 5 të nenit 10 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

III. Konferenca të tjera ndërkombëtare

a. “Në kërkim të vlerave universale të drejtësisë administrative.”

Kjo Konferencë Ndërkombëtare u mbajt nga 17-deri 20 Qershor 2001 në Quebec (*Kanada*)

Këshilli i Gjykatave Administrative Kanadeze (CCAT) është një organizatë kombëtare e përkushtuar përmirësimit të Drejtësisë Administrative. Gjatë 15 viteve të fundit, CCAT ka shërbyer si forum dhe vepruar në Kanada si katalizator për diskutime të ndryshme. Ai ka ofruar mundësi arsimimi si dhe ka marrë pjesë në zhvillimin e politikave si dhe kërkimeve për të përmbushur nevojat e gjykatave, të anëtarëve të tij dhe të komunitetit në tërësi.

Me futjen në Mileniumin e Tretë dhe në kontekstin e globalizmit në rritje, CCAT-i u angazhua për të shkuar përtej mbajtjes tradicionale të konferencave vjetore dhe ftoi që në vitin 1999 komunitetin ndërkombëtar që merret me të drejtën administrative të marrë pjesë në Konferencën e parë Ndërkombëtare në Vankuvër, Columbia Britanike. Delegatët në Konferencën e dytë Ndërkombëtare që u zhvillua në Kebek Siti (*Quebec City*) e konsideruan këtë rast si burin frymëzimi për të nxitur ide të reja për të përballuar sfidat e së drejtës administrative.

Në zhvillimin social edhe ekonomik të kombeve demokratike, e drejta administrative luan një rol të rëndësishëm. Në fillim të këtij shekulli të ri duhen trajtuar një sërë çështjesh të rëndësishme, sikudër janë:

-Vlerat mbi të cilat drejtësia administrative duhet ta bazojë zhvillimin e saj të vazhdueshëm në botë;

-Roli i drejtësisë administrative në ruajtjen e integritetit të institucioneve qeveritare sepse, në të gjithë botën, qeveritë po luftojnë të shqetësuarat për integritetin e organizatave dhe zyrtarëve të tyre publikë. Besimi i publikut në këto institucione është një bazë thelbësore e demokracisë, stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik.

Një vend të rëndësishëm në konferencë ju kushtua marrëdhënive dhe dallimeve të Gjykatës me Ombudsmanin.

Këto institucione u kosideruan si: “Dy të panjohur që ecin nëpër të njëjtën rrugë: Gjykata takon Ombudsmanin”.

Ombudsmanë nga e gjitha bota, sidomos Mediatori i Francës, Ombudsmani i Ontarios (*Kanada*) etj, ofruan pikëpamjet e tyre mbi të drejtën administrative, vënia e standarteve lidhur me pjesëmarrjen, përpikmërinë, ndershmërinë dhe cilësinë e përgjithshme të procesit administrativ dhe rolin e pazëvendësueshëm të Ombudsmanit, si mjet efektiv për parandalimin e proceseve gjyqësore dhe njëkohësisht mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit.

Duke qënë se në Shqipëri nuk ka gjykatë të veçantë administrative, por funksionin e tyre e kryejnë gjykatat e zakonshme, pjesëmarrja në këtë konferencë ishte me shumë vlera për Institucionin tonë.

b. Kongresi i Dytë i Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të vendeve Frankofone.

Shoqata e Ombudsmanëve dhe e Mediatorëve të Frankofonisë (*SHOMF*), e krijuar më 1998, mbajti Kongresin e saj të dytë në Andorre-la Vielle, Principata e Andorres me 14-18 Tetor 2001. Avokati i Popullit është pranuar anëtar më të drejta të plota në këtë shoqatë në Shtator 2000.

Tema e Kongresit ishte “*Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut dhe afrimi, me qytetarët: prerogativat e Ombudsmanit dhe Mediatorit*“. Ajo u lejoi 70 pjesëmarrësve të ardhur nga 26 vende, të riafirmojnë përkushtimin e tyre ndaj vlerave të Demokracisë e të Shtetit Ligjor, si edhe theksuan vullnetin e tyre për të vënë në zbatim një afrim më të madh me qytetarin dhe kryesisht me më të pafavorizuarit.

Ky Kongres ishte një rast për të përforcuar bashkëpunimin me organizata të tjera ndërkombëtare dhe rrjete të ndryshëm që veprojnë në kuadrin e Frankofonisë.

SHOMF riafirmoi mbështetjen dhe solidaritetin ndaj Ombudsmanëve dhe Mediatorëve që gjenden në vështirësi, veçanërisht gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, por gjithashtu edhe ndaj atyre që dëshirojnë të forcojnë pavarësinë e tyre.

Për të njohur e vlerësuar nga afër veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri, në Mars 2002 do të vijë Kryetari i *SHOMF*, Mediatori i Republikës së Francës, Zoti. Bernard Stasi

IV. Vizitat e Ombudsmanëve të Shteteve të tjera në Shqipëri

Në kuadrin e realizimit të detyrës për të bashkëpunuar me Institucionet homologe, Avokati i Popullit gjatë vitit 2001 pati të ftuar disa Ombudsmanë.

1- Më datën 21 Mars 2001, ishte në Shqipëri për here të dytë Ombudsmani Parlamentar i Mbretërisë së Danimarkës, Z.Hans Gammeltoft Hansen. Ai mori pjesë në ceremoninë e rastit për përfundimin e rehabilitimit të selisë së Avokatit të Popullit, realizuar kryesisht me ndihmën e mbështetjen financiare të Projektit DANIDA. Njëkohësisht u përcaktuan përfundimisht fushat e bashkëpunimit ndërmjet Zyrave tona, mbi të cilat vazhdoi gjatë vitit 2001 dhe do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2002, asistenca konkrete e Ombudsmanit Danez për Zyrën e Avokatit të Popullit në Shqipëri.

2- Nga data 5 deri më 8 Gusht 2001 ishte i ftuar për vizitë Z. Marek Antoni Nowicki, Ombudsperson i Kosovës, i caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB në këtë detyrë. Kësaj vizite i kishte paraprirë vizita e zëvendësit të tij, Z. Nikë Lumezi, i cili ishte i pranishëm në ceremoninë e përmendur më lart të dates 21 Mars 2001.

Me Ombudsmanin e Kosovës, u përcaktuan drejtimit e bashkëpunimit ndërmjet dy Zyrave tona. Në veçanti u vendos që stafi me kombësi shqiptare që punon pranë Zyrës së Ombudsmanit të Kosovës, të trajnohej në Shqipëri. Kjo u realizua duke ardhur në Shqipëri në muajin Shtator, dy grupe të specialistëve kosovarë me shpenzimet e Zyrës sonë. Njëkohësisht ne i ofruam zotit Nowicki, gadishmërinë tone për të pritur edhe pjesën tjetër të stafit të tij, që është nga minoritetet e tjera të Kosovës.

Në vazhdim dhe për të ardhmen, mardhëniet e Zyrës sonë me atë të Kosovës, do të jenë shumëplanëshe dhe prioritare.

3- Më datën 27 e 28 Nëntor 2001 ishte i ftuar Ombudsmani i Republikës Greke, Z.Nikiforos Diamandouros. Ai u njoh me veprimtarinë tone dhe u shkëmbyen mendime për mardhëniet e ndërsjellta ndërmjet dy institucioneve tona.

Ombudsmanit të Greqisë iu theksua se nga mediat e ndryshme shqiptare dhe të huaja, si dhe nga ankesat e shtetasve shqiptarë në Zyrën tone, konstatohet se ka raste që autoritetet greke keqtrajtojnë shtetasit shqiptarë që, për arsye ekonomike, kanë emigruar në Greqi, si dhe nuk respektohen të drejtat e tyre, sipas Konventave përkatëse që Greqia ka nënshkruar, si vend anëtar i Bashkimit Evropian.

Është mjaft pozitive për t'u theksuar se Z. Diamandouros, u shpreh i gatshëm për të pritur ankesat e të gjithë shtetasve shqiptarë në Zyrën e tij,

për të luajtur siç duhet rolin për mbrojtjen e tyre, të cilin faktikisht kishte filluar ta bënte edhe para kërkesës sonë.

Ne mendojmë se bashkëpunimi me Zyrën e Ombudsmanit Grek do të vazhdojë të jetë i ngushtë, në interes edhe të miqësisë midis dy popujve e vendeve tona.

4. Nga data 10 deri 12 Dhjetor 2001 ishte i ftuar Mbrojtësi Civil (Difensore Civico), Ombudsman i Provincës së Bolzanos në Itali. Zoti Warner Palla u njoh me veprimtarinë e Institucionit tone, mori pjesë në Konferencën Kombëtare “Për të drejtën e jetës”, dhe u shpreh i gatshëm për zhvillimin më tej të marrëdhënieve të bashkëpunimit me Zyrën tone.

Vëmë në dukje në Zyrën e Bolzanos, në vitin 2000 kemi dërguar një ndihmëskomisionere të Zyrës sonë për trajnim.

V. Vizitat për shkëmbimin e ekperiencës dhe trajnimin e stafit të zyrës së Avokatit të Popullit pranë zyrave homologe.

1. Me ftesë të Z. Anton Canellas, Ombudsmanit të Provincës së Katalonjës (Spanjë), nga data 9-12 Maj 2001 ishte në Barcelonë Avokati i Popullit dhe dy pjesëtarë të stafit të tij. Aty u shkëmbyen mendime për asistencën që ofron Zyra e Barcelonës në kuadrin e nje projekti që ajo ka për ndihmë ndaj Zyrave të reja të Vendeve Ballkanike. Në mënyrë të veçantë theksohet se nga Zyra e Barcelonës ne morëm sistemin e pritjes së popullit, sistem që kemi filluar ta zbatojmë që nga muaji Qershor 2001.

Edhe për këtë vit kemi planifikuar dërgimin e disa anëtarëve të stafit për trajnim pranë kësaj Zyre.

2. Në Janar 2001 në Zyrën e Ombudsmanit Parlamentar të Mbretërisë së Suedisë ishin 5 anëtarë të tjerë të stafit tonë për trajnim.

3. Në Shkurt 2001, 4 anëtarë të stafit tonë shkuan për trajnim në Zyrën e Ombudsmanit të Sllovenisë.

4. Në Mars 2001, një ndihmëskomisioner i Zyrës sonë ishte për trajnim në Zyrën e Ombudsmanit të Hungarisë, kurse një ndihmëskomisioner tjetër ishte në Zyrën e Ombudsmanit të Austrisë.

5. Në Maj 2001 dy ndihmëskomisionerë kanë qënë në Zyrën e Ombudsmanit Federal të Belgjikës për trajnim.

6. Përparësi ka patur trajnimi i të gjithë stafit tonë profesional në Zyrën e Ombudsmanit Danez. Kështu gjatë muajve Shtator, Tetor dhe Nëntor 2001 shkuan për trajnim të gjithë ndihmëskomisionerët, në 3 grupe të kryesuar nga Komisionerët përkatës.

Nga të gjitha këto vizita studimore është përfituar mjaft, gjë që është reflektuar në rritjen e cilësisë së punës. Kjo del qartë si nga ky raport, ashtu dhe nga vlerësimet e ekspertëve të huaj që kanë qënë në Zyrën tonë.

VI. Ekspertët e huaj në zyrën e Avokatit të Popullit

Në kuadrin e ndihmës për Institucionin tone, Këshilli i Evropës, Shoqata e Juristëve Amerikanë ABA-CEELI dhe Zyra e Ombudsmanit Danez kanë dërguar në Shqipëri ekspertë për të marrë pjesë në aktivitetet tona ose për të bërë ekspertizën e veprimtarisë sonë, nëse është në përputhje me standartet e kërkuara.

1. Në muajin Janar dhe Qershor 2001, kanë qënë në Zyrën tonë kryeeksperti Danez z. Jens Olsen dhe specialisti i sistemit kompjuterik z. Christian Moller.

2. Në muajin Prill 2001 organizuam në Tiranë një work shop me stafin tonë për Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ishin të ftuar dhe referuan edhe eksperti danez zoti Ib Trajberg dhe ekspertja e Zyrës së Komisionerit Hungarez për të Drejtat e Njeriut, zonja Katalin Haradzi.

3. Në muajin Qershor 2001, për një periudhë 10 ditore ka qënë i dërguar nga ABBA-CEELI, eksperti kanadez Z. Aleck H. Trawick, ish Ombudsman i Provincës së Albertës në Kanada.

4. Nga data 9-15 Dhjetor 2001, e dërguar nga Këshilli i Evropës, ishte tek ne znj. Marianne Von Der Esch, eksperte në Zyrën e Ombudsmanit Suedez. Kjo eksperte ka qënë në Zyrën tonë edhe në Tetor të vitit 2000 me të njëjtin mision.

Në të gjitha rastet që këta ekspertë të huaj kanë qënë në Zyrën tonë, kanë përpiluar raportet përkatëse, të cilat u janë dërguar si Institucioneve që i kanë dërguar, ashtu dhe Zyrës tonë. Theksojmë se në të gjitha këto raporte të tyre veprimtaria e zyrës së Avokatit të Popullit është vlerësuar pozitivisht.

Raportet e tyre sipas rastit, u janë dërguar si informacione edhe Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit si dhe Kryeministrit. Për të gjitha këto raporte të ekspertëve, kemi reflektuar dhe do të reflektojmë në ato raste që është nevoja për të përmirësuar veprimtarinë tonë.

VII. Bashkëpunimi me Amnesty International

Institucioni ynë ka vendosur raporte bashkëpunimi mjaft të mira me Amnesty International. Në shumë raste kjo Organizatë na ka dërguar njoftime dhe ka kërkuar informacione për çështje të ndryshme, kur ka patur shkelje të rënda të lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri ose për shtetasit shqiptarë jashtë vendit. Në të gjitha rastet ne kemi bërë veprimet përkatëse sipas ligjit “Për Avokatin e Popullit” dhe gjithmonë i jemi përgjigjur me korrektësi kërkesave që na ka drejtuar Amnesty International. Edhe në të ardhmen ky bashkëpunim do vazhdojë të jetë i ngushtë.

VIII. Konferenca Kombëtare “Shteti dhe Shoqëria Civile, në Mbrojtje të së Drejtës së Jetës”

Sipas nenit 30 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, Avokati i Popullit, në bashkëpunim me Organizatat joqeveritare, organizon, të paktën një herë në vit veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë.

Në zbatim të këtij detyrimi në datat 11-12 Dhjetor 2001, u zhvillua Konferenca Kombëtare “Shteti dhe Shoqëria Civile në Mbrojtje të së Drejtës së Jetës”, nën kujdesin e Presidentit të Republikës, organizuar nga institucioni ynë në bashkëpunim me Fondacionin “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Mosmarrëveshjeve”. Konferenca synoi inicimin e një strategjie kombëtare të përbashkët nga gjithë organet shtetërore dhe OJQ-të, për masat parandaluese të ngutshme dhe të qëndrueshme në mbrojtje të së drejtës së jetës dhe në veçanti ndaj fenomenit të gjakmarrjes.

Institucioni ynë bëri konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse të cilat i janë dërguar, Presidentit të Republikës, Kryesisë së Kuvendit të Shqipërisë, disa komisioneve Parlamentare, Kryeministrit dhe Ministrave pjesëmarrës në konferencë, Akademisë së Shkencave, Universitetit të Tiranës dhe atij të Shkodrës. Konkluzionet dhe rekomandimet janë si vijojnë:

Konkluzione:

1. Një nga sfidat me të cilat ndeshet shoqëria dhe shteti shqiptar në dhjetëvjeçarin e fundit është edhe rishfaqja e gjakmarrjes, zakon i trashëguar nga e kaluara e lashtë, i papajtueshëm me parimet e shoqërisë së qytetëruar dhe të shtetit të së drejtës. Ajo shkakton përçarje e hasmëri, sjell

pasoja shoqërore të rënda, me marrjen e jetës së njerëzve, ngujimin e mjaft familjeve, duke i rrënuar ekonomikisht dhe duke i shkëputur nga jeta politike-shoqërore si dhe duke lënë fëmijët pa shkollë. Pra është fakt se në vendin tonë shkelen, rrezikohen ose nuk zbatohen disa nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, për shkak të fenomenit të gjakmarrjes.

2. Pavarësisht se gjakmarrja nuk është e përhapur në të gjithë Shqipërinë, por është fenomen i lokalizuar në disa zona dhe me përmasa të kufizuara, ajo përbën problem shqetësues dhe prandaj meriton të vlerësohet seriozisht si nga pikëpamja politike, ashtu dhe ajo shoqërore. Por për fat të keq organizmat shtetërore akoma nuk kanë arritur të bëjnë vlerësimin e duhur të kësaj situatë të rëndë të krijuar si dhe të mendojnë e punojnë në bashkëveprim të ngushtë me njëri tjetrin. Këtë e tregon fakti se nuk ka statistika të sakta.

3. Zhvillimi i kësaj konference nën kujdesin e Presidentit të Republikës, dhe pjesëmarrja e Tij dhe drejtuesve të 5 Ministrive kryesore që prekin këto çështje, e krerëve të gjyqësorit shqiptar si dhe fjalimet e tyre premtojnë për një ndryshim pozitiv në qëndrimin e shtetit ndaj këtij fenomeni.

4. Shoqëria civile deri tashmë ka operuar vetëm në kuadrin e disa organizatave jo qeveritare, veprimtaria e të cilave vlen të përshëndetet dhe të inkurajohet nga të gjithë, përfshirë shtetin dhe gjithë spektrin e shoqërisë civile. Por ato duhet të mënjanojnë shfaqjet e konkurrencës dhe të jenë shembull i tolerancës ndërmjet tyre.

5. Fenomeni i mësipërm mund të luftohet me efektivitet vetëm nëqoftëse shteti dhe shoqëria civile do të hartojnë e punojnë sipas një strategjie të përbashkët. Zhvillimi i kësaj konference konsiderohet si hapi i parë për këtë qëllim.

Iniciativa për organizimin e kësaj Konference Kombëtare, në kuadrin e përgjithshëm të mbrojtjes së të drejtës për të jetuar, të sanksionuar në Kushtetutën tonë, në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut është një veprimtari e zhvilluar në kohën dhe në mjedisin e duhur, pikërisht që të gjitha këto liri dhe të drejta të realizohen plotësisht.

6. Sipas mendimit të përgjithshëm, të shprehur nëpërmjet referateve, kumtesave e diskutimeve të pjesëmarrësve, Konferenca ja arriti qëllimit të caktuar për sensibilizimin dhe angazhimin më të madh të organeve shtetërore e të shoqërisë civile për parandalimin dhe luftën kundër krimeve ndaj jetës, veçanërisht gjakmarrjes.

Mbi bazën e këtyre konkluzioneve, dolën këto **REKOMANDIME**:

1. Me qëllim që kjo plagë e rëndë shoqërore të kufizohet dhe të zhduket plotësisht del në plan të parë nevoja e hartimit të një strategjie

kombëtare nga organet shtetërore dhe organizatat joqeveritare, me afate të përcaktuara ku të parashikohen masat parandaluese të ngutshme dhe të qëndrueshme kundër gjakmarrjes. Në Konferencë u sugjerua që këtë strategji kombëtare duhet ta marrë përsipër ta bëjë Qeveria, duke krijuar një Komitet Ndërmintor të përbërë nga 5 Ministritë; e Rendit, e Drejtësisë, e Punës dhe e Çështjeve Sociale, e Pushtetit Vendor dhe ajo e Arsimit. Ky Komitet do të analizojë së bashku me organet gjyqësore dhe Prokurorinë çdo 3 ose 6 muaj gjendjen konkrete si dhe të përcaktojë masat për parandalimin e këtij fenomeni.

Qeveria shqiptare duhet të ndikojë mbi organet e administratës publike në varësi të saj për vlerësimin e fenomenit të gjakmarrjes, si dhe të forcojë bashkëpunimin e mbështetjen për organizatat joqeveritare për parandalimin e gjakmarrjes.

2. Një rol të rëndësishëm u takon të lozin deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të cilët mund të japin kontribut të çmuar në takimet me elektoratin, si përsa i përket parandalimit të vrasjeve, ashtu për pajtimin e familjeve në hasmëri. Njëkohësisht do të ishte mjaft i dobishëm krijimi i një Komisioni të posaçëm parlamentar për këtë problem. Parlamenti të miratojë gjithë konventat e firmosura që garantojnë jo vetëm të drejtën e jetës, por edhe të drejta të tjera sociale dhe ekonomike. Parlamenti të nxitë dhe miratojë çdo nismë legjislative për përmirësimin e legjislacionit të mësipërm. Gjithashtu duhet miratuar një ligj që të ndalohet importimi dhe tregtimi i Lodrave të fëmijëve në formë Arme.

3. Në këtë strategji detyra kryesore u dalin organeve të Rendit, si organe të specializuara për mbrojtjen e rendit e të qetësisë publike, për sigurimin e jetës së njeriut. Ato të marrin masa për parandalimin e konflikteve, për zbulimin, kapjen dhe dorëzimin e gjithë fajtorëve organeve të prokurorisë, duke forcuar edhe bashkëpunimin me Interpolin për ekstradimin e vrasësve që fshihen jashtë shtetit.

Rritja e vazhdueshme e autoritetit të shtetit të të drejtës për sigurimin e rendit e të qetësisë, për mbrojtjen e jetës së njeriut, është kërkesa kryesore që dikton situata e tanishme dhe në të ardhmen. Sa më fort të ngjallet ndjenja e siguri së shtetasve, aq më pak do të ketë vetëgjyqësi e gjakmarrje. Roli i Ministrisë së Rendit duhet të jetë më i madh dhe më efektiv për mbledhjen e gjithë armëve.

4. Ministria e Pushtetit Vendor, duhet të japë ndihmë efektive organeve të pushtetit vendor për zgjidhjen e konflikteve e kërkesave të shtetasve, me qëllim që të parandalohen vrasjet dhe ato për gjakmarrje.

Por edhe organet e pushtetit vendor siç janë pleqësitë, komunat, bashkitë, prefekturat të merren më drejtpërdrejt me zgjidhjen e konflikteve,

sepse zgjidhja e shpejtë dhe e bazuar në ligj e ankesave dhe kërkesave të banorëve ndikon mjaft për parandalimin e vetëgjyqësisë dhe të gjakmarrjes. Këto organe të pushtetit lokal duhet të kërkojnë dhe inkurajojnë bashkëpunimin me organizatat jo qeveritare.

5. Rol më të madh pozitiv e parandalues duhet të lozë Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për përmirësimin e programeve mësimore që të sigurohet edukimi i brezit të ri me ndjenjat e vëllazërimit, të mirëkuptimit e tolerancës, kundër vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes, si dhe për trajtimin e mësuesve të zonave ku është e përhapur gjakmarrja që të ndihmojnë nxënësit e ngujuar.

6. Problemet sociale të familjeve të ngujuara kërkojnë një angazhim më të madh të shtetit, posaçërisht të Ministrisë së Punës e të Çështjeve Sociale, që, nëpërmjet zyrave rajonale të ndihmojnë familjet e ngujuara me të ardhura të pamjaftueshme, si dhe për të ulur nivelin e varfërisë e të papunësisë.

7. Organet e prokurorisë duhet të bashkëpunojnë më mirë me policinë dhe të zhvillojnë hetime të shpejta, të plota e objektive, duke ia dërguar çështjet për gjykim me prova sa më të plota gjykatës.

8. Gjykatat kanë për detyrë t'i gjykojnë shpejt dhe të caktojnë dënime të drejta për çdo fajtor. Çdo dënim i butë apo pafajësi e pabazuar i lë shteg vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes personale.

Njohja dhe zbatimi i rregullt nga gjykatat i dispozitave të Kodit Penal, që parashikojnë deri dënim me burgim të përjetshëm për vrasjet për hakmarrje e për gjakmarrje, si dhe dënimin me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet për kanosjen për hakmarrje e gjakmarrje, për t'u ngujuar, do të shërbejnë si armë të fuqishme në luftën kundër gjakmarrjes. Në çdo rast zbatimi i ligjit të mos lërë hapësira për zbatimin e kanunit ndaj autorëve të vrasjeve për gjakmarrje e hakmarrje.

9. Për parandalimin e përgjithshëm social të vrasjeve për gjakmarrje rëndësi të jashtëzakonshme ka edukimi i fëmijëve në familje, në shkollë, në mjedisin shoqëror, si dhe tërë veprimtaria e organizatave dhe shoqatave joqeveritare. Të gjitha fondacionet, misionet e shoqatat që punojnë për zgjidhjen e konflikteve dhe pajtimin e mosmarrëveshjeve, sidomos të atyre me karakter penal, që sjellin si pasojë vrasje, si dhe duke ndërmjetësuar për pajtimin e gjaqeve, ashtu dhe për nxjerrjen nga ngujimi të familjeve e të fëmijëve për të ndjekur shkollën, kryejnë një mision të lartë fisnik e të dobishëm për shoqërinë. Këto detyra të rëndësishme dhe emergjente duhet të jenë prioriteti i këtyre organizatave joqeveritare, roli i të cilave është i pazëvendësueshëm.

10. I madh është dhe akoma më shumë duhet të jetë edhe roli i elementeve, të tjerë përbërës të shoqërisë civile. Klerikët e besimeve fetare, masmedia elektronike (radio, televizioni) dhe ajo e shkruar (shtypi), për ndërgjegjësimin e opinionit publik me ndjenjat e respektimit të institucioneve shtetërore e të ligjeve të shtetit, për përhapjen e përvojës pozitive të pajtimit të gjaqeve, si dhe organizimi i Kuvendeve tradicionale dhe besëlidhjeve vendore. Siç propozoi zoti Pajazit Nushi kryetar i Qendrës së të Drejtave të Njeriut të Kosovës, këto mund të jenë edhe Mbarëkombëtare në të gjitha trojet shqiptare.

11. Në planin edukativ për parandalimin e gjakmarrjes mund të bëhen studime, shkruhen artikuj, të zhvillohen biseda, të botohen materialet e kësaj Konference, fletëpalosje, postera, të organizohen seminare të organeve vendore e të organizatave joqeveritare, si dhe forma të tjera sipas kushteve konkrete të çdo zone. Në këto aktivitete të sqarohet më mirë opinionin publik për qëndrimin ndaj Kanunit, si monument kulture, dhe raportet e tij me ligjet e shtetit. Rol më të madh mund të marrin edhe Akademia e Shkencave dhe Universitetet me anë të Fakulteteve të Drejtësisë dhe Sociologjisë.

12. Avokati i Popullit, nëpërmjet veprimtarisë së tij për zgjidhjen e ankesave të qytetarëve do të veprojë më aktivisht në parandalimin e konflikteve dhe të pasojave të tyre deri të gjakmarrjes. Përfaqësuesi vendor që do caktojë në Shkodër do të ndikojë për nxitjen e administratës publike dhe bashkëpunimin me OJQ në fushën e mbrojtjes së të drejtës së jetës.

Gjithashtu ky institucion do të vazhdojë sensibilizimin e të gjithë Administratës publike shqiptare dhe të shoqërisë civile që të realizohen këto Rekomandime dhe punën e tyre ta matin me rezultatet pozitive që priten.

*
* *

Realizimi i strategjisë kombëtare për parandalimin dhe luftën kundër gjakmarrjes lidhet drejtpërdrejt me organizimin, drejtimin, e bashkëpunimin e organeve shtetërore me organizatat joqeveritare, me gjithë elementet përbërës të shoqërisë civile dhe krejt opinionin publik, duke zbatuar secili detyrat e përcaktuara në ligj si dhe angazhimet e ndërmarra në programet e tyre.

Përparimi i shoqërisë sonë krahas popujve të tjerë të qytetëruar kërkon që të kapërcejmë edhe këtë sfidë, bashkë me sfidat e tjera.

Në Konferencë u shpreh besimi se jehona dhe detyrat që dolën nga punimet e kësaj Konference për mbrojtjen e të drejtës për të jetuar, do të priten mirë kudo. Zbatimi në praktikë i rekomandimeve të saj do të

ndihmojë në realizimin e qëllimit final e human për zhdukjen e plotë të gjakmarrjes në Shqipëri në një të ardhme jo të largët.

*
* *

Deri në fund të muajit shkurt 2002 nuk kemi marrë ndonjë përgjigje apo reagim zyrtar nga Qeveria për qëndrimin e saj ndaj këtyre rekomandimeve.

IX. Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2001

1. Seminar i përbashkët i Institucionit të Avokatit të Popullit me Ministrinë e Drejtësisë dhe Qendrën Evropiane në Tiranë, për funksionimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

2. Seminar i organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit me përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Tregtisë apo në diskutime të organizuara nga kjo Dhomë.

3. Takim i organizuar nga Avokati i Popullit me përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe të Dhomave të Avokatisë Tiranë dhe Vlorë.

4. Janë realizuar marrëveshje bashkëpunimi me disa organizata joqeveritare.

5. Pjesëmarrje aktive në disa aktivitete të organizuara nga O.J.Q. të ndryshme.

6. Pjesëmarrje aktive në seminare të organizuara nga: Aleanca Kundër Korrupsionit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe Departamenti i Administratës Publike pranë Këshillit të Ministrave.

7. Pjesëmarrje aktive në Konferencën e Gjyqësorit.

8. Pjesëmarrje në aktivitete të organizuara nga Ministria e Rendit kundër trafikut të qenieve njerëzore në Tiranë dhe Fier.

9. Trajnim për parandalimin e formave të trafikimit të grave, organizuar nga OSBE, në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit.

10. Trajnim me gjithë stafin tonë, për metodat e punës në grup.

KREU I TRETË

Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat dhe njoftimet (rastet), të grupuara sipas institucioneve qeveritare

1. Këshilli i Ministrave (Qeveria)

Gjatë vitit 2001, për aparatin e Këshillit të Ministrave dhe Institucionet administrative në vartësi direkte të tij, si, Grupi Mbikqyrës, Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, Zyrat e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, kanë ardhur gjithsej 130 ankesa dhe kërkesa.

Duke realizuar detyrën e tij kryesore, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri, Avokati i Popullit në të njëjtën kohë, nuk ka reshtur së informuari, rekomanduari apo sugjeruari Kryeministrin dhe Ministrave për të gjitha çështjet që kanë dalë gjatë punës së tij. Pavarësisht nga forma në të cilën janë paraqitur opinionet e Avokatit të Popullit, mendojmë se, në njërën ose tjetrën mënyrë, kanë ndikuar në rritjen e standarteve të mirëqeverisjes. Konkretisht, gjatë vitit 2001, nga ana jonë i janë dërguar zyrtarisht Kryeministrin këto rekomandime, kërkesa apo njoftime:

1- Për nevojën e një fondi për strehimin e familjes së Gjin Markut (mars 2001).

2- Informacion për pengesat që nxjerr AKP, për regjistrimin e pasurive të paluajtshme që u ka shitur shtetasve. (14.05.2001).

3- Referim për të caktuar Ministrinë përgjegjëse për zgjidhjen e disa ankesave për Basenin e Bovillës (25.05.2001) dhe rikujtuar më (01.10.2001).

4- Mbi ankesën e 168 familjeve nga Komuna Bicaj-Kukës (27.05.2001).

5- Propozim për ndryshime në ligjin nr.7665, datë.21.01.1993, “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin “ (12.10.2001).

6- Informacion për problemet e fshatit Lazarat në rrethin e Gjirokastrës (12.10.2001).

7- Rekomandim për nxjerrjen e disa akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit nr.8606, date.27.04.2000” Për statusin e Dëshmorit të Atdheut” (18.10.2001).

8- Rekomandim për përgatitjen e ligjit për zhdëmtimin e personave të dëmtuar, në zbatim të nenit 44, të Kushtetutës. (24.12.2001).

9-Konkluzione dhe rekomandime nga Konferenca Kombëtare për të drejtën e jetës (26.12.2001).

10- Propozime për marrjen e nismës ligjvënëse, lidhur me përmirësimin e ndryshimeve të akteve ligjore e nënligjore për përfundimin e procesit të rivlerësimit e rishpërndarjes së pasurisë së ish-kooperativave bujqësore si edhe ndryshime në ligjin nr.8435, datë.28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” (26.12.2001).

Faktikisht, nga ana e Kryeministrit nuk kemi patur përgjigje direkte në adresën tonë, por nëpërmjet masave të marra ne kemi konstatuar se ka patur reague pozitive, si p.sh. për strehimin e familjes së Gjin Markut është urdhëruar dhënia e kredisë; për çështjen e pengesës financiare në regjistrimin e pasurive të paluajtshme të blera nga AKP, është dhënë zgjidhje nëpërmjet vendimit përkatës të Qeverisë etj.

Në mosdërgimin e përgjigjeve mendojmë se ka ndikuar edhe klima politike gjatë 3-muajve të fundit të vitit 2001, kohë që përkon edhe me atë të dërgimit të pjesës më të madhe të rekomandimeve. Gjithsesi, vlerësim në tërësi për veprimtarinë e institucionit tonë kemi konsideruar edhe letrën e Ministrit të Shtetit Z. Ndre Legisi, të datës.26.12.2001, i cili në emër të Qeverisë Shqiptare na ka shkruar se: “shprehim konsideratën tonë për arritjet e deritanishme dhe gadishmërinë e qeverisë për të mbështetur punën e institucionit tuaj në të ardhmen”.

a. Grupi Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave

Ndër çështjet e shqyrtuara gjatë vitit 2001, nga institucioni i Avokatit të Popullit, 17 prej tyre kanë të bëjnë me problematikën e veprimtarisë së Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave. Problemet që kanë parashtruar ankuesit, në këto ankesa apo kërkesa të paraqitura, kanë qenë:

1. Mospërfshirja në listat e qytetarëve, që do të përfitonin nga kredia Greke për strehim, pasi keta të fundit kanë humbur banesat për shkak të depozitimit të parave në skemat piramidale.

2. Lidhur me zhvillimin e procedurave në përpilimin e listave të kreditorëve të firmave piramidale, nga administratorët përkatës të Grupit Mbikqyrës.

3. Lidhur me përqindjen e kthimit të parave kreditorëve, pas administrimit, të bërë nga Grupi Mbikqyrës, të shoqerive të cilësuar si firma piramidale.

4. Për procedurat në ndjekje dhe veprimet e Grupit Mbikqyrës për kalimin në pronësi të individëve të caktuar, të pronave të ish firmave piramidale, në procesin e administrimit të tyre.

5. Mosndjekje të procedurave për nxjerrjen në ankand të objekteve, pronë e ish firmave piramidale.

6. Moskthim i parave të depozituara nga kreditorët, në ish firmat piramidale, tashme të kaluara në administrim të Këshillit Mbikqyrës.

7. Mosekzekutim të një titulli ekzekutiv të lëshuar nga Gjykata, për shoqëri në administrim nga Këshilli Mbikqyrës.

8. Mosderdhje të kontributeve për punonjësit që kanë punuar në firmat, të cilësuar, më pas, piramidale, nga ana e Grupit Mbikqyrës, pranë ISSH-së.

Pa i analizuar në hollësi ankesat e mësipërme të cilat në përgjithësi kanë qenë të drejta, mendojmë se është e rëndësishme të theksojmë në këtë raport se qëllimi i veprimtarisë së Grupit Mbikqyrës të firmave piramidale ishte “Transparenca e Firmave”, por në fakt kjo transparencë ka munguar.

Publiku akoma ka ngelur i painformuar se cila është përqindja e vërtetë e parave dhe kur ata do t’i marrin ato para. Kanë kaluar mbi 4 vjet dhe tashmë mund të thuhet se publiku e ka humbur plotësisht besimin tek organi i administratës publike që quhet zyrtarisht “Grupi Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave”.

Duhet theksuar se, gjatë procesit të hetimit të ankesave të paraqitura, është konstatuar si problemor edhe fakti i mospërgjigjes në kohe ndaj kërkesave tona për shpjegime si dhe i dërgimit me vonesa të theksuara të dokumenteve të kërkuara prej nesh nga Grupi Mbikqyrës.

b. Ankesa per Zyrat e Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme

Gjatë vitit 2001 Avokatit të Popullit i kanë ardhur 31 ankesa për Zyrat e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Objekti i ankimit ka qenë i njëjtë: pretendime për pengesa në rregjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme në formën e trojeve, tokave bujqesore e sipërfaqeve me kullota e pyje.

Nga numri total i ankesave janë zgjidhur në favor të ankuesve 7 çështje. Të tjerat, kanë rezultuar si të pabazuara në ligj apo jashtë juridiksionit, pasi kanë pasur të bëjnë me konflikte civile, si rrjedhim i

mbivendosjeve të sipërfaqeve në harta, prandaj edhe kemi sugjeruar zgjidhjen e tyre në rrugë gjyqësore.

Eshtë për t'u evidentuar fakti se të gjitha sugjerimet e rekomandimet tona, në lidhje me ankesat që kanë qënë të bazuara në ligj, kanë gjetur mirëkuptimin dhe ju është dhënë zgjidhje nga këto Zyra.

Por nga ana tjetër, gjatë verifikimeve të disa ankesave, kemi konstatuar se nga nëpunës të veçantë të këtyre Zyrave, janë kryer veprime haptazi abuzive që kanë cënuar rëndë të drejtat e pronësise së shtetasve. Tipik është rasti i ankimit të shtetasit V.Gj, banues në Tiranë. Nga hetimi i kësaj çështje prej grupit të ekspertëve të Institucionit tonë, si dhe nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se me veprime të paligjshme e të kombinuara të Zyres së Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me Ndermarrjen Komunale Banesa nr. 1, të rrethit Tiranë dhe të një shtetasi, ishte bërë njohja e rregjistrimi i pronësise për këtë të fundit mbi një vile, për të cilën asnjëherë nuk ka patur titull pronësie. Mbi bazën e parregullsive të konstatuara, ku konsistonin edhe fallsifikime aktesh, i rekomanduam Prokurorisë së Rrethit Tiranë, fillimin e ndjekjes penale ndaj personave të implikuar në këtë çështje. Prokuroria e Tiranës e refuzoi çështjen, por këmbëngulja jonë bëri që të rifillohen hetimet, të cilat vazhdojnë.

Duke u nisur edhe nga një sërë ankesash nga qytetarë dhe firma ndërtimi, që ankoheshin për shkelje të legjislacionit nga ana e Zyrave të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për rregjistrimin e kontratave të përpiluara para datës. 31.12.2000, për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme të banesave, i kemi rekomanduar Zyres Qëndrore që të rishikojë praktikën dhe të kryejë veprimet hipotekore për të gjithë ata shtetas që kanë kontrata të rregullta shitblerje me shoqëritë e ndërtimit të redaktuara para datës 1 Janar 2001, datë në të cilën ka hyrë në fuqi ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin "Për sistemin e Taksave në Republikën e Shqipërisë". Jemi të bindur, se ky rekomandim, bërë kohët e fundit, do të merret parasysh nga organet përkatëse të administratës qendrore për të rivendosur në vend një të drejtë të ligjshme, nga e cila do të përfitojnë shumë persona, bleres të banesave.

Eshtë fakt që kohët e fundit, mbi bazën e ankesave të shtetasve dhe kontrollet e ushtruara nga Këshilli i Ministrave, janë konstatuar shumë shkelje dhe afëra korruptive midis Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Zyrave të Rregjistrimit të Pasurisë në rrethet Vlorë, Kavajë, Tiranë, Korçë etj, për të cilat kanë filluar edhe hetimet nga Prokuroria. Nga kjo gjendje kemi përcaktuar si detyrë për institucionin tonë që, gjithmonë pas ankesave të drejta, për paligjshmërinë apo parregullsinë e

veprimeve të nëpunësve të këtyre zyrave, të propozojmë edhe masa ndëshkuese ndaj atyre nëpunësve që kanë shkaktuar ose lejuar shkeljet e të drejtave të njeriut, dhe t'i rekomandojmë prokurorisë fillimin e hetimeve kur ekzistojnë elementet e veprës penale, siç kemi vepruar në rastin e përmendur më sipër.

c. Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve

Një grup të veçantë ankesash përbejnë ato lidhur me veprimtarinë e Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe të Komisioneve të Tokës në të gjitha nivelet e tyre.

Për vitin 2001 pranë Institucionit tonë janë paraqitur 82 ankesa ose dyfishi i tyre në krahasim me vitin 2000, të cilat kanë të bëjnë me pretendime për mënyrën e zbatimit të ligjit nr.7698, dt.15.4.1993 “Për kthimin dhe kompesimin e pronave, ish-pronarëve”, Vendimit e Qeverisë dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Në përgjithësi ato kanë qënë të drejta. Konkretisht, kanë të bëjnë me zvarritje në dhënien e vendimeve, nga K.K.K.Pronave, pavarësisht se kërkesat për njohjen e kthimin e pronës, së bashku me dokumentacionet përkatëse, kanë vite që janë depozituar pranë tyre. Kjo dukuri, për fat të keq, po vazhdon të mbartet nga viti në vit dhe ritmet e punës së këtyre Komisioneve rezultojnë tepër të ulëta po të kemi parasysh se janë akoma pa shqyrtuar me mijra dosje të ish-pronareve.

Ne këtë mënyrë u shkelen shtetasve të drejtat e tyre kushtetuese për garantimin e mbrojtjen e pronës private, sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutes. Mangësitë e punës së këtyre komisioneve, përveç apatise, subjektivizmit, mosnjohjes së ligjit, mungesës së ndjenjes së përgjegjësisë e të kontrollit nga Komiteti Shtetëror i Kthimit e Kompensimit të Pronave, pranë Këshillit të Ministrave, kanë ardhur edhe për arsye të boshlleqeve thelbësore që ka lejuar e lejon ligji “Për kthimin e Kompensimin e Pronave ish pronareve”. Të meta të tilla janë moskaktimi i afateve kohore për perfundimin e këtij procesi në mbare vendin, si edhe moskaktimi i afateve, brenda të cilave komisionet të detyrohen të japin vendimin për çdo kerkese të paraqitur. Përqendrimi i Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit Pronave që ekzistonin pranë bashkive dhe rretheve, në një të vetëm, në qendrën administrative të Prefekturave, ka bërë që komisionet të jenë larg njerezve. Ka përqendrim të madh të dosjeve ende të pashqyrtuara e që natyrisht kërkojnë një kohë më të madhe për veprim. Nga informacioni që kemi, vetëm në Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Prefekturës së Tiranës ndodhen rreth 1800 dosje të pashqyrtuara të ish-pronarëve të qytetit e të rrethit të Tiranës dhe të Kavajës. Po ky Komision

ka rreth 100 çështje gjyqsore, të hapura nga ish-pronarët që kanë kundërshtuar në gjykatë vendimet e marra prej tij. Kjo gjendje çon në zgjatjen e perfundimit të procesit të kthimit të pronave dhe vonon në hapjen e rrugës drejt Kompensimit. për të ilustruar zvarritjet kohore që ka sjelle ky perqendrim i KKK të Pronave, po sjell faktin se, që nga vendimi përkatës, në dt.09.04.2001, të gjitha Komisionet e kanë pezulluar veprimtarinë e tyre totalisht për 5-6, muaj për efekte riorganizimi dhe grumbullimi të dosjeve nga komisionet e bashkive e të rretheve. Kështu, Komisioni i Prefektures së Vlores ka rifilluar punën me 1.9.2001. Ka raste kur disa Komisione, si ai pranë Bashkisë Vlorë, në mënyrë flagrante, kanë marrë vendime për kompensimin e pronave, kur ky proces nuk ka filluar, me përjashtim të një mikro-programi të urdhëruar nga Komisioni Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Durrës. Për më keq, në Vlorë, kompensimi është bërë në troje, ku ka pretendime dhe kërkesa nga ish-pronarët. Edhe në rrethe të tjera, janë krijuar probleme dhe konflikte të rënda. Në mjaft raste këto komisione kanë vendosur t'u kthejnë ish-pronareve, tokat bujqesore, që janë trajtuar ose janë në proces, në zbatim të ligjit “ për Token”. Ky fakt tregon se mungon bashkëpunimi midis këtyre komisioneve dhe Zyrave të Kadastres në rrethe. Nuk mund të le pa përmendur me këtë rast se akoma në shumë qytete nuk ka të dhëna të sakta për të ashtuquajturën “vije e verdhe”, e cila ka sjelle abuzime në statusin e tokave.

Një rast tipik, ku shkelen rëndë nga vete përmbajtja e ligjit, të drejtat e ish-pronarit, është ajo që ka të bëjë me ankesën e shtetasit A.T.. Shtetasi në fjalë, ka kërkuar prej vitesh nga KKK të Pronave të Rrethit Sarandë, njohjen e kthimit të një sipërfaqe tërësisht të Ksamil, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Nga ana tjetër, ish-Komiteti i Zhvillimit të Turizmit, mbi të njëjtën sipërfaqe, ka autorizuar dhe u ka dhënë personave të ndryshëm juridikë, vendas e të huaj, statusin e personit të stimuluar në fushën e turizmit, të cilët deri tani, pavarësisht nga marrëveshjet e nënshkruara, nuk kanë bërë investimet e premtuara. Këto veprime, KZH Turizmit, i ka bazuar në ligjin nr.7665, dt.21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, në nenin 7/c dhe 13 të tij. Në nenin 7/c parashikohet që KZH të Turizmit është përfaqësuesi ligjor i pronarit për marrjen në përdorim të truallit së bashku me pasuritë e patundshme që ndodhen mbi të. Ndërsa në nenin 13, nuk shpreh as më shumë dhe as më pak sesa urdhërimin e çuditshëm: “Për çështjet që trajton ky ligj do të zbatohen dispozitat e tij, pavarësisht se ç’parashikojnë dispozitat e tjera ligjore”. Pra, KZH të Turizmit merr përsipër të drejtat e pronarit dhe nuk merr parasysh asnjë akt tjetër ligjor, as Kushtetutën që mbron e garanton të drejtat e pronarit. për këtë arsye i kemi rekomanduar Komisioneve Parlamentare të Ligjeve dhe

atij të Ekonomise, Financave e Privatizimit, marrjen e inisiatives ligjvenese për ç'fuqizimin e neneve 7/c e 13 të Ligjit nr. 7665, dt.21.1.1993 “ për zhvillimin e zonave që kanë perparësi turizmin”. Kemi marre konfirmimin nga Ministria e Puneve Publike dhe Turizmit se po pergatitet nje projekt i ri i ligjit, i cili do beje permiresimet e duhura ne pershtatje me Kushtetuten. Nga ana tjetër kemi sqaruar ankuesin t'i drejtohet Gjykatës.

Ankesa për problemet e kthimit të pronave kanë ardhur nga shume rrethe, por pjesa me e madhe e tyre jane nga Vlora, Elbasani, Durresi dhe Laçi. Ne menyre të veçante, ato me problematike i kemi patur për ish-KKK të Pronave prane Bashkise Vlore, për vendime për kthim pronash me mbivendosje e ne menyre të veçante, për trajtimin që i është bere tokave të ish NB-se ne Uje të Ftohte si dhe trojeve deri ne Jonufer. Ishte ankimi i shtetas P.Sh., që vuri ne levizje Institucionin tone për kryerjen ne vend të verifikimeve, nga të cilat rezultuan nje sere shkeljesh ne zbatimin praktik të legjislacionit për pronesine. këto abuzime, jo vetem ju vune ne dukje organeve të pushtetit vendor, perfshi Prefekturen, KKK të Pronave, ZRPP të rrethit, por dhe jane bere rekomandime për rivendosjen ne vend të të drejtave të ligjshme të shtetasve, të shkelura nga veprimtaria e tyre ne kundershtrim me ligjin.

Duke pare se disa prej veprimeve të drejtuesve të ketyre organeve ne rrethin e Vlores, ishin kryer ne kundershtrim me permbushjen e rregullt të detyres e permbanin elemente të veprave penale, i është rekomanduar Prokurorise prane gjykates se shkalles se pare, fillimi i çeshtjes penale. Siç është bërë tashmë publike, Prokuroria e rrethit të Vlorës po zhvillon hetimet përkatëse.

Komiteti Shteteror i Kthimit e Kompensimit të Pronave duhet të marre persipër pergjegjesite e tij dhe të luaj rolin e duhur për perfundimin e ketij procesi, si ne drejtim të kalimit të prones tek pronaret e ligjshem, por edhe ne mbrojtje të prones shteterore nga abuzuesit dhe mashtruesit. Për këtë del detyra e kompletimit të Komisioneve me njerëz të aftë e të ndershëm, sidomos me juristë të pregatitur profesionalisht.

Dua të theksoj se nje impenjim i veçante ka qenë ndihmesa e Avokatit të Popullit për dhenien e sugjerimeve për projekt-ligjet e paraqitura ne kuadrin e zbatimit të obligimeve të nenit 181/1 të Kushtetutes . Ne kemi studiuar projektet e paraqitura nga Qeveria dhe në mjaft raste aty janë reflektuar Rekomandimet tona për eliminimin e mangësive të lartpërmendura. Duke shpresuar që Kuvendi do t'i shqyrtojë me përparësi këto projektligje, besojmë që në këtë mënyrë ne kemi ndihmuar në mirërregullimin e punëve në këtë fushë.

2. Ministria e Drejtësisë

Ndaj Ministrisë së Drejtësisë ka patur vetëm 5 ankesa direkte për funksionet e saj. Kështu përmendim ankesën e disa ish ndihmësgjyqtarëve, të cilët, pas ndryshimeve organizative të Kodeve të Procedurave Penale dhe Civile dolën të papunë. Atyre nuk ju është siguruar asnjë element i mbrojtjes shoqërore të punës, duke shkelur kështu pikën 2 të nenit 49 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ata persona, të cilët në fillim, gjatë vitit 2000 nuk ishin të paktë, nuk patën në dispozicion asnjë pagesë kalimtare për një periudhë të caktuar kohe, derisa të zinin një vend tjetër pune, në përputhje me profesionin e tyre të juristit. Sipas shpjegimeve të saj, Ministria e Drejtësisë ka pas përgatitur një projekt-vendim për Qeverinë për këtë qëllim, por që nuk është shqyrtuar nga Këshilli i Ministrave. Ky rast është i njëjlojtë me qëndrimin neglizhent që ka mbajtur edhe Prokuroria e Përgjithshme pas shkurtimit të numrit të ish oficerëve të policisë së saj gjyqësore në janar 2001.

Nën juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë ndodhen Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Zyrave të Përmbaramit, organet e pushtetit gjyqësor.

a. Ankesat për burgjet dhe administratën e burgjeve

Në lidhje me burgjet dhe personelin e burgjeve kemi patur mjaft ankesa. Burgjet janë institucione të mbyllura dhe liria në të gjitha shprehjet e saj është e kufizuar dhe mund të shkelen më lehtë të drejtat e të burgosurve. Prandaj nga ana jonë, ankesave nga këta persona ju është kushtuar dhe do t'u kushtohet vëmendje e veçantë. Deri në fund të vitit 2001 ka patur 1330 të burgosur nëpër burgje dhe 320 të dënuar që mbahen në dhomat e izolimit të komisariateve të policisë, si dhe rreth 1000 persona nën hetim sepse akoma nuk ka përfunduar gjykimi i tyre. Pra gjithsej rreth 2650 persona të privuar nga liria.

Gjatë vitit 2001, punonjës të stafit të Avokatit të Popullit kanë vizituar pothuajse të gjitha burgjet që janë në efikasitet, si dhe mjaft komisariate të policisë në rrethe që mbajnë të burgosur me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Gjatë vizitave në këto institucione janë takuar personalisht 75 të dënuar apo të paraburgosur dhe janë marrë 163 ankesa apo kërkesa të shkruara. Gjithsej janë 238 persona, ku përfshihen të burgosur, familjarë të

tyre apo personel i administratës së burgut që kanë aplikuar në zyrën tonë për çështje që lidhen me administratën e burgjeve.

Viti 2001 pati si veçori, në dallim me vitin 2000, se në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë aplikuar edhe punonjës të stafit të administratës së burgjeve që kanë kërkuar rikthimin në vendin e mëparshëm të punës pasi kanë gjykuar se janë larguar padrejtësisht nga detyra. Të gjitha këto raste janë akoma në shqyrtim.

Nga të dhënat e mësipërme del qartë se është rritur besimi ndaj institucionit tonë. Kjo duket qartë nga krahasimi me 6 mujorin e dytë të vitit 2000, kur kanë bërë ankesa vetëm 30 të burgosur.

Të burgosurit që kanë bërë ankesa me shkrim kanë qenë gjithsej 123 persona. Të ndarë sipas burgjeve, gjendja paraqitet si më poshtë:

1.Nga burgu 313, Tiranë	janë ankuar	25 të dënuar
2.Nga burgu 302, Tiranë	janë ankuar	21 të dënuar
3.Nga burgu 325 Tiranë	janë ankuar	10 të dënuar
4.Nga burgu i Lushnjës	janë ankuar	22 të dënuar
5.Nga burgu i Tepelenës	janë ankuar	11 të dënuar
6.Nga burgu i Burrelit	janë ankuar	20 të dënuar
7.Nga burgu i Vaqarit	janë ankuar	5 të dënuar
8.Nga spitali i burgut	janë ankuar	5 të dënuar
9.Nga paraburgimi	janë ankuar	4 të burgosur

Gjithashtu kanë paraqitur ankesa apo kërkesa me shkrim edhe 40 familjarë të të burgosurve.

Të ndarë sipas gjinisë, në 135 raste kanë bërë ankesa burrat, në 17 raste gratë dhe në 11 raste ankesat apo kërkesat janë dërguar nga drejtoritë e burgjeve apo është nisur shqyrtimi me iniciativën e Avokatit të Popullit.

Sipas mënyrës së përfundimit ankesat paraqiten si vijon:

Janë përfunduar 142 ankesa apo kërkesa, nga 163 të ardhura, ndërsa janë në shqyrtim 21 çështje.

Nga rastet e përfunduara 57 ose 40 % prej tyre janë zgjidhur në favor, 49 ose 34 % janë dërguar për kompetencë në organet e tjera, 36 ose 26 % janë konsideruar si të pabazuara në ligj, duke u refuzuar si të padrejta.

Duke bërë grupimin e natyrës së ankesave rezulton:

1- Mjaft të burgosur janë ankuar se mbahen padrejtësisht në dhomat e izolimit të komisariateve të policisë në të njëjtën kohë kur vendimet e Gjykatave kanë kohë që kanë marrë formën e prerë.

Ata kanë pretenduar se ju është shkelur e drejta e njohur nga neni 462 i Kodit të Procedurës Penale që urdhëron ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit të gjykatës, pasi ai ka marrë formën e prerë.

Mbi ankesën e të dënuarve, Institucioni ynë nisi një proces hetimi në përfundim të të cilit doli se në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë në rrethe kishte dhe vazhdon të ketë një numër jo të vogël të dënuarish, të cilët qëndrojnë padrejtësisht në këto dhoma. Për rastet konkrete të të dënuarve që bëjnë ankesat, ne ndërhyjmë që ata të dërgohen në burgje.

Por, Zyra jonë nuk u mjaftua me kaq. Ne i kemi rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë të marrë masa për zhvendosjen e këtyre të dënuarve sa më parë të jetë e mundur nga dhomat e izolimit në burgje.

Në përgjigje të rekomandimit tonë, Ministri i Drejtësisë premtoi se me hapjen e burgut të Rrogzhinës dhe të Lezhës brenda vitit 2002 do të vendoset në vend kjo e drejtë e të dënuarve.

Mendimi ynë është se problemi i mbipopullimit të burgjeve nuk mund të zgjidhet thjesht vetëm duke ndërtuar burgje të reja. Mbi të gjitha, më shumë rëndësi duhet t'i jepet në radhë të parë punës parandaluese që duhet të bëjë gjithë shoqëria dhe shteti shqiptar, dhe së dyti, prokuroritë dhe gjykatat duhet të bëjnë një politikë më të drejtë në zbatimin e masave të tjera të sigurimit. Duhet aplikuar më tepër masa të tilla, si garancia pasurore apo arresti në shtëpi, si dhe duhet aplikuar edhe lloje të tjera dënimi dhe jo vetëm dënimi me burgim. Mohimi i lirisë është një masë ekstreme, e cila duhet të jepet dhe përdoret vetëm nëse masa të tjera alternative do të ishin pa vend për shkak të rrezikshmërisë së madhe të veprës penale të kryer.

2- Të sëmurë mendore mbahen padrejtësisht në spitalin e burgut

Babai i E.Sh., për të cilin Gjykata ka marrë masën mjekësore mbyllje në një institut mjeksor, është ankuar se djali i tij mbahet padrejtësisht në spitalin e burgut Tiranë dhe ka pretenduar se shkelet Kushtetuta në nenin 28 të saj dhe ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

Avokati i Popullit ndërmori një proces hetimi, në spitalin e burgut Tiranë, në përfundim të të cilit rezultoi se në kundërshtim flagrant me nenin 16 të ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” mbaheshin atje edhe 34 persona të tjerë, për të cilët gjykatat kanë vendosur jo burgim, por mjekim të detyruar në institucione mjekësore.

Mbajtja e këtyre personave brenda sistemit të burgjeve është një shkelje flagrante e të drejtave dhe lirive të njeriut, të mbrojtura si nga Kushtetuta dhe legjislativi i Republikës së Shqipërisë, ashtu dhe nga aktet e njohura ndërkombëtare.

Në rastin konkret, duke i mbajtur këta persona në spitalin e burgjeve ku nuk janë kushtet e duhura për kujdes dhe mjekim të posaçëm, gjendja e tyre shëndetësore bëhet më e rëndë. Në këto rrethana, Avokati i Popullit

rekomandoi fillimin e çështjes penale në ngarkim të personave që kanë lejuar një gjendje të tillë.

Çështja është duke u hetuar nga prokuroria e rrethit Tiranë. Por, veç kësaj i janë kërkuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë shpjegime, pse nuk janë marrë masat e premtuara në maj 2001, për çeljen e spitalit të posaçëm për këto persona në Krujë, i cili ishte planifikuar të inagurohej në vjeshtë 2001. Sidoqoftë, kjo çështje vazhdon të ndiqet me prioritet nga ana jonë.

3- Ushtrim dhune nga Policia e Burgjeve dhe shkelje të tjera

a) Mbi ankesën e 5 të dënuarve në Burgun nr. 302, Avokati i Popullit nisi një proces hetimi dhe doli se Policia e Burgjeve kishte keqtrajtuar disa të dënuar. Duke patur parasysh se intensiteti i përdorimit të dhunës ishte shumë i lartë, ne i rekomanduam prokurorisë fillimin e procedimit penal kundër punonjësve të policisë së burgjeve, të cilët kanë vepruar në kundërshtim me nenin 25 të Kushtetutës dhe kërkuam që këta punonjës të Policisë së Burgjeve të përgjigjen për krimin e shpërdorimit të detyrës.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, prokuroria ka konfirmuar fillimin e procedimit penal dhe çështja vazhdon në hetim.

b- Me inisiativën e Avokatit të Popullit, pas një shkrimi në shtypin e ditës, u zhvillua një hetim i hollësishëm dhe iu kërkuua Prokurorisë së rrethit Elbasan të shfuqizojë vendimin e mosfillimit të ndjekjes penale për vdekjen e të dënuarit F. Hysi. Gjatë hetimit tonë doli se 4 ditë para se të pësonte infarkt, ai ka qenë i shtruar në spitalin e burgut, ku është mbajtur vetëm 1 ditë dhe është dërguar përsëri në burg. Duke ngritur versionin se po të ishte mbajtur për t'u ekzaminuar me kujdes në spitalin e burgut, F. Hysi mund të mos kishte vdekur, kërkuam të kryhen hetime në këtë drejtim. Por, Prokuroria e rrethit Elbasan, kërkesën tonë nuk e konsideroi të drejtë, prandaj kërkesën tonë ia kemi paraqitur Prokurorit të Përgjithshëm. Akoma nuk kemi përgjigje.

c) Ka patur 2 raste që të dënuarit kanë pretenduar se ju janë shkelur të drejtat që ju njeh ligji, që favorizon vendosjen e tyre në institucione pranë vendbanimit. Në këto dy raste, D.P.Burgjeve iu është përgjigjur pozitivisht rekomandimeve tona për t'i dërguar të dënuarit pranë vendbanimit të tyre.

d) Në 2 raste familjarët janë ankuar kundër Ministrisë së Drejtësisë pasi ka zvarritur për një kohë të gjatë kërkesat e tyre për ekstradimin e të afërmeve të tyre që vuajnë dënimin në burgjet greke, duke pretenduar se ju është shkelur e drejta e njohur nga neni 492 të Kodit të Procedurës Penale. Në këto raste kemi hyrë në dialog konstruktiv me Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Drejtësisë për të shpejtuar

procedurat e ekstradimit. Në rastin e parë, dokumentat i ishin nisur prokurorit dhe në rastin e dytë u njoftua përsëri pala greke (nga Ministria e Drejtësisë) lidhur me kërkesat për plotësimin e dokumentacionit.

Për këtë çështje është fakt se ka mjaft të dënuar që vuajnë dënimet në Greqi, Itali etj dhe dëshirojnë të ekstradohen për të kryer dënimet në Shqipëri, por kërkesat e tyre tani për tani janë objektivist të paplotësueshme për shkak të mungesës së kapaciteteve të burgjeve tona.

e) Një grup tjetër ankuesish kanë qenë ata që presin për t'u gjykuar. Ata janë ankuar për zvarritje të paarsyeshme në hetimin e gjykimin e çështjeve në ngarkim të tyre kundër Prokurorive e Gjykatave në rrethe. Të paraburgosurit kanë pretenduar se ju janë shkelur të drejtat që ju njeh pika 2 e nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për një gjykim të drejtë e publik brenda një afati të arsyeshëm dhe nenet 263 e 324 të Kodit të Procedurës Penale.

Në këto raste, nga ana jonë janë kërkuar shpjegime për këto zvarritje dhe kemi ndërhyrë për ndërprerjen e shkeljes së të drejtave të të sipërpërmendurve, kur ka qenë rasti.

Në rastin e të paraburgosurit S.L. është kërkuar marrja e masave disiplinore kundër prokurorit Y.B. që ka lejuar shkeljen e të drejtave të këtij të dënuari.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Prokurori i Përgjithshëm, ndonëse nuk kundërshton shkeljen e të drejtës, çmoi se nuk duhet të marrë masa disiplinore ndaj prokurorit.

h) Në disa raste, të paraburgosurit janë ankuar tek ne se janë penguar nga policia të ushtrojnë të drejtën e njohur nga Kushtetuta jonë, në nenin 31 gërma "ç" për t'u mbrojtur me një avokat. Në këto raste, mbi ndërhyrjen tone është ndërprerë shkelja e ligjit dhe ju është siguruar avokati.

f) Kërkesa të burgosurve kundër vendimeve të gjykatave

Kërkesat e të dënuarve për t'ju siguruar një avokat privat pa pagesë kanë qenë të shumta. Është fjala për 50 rastet kur të dënuarit i kanë kaluar shkallët e gjykimit dhe pretendojnë se gjykatat nuk i kanë vlerësuar drejt provat dhe rrethanat e veprave penale, për të cilat janë dënuar dhe kërkojnë ndihmë juridike për të paraqitur kërkesa për rishikim të vendimeve. Njëkohësisht, ata kanë paraqitur pamundësinë e tyre financiare për të pajtuar avokat privat. Në këto raste, ne ju kemi bërë të qartë të burgosurve se Gjykatat janë të pavarura dhe se nuk janë në juridiksionin e Avokatit të Popullit vendimet e gjykatave, sipas nenit 25 të ligjit "Për Avokatin e Popullit". Por në çdo rast ne ia kemi dërguar kërkesat e tyre fondacioneve të krijuara për të dhënë ndihmë juridike falas dhe kemi njoftuar edhe kërkuarit.

g) Grevat e urisë

Gjatë periudhës që analizojmë, Avokati i Popullit në disa raste ka qenë si ndërmjetës midis administratës së burgjeve dhe të dënuarve, të cilët kanë hyrë në greva urie me pretendime se ju janë mohuar të drejtat e tyre. Në mjaft nga këto raste, Avokati i Popullit ka qenë i suksesshëm sepse të dënuarit kanë ndërprerë grevën e urisë, pasi ju janë plotësuar më parë ato kërkesa për të cilat ato kanë patur të drejtë. Ndërsa, në rastet kur ata kanë përdorur këtë mjet si presion për ndryshimin e vendimit të gjykatës, ju është bërë e qartë se ankesa nuk ishte në juridiksionin tonë dhe se çështja nuk zgjidhej me grevë urie, por duke apeluar në organet më të larta të gjyqësorit. Në këto raste kemi ndërmjetësuar edhe për sigurimin e ndihmës juridike falas nëpërmjet fondacioneve të krijuara për këtë qëllim.

*
* *
*

Nga analiza e ankesave dhe kërkesave të të burgosurve që ndodhen në burgjet dhe në dhomat e izolimit, pranë komisarivateve të policisë, del se gjatë vitit 2002, veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit duhet të synojë në realizimin e këtyre Rekomandimeve kryesore për Qeverinë, për Ministrinë e Drejtësisë që ka në vartësi Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe për Ministrinë e Rendit.

1. Përfundimin e procesit të nisur për kalimin e plotë të dhomave të izolimit pranë komisarivateve të policisë në vartësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

2. Marrjen e masave për zhvendosjen e gjithë të dënuarve nga dhomat e izolimit në burgje.

3. Hapjen e spitalit të posaçëm për të sëmurët mendorë që mbahen në spitalin e burgut, sipas vendimeve të gjykatave për mjekim të detyruar.

4. Të përmirësohen në vazhdimësi kushtet e jetesës në burgje, si dhe t'u krijohen të gjitha kushtet për një integrim sa më të shpejtë në shoqëri pas daljes nga burgju.

5. Duhet që një kontroll mjekësor që në pranim të zbatohet në mënyrë strikte dhe sistematike, në të gjitha institucionet që presin të burgosur në Shqipëri, qofshin në vartësi të Ministrisë së Rendit Publik apo të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të plotësohet legjislacioni për burgjet, duke nxjerrë aktet zbatuese për t'i lejuar ata të punojnë dhe të shpërblehen për punën e kryer, sepse sipas akteve në fuqi shpërblimi i punës së tyre është simbolik dhe i padrejtë.

7. Duke patur parasysh disa ankesa, kemi konstatuar se nuk është nxjerrë ligji për zhdëmtimin e personave të dëmtuar padrejtësisht nga veprimi i organeve të shtetit. Për këtë qëllim, duke patur parasysh rëndësinë e problemeve, po e citojmë shprehimisht Rekomandimin e mëposhtëm që i është dërguar njëkohësisht Kryeministrit, Ministrit të Drejtësisë, si dhe Komisioneve Parlamentare për Ligjet dhe për të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë, me anë të të cilit kërkojmë të zbatohet neni 44 i Kushtetutës, jo vetëm në çështjet penale, por edhe ato civile.

Rekomandim për përgatitjen e ligjit për zhdëmtimin e personave të dëmtuar

Drejtuar: Institucioneve të sipërpërmendura

1. “Në Institucionin e Avokatit të Popullit, disa shtetas kanë depozituar ankesat e tyre me anën e të cilave kërkojnë të zhdëmtohen për burgim të padrejtë.

Nga shqyrtimi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Kodit të Procedurës Penale, del se:

Në nenin 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është përcaktuar e drejta e individit për t’u zhdëmtuar në përputhje me ligjin në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

Kurse në kreun e pestë të Kodit të Procedurës Penale, në nenet 268 e 269 janë parashikuar kushtet e zbatimit si dhe afatet e paraqitjes së kërkesës për kompesim për burgim të padrejtë.

Në pikën 2 të nenit 269, ligjvënësi ka përcaktuar që masa e kompesimit, mënyra e llogaritjes, si dhe rastet e kompesimit për arrestin në shtëpi të caktohen me ligj të veçantë, ashtu siç përcaktohet edhe në nenin 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në praktikën e punës së përditshme, Gjykatat aplikojnë për kompesim kriteret e nenit 57 të Kodit Penal, i cili në këtë dispozitë parashikon se “koha e paraburgimit llogaritet në dënimin me burgim ose me gjoba... një ditë paraburgim baraz me 5 mijë lekë gjobë...”. Pra, kjo vlerë nuk është caktuar për të kompesuar ditët e burgimit të padrejtë, por për të llogaritur masën e gjobës në rast se i dënuari ka qenë i paraburgosur dhe në përfundim nuk dënohet me burgim, por dënohet me gjobë.

Megjithëse ka kaluar mbi 3 vjet nga dita kur ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe 6 vjet nga dita që ka hyrë në fuqi Kodi i Procedurës Penale, një ligj i tillë ende nuk është bërë. Mungesa e një ligji të tillë është shkak që nuk gjen zbatim neni 44 i Kushtetutës së

Republikës së Shqipërisë dhe ligja procedurale në kreun e pestë të saj nuk zbatohet siç duhet.

2. Nga gjykimi i mjaft çështjeve civile del se nuk është përcaktuar masa e dëmshpërblimit për personat, të cilët dëmtohen nga veprimtari të paligjshme siç janë shpifjet, fyerjet dhe për këto kërkojnë dëmshpërblim në të holla, për dëmin civil moral të shkaktuar nga këto veprimtari të dënueshme. Në praktikë, gjykatat kanë vepruar në mënyrë individuale për çdo rast.

Përcaktimi i kriterëve për shpërblimin e dëmit civil moral në rastet e dëmtimeve nga veprat penale të shtetasve, duhet bërë për të realizuar një zbatim të barabartë e të njëjtë të ligjit, për gjithë shtetasit shqiptarë apo të huaj që kryejnë këto vepra.

Avokati i Popullit, duke parë se mungesa e ligjit që ‘parashikon neni 44 i Kushtetutës është shkaku që krijon premisa për moszbatim dhe shkelje të të drejtave të individëve, në bazë të nenit 63 të Kushtetutës dhe nenit 24 të ligjit nr. 8454, dt. 04.02.1999 ‘Për Avokatin e Popullit’, rekomandon;

Të hartohet drafti i ligjit për kriteret, masën dhe mënyrën e llogaritjes së zhdëmtimit në rastet kur individët dëmtohen për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore, si dhe në rastet kur dëmtohen moralisht nga individë të tjerë”.

Ky Rekomandim është dërguar në dhjetor 2001, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje deri tani.

4- Shtetasit shqiptarë që vuajnë dënimet në burgjet e shteteve të tjera

Shtetasit shqiptarë që vuajnë dënimet në burgjet e shteteve të tjera nuk kanë qenë jashtë vëmendjes sonë. Sinjifikative mund të quajmë takimin e marrë me dy të dënuar në burgun e Dobit në Slloveni, gjatë vizitës në atë burg bashkë me përfaqësuesin e Zyrës së Ombudsmanit Slloven, ku kishim shkuar për marrje eksperience dhe trajnim në shkurt 2001.

Dy të burgosurit shqiptarë pretenduan se meqenëse ata ishin me shtetësi shqiptare, nga administrata e burgut bëhej diferencim nga të dënuarit e tjerë. I dënuari K.B. ngriti pretendimin se ndonëse kishte plotësuar 67 % të dënimit, nuk dërgohej çështja në gjykatë për t’u liruar para kohe me kusht.

Ky pretendim iu paraqit drejtorit të burgut, i cili thirri menjëherë kartelisten dhe pas verifikimit na siguroi se ky i dënuar pas 1 muaji do të lirohej. Konstatojmë me kënaqësi se ky i dënuar vërtetë është liruar në kohën e premtuar.

I dënuari T.R. ngriti pretendimin se duke qenë larg familjes, nuk kishte asnjë të ardhur e për këtë kërkoi të vendosej në punë, dhe se në bibliotekën e burgut nuk ka libra në gjuhën shqipe. Ai u sistemua në punë nga drejtori i burgut, kurse nëpërmjet Zyrës së Ombudsmanit Slloven, nga ana jonë janë dërguar për në burgjet e Sllovenisë disa libra në gjuhën shqipe.

Një inisiativë e tillë u aplikua edhe në një nga burgjet e Danimarkës, ku gjatë vizitës së organizuar në burg u muar takim me të dënuarit shqiptarë dhe ju dorëzuan atyre një numër i konsiderueshëm librash në gjuhën shqipe.

Duke konstatuar këtë gjëndje në lidhje me të burgosurit shtetas shqiptarë që vuajnë dënimet jashtë Shqipërisë, morëm inisiativën për realizimin e një Projekti për të pajisur të gjithë të burgosurit shqiptarë jashtë Shqipërisë me një broshurë në gjuhën shqipe, të quajtur “Rregullat ndërkombëtare të burgut”, të bazuar në Konventat Ndërkombëtare që kanë dalë për këtë qëllim. Kjo bëhet me qëllim që bashkëatdhetarët tanë, kudo që ndodhen, të mësojnë të drejtat e tyre dhe të dijnë si dhe ku t’i kërkojnë ato. Këtë Projekt do ta realizojmë bashkë me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ministrinë e Drejtësisë, të cilat janë treguar të gatshme. Nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme, nëpërmjet Ambasadave dhe Konsullatave tona jashtë vendit, na janë dërguar numri dhe listat e shtetasve shqiptarë që janë të burgosur. Kështu rezulton se deri në fund të vitit 2001 kanë qenë rreth 4600 shtetas shqiptarë të burgosur, nga të cilët rreth 2000 në Greqi dhe rreth 2300 në Itali.

Këtë vit do botojmë rreth 1000 copë të Rregullores dhe me ndërmjetësinë e Ministrisë sonë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme do t’i dërgojmë ato në të gjitha burgjet dhe vendet ku ka shtetas shqiptarë. Nga ana tjetër do të bashkëpunojmë edhe me organizata jo qeveritare si Qendra Shqiptare e të Drejtave të Njeriut etj që të mbledhim edhe një sasi librash apo revista artistike dhe t’i dërgojmë në bibliotekat e burgjeve në vende të tjera.

b. Ankesat për Zyrat e Përmbartimit

Për vitin 2001, në Institucionin tonë janë paraqitur 104 ankesa ndaj Zyrave të Përmbartimit. Objekti i tyre ka qenë kryesisht mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore dhe i titujve të tjerë ekzekutivë. Nga këto, 24 ose rreth 24 % e tyre janë zgjidhur në favor të ankuesve. Duke i analizuar rastet e ankesave ndaj Zyrave të Përmbartimit, ato ndahen:

1- Mos ekzekutim i vendimeve gjyqësore të formës së prerë kur debitore është një institucion me buxhet shtetëror. Këto ankesa zënë numrin më të madh të ankesave dhe megjithë punën e bërë nga Institucioni ynë, ky problem nuk po gjen rrugëzgjdhje.

Ne e kemi ngritur këtë çështje edhe në Raportin Vjetor të vitit 2000. Sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë, kanë qenë rreth 453 vendime gjyqësore të tilla që kërkonin rreth 6 milion USD nga buxheti i shtetit për t’u ekzekutuar. Përsëri për vitin 2001, gjendja nuk është përmirësuar. Të

dhënat e mara nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit në Ministrinë e Drejtësisë flasin për rreth 450 vendime gjyqësore që kërkojnë po rreth 6 milionë USD nga buxheti i shtetit. Veç mungesës financiare, mosekzekutimin e pengon edhe ngathtësia e administratës për t'i rregulluar problemet siç duhet.

Pikërisht, për këtë arsye kemi dërguar një Rekomandim për marrjen e masave dhe nxjerrjen e udhëzimeve që përcakton V.K.M. nr. 335, dt. 02.06.1998 "Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit", drejtuar ish Ministrit të Financave, z. Anastas Angjeli dhe ish Ministrit të Drejtësisë, z. Sokol Nako me këtë përmbajtje:

"Në veprimtarinë e saj për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit, Zyra e Avokatit të Popullit e udhëhequr nga parimet e njohura të paanësisë, të profesionalizmit dhe pavarësisë, ka marrë dhe po shqyrton mjaft kërkesa dhe ankesa të shtetasve që bëjnë fjalë për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe sorollatje të paimagjinueshme disa vjeçare të ankuesve, që e kanë bazën në mosplotësimin e kërkesave të VKM-së nr. 335, dt. 02.06.1998, për nxjerrjen e udhëzimeve të përcaktuara në të.

Ky mosplotësim i kërkesave të vendimit të sipërcituar ka vënë para një përgjegjësie të madhe edhe organet drejtuese të Pushtetit Lokal përballë banorëve të njësive të tyre vendore, duke mos ju krijuar asnjë mundësi reale në përmbushjen e detyrimit kushtetues për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Më lejoni t'i referohem shprehimisht kërkesave që përcakton në pikën 1 dhe 4 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 335, dt. 02.06.1998.

Në pikën 1, paragrafi i dytë është lënë detyrë që: "Detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore përballohen nga vetë institucioni brenda fondeve të miratuara për vitin buxhetor, sipas kriterëve e procedurave që do të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave".

Kjo kërkesë e VKM-së për dy Ministritë që Ju drejtoni, nuk është përmbushur e për pasojë, mosnxjerrja e këtij udhëzimi e bën të porealizueshëm pikën 1 të vendimit, ç'ka do të thotë që të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë të mos ekzekutohen.

Në pikën 4 të po këtij vendimi është përcaktuar se: "Për vendimet gjyqësore që lidhen me nenin 6 të Ligjit Nr. 7698, dt. 15.04.1993, ngarkohet Ministria e Financave që brenda 3-mujorit të tretë të vitit 1998 të përgatitë dhe propozojë ndryshimet përkatëse të ligjit".

Pavarësisht nga rezervat ligjore që kam për përmbajtjen e pikës 4 të VKM-së nr. 335, dt. 02.06.1998, konstatoj me keqardhje se ky detyrim ligjor nuk është përmbushur akoma e për pasojë, vendimet gjyqësore të formës së prerë që kanë lidhje me zbatimin e nenit 6, paragrafi i II-të i Ligjit nr. 7698, dt. 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish pronarëve”, ngelen në letër e të pazbatueshëm.

Në këto kushte, institucioneve të tjera dhe Zyrës së Përmbartimit, u krijohet një pengesë artificiale për mospërmbushjen e detyrimit kushtetues që përcakton neni 142, pika 3 që detyron organet e shtetit të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

Nisur nga interesi i përbashkët që kemi për zbatimin me korrektesë të Kushtetës së Republikës së Shqipërisë dhe Legjislacionit në përgjithësi, bazuar në nenin 24 gërma “b” të Ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, që na jep të drejtën t’u propozojmë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore, Ju Rekomandoj marrjen e masave të shpejta për nxjerrjen e udhëzimeve që parashikohen në pikën 1 dhe 4 të V.K.M. nr. 335, dt. 02.06.1998 “Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit”, me qëllim që të vihen në vend të drejtat e shkelura padrejtësisht të shtetasve nga mosveprimi i patolerueshëm për zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe akteve ligjore, siç është edhe ky vendim Qeverie”.

Përgjigjen për masat që do të ndërmerren ministrat e sipërpërmendur duhet t’a jepnin brenda 30 ditësh por, megjithëse ky afat ka kaluar prej më tepër se 3 muaj, akoma nuk kemi ndonjë përgjigje. Problemi do vazhdojë të ndiqet me përparësi nga ana jonë: Konkluzionin se ka ngathtësi dhe neglizhencë të organeve, që duhet të synojnë dhe ndikojnë në zgjidhjen e këtij problemi, e tregon edhe fakti që përsëri nga 100 milion lekë që kishte planifikuar buxheti i shtetit i vitit 2001 për të harxhuar për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave, Ministria e Financave ka harxhuar vetëm 56% të kësaj shume, në një kohë që me këtë diferencë të pashpenzuar mund të ekzekutoheshin edhe dhjetra vendime gjyqësore për shuma të vogla për çështje mosdhënie pagash, shpërblimesh etj.

2- Ankesa ka patur për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në një kohë që në fakt nga verifikimi ynë ka rezultuar se përmbartuesit gjyqësorë kishin vendosur pushimin e ekzekutimit të çështjes dhe këto vendime nuk u janë bërë të njohura ankuesëve. Nga ana jonë, me t’u konstatuar kjo shkelje, janë vënë në dijeni ankuesit, duke ju shpjeguar edhe e drejta e ankimit brenda 5 ditëve në gjykatën e rrethit, siç parashikon neni 610 i Kodit të Procedurës Civile. Nga verifikimi i këtyre rasteve,

rezultoi se përmbauesit, kopjet e vendimit i kishin dërguar me postë. Por, ankuesit pretendojnë se nuk e kanë marrë dhe mbi këtë bazë është bërë komunikimi i ri, duke u shënuar edhe data e komunikimit të vendimit, me qëllim që atyre t'u jepej mundësia sipas ligjës për t'u ankuar në gjykatat e rretheve.

3- Ankesa ndaj Zyrave të Përmbaimit janë bërë edhe në rastet kur gjatë fazës së ekzekutimit, palët në konflikt e kanë zgjidhur çështjen civile me pajtim. Por, me këtë pajtim nuk kanë qenë dakort pjestarë të tjerë të familjes, të cilët kanë bërë ankesë se Zyra e Përmbaimit nuk ekzekuton vendimin. Si shembull të kësaj natyre mund të përmendet ai i ankuesit T.Ç. nga Lazarati i rrethit të Gjirokastrës.

4- Ankesa ndaj Zyrave të Përmbaimit ka patur edhe në rastet kur janë ekzekutuar vendimet gjyqësore, por pala debitore nuk zbaton urdhërimet e përmbauesit gjyqësor, megjithë paralajmërimet e bëra, duke pushtuar përsëri objektin e konfliktit. Në këto raste, nga ana jonë, ankuesit janë orientuar që t'i drejtohen me padi civile gjykatës së rrethit me objekt pushim cënimi në pronësi.

Nga rastet e zgjidhura në favor, mund të përmendet ai i Z.K., e cila kishte për ekzekutim një vendim gjyqësor për pension ushqimor për fëmijën dhe Zyra e Përmbaimit Tiranë nuk e ekzekutonte. Për këtë, nga ana jonë u ndërhy në Zyrën e Përmbaimit, e cila bëri kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Tiranë ndaj personit që ishte i detyruar të paguante pension ushqimor dhe nuk e paguante atë. U arrit që A.Ç. të dërgohej në gjyq si i pandehur për mospagimin e pensionit ushqimor në dobi të fëmijës së tij. Gjatë gjykimit penal në gjykatë, ai pagoi gjithë detyrimin e prapambetur të pensionit. Ndërkohë, ankuesja u orientua edhe që të bënte padi të re për rritjen e masës së pensionit. Kjo padi u pranua nga gjykata dhe masa e pensionit u rrit nga 500 lekë në 4500 lekë në muaj. Në këtë rast, ne kemi patur parasysht Konventën për të drejtat e fëmijëve, e cila përcakton ndër të tjera se në çdo rast, interesat e fëmijëve janë prioritare.

Shtetësja F.V. u ankua se Zyra e Përmbaimit Pogradec gjatë zbatimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Pogradec ka anashkaluar shumë procedura dhe, duke u nisur vetëm nga bindjet e saj personale, duke shkelur nenet 560 dhe 563 të Kodit të Procedurës Civile, i ka bllokuar një prone që nuk kishte të bënte me vendimin, duke ju sjellë dëme të tretëve që nuk kanë lidhje me konfliktin gjyqësor.

Mbas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit pranë Zyrës së Përmbaimit Pogradec dhe pranë Drejtorisë së Përmbaimit në Ministrinë e Drejtësisë, u arrit që procedurat civile të respektoheshin dhe të pushonte bllokimi i pronësisë pa të drejtë i qytetares F.V.

Zyrat e Përmbarrimit, veprimtarinë e tyre e mbështesin në Ligjin 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin të shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor”, por veprimtaria e tyre le shumë për të dëshiruar. Ka zvarritje procedurash, paaftësi etj, gjë që sjell një opinion negativ tek qytetarët. Pas sfilimit nëpër gjyqe, qytetarët i prët dhe një kalvar i gjatë zvarritjesh me sfond korruptiv pranë Zyrrave të Përmbarrimit. Prandaj ka vend për të bashkëpunuar më shumë me Drejtorinë e Përmbarrimit pranë Ministrisë së Drejtësisë, puna e së cilës nuk është në nivelin e duhur si në organizimin dhe bërjen të zbatueshëm të ligjit të ri, në kërkesën e paketë të llogarisë ndaj Përmbarruesëve të ndryshëm si dhe në mosmarrje masash për raste flagrante të shkeljes së procedurave gjatë ushtrimit të detyrës.

Një detyrë ngelet që në rastin e konstatimit të shkeljeve të ligjit nga përmbarruesit, të propozohen masa administrative ndaj tyre, prej Avokatit të Popullit.

c. Avokati i Popullit dhe marrëdhëniet e tij me gjykatat dhe pushtetin gjyqësor

1- Sfondi ligjor

Institucioni i Avokatit të Popullit është një institucion tepër i ri për mjedisin e shoqërisë shqiptare, por është një nga dy institucionet më të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Por, i pari është Institucioni i Gjykatës, pushteti gjyqësor, sepse ky ka fuqi të plotë vendimmarrëse.

Dihet se në kryerjen e funksioneve të tyre gjyqësore, gjyqtarët janë të pavarur në dhënien e vendimeve, por jo të pavarur nga ligjet. Kjo pavarësi është në të mirë të interesit publik. Vendimet e tyre në asnjë rast nuk mund e nuk duhet të jenë objekt i ndonjë shqyrtimi apo vlerësimi jashtë procedurave gjyqësore nga gjykatat e shkallëve më të larta. Çdo përpjekje e pushteteve të tjera, legjislativit apo ekzekutivit, për të bërë vlerësimin e drejtësisë apo padrejtësisë së vendimeve të gjykatave, është e rrezikshme për shtetin e së drejtës dhe demokracinë, por në veçanti, janë të rrezikshme për të drejtat dhe liritë themelore të njerëzve. Në këtë drejtim, gjyqësori ka patur dhe do ketë si mbështetje edhe Avokatin e Popullit.

Pavarësia e gjyqësorit është e rëndësishme jo vetëm për vendin tonë me demokraci e shtet ligjor në zhvillim, por edhe për vendet me tradita demokratike. Prandaj, jo vetëm në vendin tonë, por edhe në mjaft nga ato vende funksionon Institucioni i Ombudsmanit. Kjo me qëllim që të rritet efikasiteti dhe besimi i publikut tek gjyqësori. Ndhimesa e Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili është jashtë gjyqësorit, luan një rol të rëndësishëm për këtë çështje.

Siç kemi njohuri nëpërmjet literaturës, si dhe nga shkëmbimi i legjislacionit dhe i eksperiencave me kolegë nga vende të ndryshme, pushteti i Ombudsmanit në marrëdhënie me organet gjyqësore është i ndryshëm nga një vend në tjetrin. Kompetenca maksimale ka Ombudsmani parlamentar Suedez, vendi ku ky Institucion ka origjinën dhe vepron zyrtarisht qysh prej vitit 1809.

Kushtetuta dhe ligji “Për Avokatin e Popullit” i kanë zgjidhur drejt marrëdhëniet tona. Pushteti ynë në lidhje me gjyqësorin është i tillë që nuk e prek dhe as e rrezikon pavarësinë e gjyqtarëve në dhënien e vendimeve gjyqësore.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e miratuar në vitin 1998, në nenin 60 të saj përcakton se:

“Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike”.

Kurse në pikat 3 dhe 4 të nenit 63 të Kushtetutës thuhet se:

“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.

Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”.

Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, në nenin 25 të tij thekson se: “Janë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit”, ndër të tjera edhe “c” vendimet e gjykatave. Pa cënuar shkronjën “c” të këtij neni, Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa apo njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe procedurat gjyqësore. Hetimi i Avokatit të Popullit nuk prek pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit”!

Po kështu, sipas pikës b të nenit 18 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, Avokati i Popullit, pas pranimit të ankesës, kërkesës apo njoftimit për shqyrtim...” ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga organet e administratës, si dhe prokuroria, në rastet e arrestimeve dhe ndalimeve”.

Në nenin 19, në pikën b thuhet se “Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qëndrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”.

Kurse në pikën “dh” të nenit 21 të këtij ligji thuhet se “Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:

dh- Për shkelje të të drejtave nga organet e pushtetit gjyqësor, pa ndërhyrë në procedurën që ato zbatojnë, Avokati i Popullit i bën të ditur shkeljet organit kompetent”.

Pra, siç shihet nga Kushtetuta dhe ligji përkatës, Institucioni ynë ka mjaft mundësi ndërhyrje në organet gjyqësore. Praktika afër 2-vjeçare, tashmë ka treguar se ne kemi patur mirëkuptim me gjyqësorin për këto çështje dhe besoj se do të vazhdojmë të jemi në marrëdhënie korrekte. Kjo sepse të gjithë jemi të interesuar që të realizohen me përpikmëri të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Nuk duhet që gjyqtarët, veç atyre që me dashje shkelin ligjet, të kenë frikë nga fakti se Avokati i Popullit bën verifikime të ankesave kur ne marrim apo studiojmë dosjet gjyqësore. Aq më tepër që këto dosje janë të hapura për çdo individ (pjesëmarrës në çështje, apo avokatët e tyre) dhe natyrisht shqyrtimi i Avokatit të Popullit nuk ka prekur dhe nuk do të prekë në asnjë rast pavarësinë në dhënien e vendimeve apo fuqinë e tyre.

Vendi ynë, si vend ish komunist që po kalon një periudhë tranzicioni ka akoma mjaft të meta dhe mangësi në veprimtarinë për dhënien e drejtësisë nga gjykata. Këto rrjedhin për shkaqe të tilla, duke filluar nga paaftësia e gjyqtarëve, deri tek korrupsioni i tyre.

Për këto arsye, aksesimi i Avokatit të Popullit nuk është i vogël dhe mendojmë se kjo është një zgjidhje ligjore e mirë për kushtet e Shqipërisë. Avokati i Popullit ndihmon punën e gjykatave kur njofton për shkeljet procedurale apo shkeljet e administratave të gjykatave. Avokati i Popullit ndihmon edhe duke kërkuar që administrata shtetërore të zbatojë patjetër vendimet gjyqësore. Në këtë mënyrë rritet edhe autoriteti i gjyqësorit ndaj degës së ekzekutivit, i cili ka treguar dhe vazhdon të tregojë me qëndrimet e saj se e nënvleftëson fuqinë e vendimeve gjyqësore, duke i bërë një dëm të pallogaritshëm (jo ekonomik) shtetit të së drejtës.

Ne kemi patur dhe kemi mjaft ankesa kundër vendimeve gjyqësore dhe për procedurat gjyqësore. Për vitin 2000, për 6 muaj që kemi punuar, kanë qenë 177 ankesa që zinin rreth 22 % të të gjitha ankesave, kurse për vitin 2001 janë 372 ankesa që zënë rreth 17 % të të gjitha ankesave të shqyrtuara në vitin 2001. Një pjesë e tyre, 162 ankesa kanë qenë kundra vendimeve gjyqësore, pra jashtë juridiksionit tonë dhe janë refuzuar.

Por, veç 162 ankesave për padrejtësinë e vendimeve, ka patur 210 ankesa edhe për:

- Zvarritje për kohë të gjatë në gjykimet e çështjeve penale apo civile.
- Moszbatim të procedurave në lidhje me njoftimet e palëve për ditën dhe orën e gjykimit.

- Nga të akuzuarit që nuk kanë patur mundësi financiare për avokat privat për mos sigurimin e mbrojtjes në gjykimet penale.

- Kundër administratës gjyqësore që ka vonuar dosjet, duke mos i dërguar shpejt për gjykime në gjykatat e shkallëve më të larta.

- Kundër gjyqtarëve për korrupsion, mos zbatim me dashje të procedurave etj.

Gjatë vitit 2000 kemi zgjidhur në favor 14 ankesa, kurse në vitin 2001 janë zgjidhur në favor 51 ankesa, pra rreth 26 % e ankesave për shkelje të procedurave apo nga administrata gjyqësore.

Mendimi ynë është se aksesit i Avokatit të Popullit mbi organet gjyqësore duhet forcuar, sepse ndikon mjaft në nxitjen e këtyre organeve për të respektuar procedurat gjyqësore dhe si rrjedhojë për të respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njerëzve.

2. Ankesat për çështjet në gjykim

a) Ankesat ndaj Gjykatave të rretheve

Nga numri i përgjithshëm i 210 ankesave për çështjet në gjykim, ato ndaj Gjykatave të rrethit kanë qënë 155. Duke analizuar këto ankesa del se vendin kryesor të tyre e zënë ato për kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve penale e civile duke i konsideruar këto vonesa si zvarritje të qëllimshme. Ankesa të tilla kanë ardhur për gjyqtarë të shkallës së parë në të gjitha rrethet, por më të shumta janë për gjyqtarët e Tiranës, Fierit dhe Korçës.

Nga përgjigjet e dërguara për këto lloj zvarritjes nga gjykatat del se në përgjithësi shkaqet e zgjatjeve kanë qënë ligjore dhe të justifikuar. Nga ana jonë janë sqaruar ankuesit se shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore janë të parashikuara në ligje, nga të cilat më të shumtat kanë qënë vështirësitë që vërehen në njoftimet e palëve, sidomos kur ato janë nga vende të largëta dhe nuk funksionon si duhet shërbimi i postave. Por në përgjithësi qytetarët vazhdojnë të mbeten të pakënaqur.

Por tek ne janë paraqitur edhe ankesa që janë gjetur të drejta sepse, kanë patur të bënin me zvarritje të gjykimit të çështjeve për mos marrjen e masave organizative nga gjyqtarët për një gjykim të shpejtë të tyre. Si të tilla kanë qënë rastet e R.Ç, e cila është ankuar ndaj gjyqtarës A.C, në Tiranë për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimit të çështjes së saj me Ministrinë e Arsimit me objekt pagim-shpërblim nga shkelja e të drejtës së autorit; ajo me ankues K.Gj, në Gjykatën e rrethit Berat etj. Po kështu mund të përmendet si shembull i zgjidhjes në favor edhe rasti i ardhur nga Zyra e OSBE-së Tiranë për zvarritjen e gjykimit penal me të pandehur të mitur A.I. nga Gjykata e rrethit Gjirokastrë. Një ankesë të drejtë ka bërë

edhe shtetasja M.R nga qyteti i Bulqizës, e cila pretendoi se Gjykata e rrethit Bulqizë e kishte gjykuar e dënuar atë për krimin e vrasjes me dashje pa avokat mbrojtës. Kjo shkelje është shumë i rëndë, sepse cënon të drejtën Kushtetuese të parashikuar nga pika ç e nenit 31 të Kushtetutës sonë, si edhe nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Prandaj në Kuadrin e Amicus Curiae (*Mikut të Gjykatës*), shkelja ju bë prezent Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila e konsideroi shkelje të rëndë të rregullave procedurale penale dhe vendosi prishjen e vendimit të Gjykatës se rrethit Bulqizë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim të ri me tjetër trup gjykues.

Ankesa ndaj gjykatave të rretheve ka patur se ato gjatë gjykimeve penale nuk lejojnë për të marrë pjesë të afërmit dhe familjarët, ndonëse gjykimi bëhej me dyer të hapura. Si shembull mund të përmendim atë të R.Sh, i cili u ankua se gjykata e rrethit Durrës nuk lejonte për të dëgjuar gjyqin familjarët dhe të afërmit e tij. Edhe kjo gjithashtu është shkelje e nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, prandaj mbasi u ndërhy nga ana jonë, u arrit që ata të futen në gjyq për të dëgjuar. Po kështu ankesa ndaj Gjykatës janë bërë edhe në rastet kur kërkohet të merret pjesë si ndërhyrës në gjykim dhe nuk pranohen nga gjyqtari i çështjes. Si shembull në këtë drejtim mund të përmendim ankesën e V.D nga qyteti i Fierit, i cili pretendoi se kjo Gjykatë, ndonëse kishte bërë një gjyq me një person dhe i kishte rrëzuar kërkesën për problem pronësie, përsëri po gjykonte të njëjtën çështje dhe nuk e lejonin atë për t'u futur në gjykim si ndërhyrës kryesor.

Ankesa ndaj gjykatave të rrethit ka patur për mos shqyrtimin pa të drejtë të kërkesave për rishikim vendimi për fakte apo rrethana të reja, të dale pas vendimit të formës së prerë. Kështu ka qënë rasti i S.V. nga rrethi i Fierit, i cili pretendoi se Gjykata Ushtarake e Vlorës ka dënuar në mungesë me dy vjet burg djalin e tij G.V. dhe se tani nuk po gjykohej kërkesa e tij për rishikim vendimi. Nga ana jonë u ndërhy dhe po vazhdon rishikimi i çështjes. Gjithashtu ankesa ka patur se nuk u pranohen kërkesat për rivendosje në afat të ankimit, kur gjykimi është bërë në mungesë dhe nuk kanë marrë në dijeni për vendimin e tij. Me ndërhyrjen tonë u janë pranuar kërkesat për gjykim.

Mjaft kërkesa ka patur në lidhje me nevojën e sigurimit të avokatëve për t'i mbrojtur në gjyq, kërkesa që janë bërë nga persona që kanë pretenduar se nuk kanë mundësi financiare për të paguar avokat privat. Ndër këta ka patur edhe kërkesa që interesat e tyre t'i përfaqësojë Avokati i Popullit. Në këto raste ne ju kemi sqaruar se kjo kërkesë nuk mund të plotësohet nga ana jonë sepse nuk e lejon ligji. Megjithatë në të gjitha rastet kërkesa e tyre i është përcjellë fondacioneve apo klinikave të ndihmës

juridike falas dhe janë njoftuar kërkuesit që të lidhen me këto fondacione apo klinika.

Ka patur ankesa ndaj administratës së gjykatave për mosdërgimin e dosjeve nga Gjykatat e rrethit në Gjykatën e Apelit e anasjelltas; se nuk u jepen vendimet që janë shpallur, por nuk janë arsyetuar e zbardhur në kohë. Si raste të kësaj natyre mund të përmendim atë të U.P nga rrethi i Korçës, e cila pasi u verifikua doli se shkak i zvarritjes së dërgimit të saj ka qënë moskomunikimi i rekursit. Kështu rezultoi se ishte bërë kallzim për ndjekje penale për fallsikim dokumentash dhe dosja ka qënë në dispozicion të organit të Prokurorisë së rrethit Korçë deri në përfundim të hetimeve të kësaj çështje. Pasi kanë përfunduar hetimet, dosja është dërguar për gjykim në Gjykatën e Lartë.

b) Ankesat ndaj Gjykatave të Apelit

Ndaj Gjykatave të Apelit tek Institucioni ynë janë paraqitur 17 ankesa.

Duke i analizuar ato del se ankesat ndaj Gjykatave të Apelit kanë patur objekt shpejtimin e gjykimeve, anullimin e vendimeve gjyqësore të shkallës së parë, dhënien e kopjeve të vendimeve gjyqësore pas mbarimit të gjykimit, vonesat në dërgimin e dosjeve për rigjykim, mos pjesëmarrje të avokatëve në gjykim, mosnjoftimi i palëve dhe i të pandehurve për të marrë pjesë në gjykim etj. Nga verifikimi i bërë ka rezultuar se disa nga këto ankesa kanë qënë të drejta dhe është ndërhyrë menjëherë për zgjidhjen e tyre. Si shembull pozitiv dhe që është zgjidhur në favor të ankuesit përmendim ankesën e paraqitur nga M.R, nga qyteti i Bulqizës e cila ishte dënuar 17 vjet burgim për krimin e vrasjes me dashje dhe se gjykimi i saj ishte bërë pa avokat mbrojtës. Me ndërhyrjen tonë u morën masa duke i siguruar mbrojtje në shkallë të dytë, u prish vendimi i Gjykatës së rrethit Bulqizë dhe kthye çështja për rigjykim me tjetër trup gjykues. Rast tjetër është edhe ankesa e V.Ç, i cili kërkonte një kopje vendimi të gjykatës. Ai e kishte kërkuar disa herë dhe nuk i jepej, por me ndërhyrjen tonë u bë e mundur dhënia e kopjes së vendimit ankuesit.

Mund të përmendet si shembull i mirë i komunikimit dhe i mirëkuptimit me Institucionin tonë Gjykata e Apelit Tiranë, e cila kërkesave tonë u është përgjigjur menjëherë, qoftë edhe me biseda telefonike.

c) Ankesat ndaj Gjykatës së Lartë

Është e qartë se Gjykata e Lartë nuk ka lidhje vartësie nga Ministria e Drejtësisë, por ne e kemi radhitur në këtë kre për shkak të lidhjes së problemeve të saj me ato të Ministrisë së Drejtësisë.

Gjatë vitit 2001 është rritur numëri i ankesave ndaj Gjykatës së Lartë. Gjatë 6-mujorit të vitit 2000 ka patur vetëm 10 ankesa, ndërsa për këtë vit numri i tyre ka qënë 38.

Duke analizuar ankesat del se ato kryesisht kanë qënë për vonesa të gjykimit të çështjeve ,dhe moslejim pjesëmarrje në gjykim të palëve. Kurse disa prej tyre kanë kërkuar pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit në gjykimet e tyre. Nga ana e Gjykatës së Lartë ndërhyrjet tona për shpejtim të gjykimeve janë pranuar. Si rast pozitiv edhe që është zgjidhur në favor të ankuesit mund të përmendet rasti i gjykimit të çështjes penale ndaj ankuesit Q.L, i cili ishte dënuar nga gjykata e rrethit Shkodër për krimin e vrasjes ne dashje dhe Gjykata e Apelit Shkodër kishte vendosur lënien në fuqi të vendimit. I gjykuari nuk ishte njoftuar për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes në shkallën e dytë në Gjykatën e Apelit Shkodër. Gjatë shqyrtimit nga Gjykata e Lartë të çështjes u vendos prishja e dy vendimeve, të gjykatës së rrethit dhe Gjykatës së Apelit Shkodër dhe çështja u dërgua për rigjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër, me tjetër trup gjykues.

Në një rast tjetër shtetasi G.B, nga qyteti i Durrësit paraqiti ankesë tek ne se, ndonëse kishte përfunduar gjykimi në Gjykatën e Lartë, atij nuk i jepet kopja e vendimit. Pasi u verifikua ankesa e tij, rezultoi se vendimi nuk ishte arsyetuar e zbardhur në kohë. Ne ndërhyrëm, u arsyetua vendimi shpejt dhe ju dha ankuesit. Ndërsa për ankesat ndaj vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë ankuesit janë sqaruar se institucioni ynë nuk ka kompetencë si për anulimin e vendimeve gjyqësore, ashtu edhe nuk mund të marrë pjesë në gjykimet për të përfaqësuar ankuesit si në Gjykatën e Lartë, ashtu edhe në Gjykatat e tjera.

*

* *

Në përfundim do të thonim se “E drejta për t’u ankuar tek Ombudsmani për sjelljen e një gjyqtari, ka gjithashtu një funksion të rëndësishëm shoqëror si një rregullator i sigurisë. Gjykatat kanë një rol kyç në çdo vend që njeh parimet e shtetit ligjor. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme që çdo individ të ndjejë se mbrohet nga një institucion i paanshëm dhe shumë i kualifikuar kundrejt anshmërisë apo sjelljes jo të rregullt të gjyqtarëve. Veprimtaritë e Ombudsmanit në këtë fushë kontribuojnë në mënyrë thelbësore në ruajtjen e besimit të publikut ndaj

sistemit gjyqësor”. Këtë konkluzion e ka nxjerrë krye Ombudsmani Parlamentar Suedez, zoti Claes Eklundh, i cili pritet të vijë për vizitë tek ne në muajin Prill 2002.

3. Amicus Curiae (Miku i Gjykatës)

Ky është një rol që nuk njihet në legjislacionin dhe në praktikën gjyqësore shqiptare.

Amicus curiae, fjalë për fjalë do të thotë, Miku i Gjykatës. Është një person që ka interes ose pikëpamje të forta mbi çështjen në gjykim, por nuk është palë në gjykim. Ai mund t'i kërkojë leje gjykatës që të paraqesë një dosje, në dukje në emër të një pale, por në fakt për të sugjeruar një arsye themelore në përputhje me pikëpamjet e tij. Këto dosje të Mikut të Gjykatës zakonisht paraqiten në Apel lidhur me çështje me interes shumë të gjerë publik, p.sh. çështjet e të drejtave civile të grave, fëmijëve etj. Këto dosje mund të paraqiten nga institucione, persona privatë ose nga Qeveria. Në apelet e Gjykatave Amerikane të Apelit, këto dosje mund të paraqiten vetëm nëse janë të shoqëruara me një miratim me shkrim të të gjitha palëve, ose me leje të gjykatës.

Ne në Shqipëri, gjatë punës sonë për shqyrtimin e ankesave të shtetasve, për çështje që janë në gjykim shpesh herë konstatojmë se ka vend për të lozur këtë rol. Në fakt, në ndonjë rast të veçantë e për shkelje shumë të rënda ne e kemi luajtur këtë rol. Por çështja është se mund të ketë keqkuptime nga gjyqtarët, sepse mund ta interpretojnë si ndërhyrje në veprimtarinë e tyre. Në fakt kur ky rol bëhet për procedura gjyqësore dhe për çështje madhore, siç janë nevojat e zbatimit të konventave themelore për të drejtat e njeriut, mendojmë se duhet luajtur.

Këtë rol e inkurajoi edhe Këshilli i Evropës në konkluzionet e mbledhjes së Lubjanës, të mbajtur në nëntor 2001.

d- Prokuroria

Prokuroria Shqiptare dihet se nuk është nën juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, por për lehtësi shqyrtimi ne e kemi përfshirë krahas organeve të tjera të drejtësisë.

Për vitin 2001 në Institucionin e Avokatit të Popullit 110 shtetas të ndryshëm kanë paraqitur 100 ankesa apo kërkesa që drejtohen ndaj organit të Prokurorisë, kurse për vitin 2000 kanë qënë 31 të tilla.

Pra, konstatohet se numri i ankesave kundër Prokurorisë, të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit është rritur rreth tre herë, çka tregon për një besim të shtetasve tek Institucioni ynë.

Nga 110 ankuesit, 21 persona kanë qënë nga Tirana, ndërsa 79 nga rrethet, 88 ankues janë të seksit mashkull dhe 22 persona të seksit femër.

Nga numri i përgjithshëm 29 ose 29% e ankesave janë zgjidhur në favor, 24 ankesa kanë qënë jashtë kompetence, 22 ankesa kanë qënë të pabazuara dhe për rrjedhojë ato janë refuzuar, kurse 25 ankesa janë në shqyrtim. Për vitin 2002 ankesat e shtetasve drejtuar Avokatit të Popullit për veprimtarinë e prokurorisë, janë shqyrtuar me precedencë dhe për një pjesë të konsiderueshme janë ndërmarrë edhe hetime, duke marrë deklarime të personave të ndryshëm, kqyrur dhe administruar dokumente, si dhe duke studiuar dosjet hetimore, për të cilat organi i Prokurorisë kishte vendosur pushimin apo pezullimin e hetimeve.

Gjatë shqyrtimit të ankesave, janë konstatuar shkelje të të drejtave të shtetasve, të parashikuara nga nenet 28 dhe 31 të Kushtetutës (*liritë dhe të drejtat vetjake gjatë procesit penal*), neni 42 (*proces të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm*), neni 142/3 (*organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore*), si dhe nga nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*e drejta për liri dhe siguri dhe e drejta për një proces të rregullt*).

Në mënyrë të grupuar, objekti i ankesave të shtetasve ndaj organit të Prokurorisë paraqitet si më poshtë:

1) Për moskryerje të hetimeve të gjithanëshme dhe objektive, që kanë sjellë për pasojë që Prokurorët në mënyrë të nxituar të përpilojnë vendimet përfundimtare për çështjet, pra vendosin pushimin e çështjes penale sipas nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale. Në të njëjtën kohë konstatohen dhe raste kur prokurorët kanë vendosur mosfillimin e procedimit penal ose pushimin e çështjes penale me arsyetimin se: “Fakti nuk ekziston”, duke ju hequr në këtë mënyrë të drejtën të interesuarit apo të dëmtuarit nga vepra penale për të paraqitur ankesë para gjykatës së faktit kundër vendimit të prokurorit. Raste të tilla mund të përmendim:

a) Mbi bazën e informacionit të marrë nga shtypi, Avokati i Popullit ndoqi me inisiativë rastin e të miturit E.Sh, i shtëpisë së fëmijës Sarandë, i cili pretendoi se ishte keqtrajtuar nga oficeri i policisë kriminale në Sarandë, Rr.Xh. Pas verifikimit në vend të ankesës, nga ana jonë ashtu siç kemi paraqitur edhe në Raportin vjetor të vitit 2000, ju rekomandua Ministrit të Rendit Publik, largimi i tij nga puna. Ministri i Rendit e zbatoi këtë rekomandim. Me rekomandimin tonë filloi procedimin penal edhe Prokuroria e Sarandës. Por në tetor 2000 ajo kishte pushuar çështjen, me

arsyetimin e pabazuar se “nuk kishte prova për fajësinë e oficerit”, kurse ne nuk na vuri në dijeni. Pas marrjes së këtij vendimi, ish-oficeri i Policisë kishte ngritur padinë në gjykatën e Sarandës, e cila kishte vendosur rikthimin e tij në punën e mëparëshme. Pasi u vumë në dijeni të këtyre veprimeve, u pa dosja hetimore dhe ju rekomandua Prokurorit të Përgjithshëm shfuqizimi i vendimit të pushimit. Ky rekomandim u pranua me vonesë, pas 8-muajsh. Pas rifillimit të hetimit, çështja penale, është dërguar në Gjykatën e Sarandës për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në ngarkim të të pandehurit Rr.Xh.

Eshtë pikërisht kjo çështje për të cilën Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Ottava (*Kanada*), na ka vënë në dijeni se: “ka marrë dhjetra letra nga qytetarë të ndryshëm kanadezë (*Antarë të Amnesty International*) të cilët denoncojnë rastin e keqtrajtimit nga Policia e Sarandës të fëmijës 12 vjeçar E.Sh, si edhe kërkojnë të merren masat përkatëse nga Shteti Shqiptar për vënien para përgjegjësisë të autorëve. Në të gjitha letrat vlerësohet Institucioni i Avokatit të Popullit për evidentimin e këtij rasti si edhe rekomandimet e bëra për vënien para përgjegjësisë të autorëve. Gjithashtu letërshkruesit kërkojnë që Institucioni i Avokatit të Popullit të japë ndihmesën e tij edhe në drejtim të një kuadri ligjor, i cili mbron të drejtat e fëmijëve”.

b) Shtetasi P.B, në cilësinë kryetarit të shoqatës së arumunëve dega e Sarandës, është ankuar pranë Institucionit tonë se, nga punonjës të Policisë së Konispolit në Komisariatit e Policisë Sarandë janë keqtrajtuar anëtarë të atij Komuniteti L.Sh, dhe S.K. Dhe megjithë kallzimin e bërë në organin e Prokurorisë Ushtarake Gjirokastrë, prej saj janë pushuar hetimet.

Pas verifikimit në vend të ankesës së shtetasve, marrjes së deklarimeve të tyre dhe dokumentave shkresore, fotografive në të cilat pasqyroheshin dëmtimet trupore, në përfundim konkludua se pushimi i çështjes ishte i pabazuar në ligje dhe prova dhe ju rekomandua Prokurorisë rifillimi i hetimeve. Ndonëse me vonesë, rekomandimi u pranua. Në këto rrethana aktualisht çështja penale ndodhet në fazën e rihetimit.

c) Shtetasi Ll.N. nga rrethi i Mirditës u ankua se, nga ana e punonjësve të policisë është ushtruar kontroll banese meqënëse ndaj djalit të tij kishte procedim penal por edhe se janë vjedhur disa sende dhe shuma 200.000lek. Pas verifikimit të ankesës u konstatua se Prokuroria e rrethit Mirditë kishte filluar çështjen penale, por në mënyrë të padrejtë e kishte pushuar atë. Ju rekomandua prokurorit të rrethit Mirditë shfuqizimi i vendimit të pushimit dhe rifillim të hetimit të çështjes penale, rekomandim i cili është pranuar.

d) Rasti i vdekjes në burgun e Kosovës të të dënuarit F.Hysi është përshkruar në pjesën ku flitet për burgjet.

2) Ka patur raste të zvarritjeve në hetimin e çështjeve penale, që kanë sjellë cënime në objektivitetin e hetimit të çështjes, si dhe mbajtjen për një kohë të gjatë të personave në burg, si p.sh 5 persona të akuzuar për akt terrori në Fushë-Krujë, rasti i shtetasit S.L. etj. Gjithashtu ka patur raste kur nuk janë kryer veprimet e nevojshme procedurale, si ekspertime Evropikatrike të personave që kanë qënë nën hetim, kryesisht për raste që ata kanë qënë me masë sigurie “arrest në burg”. Ka patur ankesa edhe për marrje në përgjegjësi penale për një akuzë në mënyrë të padrejtë.

3) Ankesa nga punonjësit e organeve të Prokurorisë.

Shqetësuese është edhe mosdhënia e pagës kalimtare për rreth ish-100 oficerë të policisë gjyqësore, të larguar në janar 2001 nga puna në Prokurori me Ligjin “Për organizimin e Policisë Gjyqësore” Nga ana e Avokatit të Popullit problemi është ndjekur deri tek Presidenti i Republikës dhe ende personat në fjalë nuk kanë marrë pagën dhe ndihmën që u takon, duke ju shkelur të drejtat që ju sigurojnë nenet 49/2 dhe 52/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Justifikimi i Prokurorit të Përgjithshëm se e ka penguar mungesa e buxhetit nuk është i pranueshëm, sepse çështja duhej ndjekur në Këshillin e Ministrave deri në zgjidhjen përfundimtare. Kjo ankesë është e njëlojtë me atë të ish-ndihmës gjyqtarëve ndaj Ministrisë së Drejtësisë, prandaj vazhdon të ndiqet nga ana jonë.

Nga shqyrtimi dhe analiza në tërësi e ankesave të shtetasve drejtuar organit të Prokurorisë, është me interes të përmenden edhe disa konstatime që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës së Avokatit të Popullit me Prokurorinë:

1. Ka patur vonesa në kthimin e përgjigjeve lidhur me rekomandimet, kërkesat për shpjegime apo informacione. Vonesat janë më të theksuar në kthimin e përgjigjeve për rekomandimet, veprime që vijnë ndesh me nenin 63 të Kushtetutës dhe me nenin 22 të ligjit nr. 8454, dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

2. Në rastet e kthim përgjigjeve, ato shpesh janë të përcipta dhe jo me të gjitha të dhënat e kërkuara, gjë që na detyron të rikërkojmë shpjegime dhe të zgjatet koha e zgjidhjes së ankesave apo kërkesave.

3. Ka patur hezitime nga prokurorët për dhënie dokumentash ose të dhëna të kërkuara nga ndihmëskomisionerët kur ankesat verifikohen në vend. Kështu ka ndodhur sidomos me Prokurorinë e Gjirokastrës, ku të dhënat janë dhënë vetëm pas venies në dijeni të Prokurorit të Përgjithshëm. Kjo ndodh në një kohë që ligji “Për Avokatin e Popullit” është shprehur me mënyrë taksative që Avokati i Popullit ka të drejtë të shqyrtojë ankesën, që

të kërkojë e të marrë çdo lloj dokumenti, përfshirë edhe ato që janë sekret shtetëror, pa marrë ndonjë pëlqim paraprak të organit që i disponon.

Nga shqyrtimi i ankesave që janë konsideruar të drejta për shkeljet e konstatuara, sipas rastit, Avokati i Popullit i ka paraqitur Prokurorit të Përgjithshëm apo Kryeprokurorëve në rrethe 17 rekomandime, nga të cilat 9 janë pranuar, 6 rekomandime janë refuzuar dhe 2 rekomandime janë në shqyrtim. Pra konstatohet se, rekomandimet e Avokatit të Popullit, të cilat kanë qënë të bazuara, përgjithësisht janë pranuar, ndonëse disa herë veprimet përkatëse janë kryer me disa muaj vonesë. Por është shqetësuese se nga 5 raste kur është kërkuar marrja e masave disiplinore për shkelje të kryera nga prokurorët, nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm janë refuzuar 4 raste, duke arsyetuar se nuk vlerësohet të merret masë disiplinore.

Rekomandimet për marrjen e masave disiplinore janë:

1. Rekomandim i datës 13.06.2001, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, për marrje mase disiplinore ndaj prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme Y.B, për mosvënien në dijeni me vendimet e zgjatjes së afatit të hetimit të çështjes, të pandehurit S.L. Rekomandimi nuk është pranuar, duke arsyetuar se nuk vlerësohet që të merret masë ndaj prokurorit Y.B.

2. Rekomandimi i datës 17.04.2001, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, për marrje masash disiplinore ndaj Prokurorit të Apelit Vlorë H.H, dhe Prokurorit të Gjykatës së Lartë A.B sepse nuk kishin marrë masa që personi të lirohej menjëherë nga momenti i dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë për lirim e tij të menjëhershëm. Rekomandimi nuk është pranuar, dhe në përgjigje është arsyetuar se nuk është kryer shkelje procedurale, e për rrjedhojë nuk vlerësohet të merret masë disiplinore. Prokurori i Përgjithshëm me sa duket e quan “shkelje të lehtë” të mbajë në burg një person rreth 30 orë pa të drejtë.

3. Rekomandim i datës 24.05.2001 drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, për marrje mase disiplinore ndaj prokurorit I.M, për arsye të mosmarrjes pjesë në disa seanca gjyqësore në një çështje penale, duke mbajtur në burg personin pa të drejtë mbi 15 ditë. Rekomandimi nuk është pranuar me arsyetimin se prokurori nuk është paraqitur në seancat gjyqësore sepse ka qënë në një seminar.

4. Rekomandimi i datës 12.04.2001, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, për shkarkimin nga funksioni të një Prokurori të Tiranës, B.L. që ishte ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale. Ky prokuror në një rast kishte lëshuar urdhërin e ekzekutimit për të lëshuar të burgosurin nga burgu me vonesë. Rekomandimi është pranuar dhe prokurorit B.L. i është dhënë masë disiplinore “Vërejtje”. Më vonë, në një rast tjetër po ky prokuror kishte mbajtur rreth 3 muaj padrejtësisht një person tjetër në burg. Në këtë

rast ne rekomanduam fillimin e çështjes penale ndaj tij. Hetimi vazhdon, por ai nuk është më në punë si prokuror.

3. Ministria e Rendit Publik

Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigozitet i ankesave dhe kërkesave ndaj organeve të policisë së shtetit ka qenë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga detyrat tona kryesore. Kjo jo vetëm për faktin se ky organ i administratës publike përbën elementin, i cili përfaqëson dukshëm fuqinë shtrënguese të shtetit, por edhe për vetë specifikën e Policisë Shqiptare, e cila krahas mjaft arritjeve pozitive, vazhdon të ketë në radhët e saj elemente të papërgatitur profesionalisht, të pa trajnuar me konceptet e shtetit ligjor dhe respektimit të të drejtave të Njeriut, të korruptuar etj.

Në institucionin tonë për policinë gjatë vitit 2001 kanë ardhur gjithsej 198 ankesa, kërkesa apo njoftime, nga 262 persona. Nga këto 30 kanë qenë femra dhe 232 meshkuj. 67 ankesa janë bërë nga banorë të Tiranës dhe 131 janë bërë nga banorë të rretheve të ndryshme të vendit:

Nga ankesat e ardhura kanë përfunduar 150 si vijon: **47** ose 32% janë zgjidhur në favor; **35** janë nxjerrë jashtë juridiksionit; kurse **68** kanë qenë të pabazuara (të padrejta). Janë mbartur për shqyrtim në vitin 2002, 48 ankesa.

Ankesat e ardhura mund të ndahen sipas drejtimeve të mëposhtëme:

I. Ankesat për keqtrajtim të shtetasve:

Janë vlerësuar më tepër sepse kur ato kanë qenë të vërteta, kanë qenë shkelje të rënda të nenit 25 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon se: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës”. Njëkohësisht ato janë edhe dhunime të rënda të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Janë bërë **49** ankesa për keqtrajtime të shtetasve nga Policia e Shtetit shqiptar. Nga këto, **9** janë vlerësuar të drejta, **19** kanë qenë jashtë juridiksionit, **15** të pa bazuara dhe **6** ankesa janë në shqyrtim.

Si raste të zgjidhjes pozitive të tyre mund të përmendim:

1. Ankesa e shtetasit L. D. nga Kuçova, për keqtrajtimin që i kishin bërë djalit të tij, disa punonjës të policisë të Komisarariatit Kuçovë. Nga hetimi i kësaj ankese rezultoi se gjatë muajit Tetor 2000, me urdhër të Inspektorit të Policisë Kriminale z. Leonard Doçi ishte thirrur në komisarariat

shtetasi M. D. 18 vjeç. Shkaku i kësaj thirrje ishte se ai dyshohej si autor i mundshëm i disa letrave kërcënuese drejtuar vajzës së shoferit të policisë të këtij komisariati, Enver Ajazit. Në komisariat djali shkoi me të ëmën e tij, por në vend që me të të punonte vetë inspektori i krimeve, ai ua la që ta pyesnin dy policë, Enver Ajazi, babai i vajzës së kërcënuar dhe Ilir Ademi, njeri i afërm i saj. Ata “të bindur” se M. ishte “krimineli” e keqtrajtojnë mizorisht duke e goditur edhe me dërrase të pajisur me gozhdë, si rezultat i të cilave ju shkaktuan disa plagë të ndryshme në trup dhe në kokë. Megjithëse inspektori i Policisë nuk e keqtrajtoi me dorën e tij, ai kishte shkelur rëndë ligjet dhe rregullat e punës, sepse lejoi me ndërjegje të plotë që në prezencën e tij të keqtrajtohej i dëmtuari dhe të pyetej nga persona që nuk i lidhte detyra funksionale, dhe për më tepër, ata ishin të lidhur me çështjen për të cilën ai dyshohej. Nga verifikimi i librit të shoqerimit të personave në komisariat rezultoi se M. ishte shoqeruar tre ditë rresht dhe ishte mbajtur në komisariat për një kohë me të madhe se ajo e lejuar nga ligji “Për Policinë e Shtetit”,(një herë 24 orë më shumë dhe një herë tjetër 17 orë më shumë).

Ndaj oficerit Leonard Doçi dhe të dy policëve të përmendur më sipër patem edhe një ankesë tjetër nga shtetasi I. L. për keqtrajtimin që i kishin bërë vajzës së tij, nxënëse shkolle, po për të njëjtën ngjarje për të cilën kishin keqtrajtuar edhe M. D. Meqenëse Leonardi i kishte kërkuar falje, ankuesi hoqi dorë nga ankesa.

Veprimet e punonjësve të policisë lidhur me M. D. ishin të kundraligjshme, sepse ato shkelin rëndë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve të garantuara nga neni 25 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nga Ligji “Për Policinë e Shtetit” dhe nga Konventat Ndërkombëtare ku aderon vendi ynë.

Të ndodhur në këto kushte i propozuam Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, z.Bilbil Mema lirim nga detyra të oficerit të policisë Leonard Doçi dhe njëkohësisht i propozuan Drejtorit të Policisë së Qarkut Berat lirim nga detyra të policit Ilir Ademi dhe dhënien e masës disiplinore për policin Enver Ajazi.

Ndaj tyre u morën masa disiplinore, “Vërejtje me paralajmërim”, por mendimi ynë është se këto masa janë të lehta në raport me veprimet e rënda që ata kanë kryer.

2. Ankesa e shtetasit R. Ç., nga Pogradeci për keqtrajtimin që i kishte bërë djalit të tij, Shefi i Policisë së Rendit Pogradec z. Klodian Tili. Nga hetimi në vend i kësaj ankese, rezultoi se në datën 20 Mars 2001 në qytetin e Pogradecit, në orët e darkës, ishte qëlluar me armë dhe kishte ngelur i plagosur një qytetar i rastësishëm. Policia me në krye shefin e

rendit kishin organizuar shërbim në qytet për kapjen e autorit të kësaj ngjarjeje. Rreth orës 20.⁰⁰ në rrugën “Rinia” me urdhër të z.Klodian Tili ndalohet një makinë që po lëvizte dhe tre personat që ishin brenda urdhërohen të dalin jashtë. Ndaj tyre filloi kontrolli për armë në trup dhe në makinë, por nuk ju gjet asgjë e ndaluar nga ligji. Gjatë kontrollit, pa patur asnjë shkak, personat goditen nga shefi i rendit, me grushta e shqelma dhe njërin prej tyre L. Ç. e goditi edhe në syrin e majtë, duke i shkaktuar dëmtime. Pas kontrollit, policia me urdhër të shefit të rendit, i shoqëroi ata në komisariat. Gjatë shoqërimit dhe në komisariat ndaj tyre nuk është përdorur dhunë, por faktikisht nga të dhënat e marra prej tyre policia bëri të mundur të zbulojë autorin e veprës penale.

Shefi i Rendit z. Klodian Tili nuk pranoi që të kishte keqtrajtuar djalin e ankuesit, por kjo u provua plotësisht nga pyetja e të dëmtuarit, e dëshmitareve okular dhe nga akt dëshmia mjeko-ligjore, e shoqëruar nga fotografia e të dëmtuarit.

Gjatë hetimeve rreth kësaj ankese, në Pogradec ndihmës-komisionerët tanë u takuan edhe me shumë qytetarë të tjerë pogradecarë, të cilët u ankuan se ishin keqtrajtuar nga z.Klodian Tili në kohë e vënde të ndryshme.

Nga biseda që u bë me shefin e komisariatit të Policisë Pogradec mësuam se ndaj shefit të rendit z. Klodian Tili ishte bërë propozim në Ministrinë e Rendit **për transferim për mangësi të theksuar në detyrë.**

Për veprimet e kryera, shkeljet e rënda të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasit L.Ç., i propozuam Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit shkarkimin nga detyra të Shefit të Policisë së Rendit Pogradec, z. Klodian Tili. Propozimi ynë u pranua dhe z. Klodian Tili u shkarkua nga detyra e shefit të policisë së rendit dhe u emërua në një detyrë tjetër më të ulët, në një rreth tjetër.

3. Ankesa e shtetasit F. B., i cili pretendonte se ishte keqtrajtuar nga oficeri i policisë gjyqësore Flamur Gjuzi, efektiv i Drejtorisë Policisë Qarkut Durrës dhe se gjatë kohës së shoqërimit të tij në polici atij i ishte bërë kontroll banese, duke mos lënë procesverbal kontrolli. Nga hetimi i kësaj ankese rezultoi se ndaj ankuesit ishte bërë një kallzim penal nga vëllai i tij për veprën penale të kanosjes serioze për vrasje. Ditën e ngjarjes, krejt rastesisht, ankuesi F. B., i cili punon si postjer pranë Gjykatës së rrethit Durrës, kishte shkuar ne Komisarlatin e Policisë Durrës për të shpërndarë postën e gjykatës. Atje atë e ka parë oficeri Flamur Gjuzi dhe e ka thirrur për të sqaruar kallëzimin e bërë në ngarkim të tij, dhe ka sugjeruar për ta zgjidhur këtë problem me mirëkuptim, sepse mosmarrëveshja ishte ndërmjet atij dhe vëllezërve. Ankuesi F.B. nuk e ka

mirëpritur këtë sugjerim të oficerit dhe ka tentuar të largohet, por Flamuri së bashku me dy kolegët e tij e ka kapur dhe ulur në karrige me qëllim sqarimin e problemit. Gjatë këtyre veprimeve ai është çarë në dorën e djathtë nga ora e ankuesit. Kjo e ka irrituar oficerin e policisë dhe në gjaknxehtësi e sipër e ka qëlluar me pëllëmbë ankuesin dhe më pas e ka shoqëruar e mbajtur në dhomat e shoqërimit të policisë. Keqtrajtimi i bërë ankuesit u provua nga kallzimi i tij në Prokurori, akt dëshmia mjeko ligjore, një shkresë e Zv/Kryetarit të Gjykatës së rrethit Durrës, kqyrja e librit të shoqërimit të personave në polici si dhe nga vetë pohimet e oficerit të akuzuar.

Nga hetimi rezultoi gjithashtu se organi i Prokurorisë Durrës kishte filluar procedimin penal ndaj oficerit Flamur Gjuzi, për veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare dhe se vazhdonte hetimet rreth saj. Nga vlerësimi i punës së Flamurit rezultonte që ai kishte rezultate të mira dhe qëndrime korrekte në punë, gjatë punës në polici nuk kishte marrë asnjë masë disiplinore, prandaj kohët e fundit ishte ngritur në përgjegjësi në detyrë.

Meqenëse u provua që oficeri Flamur Gjuzi kishte shkelur të drejtat kushtetuese të ankuesit, por duke mbajtur parasysht edhe të gjitha rrethanat e tjera pozitive të përshkruara më sipër, si dhe pendimin e tij për këto shkelje, ju propozua Drejtorit të Policisë së Qarkut Durrës, që të merte masë disiplinore ndaj këtij oficeri dhe njëkohësisht këtë shkelje ta përgjithësonin me gjithë efektivin e policisë, me qëllim parandalimin në të ardhmen të veprimeve të tilla të kundraligjshme.

Nga Drejtoria e Policisë Qarkut Durrës na erdhi shumë shpejt përgjigja se rekomandimi jonë u pranua.

4. Ankesa e shtetasit D. B., për veprime të paligjshme dhe keqtrajtme të bëra ndaj vajzës së tij 15 vjeçare, nga oficeri i policisë të Komisarariatit Lezhë, Martin Dona.

Nga hetimi i kësaj ankese rezultoi se oficeri Martin Dona, ka marrë në pyetje nxënësen E. B., e cila ishte shoqe e ngushtë me shtetasen B. Sh., që ishte larguar në drejtim të paditur dhe për të ishte bërë një kallëzim nga prindërit e saj. Pyetjen e saj të parë më dt. 18.10.2000 e kishte bërë konform rregullave procedurjale, në prani të prindit. Dy ditë më vonë Martini e ka thirrur vajzën bashkë me të atin e saj në Komisarariat, por e ka marrë në pyetje pa praninë e tij. Ai e ka lënë të lirë atë pas 4 orësh, dhe kur ka dalë në orën 24⁰⁰ nga Komisariat, ajo i ka thënë të atit se gjatë pyetjes është goditur me shkop gome nga oficeri i policisë Martin Dona, kurse një person tjetër që ka qënë i pranishëm në pyetje, i veshur me uniformë policie, e ka qëlluar me pëllëmbë në fytyrë. Pavarësisht se nga hetimi ynë

nuk u arrit të vërtetohej fakti i përdorimit të dhunës fizike nga oficeri i policisë Martin Dona, doli se nga ana e tij janë kryer shkeljet ligjore si më poshtë:

a. Pyetja e nxënësës E. B. dhe ballafaqimi i saj me një person tjetër është bërë në orët e vona të natës, nga ora 20⁰⁰ deri në orën 24⁰⁰, ndërkohë nuk ishte e ngutshme që e mitura të pyetej natën. Gjatë seancës së pyetjes janë kaluar kufijtë e dëshmisë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 153 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale.

b. Zoti Martin Dona, ndonëse ishte me atributet e oficerit të policisë gjyqësore, nuk ka mbajtur procesverbalin përkatës, të parashikuar në nenin 153 dhe 169 të Kodit të Procedurës Penale.

c. Gjatë procesit të pyetjes së shtetasës së mitur E. B., nuk ka qenë i pranishëm as prindi dhe as një specialist i fushës së edukimit, p.sh. ndonjë mësues apo psikolog, sipas kërkesave të parashikuara në nenin 361, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale.

d. Marrja e shpjegimeve dhe ballafaqimi i vajzës E.B., janë bërë në kushtet e një presioni psikologjik. Martini pranoi se kur vajza nuk jepte shpjegime, ai e ka ngritur tonin e zërit dhe mbante në dorë shkopin e gomës si mjet presioni.

Për shkeljet ligjore të kryera nga oficeri Martin Dona, ju propozua Ministrit të Rendit Publik marrja e masës disiplinore. Mbi këtë propozim ndaj tij u muar masa disiplinore “Vërejtje”.

5. Rasti i dërguar tek ne nga Zyra e OSBE në Tiranë, ku në një kasetë filmike tregohet keqtrajtimi pa shkak i tre shtetasve nga forcat speciale të policisë në 28 nëntor 2000, para selisë së Partisë Demokratike. Megjithëse rasti paraqiti mjaft vështirësi, sepse së pari, duheshin identifikuar të keqtrajtuarit, pa ankesën e të cilëve Avokati i Popullit, sipas ligjit, nuk mund të shqyrtojë ankesën deri në fund, dhe së dyti, sepse sipas ligjit për forcat speciale, identiteti i tyre mbahet sekret. Pavarësisht nga këto vështirësi, ne arritëm të identifikonim njërin nga personat e keqtrajtuar A.V. Gjithashtu edhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë u tregua e gatshme për identifikimin e policit që, në kundërshtim me ligjet, keqtrajtoi pa shkak tre qytetarët. Si rrjedhojë, ndaj atij polici u morën masa disiplinore. Ky rast ishte një ndër shkaqet pas së cilave Drejtoria e Përgjithshme e Policisë bëri ristrukturimin e gjithë repartit të policisë që ishte i pranishëm në atë ngjarje.

Duke shqyrtuar 9 rastet e ankesave të shtetasve për keqtrajtime nga verifikimi i të cilave ato kanë rezultuar të vërteta, dhe që pas Rekomandimeve tona për 6 oficerë policie dhe 4 nënoficerë janë marrë masa disiplinore, mund të nxjerrim si konkluzion se këto masa kanë qënë të

buta. Prandaj në të ardhmen, për rastet e shkeljeve të rënda, siç janë keqtrajtimet ndaj shtetasve do të Rekomandohet që Drejtoria e Përgjithshme e Policisë apo drejtoritë e policisë në qarqe të marrin masa më të rrepta, deri në largim nga detyrat në polici.

II. Ankesat për veprime të tjera të paligjshme nga policia

Kanë qenë 57 ankesa për veprime arbitrare, të forcave të policisë si humbje sendesh, të sekuestruara nga policia, kontrole banese dhe fizike, shpallje në kërkim, etj. Si raste të zgjidhjeve pozitive mund të përmendim:

1. Ankesat e 16 banorëve të fshatit Lazarat të rrethit Gjirokastrë, të cilët në një takim që bënë me Avokatin e Popullit, në shtator 2001, ngritën shqetësimin se padrejtësisht policia i kishte shpallur persona në kërkim dhe për këtë i kishte nxjerrë emrat dhe fotografitë e tyre në gazetën "Shekulli" dhe "Shqiptare". Duke u shpallur si persona në kërkim ata ishin privuar nga e drejta e lëvizjes së lirë, sepse jetonin nën ankthin e ndjekjes nga policia ngaqë kishin frikë të lëviznin jashtë fshatit. Të ndodhur në këto kushte ata nuk mund të punonin, kishin ndërprerë aktivitetin ekonomik, pra, kjo u kishte sjellë edhe vështirësi ekonomike për familjet përkatëse. Ankesa u vlerësua seriozisht nga ana e Avokatit të Popullit dhe menjëherë u ngarkua një grup ekspertësh, të cilit ju dhanë detyra që të bënin verifikimet përkatëse në organet e policisë, në prokurori dhe në gjykatën e Gjirokastrës. Nga verifikimet e bëra në organet e mësipërme rezultoi se 8 persona nga 16 ankuesit nuk kishin qenë asnjëherë të shpallur në kërkim nga organet e mësipërme.

Sipas gazetave të mësipërme dhënia e informacioneve ishte bërë nga ana e Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë, por drejtuesit e tij, na konfirmuan se këto të dhëna nuk u janë dhënë gazetarëve prej tyre. Kemi kërkuar shpjegime edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për të gjetur burimin e informacionit të dhënë gazetave, sepse shkelja e mësipërme e të drejtave të njerëzve, që janë publikuar në Mediat pa të drejtë si kriminelë, është mjaft e rëndë. Prandaj për këtë aspekt çështja është akoma në ndjekje nga ana jonë.

Në përfundim të verifikimeve të bëra ankuesve ju kthyem përgjigje individuale. Gjithashtu në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës Lazarat u bë i mundur afishimi i listave të banorëve të ketij fshati, të cilët ishin në kërkim dhe i atyre që nuk ishin në kërkim. Veprimet dhe përgjigjet e institucionit tonë u mirëpritën nga ankuesit, banorët dhe autoritetet e Komunës Lazarat.

2. Njoftimi i bërë nga misioni i OSBE, në Peshkopi, për një incident të ndodhur më dt. 13.04.2001, midis punonjësit të saj R. B. me

punonjësit e policisë të Komisarariatit Peshkopi. Njoftimi bënte fjalë për veprime arbitrare, si kontroll banese në mesnatë dhe sjellje jo korrekte të punonjësve të policisë. Nga ana jonë u shkua në vend dhe ju morëm shpjegime të dëmtuarit R. B. Nga hetimet e zhvilluara rezultoi se veprimet e punonjësve të policisë, në dëm të ankuesit, ishin arbitrare, sepse nuk motivohej kontrolli i banesës së tij. Në kontakt me të dëmtuarit policët kishin demonstruar sjellje jo korrekte dhe nuk kishin mbajtur procesverbal mbi kontrollin e banesës. I dëmtuari na theksoi se nuk dëshironte që të mbahej qëndrim ndaj punonjësve të policies, por donte vetëm të mësonte shkakun e vërtetë të këtij veprimi dhe t'i kërkohej falje nga organi i policisë. Nga verifikimet tona u zbulua shkakun i vërtetë i kontrollit të banesës, i cili kishte të bënte me një plagosje që kishte ndodhur në mesnatë në afërsi të banesës së ankuesit. Në ato momente kishte ndriçim në banesën e të dëmtuarit dhe kjo kishte bërë që policët të dyshonin se autorët ishin futur në atë banesë. Për këtë dyshim të çastit ata bënë kontrollin e saj, duke u justifikuar me kontrollin për armë. Shefi i komisarariatit të Policisë Peshkopi, në prezencë të punonjësve tanë, i kërkoj falje të dëmtuarit dhe sipas porosisë tonë mori përsipër detyrimin që këtë ngjarje do ta analizonte me gjithë efektivin, me qëllim që të mos përsëriteshin më në të ardhmen shkelje të të drejtave të njeriut të kësaj natyre, të garantuara nga neni 37 i Kushtetutës. Këto veprime të kryera nga ana jonë jua bëmë të njohur edhe përfaqësuesve të Zyrës së OSBE-së në Peshkopi e Tiranë, të cilët mbetën të kënaqur nga vlerësimi që ju bë nga ana jonë këtij problemi dhe nga mënyra e zgjidhjes së tij.

3. Ankesa e shtetases N. B., e cila pretendoi se nga Komisaritati i Policisë Nr. 4 Tiranë, nuk i jepet ora e djalit të saj. Nga verifikimi i kësaj ankese, si pyetja e ish shefit të policisë kriminale të Komisarariatit nr. 4, z. Agron Nano dhe e oficerit të policisë gjyqësore Dalip Hoxha si dhe studimi i dosjeve gjyqësore dhe hetimore në gjykatë dhe në prokurori u vërtetua se Ora e markës “Lankoster” ishte gjetur në vendin e ngjarjes në një fshat të Tiranës, ku kishte ndodhur një vrasje. Djali i ankueses ishte njëri nga autorët e saj. Ora ishte marrë nga policët në vendngjarje me procesverbal, i cili gjendej në dosje. Pas dënimit të tij, gjykata kishte vendosur që ora t'i kthehej familjarëve të të dënuarit. Mirëpo, megjithëse të dy oficerët e mësipërm këmbëngulnin se orën ia kishin përcjellë prokurorisë, nga verifikimi i rregjistrave të këtij organi dhe i dosjes hetimore, në fakt nuk rezultonte që ajo të ishte çuar në prokurori, megjithëse ishte marrë edhe një vendim nga prokurori i çështjes që ajo orë t'i bashkohej materialeve të dosjes.

Në përfundim të këtij hetimi u konkludua se ora kishte humbur apo ishte vjedhur?? në ambientet e komisariatit dhe për këtë i rekomandua Prokurorisë së rrethit Tiranë që të fillojë procedimin penal ndaj oficerëve të policisë Agron Nano dhe Dalip Hoxha për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248 i Kodit të Procedurës Penale. Nga Prokuroria ka filluar çështja penale për shpërdorim detyre.

4. Ankesa e shtetasit V. V., i cili pretendoi se nga ana e Komisarariatit të Policisë Korçë i ishte dërguar padrejtësisht një urdhër administrativ për ta nxjerë atë jashtë një magazine, të cilën e kishte marrë me qira, por që i kishte kaluar afati i saj. Ankuesi së bashku me ankesën paraqiti pranë nesh edhe kontratën e qirasë që kishte lidhur me pronarin e saj.

Nga ballafaqimi i urdhërit të dërguar nga Komisarati i Policisë Korçë me legjislacionin përkatës, konkretisht me ligjin “Për policinë e shtetit”, u arrit në konkluzionin se urdhëri administrativ i policisë ishte i kundraligjshëm sepse ishim para një konflikti civil dhe palët duhet t’i drejtoheshin gjykatës për zgjidhjen e tij.

a. Ligji “Për Policinë e Shtetit” nuk i jep të drejtë policisë dhe as e ngarkon atë me detyrë për të nxjerrë urdhëra administrativ për lirim e objekteve, edhe kur ato janë zënë forcërisht.

b. Ligji i vjetër “Për Ruajtjen e Rendit Publik” që e ngarkonte policinë me këtë detyrë është shfuqizuar nga ligji i ri “Për Policinë e Shtetit”.

c. Edhe në qoftëse do të ishte në fuqi ligji i vjetër, ai i jepte të drejtë policisë të ndërhynte vetëm në ato raste kur objektet ziheshin forcërisht, ndërsa në rastin konkret magazina jo vetëm nuk ishte zënë forcërisht, por ankuesi kishte lidhur me pronarin kontratë qiraje, pavarësisht se kishte kaluar afati i saj.

Meqenëse urdhëri administrativ duhej të zbatohet pas dy ditësh dhe koha nuk premonte për të bërë rekomandimin me shkrim, u bisedua me drejtuesit e Komisarariatit Korçë, të cilët u bindën për padrejtësinë e këtij urdhëri dhe e revokuan atë.

5. Ankesa e shtetasit Y. P., i cili pretendoi se nga Komisarati i Policisë Berat i ishte bllokua padrejtësisht makina e tij. Policia i kishte vënë kusht që të gjente një shokun e tij që kërkohej nga policia, pastaj t’i jepte makinën.

Nga shpjegimet e dhëna prej Policisë dhe Prokurorisë së rrethit Berat doli se ndaj ankuesit rëndonte një akuzë nga policia greke për vjedhje, por pranë atyre organeve nuk ishin dërguar materiale dhe prova për vërtetimin e kësaj akuze. Mbi këtë bazë dhe me justifikimin e verifikimit të dokumentacionit ishte bllokua automjeti. Ndërhyrja jonë në organin e

policisë Berat, duke jua bërë të qartë se ankuesit i ishin shkelur të drejtat dhe nuk ishte i ligjshëm bllokimi i automjetit, bëri të mundur çbllokimin e automjetit dhe dorëzimin e tij ankuesit.

7. Ankesa e shtetasit D. P., i cili pretendoi se nga ana e Komisarariatit të Policisë Elbasan i ishte bllokuar padrejtësisht makina e tij.

Nga ana jonë u bisedua në telefon me drejtuesit e këtij komisaritati, të cilët sqaruan se ankuesi kishte bërë një vepër penale, rrahje ndaj një personi tjetër, i cili kishte bërë kallzim ndaj tij. Gjithashtu i kërkua policisë shpjegime me shkrim. Nga përgjigjia rezultonte se ankuesi kishte bërë edhe kundravajtje administrative, duke e parkuar automjetin në mënyrë të gabuar dhe se nuk kishte patur me vete dokumentat e makinës, por komisaritati na sqaronte se mbasi ankuesi kishte paguar gjobën, nga ana e policisë i ishte çbllokuar dhe dorëzuar automjeti. Ndërhyrja jonë nëpërmjet shkresave dhe bisedave telefonike bëri të mundur çbllokimin e automjetit të ankuesit, brenda një kohe relativisht të shkurtër.

8. Kanë qenë 6 ankesa për gjoba administrative të paligjshme, nga të cilat si shembull mund të përmendet si gjobë e padrejtë:

Ankesa e shtetasit A. S., i cili pretendoi se ishte gjobitur padrejtësisht me 1000 lekë nga punonjësi i policisë së qarkullimit rrugor Tiranë Martin Coli. Ankesa, pavarësisht se masa e gjobës ishte e vogël u vlerësua. U bënë hetimet rreth saj, duke u pyetur ankuesi, punonjësi i policisë për të cilin ishte bërë ankimi si dhe u bë kqyrja e vendit ku pretendohet se ishte bërë shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor. Meqenëse nga ana jonë nuk u krijua bindja se ankuesi kishte bërë kundravajtje, për të qenë të saktë në vlerësim, ne vendosëm të kryenim ekspertizë, duke caktuar dhe thirrur një ekspert të fushës së qarkullimit rrugor. Eksperti pasi studjoi dokumentat dhe bëri kqyrjen e vendit ku pretendohet se ishte bërë shkelja e rregullave të Kodit Rrugor, arriti në konkluzionin se ankuesi nuk kishte bërë shkelje të dispozitave të Kodit Rrugor dhe se punonjësi i policisë e kishte gjobitur padrejtësisht atë. Mbështetur në provat e administruara dhe në aktin e ekspertimit i rekomanduam shefit të sektorit të qarkullimit rrugor që ankuesit t'i kthehej shuma prej 1000 lekësh e vjelë si gjobë dhe njëkohësisht ju kërkua që ndaj policit Martin Coli të merej masë disiplinore. Nga ana e shefit të Policisë së Qarkullimit Rrugor Tiranë na erdhi përgjigjia se rekomandimi i bërë prej nesh u vlerësua i drejtë dhe u pranua prej tij.

III. Ankesat për largime nga puna në organet e Policisë së Shtetit

Në Institucionin tonë kanë paraqitur ankesa 22 oficerë apo policë për largime të padrejta nga puna. Por si shembull të zgjidhjes pozitive në favor të ankuesve mund të përmendim:

1. Ankesa e shtetasit S. B., ish punonjës policie në Komisariatin e Lushnjës, i cili pretendoi se ishte liruar nga detyra padrejtësisht, me motivacionin “Shpërdorim detyre”. Nga hetimi i kësaj ankese rezultoi se ankuesi ishte liruar nga detyra për shkak se para një viti nga organet e policisë së Lushnjës ishte lëshuar brenda ditës një pasaportë në favor të shtetasit A. B. Më vonë A.B. ishte shpallur në kërkim sepse akuzohej për disa vepra penale. Kurse në zyrën e lëshimit të pasaportave mungonin disa dokumenta që lidheshin me këtë shtetas.

Nga hetimet e bëra rezultoi se përgjegjësia për pajisjen e shtetasit A. B. (kriminel i njohur) me pasaportë rëndonte mbi punonjës të tjerë të policisë ndaj të cilëve nuk ishte marrë asnjë masë disiplinore. Ankuesi nuk ishte punonjës i zyrës së lëshimit të pasaportave, e nuk mund të përgjigjej për humbjen e dokumentave. Gjithashtu ai nuk kishte as të drejtën e lëshimit të pasaportave e aq më tepër brenda ditës, siç ishte bërë në fakt. Detyra e tij ishte të verifikonte nëse shtetasi në fjalë ishte apo jo banor i zonës së tij. Këtë detyrë ai në fakt e kishte kryer dhe rezultoi se A.B. në atë kohë nuk kishte pengesa ligjore për t’u pajisur me pasaportë. Nga verifikimet rezultoi gjithashtu se lirimin e ankuesit nga detyra e kishte bërë Shefi i Policisë së Komisarariatit, i cili në bazë të ligjit “Për Policinë e Shtetit” nuk është kompetent dhe nuk e gëzon këtë të drejtë. Gjithashtu nga studimi i dosjes personale të punës së ankuesit rezultoi që ai kishte vlerësime pune pozitive për rreth 16 vjet që kishte shërbyer në polici dhe nuk kishte marrë asnjë herë masë disiplinore.

Nga shyrtimi në kompleks i ankesës u arrit në konkluzionin se ankuesi ishte hequr nga puna padrejtësisht, prandaj për të rivendosur në vend të drejtën e shkelur, ju rekomandua Shefit të Policisë Lushnje të bënte propozimin për rikthimin e tij në detyrë, ndërsa Drejtorit të Policisë së Qarkut Fier ju rekomandua rikthimi i ankuesit në punë. Rekomandimet e bëra u mirepritën nga organet përkatëse dhe ankuesi u rikthye në detyrë.

2. Ankesa e shtetasit Sh. K., ish oficer policie në Komisariatin e Policisë Lushnje, i cili pretendoi se ishte larguar padrejtësisht nga detyra, nuk ishte dakort me motivacionin e lirimit “mangësi të vazhdueshme në kryerjen e detyrës” si dhe nuk i ishte dhënë një kopje e urdhërit të lirimit. Ai e kishte kërkuar në mënyrë të vazhdueshme, këtë sepse i duhej për ngritjen e padisë kundër Ministrisë së Rendit Publik në Gjykatë.

Nga studimi i ankesës konstatuam se ankuesit i ishte mohuar e drejta kushtetuese e informimit, parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës sonë. Me ndërhyrjen tonë pranë M.R.Publik u bë e mundur marrja e kopjes së urdhërit të lirit të tij nga detyra. Ndërsa për problemin e motivacionit të lirit, meqenëse kishte kaluar një kohë e gjatë, më shumë se dy vjet, që sillte pamundësinë tonë në verifikimin e pretendimeve të tij, ju sugjerua që të bënte padi në gjykatën kompetente, mbasi ju dha edhe kopja e urdhërit të lirit, mungesa e të cilit nuk e lejonte atë t'i drejtohej Gjykatës.

Ankesa të kësaj natyre, të mosdhënies të kopjeve të urdhërave të largimit nga detyra në polici apo për mosdhënie të dokumentacioneve të tjera, duke shkelur edhe ligjin nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, kanë qenë edhe 7 të tjera, të cilat janë zgjidhur pozitivisht, duke plotësuar kërkesat e njerëzve që janë ankuar.

IV. Moszbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë

Ky problem tashmë është i njohur dhe i pranishëm pothuajse në të gjitha organet e administratës publike shqiptare. Prandaj ankesat në këtë fushë kanë qenë të shumta edhe për Ministrinë e Rendit Publik dhe institucionet apo organet e tjera në varësi të saj. Kështu për vitin 2001 janë bërë **19** ankesa për moszekutim të vendimeve gjyqësore për kthimin në punë, për mosdëmshpërblimin për kohën e qëndrimit pa punë, mosdhënien e pagesës kalimtare për largimet nga puna si dhe mosshlyerjen detyrimeve kontraktore të M.R.Publik ndaj personave të tretë fizikë dhe juridik. Si rast të zgjidhjes pozitive mund të përmendim:

Ankesën e shtetasit R. D., i cili ankohej ndaj M.R.Publik, e cila nuk ekzekutonte vendimin gjyqësor në favor të tij, për largim të pa drejtë nga puna, nga Klubi Sportiv Dinamo. Pas verifikimeve të bëra dhe shpjegimeve të marra nga M.R.Publik, ankesa u vlerësua e drejtë, sepse ishte shkelur pika 3 e nenit 142, të Kushtetutës, i cili detyron të gjitha organet shtetërore të ekzekutojnë vendimet gjyqësore. Ju rekomanduam M.R.Publik ekzekutimi i vendimit gjyqësor. Rekomandimi ynë u pranua dhe u bë i mundur ekzekutimi i vendimit në favor të ankuesit. Pozitivisht janë zgjidhur kohët e fundit edhe disa raste të tjera.

V. Ankesa për mbajtjen në dhomat e izolimit të policisë të personave të dënuar

Problem tjetër që ka të bëjë me Ministrinë e Rendit Publik dhe policinë është mbajtja e personave të dënuar me vendim të gjykatave të formës së prerë në qelitë e paraburgimit të komisariateve të policies. Sipas të dhënave të dërguara nga Ministria e Rendit Publik, në fillim të vitit 2002

në dhomat e izolimit të komisariateve të policisë kanë qënë 1300 persona, nga të cilët 320 të dënuar me vendim të formës së prerë. Kapaciteti i këtyre dhomave të izolimit për të gjithë vendin tonë është 830 persona. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së vendeve në burgje, që janë të mbingarkuara, por jo për fajin e Ministrisë së Rendit Publik. Ne kemi ndërhyrë për këtë çështje me forcë, pas mjaft ankesave që kemi marrë nga të burgosurit. Më hollësisht kjo çështje trajtohet në pjesën ku flitet për ankesat nga të burgosurit.

Në vitin 2000 dhe 2001 anëtarë të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Keqtrajttimeve pranë Këshillit të Evropës, (CPT) kanë kryer vizita në disa komisariate të Policisë së shtetit dhe Institucione të tjera, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë. Shpesh herë konstatimet tona kanë qënë të njëjlojta me ato të CPT. Prandaj e shohim me vend të paraqesim Rekomandimet e mëposhtëme, të nevojshme për të garantuar çdo shtetas shqiptar nga Torturat apo forma të tjera të keqtrajtimit nga Policia.

VI. Rekomandime për parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe shkeljeve të ligjit nga policia

1. Duhet që të merren masa me qëllim që e drejta e një individi të privuar nga liria, për njoftimin e një të afërmi ose të një të treti ose avokatit sipas dëshirës, të vihet efektivisht në çdo rast në praktikë, sepse në të kundërt shkelet pika 1 e nenit 28 të Kushtetutës sonë dhe aktet e njohura ndërkombëtare.

2. Duhet që të merren masa që të sigurohet që e drejta e vizitës nga një mjek për personat e privuar nga liria të jetë efektivisht e zbatueshme, qysh në fillim të privimit të tyre nga liria. Kjo e drejtë duhet gjithashtu të nënkuptojë të drejtën që këta persona kanë për t'u egzaminuar nëse ata dëshirojnë nga një mjek i zgjedhur prej tyre.

Për realizimin e kësaj gjithashtu duhet që:

- Të gjitha egzaminimet mjekësore të personave të privuar nga liria e tyre prej policisë duhet të jenë larg dëgjimit, dhe, vetëm nëse kundërshton mjeku, për ndonjë rast të veçantë, larg edhe shikimit të punonjësve të policisë kur ata vizitohen nga mjeku.

- Rezultatet e çdo egzaminimi, si dhe çdo deklaratë e bërë nga personi i vizituar, duhet të shënohen nga mjeku dhe të jenë në dispozicion të personit të privuar nga liria dhe të avokatit të tij.

3. Duhet që, që në fillim, çdo personi të privuar nga liria prej policisë, t'i dorëzohet sistematikisht një formular ku saktësohen të drejtat e tij. Ky formular duhet që të jetë i disponueshëm edhe në gjuhë të huaj. Për

më tepër, të interesuarit duhet të ftohen që të firmosin një deklaratë që ata kanë qenë të informuar mbi të drejtat e tyre.

4. Duhet të përpunohet një udhëzim i saktë (kod i sjelljes) për marrjen në pyetje nga policia. Ky kod duhet ndër të tjera të trajtojë aspektet e mëposhtme; t'i tregohet sistematikisht të ndaluarit identiteti i personave të pranishëm gjatë marrjes në pyetje (emri dhe/ose matrikuli); kohëzgjatja e lejuar e një seance pyetjesh; periudhat e pushimit ndërmjet këtyre seancave dhe pauzat gjatë marrjes në pyetje; vendi apo vendet ku mund të mbahet një seancë e tillë; nëse do t'i kërkohet të ndaluarit të qëndrojnë në këmbë gjatë marrjes në pyetje; dhe që ndalohet marrja në pyetje e personave nën ndikimin e drogës, alkoolit, ilaçeve ose nën një gjendje tronditjeje. Ky kod duhet gjithashtu të parashikojë që të shënohet sistematikisht momenti i fillimit dhe i përfundimit të çdo marrje në pyetje, identitetin e çdo të pranishmi gjatë çdo seance pyetjeje, si dhe çdo kërkesë të formuluar nga i ndaluarit gjatë kësaj seance. Situata e personave veçanërisht të pambrojtur (për shembull, minorenët, personat e prekur nga sëmundje ose mangësi mendore) duhet të bëhen objekt i garancive specifike.

5. Duhet që të drejtat e mësipërme të zbatohen gjithashtu për personat e mbajtur nga policia për qëllime administrative. T'u sqarohet punonjësve të policisë se "shoqërimi në polici" nuk duhet në asnjë rast të përdoret ndaj personave të dyshuar për një vepër penale. Pra të mos përdoret shoqërimi për të sqaruar veprime administrative me qëllim hetimesh për vepra penale. Po kështu të mos kryhen veprime që çojnë në mbledhjen e të dhënave në mënyrë të paligjshme, duke shkelur pikën 2 të nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Më shpesh në këtë drejtim abuzohet me pretekstin e kontrollit për armëmbajtje pa leje.

6. Duhet që autoritetet e policisë të shpërndajnë ndër forcat e policisë një qarkore që i sqaron se koha e mbajtjes për arsye administrative ose gjyqësore duhet të llogaritet brenda afatit kohor të caktuar për paraqitjen e një personi para një gjyqtari, kohë që, sipas nenit 28 të Kushtetutës, është jo më tepër se 48 orë.

7. Autoritetet shqiptare duhet të forcojnë kërkesën e llogarisë në lidhje me rregjistrat e mbajtjes së personave në ambjentet e policisë, me qëllim që ato të plotësohen saktë e të mos manipulohen për të mbuluar shkeljet e ligjit.

8. Duhet gjithashtu që kushtet e mbajtjes në qelitë e paraburgimit në ambjentet e policisë të përmirësohen, me qëllim që:

- të respektohen në mënyrë strikte kriteret e parashikuara lidhur me çështjen e hapësirës minimale për të ndaluarin; si dhe
- të ndahen të rriturit nga minorenët dhe t'i kushtohet këtyre të fundit një vëmendje e veçantë në planin e shëndetit dhe të edukimit.

9. Duhet që të gjitha rajoneve të policisë t'u akordohet një buxhet i posaçëm për të financuar ushqimin e të ndaluarve pa burime financiare, sepse gjendja është problematike kur të ndaluarit janë të huaj, që kapen në tentativa për të kaluar ilegalisht në Itali.

Për të realizuar këto Rekomandime duhet t'i jepet nga Qeveria një prioritet më i madh kalimit të vartësisë të personelit të dhomave të izolimit nga varësia e Ministrisë së Rendit Publik në atë të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe të shumëfishohen përpjekjet për të vënë efektivisht në jetë të gjitha dispozitat e caktuara në "Rregulloren mbi sigurimin dhe trajtimin e të burgosurve", të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.96 datë 09.03.2000.

Gjithashtu duhet që t'i jepet një përparësi më e madhe formimit profesional fillestar dhe në vazhdim të punonjësve të policisë të të gjitha gradave dhe kategorive. Një rëndësi e konsiderueshme duhet t'i kushtohet arritjes dhe zhvillimit të teknikave të komunikimit ndërpersonal, me qëllim që aftësia komunikuese të jetë një faktor përcaktues në përzgjedhjen dhe rekrutimin e punonjësve të policisë dhe gjatë formimit të tyre.

Dhe së fundi, duhet që nga autoriteti politik i nivelit më të lartë, ashtu siç u veprua me rastin e ish drejtorit të policisë së Elbasanit, Koseni, të dalë një mesazh i qartë që dënon keqtrajtimet nga policia dhe se keqtrajtimet e personave të privuar nga liria, janë të papranueshme dhe ato do të ndëshkohen rreptë. Kjo duhet të përsëritet me intervale të rregullta nga drejtuesit në të gjitha shkallët e policisë, dhe në veçanti t'u theksohet organeve të policisë të ngarkuara me marrjen në pyetje të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu duhet që autoritetet kompetente të Gjykatës dhe Prokurori i Përgjithshëm të ftohen që të japin direktiva të sakta që sa herë që një person i arrestuar, që del para prokurorit apo gjykatësit në mbarim të arrestit dhe pretendon se ka qenë viktimë e keqtrajtimit të policisë, prokurori apo gjykatësi të mbajnë shënim këtë dhe të urdhërojnë menjëherë një kontroll mjeko-ligjor si dhe të marrin masat e nevojshme që ankesa të shqyrtohet siç duhet. Kjo rrugë duhet të ndiqet pavarësisht nëse personi në fjalë ka apo jo shenja të jashtme të dukshme. Për më tepër, edhe në mungesë ankesash për keqtrajtime, prokurori apo gjykatësi të japin urdhër që të kryhet një kontroll mjeko-ligjor sa herë që ai konstaton se një person nën arrest që i paraqitet atij, ka mundësi që të ketë qenë viktimë e keqtrajtimit.

Po kështu, duhet që prokurorët të inkurajohen që të interesohen veçanërisht për mbikqyrjen e punës së policisë në kuadrin e hetimeve penale. Kjo duhet të nënkuptojë ndër të tjera, vizita të papritura dhe në

vazhdim në vende të arrestit të policisë, në mënyrë që të hyhet në kontakt direkt me personat në paraburgim. Prokurorët mund të shoqërohen gjatë këtyre vizitave edhe nga mjekët ligjorë ose nga mjekë me përvojë në mjekësinë ligjore.

VII. Ankesa nga shtetasit shqiptarë të keqtrajtuar nga policia e shteteve fqinjë

Në 19 raste pranë Institucionit tonë kanë paraqitur ankesa edhe shtetas shqiptarë për keqtrajtim nga policitë e shteteve të Greqisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi. Është e qartë se ne nuk kemi juridiksion në këto raste. Shumicën e ankesave jua kemi dërguar për kompetencë Ombudsmanit të Greqisë dhe atij të Maqedonisë.

Por i rëndësishëm ka qenë konstatimi se organet e policisë kufitare shqiptare në këto raste nuk i evidentonin në kallëzime penale të shkruara këto raste të keqtrajtimit të shtetasve shqiptarë, kur ata hynin në tokën shqiptare. Si rrjedhojë e Rekomandimit tone, me urdhërin e përbashkët nr.2037, datë 23.07.2001, Ministri i Rendit dhe Prokurori i Përgjithshëm udhëzuan organet e tyre vartëse për evidentimin dhe hetimin e këtyre rasteve të keqtrajtimit.

Duke marrë shkas nga ankesat e shtetasve shqiptarë për keqtrajtime nga Policitë e vendeve të tjera ballkanike, kemi lançuar idenë për krijimin e një rrjeti (network) midis zyrave të Ombudsmanëve të rajonit të Ballkanit. Me anë të këtij rrjeti të shkëmbejmë jo vetëm informacione dhe përvojë nga veprimtaria e secilit, por kur do ketë raste të shkeljeve të të drejtave të shtetasve tanë në vendet e tjera, do t'ja dërgojmë ankesat apo njoftimeve Ombudsmanëve të vëndevë përkatës për t'i verifikuar dhe zgjidhur sipas ligjeve të secilit vend. Kuptohet se nga realizimi i kësaj ideje do të përfitojnë të gjithë qytetarët ballkanikë, por besoj se më tepër se të gjithë do të përfitojnë shtetasit shqiptarë. Këtë ide e kanë mirëpritur Ombudsmanët e Greqisë e të Kosovës. Ne do të punojmë për realizimin e plotë, duke kërkuar edhe përkrahjen e Këshillit të Europës.

4. Ministria e Mbrojtjes

Për vitin 2001, numri i ankesave që kanë të bëjnë me subjektet e Forcave të Armatosura dhe subjektet e tjerë, objekti i ankimit të të cilëve lidhet me veprimtarinë e dikasterit të Ministrisë së Mbrojtjes, është 190, nga 45 që ka qënë në vitin 2000.

Por persona të interesuar kanë qënë mbi 500 veta. Kjo sepse ka ankesa të cilat janë bërë nga një përfaqësues por, në emër të 10, 15 e deri dhe 50 personave të tjerë. Këtu nuk llogariten të interesuarit që përfitojnë nga pergjithesimi i çështjeve siç ndodh p.sh, për çështjen e shërbimit 24 orësh dhe punën jashtë orarit për ushtarakët, për të cilën janë të interesuar rreth 90% e kuadrove ushtarakëve aktiv në ushtri, ose për ndryshimin e nenit 19/1 të ligjit 8087 që përfitojnë 40 ushtarakë etj.

Ankesat janë paraqitur nga 168 meshkuj dhe 22 femra, nga rrethet kanë ardhur 124 ankesa , ndërsa 66 nga Tirana.

Të para në këndvështrimin e mënyrës së përfundimit, del se nga 169 ankesat apo kërkesat e përfunduara në vitin 2001, janë zgjidhur në favor të ankuesve 90 prej tyre , 31 kanë qënë jashtë kompetencës dhe juridiksionit tonë, kurse 48 ankesa kanë qënë të pabazuara. Janë në shqyrtim për vitin 2002 edhe 21 ankesa.

Të shprehura në përqindje del se rreth 58% e çështjeve të përfunduara janë zgjidhur në favor. Kjo është një tregues pozitiv për këtë sektor.

Vlen të theksohet se zgjidhjet pozitive kanë ardhur si rezultat i vënies në levizje të të gjitha strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes si nëpërmjet kërkesës për shpjegime, verifikimit në vend, ballafaqimit dhe ndjekjes së problemit në bashkëpunim me strukturat e ndryshme të Ministrisë së Mbrojtjes etj.

Duke bërë grupimin e këtyre ankesave sipas subjekteve dhe sipas problematikës që ato trajtojnë, konstatojmë se Avokatit të Popullit i janë drejtuar:

a) 71 persona, që janë ushtarakë aktivë, oficerë ose nënoficerë që punojnë në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe janë ankuar për:

-mos dhënien e shtesës së pagës të shërbimit 24 orësh dhe oreve të punës jashtë orarit. Këta ushtarakë janë të gjitha rangjeve dhe në të gjitha strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes;

-mos dhënien e shtesës së pagës për ushtarakët, oficerë dhe nënoficerë, të cilët veç detyrës funksionale, kanë dhe përgjegjësi materiale;

-lëvizje të pamotivuara në detyrë;

-lirim e shkarkim nga detyra në kundërshtim me ligjin, deri dhe një rast kur lirohet nga detyra oficerja aktive (femër) pikërisht në kohën kur ajo ishte me lejen e lindjes;

-moskujdesje sa duhet për problemet sociale të ushtarakëve p.sh, me strehimin, etj;

-mos dhënia e shtesave të pagave të bashkeshortëve të papunë për ushtarakët dhe sidomos mos derdhja e kontributit të sigurimeve shoqërore për to.

Disa nga rastet më tipike të trajtimit të ankesave apo kërkesave në këtë fushë janë:

Objekt mjaft i rëndësishëm pune për ne, ka qënë ankesa që ka të bëjë me rreth 40 ushtarakë oficerë të rangjeve të ndryshme për mospagesën në masën e duhur të shtesës së pagës për shërbimet 24 orëshe dhe oret e punës jashtë orarit.

Gjatë hetimit të kësaj çështjeje rezultoi se problemi ishte mjaft i gjërë dhe nuk ju përkiste vetëm atyre 40 ushtarakëve por prek të gjithë masën e gjerë të oficerëve aktiv sepse këta oficerë, për vetë natyrën e punës së tyre në repartet e nënrepartet e të gjithë vendit, kryejnë shërbimet 24 orëshe. Ata janë të detyruar që në mjaft raste të qëndrojnë me orë të tëra në punë apo në gadishmëri më tepër se 8 orë, që është orari zyrtar i punës.

Nga shqyrtimi i legjislacionit përkatës rezultoi se për rregullimin e kohës së punës dhe të pushimit për ushtarakët aktiv të Ministrisë së Mbrojtjes, kanë shërbyer V.K.M. nr 60 datë 27.02.1992 dhe më pas V.K.M. nr.258, date.22.05.1995.

Aktualisht, siç konfirmoi Drejtoria e Plan - Financës pranë Ministrisë së Mbrojtjes, pagesa e shërbimit 24 orësh dhe orëve të punës jashtë orarit, mbeshtetet në V.K.M. nr.60, date.27.02.1992, me arsyetimin se Vendimi i K.M. nr. 258, datë.22.05.1995, është shfuqizuar si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit nr.7961, datë.12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” po në vitin 1995.

Pra në vend që Ministria e Mbrojtjes, që në vitin 1995, t’i propozonte Këshillit të Ministrave, nxjerrjen e një vendimi të ri, ajo neglizhon prej rreth 7 vjetësh dhe zbaton vendimin e vitit 1992, i cili parashikon një shpërblim sa qesharak, aq edhe diskriminues pasi, dhënia e një shtese në pagë për 24 orë shërbim, është vetëm 85 deri 100 lekë të reja (0.6-0.7 USD)

Kjo do të thotë se një mase të gjerë ushtarakësh, në gjendjen aktuale, ju shkelet e drejta e shpërblimit për punën e kryer.

Në këto rrethana, për daljen nga kjo gjendje, ne i rekomandojmë ish Ministrin të Mbrojtjes z. Pandeli Majko, studimin dhe rregullimin ligjor të çështjes që ka të bëjë me pagesën e ushtarakëve për kryerjen e shërbimit 24 orësh dhe orëve të punës jashtë orarit, në përshtatje me ligjin nr 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, dhe ligjin nr.7496, datë. 03.07.1991 “Për Statusin e Ushtarakut”.

Ky është një problem i akumuluar prej vitesh dhe që sigurisht dalja nga kjo gjendje kërkon dhe një kosto financiare jo të vogël.

Ne mund të raportojmë se rekomandimi ynë për këtë çështje, është mirëpritur nga ish Ministri i Mbrojtjes (tashmë Kryeministër i vendit) dhe me sa jemi në dijeni ka filluar puna për studimin e gjendjes dhe marrjen e masave të nevojshme.

Kjo gjendje e paligjshme, siç thamë edhe më sipër, ka ardhur si rezultat jo i mungesës së bazës ligjore, por i mosvlerësimit dhe koncepteve jo të drejta, përtesës së strukturave brenda Ministrisë së Mbrojtjes për të përgatitur në kohë aktet e duhura nënligjore, në përshtatje të ndryshimeve që kanë pësuar vetë ligjet.

Për sa i përket ankesave që kanë të bëjnë me lëvizje të pamotivuara apo me lirim e shkarkim nga detyra, në kundërshtim me ligjin, mund të përmendim si tipike rastin e ankesës së ushtarakut me gradën n/kolonel S.H. nga Tirana, të ushtarakut me gradë n/toger J.K. nga Durrësi, të oficerës F.S. nga Tirana etj.

Në kuadrin e reformave të njëpasnjëshme në Ushtrinë Shqiptare, me qëllim për të bërë hapa përpara e për t'u përshtatur e integruar në strukturat e NATO-s, është i njohur fakti i shkurtimit të numurit të ushtarakëve aktivë, prandaj ka patur mjaft nga subjektet që prekeshin nga reforma.

Është vënë re se, megjithë vështirësitë për të bërë përzgjedhjen mes kuadrosh, ka dhe raste kur faktet flasin hapur për shkelje në administrimin e dokumentacionit dhe vlerësimin e punës së oficerëve, pa folur edhe për shkelje të rënda, si në rastin e ankuesve B.S. apo K.K. zgjidhja e ankesës dhe rivendosja e të drejtave të të cilëve erdhën vetëm pasi Avokati i Popullit i bëri prezent këto raste deri dhe tek Kryeministri dhe Presidenti i Republikës.

Kështu B.S. me gradë gjeneral, u ankua se edhe pse ishte oficer aktiv dhe mbante gradën e sipërpërmendur, kishte mbi tre vjet që ishte pa vend pune dhe nuk merrte asnjë lloj pagese.

Akoma më tej, edhe pasi doli një vendim gjykate i formës së prerë që detyronte Ministrinë e Mbrojtjes t'i jepte B.S. pagën për gjithë kohën që nuk ishte sistemuar, deri në emërimin e tij në detyrë, Ministria e Mbrojtjes hezitonte, nuk bënte ekzekutimin e vendimit gjyqësor, duke thënë që gjeneralët emërohen e shkarkohen nga Presidenti i Republikës, por nuk bënte procedurat për t'i propozuar zgjidhjen Presidentit.

Në këto kushte, vetëm me rekomandimin dhe insistimin e Avokatit të Popullit, u arrit që të viheshin në lëvizje strukturat e nevojshme dhe të ndërpritej gjendja e paligjshme me këtë shtetas, duke bërë që ai të merrte pagën për gjithë kohën e lenë pa sistemuar në detyrë.

Ankuesi J.K. oficer i ri me gradë nëntoger, i sapo dalë nga shkolla e lartë ushtarake, pas 1 vit pune cilësohet si i papërshtatshëm për t'u mbajtur në ushtri dhe projektohet për të dalë në reformë.

Kur hetohet rasti nga ana jonë, në dosjen e tij nuk kishte asnjë vlerësim pune, asnjë masë disiplinore, asnjë fakt sado të vogël që të justifikonte daljen e tij në lirim.

Ndërhyrja jonë me propozimin përkatës, bëri që ushtaraku i sipërpërmendur të mbante vendin e punës dhe të mos nxirrej në lirim.

Ankuesja, oficere F.S. nga Tirana, e cila në kohën që ishte me lejen e lindjes lirohet nga detyra si oficere prapavije në Qendren Kulturore të Ushtrisë në Tiranë, dhe emërohet itendente në repartin ushtarak të tankeve në Zallherr.

Pasi mbaron lejen e lindjes, ajo urdhërohet që me gjithë vështirësitë dhe domosdoshmërinë për t'u kujdesur tashmë edhe për fëmijën e saj të porsalindur, të shkonte në një punë shumë më të vështirë se sa e kishte para lindjes, në Zallherr, disa kilometra jashtë Tiranës. Ankuesja pretendoi se kishte një vit që kërkonte të drejtën e saj.

Nga studimi i dokumentacionit të paraqitur, rezultoi se vërtet në kohën e firmosjes së urdhërit për transferim nga detyra, ankuesja, ka qenë me raport lindjeje.

Ne saktësuam se për rastin, kemi të bëjmë dhe shkeljen e një të drejte të siguar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë pasi, në nenin 54, pika 1 të saj, thuhet: "Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja, kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti."

Gjithashtu janë shkelur dhe aktet ndërkombëtare, pikerisht Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me rezolutën e saj të 18 dhjetorit 1979, ku parashikohet shprehimisht:

"Për të parandaluar diskriminimin ndaj gruas për shkak martesë ose materniteti, ose dhe për të garantuar të drejtën e saj efektive për punë, shtetet palë, zotohen të marrin masa të përshtatshme që të kenë efekt:Vendosjen e akordimit të lejeve të barrës të paguara ose të së drejtës për të përfituar ndihma sociale të krahasueshme, të shoqëruara me garancinë e ruajtjes së vendit të punës të mëparshëm, të të drejtave të vjetësisë dhe të avantazheve sociale".

Për këto arsye ne kemi bërë tashmë rekomandimin përkatës për rivendosjen e të drejtave të saj të ligjshme, dhe kthimin në punën e mëparshme.

Për sa i përket rastit të ankuesit S.H, me gradë nënkolonel, vlen të përmendet për faktin se ankuesi me të drejtë kërkonte të njihej me dosjen e

tij të kuadrit dhe, mbi bazën e saj të vlerësonte nëse lëvizja e tij në detyrë me ulje dy apo tre shkallë, ishte bazuar në të dhëna të sakta ose jo.

Me këtë rast permendet fakti se Drejtori i Personelit ne Ministrine e Mbrojtjes, jo njëherë ka hezituuar dhe nuk është angazhuar siç duhet për zbatimin e ligjit “Për Avokatin e Popullit” dhe nuk zbatonte detyrimin kushtetues, që buron nga pika 4 e nenit 63 të saj ku thuhet se “Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”.

Ky funksionar nuk donte të zbatonte nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon se “Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij” dhe se “Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin”.

Këto të drejta janë parashikuar më hollësisht edhe në ligjin nr.8517, date.22.07.1999, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Oficeri S.H. me të drejtë kërkonte të lexonte dosjen e tij personale si kuadër ushtarak, gjë e cila u realizua gati pas një viti me insistimin tonë.

Duhet vënë në dukje se këto të drejta kushtetuese nuk njihen sa duhet jo vetëm nga ushtarakët, por nga të gjithë shtetasit shqiptarë. Kjo del nga numri i pakët i ankesave. Po ashtu ato nuk njihen edhe nga zyrtarët që kanë për detyrë t’i zbatojnë këto të drejta kushtetuese.

U ndalëm në këtë rast pasi akoma ka koncepte si në rastin në fjalë, që përfaqësues të veçantë të administratës shtetërore hezitojnë të përgjigjen me korrektesën e nevojshme Institucionit tonë, duke penguar jo vetëm punën tonë, por duke treguar se nuk janë të aftë të çojnë përpara punët e tyre me koncepte bashkëkohore. Ato përkundrazi, krijojnë probleme, nuk i menaxhojnë ato si duhet, nuk i referohen si duhet ligjit, duke sjellë si pasojë në fund të fundit shkeljen e të drejtave të njeriut.

Ankesa të tjera të paraqitura në institucionin tonë nga ushtarakë aktiv, kanë qënë, moskujdesja si duhet për problemet sociale të ushtarakëve, si strehim dhe mos derdhja e kontributit të sigurimeve shoqërore për pagat e bashkëshorteve të papuna.

Për sa sipër mund të përmendim 10 ushtarakë të garnizonit Librazhd, mjaft ushtarakë të Garnizonit të Tiranës, 8 ushtarakë në Garnizonin Ushtarak të Vlorës etj, të cilët kanë paraqitur shqetësimin në lidhje me mos privatizimin e objekteve, ish reparte ushtarake, që ju janë dhënë për strehim. Ata prej vitesh ose nuk lejohen që të futen me familjet e tyre në banesë, ose jetojnë në to me pasigurinë se mund t’i nxjerrin jashtë në çdo kohë.

Nga verifikimi i bërë në rastin e Bashkisë së Himarës, rezulton se, çdo dokumentacion është plotësuar konformë rregullave, por privatizimi nuk bëhet sepse pengon bashkia e qytetit të Himarës prej më shumë se 5 vjetësh.

Në rrethanat e mësipërme, kemi kërkuar shpjegime, por Bashkia e Himarës nuk ka marrë ndonjë hap konkret në këtë drejtim, duke shkelur kështu detyrimin që rrjedh nga pika 4 e nenit 63 të Kushtetutës për plotësimin e detyrimeve të të gjitha Institucioneve ndaj kërkesave të Avokatit të Popullit. Problemi është në ndjekje nga ne, por edhe Ministria e Mbrojtjes nuk ka bërë detyrën deri në fund për strehimin e këtyre ushtarakeve, duke mos kërkuar respektimin e ligjit nga bashkia përkaëse.

b)-53 persona, që janë ushtarakë në rezervë, të liruar nga ushtria në kohë të ndryshme para vitit 1992 dhe më pas deri në vitin 2001, janë ankuar për;

-mos përfitimin nga ligji 8087 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakeve”;

-mos përfitimin po nga ky ligj, sidomos nga një kategori ushtarakësh që janë liruar nga ushtria me motivacionin “për braktisje detyre”;

-mosderdhja e kontributit për sigurimet shoqërore gjatë kohës së pageses kalimtare, dhe dhënia e pensioneve minimale për ushtarakë që kanë bërë deri dhe 30 vjet pune në ushtri.

-ankime për lirim jashtë kriterëve nga ushtria dhe kërkesë për rikthim në radhët e Forcave të Armatosura etj;

Kështu mund të përmendim raste të ndryshme, por ai që ne e kemi quajtur më të rëndësishmin edhe në Raportin tonë të vitit 2000, ju përket rreth 40 ish ushtarakeve të prekur drejtpërdrejtë nga mospërfitimi prej ligjit nr.8087, datë.13.03.1996, të ndryshuar me ligjin nr.8521, datë.30.07.1999, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakeve.

Gjatë hetimit në tërësi të kësaj çështjeje ka rezultuar se:

Për t’ju garantuar përfitime suplementare mbi ato të përcaktuara në ligjin për Sigurimet Shoqërore për kategorinë e ushtarakeve që ju nënshtruan reformave të vazhdueshme në ushtri, u miratua ligji nr.8087 dt.13.03.1996. Këtij ligji ju bënë disa shtesa dhe ndryshime me Ligjin nr.8521, dt.30.07.1999.

Në nenin 9 të këtij ligji thuhet:

Pas nenit 19 shtohet neni 19/1 me këtë përmbajtje:

“Nga ky ligj nuk përfitojnë ushtarakët e nxjerrë në lirim për braktisje detyre, si dhe ata që janë dënuar me burg nga gjykata me vendim të formës së prerë për krime ushtarake”.

Është pikërisht paragrafi i parë i kësaj dispozite, për të cilin institucioni ynë, tashmë ka shfaqur qëndrimin, se është i domosdoshëm ndryshimi apo shfuqizimi i tij.

Prandaj ne u jemi drejtuar me rekomandimin përkatës Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisioneve parlamentare të Mbrojtjes dhe atij të Ligjeve. Nuk kemi patur përgjigje nga dy ministritë por aktualisht, kemi një përgjigje pozitive nga Kryetari i Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes z. Dashmir Shehi.

Shpresojmë që projekti i paraqitur prej tij, të gjejë miratim sa më të shpejt nga Kuvendi, pasi është një problem që ka të bëjë direkt me çënim të drejtave të njeriut.

c) 33 persona, që janë Veteranë të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, janë ankuar për:

-mos marrje të shpërblimit përkatës, pas përfitimit të Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare;

-zvarritje të shqyrtimit të dokumenteve për vlerësim apo rivlerësim të *statusit të veteranit*;

-mosrespektim të vendimit të gjykatës në lidhje me përfitimin e Statusit të Veteranit etj.

Për sa i përket ankesave të veteranëve të L.A.N.C-it, mund të themi se për këto subjekte kemi patur një bashkëpunim mjaft të mirë me sektorin e veteranëve në Ministrinë e Mbrojtjes. Nga rreth 33 ankesa që kemi patur nga ky grup subjektësh, 24 prej tyre janë zgjidhur pozitivisht.

d) 33 persona, civilë të ndryshëm, që janë ankuar për:

-mos zbatim të vendimeve të gjykatave ku palë ka qënë Ministria e Mbrojtjes, reparte apo nënreparte të strukturave të saj;

-pretendime për pronat apo objekte që ndodhen në reparte apo ish reparte ushtarake;

-probleme për banesa të dhëna për strehim familjeve të ushtarakëve, por që ka mosmarrëveshje me bashkitë për privatizimin e tyre;

-shkelje të të drejtave për pranim në Akademinë Ushtarake pas konkurimit të bërë etj.

Këtu nuk ka vend për të diskutuar në se kanë apo jo të drejtë ankuesit, pasi një gjë e tillë është thënë nëpërmjet vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Megjithë situatën aspak të këndëshme që ekziston në përgjithësi për këtë problem në vendin tonë, mund të themi se i vetmi pretendim që mund të justifikojë zvarritjen e zbatimit të vendimeve të gjykatës së formës së prerë, si në të gjithë vendin, edhe në Ministrinë e Mbrojtjes, është mungesa e burimit financiar. Por, kjo gjëndje nuk ka qenë plotësisht e tillë në Ministrinë e Mbrojtjes, dhe më e keqja është se drejtuesit në Drejtorinë e Plan Financës ka patur raste që kanë bërë rolin e gjyqtarit mbi gjykatat e shtetit. Kjo nuk mund të shpjegohet ndryshe veçse me mungesë të theksuar të koncepteve bazë të të drejtave të njeriut dhe të shtetit ligjor.

Rast tipik është ai i ankuesit H.P. për të cilin nuk zbatohet një vendim i gjykatës së formës së prerë, që kishte kaluar në të gjitha shkallët dhe që vetë përfaqësuesit e palës së paditur kishin pranuar fajin për dëmin e shkaktuar në mos zbatimin e kontratës për pagesën e furnizimeve etj.

Drejtorja e Plan–Financës në Ministrinë e Mbrojtjes zj.S.K, vihet në rolin e gjyqtares mbi vendimin e gjykatës, duke marrë përsipër të përcaktojë se cila pjesë e vendimit ishte e drejtë dhe cila pjesë nuk ishte e drejtë. Ndaj dhe ekzekutimin nuk donte t'a bënte në rastin në fjalë për 100 % të shumës së detyruar, por vetëm për 10%. Pra ajo merrte përsipër të bënte ndryshimin e vendimit të gjykatës që kishte marrë formë të prerë. Jo vetëm kaq, por ajo e quante të ligjshëm këtë veprim. Ky qëndrim ndaj një vendimi të gjykatës kur kanë shterruar të gjitha rrugët për ta kontestuar atë, dhe që ka marrë formë të prerë, është një qëndrim tejet i rrezikshëm që i hap rrugë antiligjit, i hap rrugë korrupsionit dhe sjell pasoja tejet të rënda jo vetëm për të drejtat e shtetasve, por dhe për vetë funksionimin normal të shtetit, duke krijuar në këtë formë precedentë mjaft të rrezikshme për shtetin e së drejtës.

Ne deri tani jemi fokusuar me punën tonë në gjetjen e formave të bashkëpunimit, me të vetmin qëllim të arrihet rivendosja e të drejtave të shtetasve. Por për rastësi ato të sipërpërmendura, në të ardhmen do të shfrytëzojmë më mirë kompetecat që na jep ligji, për të propozuar masa ndëshkuese ndaj këtyre përfaqësuesve të administratës që me veprimet dhe mosveprimet e tyre i sjellin mjaft dëm punës, i shërbejnë jo mirëqeverisjes, por përkundrazi diskreditojnë administratën tonë.

Një konstatim që del nga ankesat në Forcat e Armatosura por dhe për çështje të tjera, është mundësia që përfaqësuesit e administratës në ushtri, në bashkëpunim me juristët ushtarakë që nuk janë të pakët, të vlerësojnë më mirë veprimet apo mosveprimet e tyre, para se konflikti të shkojë në

gjykatë dhe të mos përdoret gjykata as si mjet për të justifikuar veprimin, dhe as si shkak për të zvarritur problemet pambarim.

Në këtë kuadër del domosdoshmëri edhe vlerësimi i proceseve gjyqësore ku është si palë Ministria e Mbrojtjes dhe ndërkohë, kërkohet korrektesa për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, shoqëruar kjo me vënien para përgjegjësisë të subjekteve, që me veprimet e mosveprimet e tyre të deklaruar të paligjshme kanë sjellë pasoja në dëm të shtetit.

Kjo e fundit do të kishte mjaft rëndësi, si një masë efiçente për parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe punës pa përgjegjësi të përfaqësuesve të administratës ushtarake që jo rrallë, për të mbuluar paaftësinë e tyre, kërkojnë të dalin flamurtarë të mbrojtjes së interesave të shtetit, sidomos me mosveprime, duke penguar kështu realizimin e të drejtave të shtetasve.

Kjo pjesë e punës sonë me këto subjekte, në fund të fundit ka shërbyer, në realizimin e objektivit kryesor të Avokatit të Popullit, jo vetëm për të mbrojtur e zhvilluar të drejtat e njeriut por dhe për të ndihmuar në mirëqeverisjen e vendit.

Është i rëndësishëm konkluzioni se në Forcat tona të Armatosura, nuk ka patur ankesa për shfaqje të diskriminimit të ushtarëve, nënoficerëve apo oficerëve për shkak të racës, fesë apo besimit, të bindjeve politike apo të gjendjes shoqërore. Ky është një tregues i rëndësishëm në fushën e të drejtave të njeriut për komunitete të tilla siç janë ushtarakët dhe mjediset e tyre.

5. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit

Për vitin 2001 për këtë Ministri ka patur 77 ankesa, kurse për organet e pushtetit vendor, 194 ankesa ose kërkesa. Problematika e çështjeve kryesisht ka qenë për mospërfitim të ndihmave nga shteti në raste fatkeqësish që kanë ardhur nga forcat madhore; nga përmbytjet e pronave nga ndërtimi i Hidrocentralit të Fierzës; shembje banesash nga rrëshqitjet e tokave; dëmtimet që pësuan zonat kufitare nga bombardimet serbe, apo shpërblimet për familjet pritëse gjatë krizës kosovare etj.

Edhe në vitin e kaluar problemet e evidentuara për këtë Ministri kanë qenë po këto që janë paraqitur edhe këtë vit. Fakti që përfitimi i ndihmave nga shteti për ankesat e shqyrtuara, ka të bëjë me akordim fondesh, të cilat nuk disponohen në çdo kohë, e bën të vështirë zgjidhjen e këtyre ankesave. Si raste specifike do të veçonim ankesën e H. P., i cili përfaqëson Komunën Bicaj Kukës, problem i cili është bërë prezent edhe në Raportin e vitit 2000. Ankuesi pretendon se i janë shkelur të drejtat që i takojnë sipas VKM

Nr. 149, date 20.04.1999 si dhe me Urdhërin Nr. 2 datë 11.05.1999 “Për procedurat e dhënies ndihmë financiare për familjet pritëse shqiptare, që mbajtën të ardhurit nga Kosova”.

Këtë ankesë e kemi ndjekur në vazhdimësi në Ministrinë e Pushtetit Vendor, të Financave, dhe me Kontrollin e Lartë të Shtetit, përgjigjet e të cilave nuk i kanë dhënë zgjidhje problemit.

Duke gjykuar se ky është një problem që ka të bëjë me një numër të madh familjesh, nga një zonë e varfër në veri të vendit, për një shumë që në total është rreth 4 milion lekë, i jemi drejtuar së fundi Kryeministrit, duke sugjeruar përgatitjen e një projekt vendimi nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe ajo e Financave, që të zgjidhë përfundimisht këtë problem që lidhet me akordim fondesh. Kësaj ankese i bashkangjiten edhe ankesat e qytetarëve të Fierit, apo qytetarë të zonave kufitare që pritën fluksin e të ardhurve nga Kosova, të cilët paraqesin të njëjtin shqetësim.

Po kështu do të veçonim edhe ankesat e qytetarëve të zonave kufitare, Kukës, Has, Tropojë, të cilëve u janë dëmtuar pronat nga bombardimet serbe në kufi. Edhe për këtë i jemi drejtuar Kryeministrit dhe jemi në pritje të përgjigjes.

Nga ankesat e tjera, të cilat lidhen me Ministrinë e Pushtetit Vendor, dhe që kanë të bëjnë me përfitimin e një të drejte, do të gruponim edhe:

1-Kërkesat për shpërblimet në raste fetkeqësish si zjarre, shembje banese apo rrëshqitje toke, për të cilat shteti jep një ndihmë për zbutjen e efekteve të këtyre fatkeqësive, bazuar në VKM Nr. 206 datë 26.03.1998 “Për pjesëmarrjen e shtetit në raste fatkeqësish”. Edhe për këto raste, përgjigjet kanë qenë standarte”: - sigurimi i fondeve do të bëjë të mundur realizimin e shpërblimit”. Ankesat mbarten në vite dhe të drejtat nuk përfitohen nga qytetarët që kalojnë në këto situata.

2-Ankesat që vijnë nga zona e rezervuarit të Bovillës për kompensim të pronave, si rezultat i shpronësimeve publike. Ankuesit kanë fituar gjyqet por, vendimet gjyqësore nuk zbatohen nga Ministria e Punëve Publike, duke ia kaluar çështjen Ministrisë së Pushtetit Vendor. Në lidhje me këtë çështje i kemi kërkuar Kryeministrit përcaktimin e Ministrisë përgjegjëse për këto kompensime, sepse këto Ministri nuk realizojnë detyrat e tyre, por “ia hedhin topin njëra-tjetrës”.

Ankesat për organet e Pushtetit Vendor

(për Komunat, Bashkitë, Këshillat e Rretheve, Qarqeve, dhe Prefekturat)

Gjatë vitit 2001 për këto organe kemi patur 194 ankesa apo kërkesa. Kryesisht, problematika e ankesave ka qenë për largime nga puna,

mosekzekutim vendimesh gjyqësore; çështjet e strehimit, në të cilat përfshihen tre kategori: kategoria e të pastrehëve nga rënia e skemave piramidale, kategoria e të pastrehëve nga mosekzekutimi i kontratave apo aktmarrëveshjeve që qytetarët kanë nënshkruar me organet e pushtetit lokal në vitet e mëparshme; si dhe kategoria e personave të tjerë me status të pastrehi; ankime ndaj akteve të ndryshme të pushtetit vendor; mospërfitimi i ndihmave të ndryshme financiare në raste fatkeqësish, pengesat në lidhje me privatizimin si zvarritje procedurash; mospagim i taksës së rregjistrimit për kalimin e pasurisë së paluajtshme, kur këto organe paraqiten me cilësinë e shitësit; abuzime me hartimin e listave të të pastrehëve që përfitojnë nga akordimi i kredive, etj.

Nga shqyrtimi i tyre ka dalë se në përgjithësi, ankesat apo kërkesat kanë qenë të drejta, por shpesh herë zgjidhja përfundimtare në favor të ankuesve është e pamundur të realizohet për pamundësi financiare të buxhetit të pushtetit vendor ose qendror.

Nga problematika e këtyre çështjeve, ka dalë se janë shkelur kryesisht dispozitat e Kodit të Punës; dispozitat e Ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”; të drejtat që rrjedhin nga VKM Nr. 585 datë 11.12.1997 “Për evidentimin e qytetarëve që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale”; dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative; VKM Nr. 149 datë 20.04.1999; Urdhëri Nr. 2 datë 11.05.1999 “Për procedurat e dhënies ndihmë financiare për familjet pritëse shqiptare që mbajtën të ardhurit nga Kosova”; VKM Nr. 206, datë 26.03.1998. Për ndihmat e shtetit në raste fatkeqësish; Ligji Nr. 8030 datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”; VKM Nr. 321 datë 05.07.1999 “Për akordimin nga fondet e kredisë greke”; Ligji “Për sistemin e taksave në RSH”; të drejtat që burojnë nga Kushtetuta për mbrojtjen e pronës private, e drejta e informimit, ndihmës sociale etj.

Ndër ankesat për pushtetin vendor do të veçonim ato që kanë të bëjnë me strehimin:

1-Të pastrehët që dolën të tillë nga rënia e skemave piramidale, por ka mjaft, rreth 500 persona në të gjithë vëndin që nuk u përfshinë në këto lista, pasi kishin humbur afatet ligjore të përcaktuara për këtë qëllim. Megjithëse ky problem u paraqit në raportin e vitit 2000 si i zgjidhur, konstatoam se në fakt nuk i ishte dhënë zgjidhje problemit nga Grupi Mbikqyrës i firmave piramidale pranë Qeverisë. Ministria e Punëve Publike nuk pranoi kërkesën e Bashkisë Tiranë për rregjistrimin në listat e 300 të pastrehëve që kishin paraqitur dokumentet jashtë afatit, të përcaktuar në VKM Nr. 585 datë 11.12.1997, megjithëse Vendimi i mësipërm Nr. 585, dt. 11.12.1997, nuk është botuar ende në Fletoren Zyrtare. I jemi drejtuar

sërisht Kryetarit të Grupit Mbikqyrës në lidhje me këtë çështje, por ende nuk kemi asnjë përgjigje. Ndërkohë, Këshilli i Ministrave nuk prononcohet, ndonëse është shkelur detyrimi i Kushtetutës, përkatësisht neni 117 i saj, në të cilën përcaktohet se vendimet e Këshillit të Ministrave me karakter të përgjithshëm duhet të botohen në Fletoren Zyrtare. Por, edhe nëse kjo do të realizohet, nuk dihet konkretisht se çfarë është arritur nga kredia greke, sepse nuk ka transparencë. Kjo çështje, praktikisht është e pazgjidhur.

2- Sigurimi i strehimit nga Bashkia e Tiranës, për kontigjentin e të pastrehëve, të cilët kanë lidhur kontrata me organet e pushtetit vendor që para 10 vjetëve, por që ende nuk kanë realizuar të drejtën e tyre të strehimit. Numri i këtij kontigjenti, siç jemi informuar, është rreth 100 persona, të evidentuar nga Bashkia e Tiranës.

Edhe për këto ankesa, përgjigjet e ardhura nga Bashkia e Tiranës se: “nuk ka fonde dhe banesa për këtë kontigjent”, nuk zgjidhin problemin. Mendojmë se për këto raste duhet të hartohet një plan strategjik me objektiva të qartë, për mënyrën e zgjidhjes dhe kontigjentin që duhet të mbulohet, për të bërë të mundur edhe gjetjen e një fondi të veçantë të përcaktuar për këtë qëllim.

3- Çështja e strehimit të personave, që kanë statusin e të pastrehëve është një objektiv social, emergjent, i shtruar për zgjidhje.

Nga ankesat që lidhen me veprimtarinë e Bashkive dhe organeve të tjera të qeverisjes vendore, ka rezultuar se është urgjent tashmë problemi delikat i strehimit. Ka patur mjaft ankesa nga të gjitha rrethet për këtë çështje. Në shumicën e rasteve, shtetasit e kanë fituar statusin si të pastrehë, por momenti i përfitimit të të drejtave që lidhen me këtë status duket i largët.

Neni 59 i Kushtetutës, ndër të tjera parashikon se: “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim...”.

Në këto kushte, pavarësisht se strehimi përfshihet si një objektiv social, vëmë në dukje faktin se ky është një problem imediat. Nga ana e organeve të qeverisjes vendore duhet së paku të ekzistojë transparenca në vendimmarrje dhe në objektivat e tyre për të zgjidhur këtë çështje apo të bëhen të njohura strategjitë përkatëse. Organet e qeverisjes vendore, tashmë janë të organizuara në bazë të parimit të autonomisë dhe vetqeverisjes, prandaj duhet që të krijojnë mundësinë e zgjidhjes së problemeve sociale për komunitetin që përfaqësojnë. Në lidhje me këtë, përgatitja e strategjive përkatëse se si mendojnë këta të fundit t’u zgjidhin problemin në fjalë, në çfarë kohe, kur dhe si, duhet të bëhet objekt i punës së tyre.

Kështu për shembull nga verifikimi i një ankese në Shkodër, në Zyrën e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë na u konfirmua se: Ekzistojnë rreth 190 familje të miratuara për kredi në vitin 1996, dhe kanë tërhequr kredi vetëm 78 familje, sepse nuk janë akorduar fonde për të gjithë. Kjo Bashki i ka kërkuar instancave të larta të Pushtetit Qendror akordimin e fondeve për ndërtim banesash, sidomos për strehimin e kategorisë emergjente të të pastrehëve dhe janë në pritje të akordimit përkatës nga Qeveria. Veçse mendojmë se zgjidhja nuk duhet pritur vetëm nga pushteti qendror.

4-Ankesa e shtetasit D.D. dhe 20 familje të tjera të pastreha që ankohen, pasi nga ana e Bashkisë Tiranë në muajin korrik 2000, ju janë shpërndarë autorizime strehimi, të cilat ju kanë rezultuar të pavlefshme dhe të pazbatueshme, e deklaruar kjo si nga vetë Bashkia Tiranë dhe nga Enti i Banesave. Institucioni ynë verifikoi në të gjitha Institucionet e përmendura në ankesë dhe në dokumentacionin përkatës dhe arriti në konkluzionin se: Bashkia Tiranë dhe respektivisht ish kryetari i saj Brojka kishte nënshkruar autorizime të pavlefshme juridikisht.

Vetë Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Entin Kombëtar të Banesave, është në tratativa për të zgjidhur këto lloj problemesh, që si shumë të tjera analoge futin qytetarët në rrugë pa zgjidhje.

5-Ankesë interesante ka qenë ajo e shtetasit M.F. në lidhje me disa veprime të ish Kryetarit të Këshillit të Rrethit Përmet, veprime të cilat kanë sjellë që ankuesi të përjashtohet nga listat e përfitimit, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak. Në kategorinë emergjente ai figuronte në listë i katërti, dhe ishte zëvendësuar me një tjetër person.

Duke gjykuar mbi faktet dhe dokumentet që disponohen për këtë çështje, çmuam se qytetarit M.F. i është shkëlur një e drejtë e ligjshme, nga veprimet e padrejta dhe antiligjore të ish kryetarit të Këshillit të Rrethit Përmet, i cili duke shpërdoruar postin e tij drejtues, ka vepruar në kundërshtim me vendimet e organeve të pushtetit lokal.

Përballë kësaj situatë, gjykojmë se veprimet apo mosveprimet e ish-kryetarit të Këshillit të Rrethit Përmet, plotësonin elementet e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Për këtë rekomandojmë fillimin e procedimit penal në ngarkim të tij, si dhe i rekomandojmë kryetarit të Bashkisë për të marrë masa për vënien në vend të të drejtës së shkëlur nga paraardhësi i tij. Çështja është ende në shqyrtim, megjithëse ka mbërritur një përgjigje nga Prokuroria e Përmetit, e cila shpjegon se meqenëse nuk ka ardhur pasoja, pra nuk i është akorduar kredi asnjë personi, nuk mund të fillohet në këto kushte çështja penale. Jemi

duke studjuar këtë përgjigje, sepse ne mendojmë se jemi para një vepre penale, ku mund të ketë edhe korrupsion.

6-Një rast tjetër që do të veçonim është ai i qytetarit të Vlorës I. L. Ai u ankua në lidhje me pengesat për privatizimin e banesës së tij, sepse Bashkia e Vlorës, nuk paguan taksën e rregjistrimit të pasurisë, kur ajo paraqitet me cilësinë e shitësit, për kalimin e pasurive të paluajtshme, me argumentin se nuk ka fonde për këto shpenzime. Sipas ligjit, taksa për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme paguhet nga shitësi (dhe në këtë rast me këtë cilësi ishte Bashkia).

Zyra jonë, në lidhje me këtë problem i dërgoi një Rekomandim Ministrisë të Financave për rishikimin e ligjit të taksave, rekomandim i cili u pranua. Në paketën fiskale të miratuar në dhjetor 2001 u vendos që organet e pushtetit vendor të përjashtohen nga pagimi i taksës së kalimit të pasurisë së paluajtshme. Duke zgjidhur këtë ankesë, u zgjidhën edhe mjaft të tjera që kanë të njëjtin objekt.

7-Ndërmjet ankesave për strehim do të veçonim edhe ato që kanë ardhur nga disa pronarë të ligjshëm, të cilat kanë të strehuar në banesat e tyre, ish prone shtetërore, të pastrehë, me cilësinë e qeramarrësve. Por qeramarrësit në zbatim të Ligjit Nr. 8030 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, nuk kanë shfrytëzuar lehtësitë e përcaktuara në këtë ligj, duke vazhduar të banojnë në këto banesa si qeramarrës. Duke u mbështetur në ligjin e sipërcituar, vërejmë se nuk ka ndonjë dispozitë, e cila të përcaktojë se: nëse të pastrehët në shtëpi ish-pronari nuk shfrytëzojnë të drejtat që i jep ky ligj për të siguruar strehimin e tyre, të humbasin të drejtat dhe si rrjedhim edhe strehimin në këto banesa si qeramarrës. Duke qenë se e drejta e pronës, është një e drejtë themelore kushtetuese që mbrohet me ligj, nuk ka sepse të mos favorizohen pronarët e ligjshëm, në rastet kur qeramarrësit nuk duan të ndryshojnë banesë dhe nuk shfrytëzojnë procedurën për të paraqitur dokumentat pranë Bankës së Kursimeve, për t’u trajtuar me kredi.

Për këto raste i kemi rekomanduar Bashkisë që të nxjerrë urdhërat administrative, me objekt lirim dhe dorëzim objekti, por mendojmë se duhet të rishikohet edhe vetë Ligji Nr. 8030 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, për t’i rregulluar këto raste.

Si konkluzion mund të themi se si nga Ministria e Pushtetit ashtu dhe nga organet e Pushtetit Vendor të të gjitha niveleve ka mjaft ankesa për keqadministratim të fondeve dhe kapërcime të rradhës së shpërndarjes së tyre. Psh: ka patur fonde për dëmshpërblimin e gjithë banorëve të zonës së Bovillës për tokat dhe banesat e tyre të përmbytura, por rezulton se disa janë shpërblyer më shumë dhe disa kanë mbetur pa shpërblyer, ose janë

shpërblyer banorë që kanë qenë larg zonës së liqenit, kur, ndërkohë kanë mbetur pa shpërblyer banorë pranë tij. Nga ky shembull del se duhet rritur kontrolli i shpërndarjes së fondeve dhe mirëadministrimit nga të gjitha hallkat kontrolluese si të dikasterit ashtu dhe i drejtorisë përkatëse të Këshillit të Ministrave.

6. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale

Gjatë vitit 2001 për këtë Ministri si dhe Institucionet në vartësi të saj si Instituti i Sigurimeve Shoqërore Shtetërore, Instituti i Integritit të të Përndjekurve Politikë, Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe Përkrahjes Sociale dhe filialet e tyre në rrethe, kanë ardhur gjithsej 131 ankesa dhe kërkesa. Nga këto, vetëm për Institutin e Sigurimeve Shoqërore kanë qenë 118 ankesa, të cilat do të trajtohen në veçanti si më poshtë:

a. Instituti i Sigurimeve Shoqërore Shtetërore

Gjatë vitit 2001, janë trajtuar 118 ankesa apo kërkesa, të cilat lidhen me zbatimin e Ligjit Nr.7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (ndryshuar me ligjet Nr.7932 datë 17.05.1995, Nr.8286 datë 16.02.1998 dhe Nr.8392 datë 2.09.1998), ndërsa për 6-mujorin e parë të punës sonë për vitin 2000 kanë qenë 49 ankesa dhe kërkesa. E parë në aspekt krahasues, ankesat e paraqitura për vitin 2001, kanë ardhur në rritje. Kjo ka ardhur si pasojë e rritjes së mirëbesimit dhe vlerësimit për Institucionin e Avokatit të Popullit.

Në ankesat dhe kërkesat e tyre, personat kanë ngritur:

Çështje që lidhen me llogaritjen dhe masën e përfitimit të pensionit të pleqërisë, të trajtimit me grupin përkatës të invaliditetit dhe pagesën përkatëse, të mosdhënies të së drejtës së përfitimit të pensionit të pleqërisë pas ndjekjes së procedurave për këtë qëllim, të mospërfitimit të kompensimeve nga sistemi i sigurimeve shoqërore, përfitim pensioni familjar apo të përkohshëm ose shtesë mbi pension. Gjithashtu qytetarët kanë patur ankesa apo kërkesa për shtyrje afati për dalje në pension, për pagesën pas ditës së 14-të të raportit mjekësor, për ripunësim sipas kushteve të grupit të invaliditetit, për trajtim me vlefata të prapambetura të pensionit, etj. Nga çështje e shqyrtuara rezulton se nga 118 çështje të shqyrtuara, rreth 41% e zënë ato që kanë të bëjnë me kërkesën për rritjen e masës së pensionit, të cilën ankuesit përfitojnë në momentin e ankimit.

Theksojmë që në fillim, se nga 118 ankesa vetëm 2 prej tyre, kanë qenë të drejta dhe janë zgjidhur në favor të ankuesve. Të tilla janë:

1. Ankesa e shtetases DH.I. nga Tirana. Ngrihej problemi i mosnjohjes dhe moscilësimit të saj si invalide lufte, nga vendimet përkatëse të Komisioneve Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP-ve), pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH). Për këtë arsye ankuesja ka kundërshtuar këto vendime në Gjykatën e Rrethit Tiranë, e cila me vendimin e saj ka vendosur detyrimin e ISSH-së, të njohë ankuesen invalide lufte. Por kjo e fundit, nuk ka pranuar ekzekutimin e vendimit që ka marrë formë të prerë.

Pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit, me anën e një rekomandimi drejtuar ISSH-së, për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, konform nenit 142, pika 3 të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë, rekomandimi është pranuar dhe zbatuar nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

2. Ankuesi P. P nga Tirana u ankua se Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit të Luftës ANÇL pranë Ministrisë së Mbrojtjes i ka njohur statusin e veteranit të luftës, por nuk po merrte dot shpërblimet përkatëse nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Ata refuzonin të zbatonin efektet financiare të këtij vendimi administrativ.

Mbasi u verifikua ankesa, iu rekomandua Institutit të Sigurimeve Shoqërore zbatimi i vendimit të Komisionit Qendror të Statusit të Veteranit të Luftës pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Rekomandimi u pranua dhe u fillua procedura e përfitimit për ankuesin.

3. Ankesa e disa punëtorëve të Fabrikës së Konjakut, Tiranë .

Ata janë ankuar lidhur me mosderdhjen e kontributit në Institutin e Sigurimeve Shoqërore për periudhën Janar 1998-Dhjetor 1999 nga Grupi Mbikqyrës i Firmave Piramidale. Sipas ligjit “Për firmat piramidale”, fondi i sigurimeve shoqërore për punëtorët është “ngrirë” dhe do të kalojë në favor të këtyre personave kur të fillojë shpërndarja e parave.

Përballë kësaj situate, punonjësit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Tiranë, e cila ka vendosur, detyrimin e të paditurit Shoqëria”M. Leka” sh.p.k., në administrim nga Grupi Mbikqyrës, të derdhë kontributin e sigurimeve shoqërore pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për këtë punëtorë.

Ankesa është akoma në proces shqyrtimi nga ana jonë sepse ndërkohë që kemi një ligj që pengon derdhjen e kontributeve, sepse ka “ngrirë” fondin, vendimi i gjykatës nuk e ka marre parasysh këtë ligj, por ka vendosur derdhjen e kontributeve.

Vendimi i gjykatës është bazuar tek neni 52 i Kushtetutës ku përcaktohet se çdokush ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri. Ndërkohë ligji i sipërpërmendur ia privon këtë të drejtë qytetarëve, të cilët kërkojnë që kontributet të paguhen rregullisht dhe nuk mund të presin të dalin në pension, sepse Grupi Mbikqyrës i Firmave Piramidale, nuk po bën shpërndarjen e pasurisë dhe as paguan kontributin e Sigurimeve Shoqërore.

Përballë këtij fakti, është krijuar mundësia e bërjes së një rekomandimi për ndryshimin e ligjit, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

4. Ankuesi E.T është ankuar lidhur me mospërfitimin e pensionit suplementar të babait si ish ushtarak. Pensionin që merrte ia kanë ndërprerë dhe momentalisht së bashku me motrën gëzon vetëm pensionin familjar. Nga verifikimi doli se në rastin e ankuesit, babai i tij nuk ka qenë ushtarak i shërbimit aktiv, personat në ngarkim të tij, pra ai dhe motra e tij, nuk kishin të drejtën e pensionit suplementar familjar.

Duke marrë shkas nga kjo ankesë u vumë në dijeni se nga Ministria e Mbrojtjes, së bashku me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, është duke u parë mundësia e ndryshimit të Ligjit nr.8087 dhe pikërisht nenit 15, ku në vend të fjalës “*ushtarakë të shërbimit aktiv*” është propozuar thjesht fjala “*ushtarakë*”. Pra në këtë mënyrë do të mund të përfshihen një numër i madh subjektsh përfitues për pension suplementar familjar.

5. Një grup ish minatorësh janë ankuar për mospërfitimin nga Ligji nr.8685, dt.9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

Nga Avokati i Popullit ata kërkonin që të bëhen ndryshimet përkatëse në ligje apo në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.73 dt. 15.02.2002 “Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, me qëllim që t’i njihet kontributi i derdhur vullnetarisht si periudhë sigurimi.

Duke iu referuar Ligjit nr. 8685 dt. 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë në nëntokë”, sipas të cilit përfitojnë trajtim të veçantë të gjithë punonjësit e nëntokës që kanë një periudhë të përgjithshme sigurimi jo më pak 23 vjet, prej të cilave 11.5 vite pune të jenë nëntokë. Ankesa rezultoi e pabazuar dhe ankuesve ju kthye përgjigje.

6. Shtetasi M.D. u ankua lidhur me trajtimin e diferencuar që i bëhet atij dhe grupimit të ushtarakëve në të cilin bën pjesë në lidhje me masën e përfitimit të pensionit për kategorinë e ish ushtarakëve, të cilën e cilëson si diskriminues. Ai pretendon se ish ushtarakëve në pensionin e pleqërisë u mohohen dhe vjetërsia e shërbimit, gradat, kualifikimet etj.

Ankesa është akoma në proces verifikimi. Rezulton se me mbushjen e moshës për pension, ish ushtarakët e trajtuar me pension të parakohshëm do t'u takojë pension minimal. Sigurimet shoqërore përdorin argumentin se institucionet përkatës: Ministria e Mbrojtjes, e Rendit etj nuk kanë derdhur kontribute për personat, të cilët kanë qenë në përfitim shpërblimi të pjesshëm. Pra, përderisa nuk rezultojnë derdhje kontributesh pranë ISSH-së, kjo periudhë nuk mund të llogaritet si periudhë sigurimi, prandaj nuk merret parasysh për llogaritjen e masës së pensionit.

Së dyti, përsa i përket faktit të mosmarrjes parasysh të vjetërsisë së shërbimit të gradave, kualifikimeve të ish ushtarakëve për masën e pensionit të pleqërisë, nga shpjegimet e kërkuara në lidhje me këtë problem pranë Ministrisë së Mbrojtjes, na rezulton se ka vend për të përmirësuar aktet ligjore. Ekziston një korrespondencë bashkëpunimi mes Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Mbrojtjes për ta rregulluar këtë çështje.

Konkluzione përsa i përket legjislacionit dhe veprimtarisë së administratës të sigurimeve shoqërore shtetërore

Në bazë të të gjitha evidentimeve, statistikave dhe observimeve të nxjerra në këtë raport si dhe bazuar në rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit që ndikon dhe përçon vizionin e mirëqeverisjes, arrihet në konkluzionin se Qeveria Shqiptare së bashku me institucionet e tjera përkatëse, duhet të jetë më efektive, më reale dhe më të përgjegjshme, në politikatat që lidhen me përcaktimin e masës së pensioneve.

Ky konkluzion del pasi shumica e ankuesve problemin e masës së pensionit që ata përfitojnë, e shohin në këndvështrimin e një diskriminimi që u bëhet atyre nga shteti për punën që ata kanë bërë për vite me radhë. Ata kërkojnë të ketë edhe një bazë më të mirë për politikatat shtetërore që zhvillohen në këtë drejtim. Kjo lloj politike, do të përkonte më mirë edhe me objektivat sociale të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ku një ndër pikat kryesore është synimi për standartin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor të mundshëm, si dhe përkujdesja dhe ndihma për të moshuarit, jetimët dhe invalidët.

Vlen të vihet në dukje se administratatat qendrore dhe lokale e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Shtetërore rezulton nga më të mirat ... *lidhur me implementimin e parimit të mirëadministrimit në punën e saj, krahasuar me mjaft organe të tjera të administratës shqiptare. Por, duke ju referuar parimeve të sanksionuara në Kodin e Procedurave Administrative, mund të themi se;*

Së pari duke u nisur nga praktikat problematike të legjislacionit të sigurimeve shoqërore, administrata e saj duhet t'i përmbahet më mirë dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

Së dyti, duke iu referuar ankeses S. Sh, ndodh shpesh që ankuesve u jepet përgjigje nga ekspertet e ISSH-së për ankesat e tyre, duke mos u trajtuar ankesat nga komisionet përkatëse të Apelit. Duhet të bëhet i qartë ndryshimi midis një përgjigje të letrës nga eksperti dhe një vendimi të një Komisioni Rajonal të Apelit. Prandaj po shqyrtojmë mundësinë e ndërhyrjes pranë ISSH-së, në mënyrë që si specialistët, ashtu edhe qytetarët të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm për ndjekjen e procedurave të apelit (neni 20/3 i Kodit të Procedurave Administrative).

Së treti, duke iu referuar rastit të ankesës së Z. A., i cili ka kërkuar t'i sqarohet thjesht nga pikpamja ligjore problemi i tij, del se shpesh herë përgjigjet e kthyer nga organet e administratës e kanë pjesën arsyetuese të formuluar dhe shpjeguar jo qartë, duke mos zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

b. Ndhimja dhe përkrahja sociale

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale ka në prioritetet e punës së saj, përdorimin me efektivitet të fondeve të ndihmës sociale, rritjen e shërbimit ndaj kategorive të ndryshme shoqërore, lehtësimin e varfërisë dhe nxitjen e kategorive sociale në nevojë drejt integritit në jetën normale. Por Administrata e Përgjithshme e Ndhimës dhe Përkrahjes Sociale për shpërndarjen e ndihmës ka patur probleme si në fazën e detajimit të buxhetit dhe në procesin e zbatimit të tij. Kjo ka çuar në kërkesat e vazhdueshme nga njësitë vendore për ndryshime në buxhet dhe shtesë fondesh nga kjo administratë. Organet e Pushtetit Vendor, duke forcuar kontrollin, kanë patur mundësi të pakësojnë numrin e familjeve që përfitojnë në mënyrë të pamerituar dhe për rrjedhojë, të sigurohet rritja e masës së fondit të ndihmës për çdo familje. Këto konfirmohen në spjegimet që ish Kryeministrja dhe ministrja e Punës dhe Çështjeve Sociale i ka dërguar Zyrës sonë. Megjithatë ankesat dhe kërkesat në këto fusha për mostërheqje të përkrahjes sociale për periudhat e prapambetura, për mosdhënie të ndihmës për arsye të ndërrimit të vendbanimit, për ndërprerje të padrejtë të ndihmës për invalidët, etj, kanë rezultuar nga verifikimet tona shumica të padrejta. Megjithatë, në mjaft raste, ne ju kemi sqaruar ankuesve rrugët që duhet të ndjekin për plotësimin e kërkesave të tyre, duke patur gjithmonë parasysh nenin 52, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që përcakton se: “Kushdo, kur mbetet pa punë për

shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj”.

c. Instituti i Integritit të ish të Përndjekurve Politikë

Për Institutin e Integritit të ish të Përndjekurve Politikë ka patur 2 ankesa, por që të dyja ato kanë rezultuar të pabazuara. Ndër to, më interesante ka qenë ajo e ankuesit V.N, i cili ka vuajtur rreth 19 vjet në burgje si i dënuar politik. Meqënëse plotësoi moshën, për të përfituar pension, dorëzoi dokumentacionin e nevojshëm pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe ankohej për përgjigjen negative që ka marrë. Kjo ishte argumentuar me faktin se në dëshminë e tij të penaltetit janë përfshirë si dënimet për veprat penale ordinere, ashtu edhe ato me motive politike. Kjo është e bazuar në Ligjin nr.7514 datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve politikë”, neni 1 i të cilit përcakton që: “Kur në dokumentet e ish të dënuarit politik nuk janë përcaktuar qartë këto dispozita ose kur mund të jetë dënuar me të njëjtin vendim edhe për një krim tjetër ordiner, e kjo masë dënimi nuk figuron e ndarë, saktësimin e vendos komisioni i krijuar nga Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Drejtësisë”. Por ky komision e ka përfunduar tashmë veprimtarinë, prandaj ju referua ankuesit që çështjen ta bëjë konflikt gjyqësor.

7. Ministria e Punëve Publike dhe Rregullimit të Territorit

Për këtë Ministri gjatë vitit 2001, ka patur 94 ankesa, nga të cilat 71 kanë qënë për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Ndërtimore dhe degët e saj në rrethe. Objekt i ankesave kanë qënë shpronësimet për interesa publike dhe problemet që kanë dalë nga ky proces, mospërfitimi i kompensimit për këto shpronësime, shpeshherë të fituar edhe me vendime gjyqësore, por që nuk janë ekzekutuar për mungesë fondesh, prishje apo mosprishje e ndërtimeve pa leje etj. Nga numri i përgjithshëm i ankesave të përfunduara për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Ndërtimore dhe degët e saj në rrethe, janë zgjidhur në favor të ankuesve 9 prej tyre.

Siç del edhe nga raporti i vitit të kaluar, ankesat për këtë Ministri kanë qënë të njëjta dhe problemet mbarten nga viti në vit.

Nga verifikimet tona ka rezultuar se shkaqet e ankesave janë rezultat i moszbatimit të Ligjit Nr.8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes

publik”; VKM-së Nr.297, datë 15.05.1998 “Për masën e kompensimit për shpronësimet publike”; VKM-së Nr.85, datë 02.03.1994 “Për vënien në dispozicion të zonave të banimit për familjet që shpërngulen nga Ujëmbledhësi i Bovillës dhe ato që kanë ndërtuar pa leje, për rreth qytetit të Tiranës”, si dhe të nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Si rast specifik do të veçonim disa ankesa me të njëjtin objekt që vijnë nga qytetarë, që u janë përmbytur tokat nga Bovilla.

Ata ankohen se duke qenë banorë në zonat të cilat u përmbytën nga ndërtimi i basenit të Bovillës, duhet të përfitonin kompensim të pronave të tyre, si rezultat i këtyre shpronësimeve për nevoja publike. Ata ende nuk po e gëzojnë këtë të drejtë, megjithëse e kanë fituar atë me vendime gjyqësore. Për këtë ankesë i kemi drejtuar disa herë Ministrisë së Punëve Publike dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal, por nuk gjejmë mirëkuptim. Ato nuk pranojnë përgjegjësitë për zgjidhjen e kësaj çështje, dhe nuk marrin përsipër që të përgatitin e të paraqesin në Qeveri projekt vendimet përkatëse.

Së fundi i kemi drejtuar Kryeministrin dhe kemi në pritje të përgjigjes për gjetjen e rrugës së zgjidhjes, që të caktojë ai Ministrinë përgjegjëse në këtë çështje.

Ankesat për ndërtimet pa leje

Policia e Ndërtimit është një nga Institucionet më të rëndësishme në luftën kundër konfuzionit dhe çrregullimeve urbane në planin ndërtues, sepse vë në zbatim forcën që i jep ligji për shkatërrimin e ndërtimeve të paligjshme ose ekzekuton urdhërat dhe vendimet e organeve të pushtetit vendor, për këtë fushë. Në këtë kuadër është për t’u përmendur numri i ankesave të shumta ndaj këtij organi si në planin mosveprues të tij, ashtu dhe për prishje të paligjshme.

Gjatë vitit 2001 janë trajtuar rreth 71 ankesa që kanë patur të bëjnë me ndërtimet pa leje. Vihet re një rënie mjaft e madhe e ndërtimeve pa leje ose e shkeljes së kondicioneve urbanistike nga shoqëritë e ndërtimit apo individë të veçantë. Kjo është rezultat jo vetëm i ndërgjegjësimit të subjekteve që bëjnë ndërtime, por është edhe rritja e gatishmërisë së organeve të pushtetit lokal për parandalimin ose moslejimin e ndërtimeve pa leje, në fazën e tyre fillestare. Ankesat e shumta të mbërritura pranë institucionit tonë kanë si problematikë të tyre më tepër shkelje të cilat janë të mbartura nga e kaluara, qysh para 2-3 vjetësh. Institucioni i Avokatit të Popullit ka qenë i angazhuar për secilin rast, duke kërkuar shpjegime nga organet përgjegjëse për moszbatimin e urdhërave administrative kryesisht,

ku përgjegjësinë kryesore e mban Policia Ndërtimore, por edhe duke bërë kqyrje në vend ose caktuar ekspertë për mendim të kualifikuar.

Fillimi i vitit 2001 u karakterizua nga një neglizhencë e theksuar e këtij organi dhe mungesë gadishmërie për të kthyer përgjigje, pas kërkesave të dërguara nga institucioni ynë. Në muajin Shkurt 2001 ndodhi që disa kryetarë degësh, përfshi edhe atë të Tiranës, u zëvendësuan nga kuadro të rinj. Kjo lëvizje na detyroi që ne t'i drejtoheshim edhe njëherë këtij organi, duke i kërkuar shpjegime për shkaqet e mosveprimeve për zbatimin e akteve administrative, por e njëjta situatë neglizhence shoqëroi edhe një periudhë tjetër dymujore. Ky ishte dhe shkak i cilin u organizua dhe një takim i drejtpërdrejtë ndërmjet Avokatit të Popullit me ish-Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë Ndërtimore, Z. Mit'hat Havari. Pas këtij takimi u ndje një farë përmirësimi i situatës, si dhe njëkohësisht u vunë kontakte të rregullta me juristët dhe drejtuesit e Policisë Ndërtimore. U rrit numri i përgjigjeve nga ana e këtij organi në drejtim të institucionit tonë, por duhet thënë se përgjigjet kishin të bënin më shumë me çështje për të cilat Policia Ndërtimore justifikohet, duke vlerësuar kërkesat e ankuesve si të pabazuara ose përgjigjet ngeleshin në fazën e premtimit për zgjidhjen e tyre, në një periudhë pak të mëvonëshme. Duke mbetur objektiv në trajtimin e situatës, duhet pranuar se Policia Ndërtimore ka patur një aktivitet mjaft të ngjeshur për rikthimin e parqeve dhe territoreve publike në gjendjen e mëparëshme. Kjo ka bërë që ky organ të justifikohet për mosveprime në raste të veçanta, ka patur edhe ndonjë rast që mosveprimet e tyre kanë qenë të qëllimshme dhe në këtë drejtim mendojmë se shkak i vërtetë mund të ketë qenë korrupsioni i individëve të veçantë nga shoqëritë e ndërtimit. Një fenomen që u vu re për këtë vit, është se Policia Ndërtimore ka patur raste që ka vepruar duke shkatërruar ndërtime, edhe pse ato kanë qenë të legjitimuara me vendime të formës së prerë nga gjykata. Megjithëse këto raste janë shumë të pakta, kjo nuk përbën justifikim, pasi vendimet e gjykatave vetëm duhet të zbatohen dhe nuk duhen diskutuar dhe, aq më tepër, s'duhet të veprohet kundër tyre nga organet e administratës.

Një numër i konsiderueshëm ankesash kanë qenë për prishjen e kioskave, të cilat me kalimin e kohës ishin shndërruar në objekte me konstruksion tullash dhe betoni, ndërsa zotëruesit e tyre kishin mundur të bënin dhe hipotekimin e tyre nëpërmjet vërtetimeve të faktit nga gjykata, formë e cila është e kundraligjshme. Për këto raste institucioni ynë u mjaftua duke i kthyer përgjigje ankuesve, duke i bërë të qartë se ankesat e tyre ishin të pabazuara ose në raste të veçanta, ju ka dhënë orientime për rrugët e mundshme që ata duhet të ndiqnin.

Ndër ankesat më tipike mund të paraqesim:

1. Ankesa e shtetasit A.SH, nga Durrësi, i cili është pronar i ligjshëm në një sipërfaqe të konsiderueshme trualli, në ish kompleksin e kabinave të pushimit në plazhin e Durrësit. Rreth këtyre kabinave ishin ndërtuar disa baraka pa leje, ku ishin strehuar persona të caktuar. Ankuesi pasi kishte ndërhyrë disa herë pranë Bashkisë Durrës si dhe Policisë Ndërtimore, u paraqit dhe beri ankesë pranë Zyrës së Avokatit të Popullit. Pasi u njohëm me ankesën nisën menjëherë veprimet duke i kërkuar shpjegime me shkrim këtyre dy organeve, në lidhje me çështjen. Pas një verifikimi që u bë në vend nga ekspertë të caktuar nga Avokati i Popullit, si dhe të takimeve që u zhvilluan në Bashkinë Durrës, u arrit përfundimisht të zgjidhej problemi i ankuesit. Bashkia futi në axhendën e projekt vendimeve të Keshillit Bashkiak edhe prishjen e të gjitha objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme. Në bashkëpunim edhe me Policinë Ndërtimore, është kryer prishja e objekteve dhe pronari është paraqitur vetë pranë Avokatit të Popullit, për të na vënë në dijeni lidhur me këtë përfundim. Nga kjo çështje është për t'u evidentuar se burokracitë që vihen re në fushën e organizimit dhe të funksionimit të organeve vendore, shpesh herë nuk lenë hapësirë apo krijojnë pengesa që shtetasit të gëzojnë pronat e tyre. Në këto kushte shpesh ka lindur nevoja që ekspertët e Avokatit të Popullit, të shkojnë pranë këtyre organeve për verifikime, pasi korrespondenca zyrtare me institucionet vendore, karakterizohet nga vonesat dhe mangesitë në informacion.

2. N. J. nga Korça, u ankua se megjithëse ishte e pajisur me leje ndërtimi, pengohej të vazhdonte punimet nga ndërhyrja e drejtperdrejtë e ish drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Ndërtimore, i cili sipas saj, ishte kushëri me fqinjin e ankueses. Pas rekomandimit tonë pati reagim të menjëhershëm nga z.Havari, i cili në përgjigjen e tij garanoi se ankuesja nuk do të pengohej të bënte ndërtimin për të cilin kishte leje të rregullt. Pas kësaj ankuesja nuk u ankua më.

3. Ankuesi J. Ç. nga Tirana, u ankua për pengesa të nxjerra nga Policia Ndërtimore gjatë ndërtimit të një objekti prej tij, për të cilin kishte leje. Pas ndërhyrjes tonë tek ky organ pengesat u hoqën dhe ankuesi vazhdon ndërtimin i qetë.

4. H.H. nga Tirana, u ankua se i ishte prishur një pjesë e lokalit të saj në Rr. "Kavajës", një shtesë brenda territorit të pronës së saj, por pa leje ndërtimi. Ajo kërkoi ndërhyrjen tonë urgjente për ndërprerjen e prishjes së mëtejshme të dyqanit nga Policia Ndërtimore, pasi ajo ndërkohe priste të pajisej me leje ndërtimi nga KRRT-ja. Pas rekomandimit tonë verbal,

Policia Ndërtimore i ndërpreu veprimet e saj dhe pas dy javësh, kur shtetësja u pajis me leje ndërtimi, vazhdoi e qetë aktivitetin e saj ekonomik.

5. Shoqëria e Ndërtimit “Rexhepi”, Tiranë, u ankua se i kishin dalë pengesa nga ana e Policisë Ndërtimore, e cila pasi i kishte ndërprerë punimet në një objekt, e kishte kaluar çështjen e tij pranë KRRTRSH- së, për rishqyrtim. Për këtë çështje ju drejtuam Sekretariatit Teknik pranë Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe më pas Ministrin të Ndërtimit. Nga të dyja përgjigjet e mbërritura rezultoi se këto organe nuk do të bëheshin pengesë, në rast se çështja do të zgjidhej në favor të ankuesit nga gjykata. Ndërsa ankuesi e fitoi gjyqin, por përsëri ju bë pengese Policia Ndërtimore. Pas rekomandimit tonë, Policia nuk i paraqiti më pengesa ankuesit dhe në këtë mënyrë çështja u konsiderua e zgjidhur në favor. Por pas një muaji ankuesi paraqet një ankesë të dytë, pasi këtë rradhë pengesat i kishin dalë nga Bashkia. Në lidhje me këtë i jemi drejtuar Bashkisë duke i kërkuar shpjegime, por megjithëse ka kaluar mbi një muaj, ende nuk kemi marrë përgjigje. Çështja është në shqyrtim, por në këtë rast vemë në dukje se janë parregullsitë e administratës tonë publike që ju shkaktojnë shumë shqetësime qytetarëve.

8. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit

Numri i përgjithshëm i ankesave dhe kërkesave në lidhje me pretendimet e ankuesve, për shkeljen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimeve (MEPP) dhe organeve të lidhura me të, është 69. Në këtë grup janë përfshirë edhe ankesat e kërkesat që lidhen me Agjensinë Kombëtare të Privatizimit (AKP), Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) dhe Telekomin.

Ankesat dhe kërkesat e mësipërme, janë trajtuar sipas marrëdhënieve dhe kompetencave që i përkasin administratës së institucioneve të përmendura më lart dhe më konkretisht:

Për M.E.P.P. janë 22 ankesa e kërkesa; për A.K.P. janë 20 ankesa e kërkesa, për KESH-in, 21 ankesa e kërkesa. Kurse për Telekomin kemi 6 ankesa e kërkesa.

Përpara se të ndalemi në rastet konkrete, del se gjatë vitit 2001, kanë ardhur 10 herë më shumë ankesa se në vitin 2000, për shkelje të të drejtave nga administratat e institucioneve të sipërcituara. Kjo rritje e ka burimin në veprimet dhe mosveprimet e paligjshme të kësaj administrate që vijnë si pasojë e mosnjohjes sa dhe si duhet të Kushtetutës dhe ligjeve dhe në

konfliktin e interesave që janë evidente për këto institucione. Po ndalemi shkurtimisht në disa raste ankesash që kemi trajtuar në M.E.P.P.

Në ankesën që kanë dërguar katër ish punonjës të Shërbimit Informativ dega Vlorë, pretendohet se objekti i ish zyrave të filialit të shpim-kërkimit Vlorë (Pusi i Mezinit) është privatizuar dhe rregjistruar në zyrat e rregjistrimit të pasurive të paluajtshme Vlorë, me dokumentacion të rregullt, në emër të tyre. Ata shprehën shqetësimin se dokumentacioni ishte i ligjshëm, por, disa nëpunës të ndërmarrjes së “Albpetrolit Patos” kishin paraqitur dokumenta të fallsifikuara pranë M.E.P.P. për t’u rishitur këtë objekt. Pas verifikimit që iu bë kësaj ankese dhe dokumentacionit që e dispononte edhe M.E.P.P., rezultoi se shqetësimi i ankuesve ishte i ligjshëm.

Ndërhyrja e Institucionit të Avokatit të Popullit, për të mos u lejuar shkelja e të drejtave të ankuesve të mësipërm u vlerësua e drejtë dhe në përgjigjen e ardhur nga M.E.P.P. u pranua se, procedurat për privatizimin e këtij objekti ishin kryer konform ligjit e nuk kishte asnjë bazë ligjore për t’u rinxjerrë përsëri në shitje, siç kërkonte pranë kësaj ministrie filiali i shpim-kërkimit Vlorë, veprim që po përgatitej t’u miratonte edhe ministria.

Qëndrimi ligjor dhe korrekt i M.E.P.P. për rastin e përmendur nuk mund të justifikojë zvarritjen e pajustificueshme që është treguar për rastin si më poshtë:

-Në ankesën e ardhur nga shtetasi B.M. administrator i shoqërisë “Zhaku i Dajlanit” sh.p.k. pretendohet se me shkresë të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit i është pezulluar veprimtaria dhe nuk lejohet së bashku me ortakët e tjerë të hyjnë në objektin “Dajlani i Butrintit”, njësi e ndërmarrjes së midhjes dhe peshkut Sarandë.

Nga hetimi i çështjes rezultoi se pretendimi i ankuesve ishte i bazuar dhe i mbështetur në V.K.M. datë 23.09.1999, “Për dhënien me qera të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive apo institucioneve shtetërore” sepse:

-kishte autorizim të Ministrit të E.P.P. për lidhjen e kontratës së qerasë për objektin “Dajlani i Butrintit”;

-kishte kontratë 10-vjeçare qeraje, lidhur më 22.05.2001, ndërmjet M.E.P.P. edhe ankuesit;

-kishte aktdorëzim të objektit nga drejtori i ndërmarrjes së midhjeve, Sarandë;

-kishte vendim të formës së prerë nr. 154, datë 08.02.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë, etj.

Po kështu, në përgjigjen e parë që dërgoi Ministri pas kërkesës tonë për shpjegime, thuhej shprehimisht se: “Ministria e E.P.P. nuk ka kërkuar prishjen e kontratës së dhënies me qera të objektit në fjalë për shoqërinë

“Zhaku i Dajlanit” Sarandë, por kundrejt kërkesës për anulimin e aktit të dorëzimit nga ana e drejtorisë së ndërmarrjes, Ministria me anë të shkresës nr. 4407/2, dt. 19.02.2001, i është drejtuar drejtorit të ndërmarrjes për mosdorëzimin e objektit të mësipërm deri në rivlerësimin e tij”. Pavarësisht nga qëndrimet jo koherente të shprehura më parë nga M.E.P.P. për këtë çështje, përgjigjen e cituar më lart e vlerësuam korrekte dhe të bazuar në ligj. Ky vlerësim vlen deri në momentin që u bë rivlerësimi i objektit nga ekspertët që caktoi vetë kjo ministri. Më pas, në përgjigjen e M.E.P.P., përdoret si justifikim, për shkeljen e ligjit dhe të së drejtës së ankuesit, paraqitja e rekursit në Gjykatën e Lartë.

Kjo çështje është ende e pazgjidhur, por jo jashtë vëmendjes së Institucionit të Avokatit të Popullit. Kërkesa dhe qëllimi ynë është në rradhë të parë mbrojtja e interesave të ligjshëm të këtyre ankuesve dhe nuk mund të lëmë jashtë vëmendjes qëndrimet abuzive dhe korruptive, prandaj i jemi drejtuar përsëri kësaj ministrie dhe kemi ritheksuar se: “Kontrata e qerasë që ka lidhur kjo ministri me ankuesit dhe që Ministri e konfirmon në përgjigjen e tij, se nuk ka kërkuar prishjen e saj, është lidhur me datën 22.05.2001, pra rreth 3 muaj pasi është dhënë Vendimi nr. 154, datë 08.02.2001 i Gjykatës së Apelit Tiranë”.

Po kështu, veprimet e kryera nga kjo ministri, për dorëzim objekti, më pas anulim, përsëri dorëzim dhe prapë anulim, janë kryer të gjitha pas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Njëkohësisht, theksojmë se paraqitja e rekursit në Gjykatën e Lartë nuk mund të përdoret si argument për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, pasi kjo gjykatë nuk ka marrë ndonjë vendim pezullimi për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit, i cili në bazë të nenit 551, pika “ç” të Kodit të Procedurës Civile është i formës së prerë. Kurse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 143, pika 3, përcakton shprehimisht se: “Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”.

Ka edhe ankesa të tjera për këtë ministri lidhen me mospërfitimin e të drejtave që rrjedhin nga procesi i privatizimit, për arsye të përcaktimit jo të drejtë të kritereve për kategorinë e punonjësve aktualë të shoqërive që do të privatizohen.

Konkretisht janë dy çështje, por që përfshijnë një numër jo të vogël ankuesish që janë trajtuar dhe kanë patur të bëjnë me interpretimin e nenit 1 të Ligjit nr. 8384, dt. 23.04.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, në të cilin theksohet se “... Punonjës të shoqërisë konsiderohen punonjësit aktualë dhe ata të trajtuar me asistencë sipas Ligjit nr. 7521, datë 30.10.1991 “Për Përkrahjen Sociale për personat

që dalin pa punë nga zbatimi i reformës ekonomike”, një vit para publikimit të shoqërisë për privatizim”.

Kështu, pranë Institucionit tonë janë paraqitur së pari, një grup pensionistësh, të cilët kërkonin të trajtoheshin si punonjës aktualë dhe së dyti, një shtetase, e cila kishte punuar për një kohë të gjatë pranë Profarmës Tiranë dhe ishte larguar nga ajo punë, pasi kishte përfituar statusin si invalide.

Në këto kushte, para autoriteteve përkatëse u shtrua çështja, nëse ky grup do të konsiderohej si punonjës aktualë të shoqërisë. Për këtë iu referuam në të njëjtën kohë dhe VKM nr. 119 dt. 18.03.2000.

Në përfundim u arrit në konkluzionin se ankuesit kanë të drejtë si të gjithë punonjësit e tjerë të shoqërisë të përfshihen në paketën e aksioneve të shoqërisë me bonot e tyre të privatizimit dhe të marrin një shpërblim, i cili përcaktohet në varësi të bilancit të shoqërisë. Kjo zgjidhje u arrit nëpërmjet ndërhyrjes së Institucionit tonë me rekomandim për çështjen në fjalë.

Kurse në ankesën e tij, qytetari H.B. si kryetar i “Bashkimit të Përgjithshëm të Pensionistëve të Shqipërisë”, ngre shqetësimin e shoqatës për mosfutjen në përdorim të letrave me vlerë në objektet për privatizim.

Duke iu referuar legjislacionit, në të cilin është përcaktuar mënyra e përfshirjes së letrave me vlerë në strategjinë e privatizimit, na rezulton se në Ligjin nr. 8306, dt. 14.03.1998, në nenin 9 përcaktohet se është Këshilli i Ministrave që ngarkohet për të përcaktuar formulën e privatizimit dhe kufirin e mundshëm të pjesëmarrjes së letrave me vlerë. Gjithashtu, në aktin normativ dt. 16.02.1999 “Për një ndryshim në Ligjin nr. 8162, dt. 07.11.1996 “Për miratimin me ndryshime të dekretit 1630, dt. 01.01.1996”, është vendosur që afati i bonove dhe lekëve të privatizimit të jetë deri më date 31.12.2005. Platforma dhe programi i përdorimit të tyre të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ky akt i fillon efektet juridike nga data 1 janar 2000.

Referuar akteve të sipërpërmendura, baza ligjore për futjen në përdorim të letrave me vlerë ekziston, por për zbatimin e saj duhen ndërmarrë disa hapa të tjerë. Në këto kushte, duke qenë se kemi një ligj që përcakton qartë detyrimin e Këshillit të Ministrave për hartimin e një platforme, ndodhemi para paraqitjes së problemit për zgjidhje pikërisht pranë këtij organi. Afati kohor i zbatimit të këtij akti është 5 vjet dhe kanë mbetur dhe 3 vjet për marrjen në shqyrtim të tij. Problemi paraqet rëndësi, si përse i përket numrit të personave që janë të interesuar, ashtu edhe për faktin që një sërë objektesh vazhdojnë të jenë në proces privatizimi.

Përballë rastit konkret, Qeveria duhet të ketë parasysh se mospërdorimi i letrave me vlerë për arsye të mos-hartimit të platformës nga

Këshilli i Ministrave, prek interesat e ligjshme të shtetasve, duke mos u krijuar atyre mundësinë për pjesëmarrje në privatizimin e disa objekteve të rëndësishme që po privatizohen.

Duke e vlerësuar këtë çështje si mjaft të rëndësishme, Institucioni i Avokatit të Popullit po punon që, nëpërmjet kontakteve dhe rekomandimeve të nevojshme, të ndikojë pranë Qeverisë për realizimin brenda afatit kohor të detyrimit që përcakton ligji.

Problematike kanë qenë edhe largimet nga puna dhe mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Ankesat flasin për qëndrime subjektive dhe abuzive, si dhe shkelje të detyrimeve kushtetuese, nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Si rast do të veçonim rastin e H.XH., i cili përfaqëson 103 familje të Kukësit. Ata pretendojnë se u janë shkelur të drejtat dhe ankohen në lidhje me pengesat që u kanë dalë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Kukës, për të drejtën e përfitimit të dëmshpërblimit të pronave të tyre, në fshatin Gjegjan, të cilat janë dëmtuar nga punimet e Minierës së Bakrit Gjegjan.

Çështja është në shqyrtim, pasi kjo ministri, në përgjigjen e saj, justifikohet se nuk është debitore, pasi Miniera është likuiduar dhe të drejtat i kanë kaluar administratorit, i cili nuk i pranon këto detyrime.

a. Agjensia Kombëtare e Privatizimit

Kjo Agjensi është në vartësi të Këshillit të Ministrave, por për shkak të problemeve që trajton, është e lidhur me Ministrinë e Ekonomisë dhe Privatizimit.

Ankesat e ardhura pranë Institucionit tonë ndaj AKP-së lidhen me shkelje të natyrave të ndryshme, por po ndalemi vetëm në disa prej tyre.

Në ankesën e saj, shtetësja M.G. pretendoi se procesi i privatizimit të një objekti në Pogradec ishte pezulluar pa të drejtë nga dega e AKP-së Pogradec, duke penguar atë të ushtronte të drejtën e parablerjes si pronare e truallit nën këtë objekt. Nëpërmjet vendimeve gjyqësore të tre shkallëve, ankuesja kishte fituar të drejtën për të përfituar nga privatizimi i një pjese të konsiderueshme të objektit. Pasi u kryen të gjitha verifikimet dhe sqarimet e rrethanave konkrete të çështjes, iu rekomandua AKP-së të fillonte procedurat ligjore të privatizimit. Ky detyrim vinte nga vendimi i Gjykatës së Lartë. Në përgjigjen që kemi marrë, vihemi në dijeni se po punohet për realizimin e këtij procesi.

Nga studimi i kujdesshëm i një ankese u njohëm me një problem që lidhet me dhjetra e qindra shtetas që kanë blerë objekte shtetërore, por nuk

mund t'i regjistronin këto prona në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Pengesë për këtë ishte AKP-ja, e cila duke qenë në rolin e shitësit, nuk paguante detyrimin për tatimin mbi shitje sipas ligjit për taksat.

Moskryerja e pagesës nga ana e AKP-së kur realizonte shitje të objekteve të ndryshme u vlerësua si një çështje që cënonte në mënyrë direkte të drejtat e pronësisë të parashikuara në nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Prandaj mbi bazën e argumentave ligjore iu drejtuan Kryeministrit dhe Ministrit të Financave duke i kërkuar rregullimet e nevojshme ligjore, për të evituar cënimin e mëtejshëm të të drejtave të ish pronarëve dhe shtetasve të tjerë që përfitojnë nga shitja e pronës shtetërore.

Kryeministri dhe Këshilli i Ministrave u impenjuan shpejt dhe vlerësuan maksimalisht problemin, duke nxjerrë vendimin përkatës që i akordonte AKP-së, nga çdo shitje objekti shtetëror, një pjese të shumës së tij, për efekt të shlyerjes së detyrimit për tatimin mbi shitjen, duke bërë të mundur në këtë mënyrë realizimin e regjistrimit të pronës nga blerësit e interesuar. Kjo zgjidhje pozitive e çështjes, siç thamë edhe më lart, përfshin një numër të madh personash, të cilët ishin prekur nga pezullimi i këtij procesi dhe ndikoi në mënyrë direkte në realizimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve.

b. Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH)

Kanë ardhur mjaft ankesa për KESH-in dhe, bazuar në to si dhe në median e shkruar dhe elektronike, kemi filluar një proces të veçantë për verifikimin nëpërmjet një grupi pune.

Veç sa më sipër, konstatojmë se, edhe për probleme (ankesa) që nuk kanë të bëjnë me krizën energjitike, apo arsye të tjera objektive, nuk veprohet fare ose veprohet në mënyrë abuzive.

Po ndalemi vetëm në dy raste që flasin shumë për mungesë përgjegjësie dhe për mënyra sjelljeje abuzive të nëpunësve që i trajtojnë hallet e shtetasve sipas dëshirave subjektive.

Shtetasi A.A. nga Tirana, në emër të banorëve të zonës së lagjes nr. 14, rruga "Sitki Çiço" pretendoi për kufizime të theksuara të energjisë elektrike që variojnë nga ora 08.⁰⁰-16.⁰⁰ dhe nga ora 24.⁰⁰ deri në 04.⁰⁰ të mëngjesit, veprim ky që nuk ndodhte në këtë masë në zonat e tjera të Tiranës. Nga verifikimi rezultoi se kjo zonë realisht diskriminohej krahasuar me zonat e tjera të qytetit të Tiranës, ç'ka bie ndesh me të drejtat që u garanton Kushtetuta, për tu trajtuar si të barabartë, por edhe me vetë

praktikën e përcaktuar në grafikët e KESH-it Tiranë. Pas ndërhyrjes sonë, u pranua se kjo situatë e rënduar në ndërprerjen e energjisë elektrike, kishte ardhur si pasojë e lidhjeve të kabinës elektrike të kësaj zone, në një lidhje me atë të fshatit, i cili, sipas grafikut të përcaktuar nga KESH-i, ka një ndërprerje më të madhe të energjisë elektrike. Pas ndërhyrjes dhe kontakteve tona me drejtues të KESH-it, u informuam se u morën masat e nevojshme teknike për të bërë ndryshimet e nevojshme. Por, pas disa ditësh përmirësimi, u rikthye përsëri gjendja e mëparshme. E sollëm këtë rast, për të argumentuar nevojën që ka KESH-i, jo thjesht për zgjidhjen teknike të problemeve, por edhe për zgjidhje të studjuara dhe kulturë pune.

Rasti tjetër ka të bëjë me ankesën e shtetasit M.V., që pretendoi se, megjithëse i ishte drejtuar disa here degës së shitjes Tiranë për të nënshkruar kontratën e lidhjes së energjisë elektrike, çuditërisht ky shërbim nuk i ofrohej nga punonjësit e kësaj dege. Qëndrimi i punonjësve deri dhe juristes të kësaj dege ishte i paligjshëm, pasi i kërkonin shtetasit në fjalë, që kishte blerë dhe rregjistruar apartamentin në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në dhjetor të vitit 2000, të paguante detyrimet që nga viti 1995, pasi ish pronari që i kishte shitur banesën, nuk kishte bërë pagesën.

Kërkesës tonë për zbatimin e ligjit dhe lidhjen e kontratës së qerasë, filiali i korporatës elektroenergjetike dega Tiranë iu përgjigj dhe e zgjidhi pozitivisht, por e gjejmë në vend të theksojmë se organizimi i punës dhe përgjegjësia e këtyre nëpunësve para shtetasve është në nivelet më të ulta, pa folur për ankesat se korrupsioni është ulur këmbëkryq, duke filluar nga faturistët.

Ka patur ankesa edhe raste të shkaktimit të zjarreve që janë pretenduar se kanë ardhur nga korenti elektrik apo shkaktim dëmsh për pajisje elektroshtëpiake nga ndryshimi i tensionit të rrymës elektrike. Për të gjitha këto raste, kemi sugjeruar që ankuesit t'i drejtohen gjykatës, sepse ne nuk kemi mundësi të caktojmë grupe ekspertësh, që janë të nevojshëm për të sqaruar ankesat në këto raste, për shkaqet, sasinë e dëmeve etj.

c-Telekomi

Edhe ankesat për entin e telefonisë fikse, që përfaqësohet nga Telekomi sh.a., deri tashmë nën pronësinë 100 % nga shteti shqiptar, kanë qenë e vazhdojnë të jenë të shumta. Ankesat kanë patur si përmbajtje moslidhjen e telefonave në bazë të listave të afishuara, por mbi baza subjektive dhe selektive, moskryerjen në kohë të shërbimeve për ndryshim numri apo linje, riparimin me vonesa të theksuara, deri mujore të difekteve,

e deri tek ankesat për faturim pagesash anormale, kur qytetarët vërtetojnë se nuk kanë përdorur telefonin, pra pretendohet për vjedhje impulsesh etj.

Në pjesën më të madhe këto ankesa janë konsideruar të drejta nga ne, është ndërhyrë dhe në disa raste ankuesve u është zgjidhur problemi. Por, në rastet e ankesave për vlerën e impulseve ne u kemi sugjeruar t'i drejtohen gjykatës, sepse nuk mundemi të realizojmë verifikime të plota në raste të tilla.

9. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit

Gjatë vitit 2001 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit si edhe për Institucione apo organizma që kanë si objekt veprimtarinë e problemet e bujqësisë dhe ushqimit janë gjithsej 59 ankesa apo kërkesa.

Nga këto për vetë Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit nuk ka asnjë ankesë.

a. Ankesa për çështje të ligjit “Për Tokën”

Një problem më vehte, dhe tepër i mprehtë, është ai i zbatimit të ligjit nr.7501, dt.19.7.1991 “Për Tokën”. Çështja varet sa nga Ministria e Bujqësisë, aq edhe nga organet e pushtetit vendor. Ndërsa vitin e kaluar, pjesa më e madhe e ankesave për këtë problem, kishin si objekt moszbatimin e saktë në praktikë të ligjit, mos shpërndarjen e Akteve të Marrjes së Tokës në pronësi, dhënien e të njëjtës tokë disa personave, ose me mbivendosje; në vitin 2001, shumica e ankesave kanë ardhur nga ish-anëtarë të kooperativave bujqësore dhe ish-punonjës të NB-ve e bashkëthemelues të këtyre të fundit, që kanë të bëjnë me mos-dhënien e tokës bujqësore në pronësi.

Për mënyrën e zbatimit të ligjit “ Për Tokën” gjatë vitit 2001 janë paraqitur 44 ankesa dhe kërkesa, prapa të cilave janë rreth 200 familje. Por ndërsa nga viti i kaluar, siç thamë ka ndryshuar vetëm objekti i ankimit të tyre, sepse përta i përket përgjegjësisë dhe veprimtarisë, së Komisioneve të Tokave, në të gjitha nivelet, rezulton se asgjë nuk ka ndryshuar në sensin pozitiv. Mungon impenjimi i tyre për shqyrtimin e zgjidhjen e këtyre ankesave, ka zvarritje të pafund, ja lënë përgjegjësinë komisioneve të rangjeve të tjera, ka dhënie të tokave bujqësore jashtë kriterëve, tejkalime të dhënies së tokës në pronësi brenda fisit, tej normave të caktuara, nuk ka të dhëna të sakta sa tokë ka mbetur pa u ndarë, e shumë qëndrime e veprime spekulative.

Ankesat më të shumta kanë ardhur nga Tirana, Fieri Vlora, Laçi, Lezha, Elbasani Librazhdi, etj. Është fakt se nga rrethet e Pukës, Malësisë së Madhe, Gramshit, Shkodrës. Kukësit, Hasit, nuk ka patur asnjë ankesë.

Gjatë aktivitetit tonë, në kuadrin e shqyrtimit të ankesave të shtetasve lidhur me mos-respektimin e ligjit nr.7501, dt.19.7.1991 “Për Tokën”, e aktet e tjera dalë për zbatimin e tyre, kemi konstatuar se, Komisionet e Tokës, në të gjitha nivelet e tyre, kanë vazhduar edhe në vitin 2001, të njëjtën mënyrë zvarritje të shqyrtimit të kërkesave të shtetasve, që pa frikë mund të themi se është ngritur në një sistem pothuajse korruptiv, duke mos shfaqur as minimumin e impenjimit për t’ua dhënë tokën atyre që ju takon sipas ligjit. E thënë në një mënyrë tjetër, të gjitha të metat e evidentuara në raportin publik të Avokatit të Popullit paraqitur në Parlament për vitin 2000, për këto probleme, vazhdojnë të ekzistojnë në të njëjtat nivele.

Tipike në zvarritjen e zgjidhjes së ankesave të shtetasve që plotësojnë kriteret e vendosura për marjen e tokës bujqësore në pronësi, janë Komisionet e Tokave pranë Bashkisë së Laçit, të qarkut të Durrësit, Elbasanit, Librazhdit e Vlorës. Me shumë keqardhje, konstatojmë se nga moria e ankesave të shtetasve, me objekt mos dhënien e tokës bujqësore ne pronësi, pasi plotësojnë të gjitha kriteret ligjore, edhe pas konfirmimeve zyrtare të Komisioneve të Tokave përkatëse për legjitimitimin e tyre, nuk ka asnjë veprim konkret për rivendosjen në vend të të drejtave të shtetasve të shkelura nga vetë këto Komisione. Theksojmë se vetë ligji “Për Tokën” nuk është faktor pengues. Me gjithë përpjekjet, angazhimin e dëshirën tonë të mirë për t’u dhënë rrugëzgjidhje ankesave të kësaj natyre, me gjithë rekomandimet e bëra, kujtesën që ju kemi bërë këtyre Komisioneve për detyrimet për zbatimin e saktë të ligjit dhe pasojat që kanë në të kundërt, për vitin 2001, nuk është zgjidhur asnjë ankesë e tillë. Më e keqja është se veprimet e Komisioneve të Tokave, nuk të lënë shteg për të shpresuar diçka në të ardhmen. Këto Komisione për ne dhe për publikun janë bërë plotësisht të pabesueshëm.

Për sa më sipër si dhe duke parë se në shumë fshatra e komuna, komisionet e tokës nuk ekzistojnë, i kemi rekomanduar Ministrin të Bujqësisë dhe Ushqimit, i cili sipas ligjit është edhe Kryetar i Komisionit Qeveritar të Tokës, që të ndërmarrë nismën ligjvënëse për përmirësime të akteve ligjore e nënligjore, me qëllim zbatimin korrekt e të shpejtë të ligjit “Për Tokën”, riformimin e Komisioneve të Tokave në të gjitha nivelet, ku ato nuk ekzistojnë dhe vënien e tyre në efikasencë. Kjo me objektiv që të përfundojë plotësisht procesi i ndarjes së Tokave, i nisur që para 10-vjetësh, në vitin 1991.

b. Ankesa për pasurinë e ish-kooperativave bujqësore

Një grup tjetër ankesash, kanë qënë nga ish-anëtarët e kooperativave bujqësore, të cilët ende nuk kanë marrë kontributin në të holla nga pasuria e këtyre të fundit. Janë 4 të tilla, por realisht është mjaft problematike në shumë fshatra. Nga hetimet tona rezultojnë se të gjitha këto ankime janë të bazuara në Ligjin nr.7745, dt.26.7.1993 “Për rivlerësimin dhe rishpërndarjen në vlerë të pasurisë së ish-kooperativave bujqësore” dhe VKM nr.450, dt.16.9.1993 dalë në zbatim të tij.

Këto ankesa janë të drejta, por nga ana tjetër nuk ka më hapësira ligjore që rekomandimet tona për likuidimin e kreditorëve të merren parasysh e të zbatohen. Kjo për arsye se afati kohor për përfundimin e këtij procesi ka qënë 1 Shtatori i vitit 1996. Pas kalimit të këtij afati, pasuria e debitoreve (*personave që morën objekte të kooperativave bujqësore dhe që nuk kanë derdhur vlerat e tyre monetare, të cilat do të rishpërndaheshin*) duhej të shitej në ankand për llogari të kësaj rishpërndarje. Akte nënligjore për kryerjen e ankandit, nuk ka. Vetë komisionet e vlerësimit të kësaj pasurie, nuk ekzistojnë. Po ashtu Zyrat e Përmbarrimit nuk mund të kryejnë ekzekutimin e titujve ekzekutivë, të vendimeve të Këshillave, të Komunave dhe Bashkive, për pamundësi parapagimi të taksës së ekzekutimit, e cila zë 7% të objektit të vlerësueshëm.

Edhe për këtë problem, duke e konsideruar si një shkelje të të drejtave e interesave të ligjshme të shtetasve, ish-anëtarë të kooperativave bujqësore, në bazë të nenit 24 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i kemi rekomanduar Ministrin të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministrin të Financave, marrjen e iniciativës ligjvënëse për përmirësime dhe ndryshime, përfshi zgjatjen e afateve dhe rikrijimin e komisioneve të vlerësimit të pasurisë të të gjitha niveleve, të akteve ligjore e nënligjore për vazhdimin deri në përfundimin e plotë të procesit të rivlerësimit e rishpërndarjes në vlerë të pasurisë së ish-kooperativave bujqësore.

c- Probleme për pyjet

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve ka patur 3 ankesa me të njëjtin objekt, dorëzimin me proces verbal të sipërfaqeve pyjore dhe kullotave, kthyer me vendim të Komisioneve të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave. Nga këto ka rezultuar se dy ankesa ishin të pabazuara, (*në dispozitivin e vendimit mungonin kufijtë real që të identifikonin pronën*), ndërsa ankesa që i përkiste shtetas Sh.M, banuese në Tiranë, u zgjidh në favor të saj; duke i kthyer Drejtoria e Shërbimit Pyje-Kullotave Përmet,

sipërfaqen pyjore si edhe u bë regjistrimi i pronës në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme të Rrethit.

Janë depozituar pranë institucionit tonë edhe 2 ankesa të tjera lidhur me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për dëme që këto Drejtori ju kanë shkaktuar personave privatë. Drejtoritë e Shërbimit Pyje-Kullota të rretheve Gramsh dhe Kolonjë i kanë kërkuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit akordimin e fondeve për likuidimin e kreditorëve. Ankesat janë në ndjekje.

d- Probleme për cilësinë e ushqimeve

Lidhur me këtë problem pranë Institucionit tonë ka paraqitur ankesë Kryetari i Shoqatës së Konsumatorëve Shqiptare, i cili ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit me rekomandime për Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministrinë e Shëndetësisë, lidhur me ndryshime dhe rakordime të legjislacionit për ushqimin, për t'i përputhur me ligjin "Për Mbrojtjen e Konsumatorit". Duke parë se kërkesa ishte e bazuar, ju rekomandua Ministrive përkatëse të ndërmerrnin nismën ligjvënëse për ndryshime në legjislacion. Në përgjigje të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe asaj të Shëndetësisë shprehej vullneti i mirë për marrjen parasysh të një pjese të rekomandimeve të cilat do të gjejnë pasqyrim në ndryshimet që do të bëhen në një të ardhme të afërt.

e- Ankesa për Drejtoritë e Bujqësisë dhe Ushqimit në rrethe

Janë 5 ankesa për këto Drejtori, nga të cilat 4 kanë qënë për kundërshtimin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ose për transferim. Nga këto një është zgjidhur në favor, duke ja dhënë ankuesit pagën e një viti, fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Kjo i përket shtetasit S.Ç. banues në Elbasan. Për këtë ankesë mund të vemë në dukje predispozicionin dhe gadishmërinë e Ministrit të Bujqësisë, Z.Agron Duka, i cili personalisht vlerësoi Rekomandimin tonë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor që ankuesi S.Ç, të marrë pagën, duke urdhëruar menjëherë çeljen e fondit financiar përkatës Drejtorisë së bujqësisë në Elbasan. Ky është një qëndrim që duhet përshëndetur dhe të merret shembull edhe nga ministra apo zyrtarë të tjerë të lartë që ngurojnë të zbatojnë nenin 142/3 të Kushtetutës që "*detyron gjithë organet e shtetit të ekzekutojnë vendimet gjyqësore*".

3 (tre) ankesa të tjera, pas shqyrtimit dhe hetimit të bërë, kanë rezultuar të pabazuara pasi kishin të bënin me lëvizje personeli brenda

drejtorive. Një ankesë ka qënë lidhur me shpronësimin e një pasurie të palujtëshme, u rekomandua për t'u zgjidhur në rrugë gjyqësore.

f- Ankesa për Drejtorinë e Ujrave në Rrethe.

Rezultojnë dy ankesa të tilla, një që i përket Kryeplakut të fshatit Lis të rrethit Mat, në të cilën evidentohet shqetësimi lidhur me mungesën e ujit për vaditje. Për sqarimin e problemit është kontaktuar, përveç të tjerave, edhe me Drejtorinë e Ujrave në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, të cilët kanë konfirmuar drejtësinë e ankesës por edhe pamundësinë reale të përmirësimit të strukturës së vaditjes për mungesë fondesh që kapin një shifër të konsiderueshme. Ankesa tjetër rezultoi konflikt privat, i cili duhej zgjidhur midis palëve në rrugë gjyqësore.

10. Ministria e Financave

Ankesat, kërkesat dhe njoftimet drejtuar Avokatit të Popullit me pretendimet e shtetasve dhe subjekteve tregtare për shkeljen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të tyre nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve financiare si, Ministria e Financave, (doganat, dhe tatim-taksat), për vitin 2001 janë 40.

Këto ankesa konsistojnë në moszbatimin e nenit 142/3 të Kushtetutës; të Ligjit nr.8435 dt. 28.12.1998 “Për sistemin e taksave” me ndryshimet përkatëse; të Ligjit nr. 8449 dt. 27.01.1999 “Për Kodin doganor”; të Ligjit nr. 8379, dt. 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit”; të V.K.M. nr. 205, dt. 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”; të V.K.M. nr. 335, dt. 02.06.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore”; të Udhëzimit nr. 2, dt.02.02.2001 “Për zbatimin e buxhetit të shtetit”; të Udhëzimit nr. 39 dt. 31.03.1999 të Bankës së Shqipërisë etj, nga organet e mësipërme. Më poshtë do të përmendim si pozitive disa Rekomandime që kemi bërë në fushën financiare, miratimi i të cilave po sjell miradministrim të punëve edhe në këtë fushë:

1) Rekomandimi drejtuar Ministrit të Financave për botimin në Fletoren Zyrtare të V.K.M. nr. 205, dt. 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, pasi ky vendim mjaft i rëndësishëm nuk është botuar në Fletoren Zyrtare. Për pasojë, në bazë të nenit 117/1 të Kushtetutës dhe vendimit nr. 47, dt. 07.07.1999 të Gjykatës Kushtetuese, nuk duhet të

merret si bazë për zhvillimin e aktivitetit doganor, siç është vepruar në fakt, pasi mungon fuqia juridike.

Kërkesa jonë këmbëngulëse për botimin në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi Qeverie shumë të rëndësishëm, lidhet dhe me pasojat që rrjedhin nga zbatimi i tij në praktikë pa pasur fuqinë juridike, sepse përbën një shkelje flagrante dhe me pasoja të pallogaritshme financiare për vetë shtetin, nese subjektet juridike të interesuara do të godisnin në gjykatë vendimet e organeve doganore që mbështeten në dispozitat e këtij vendimi Qeverie.

Veç sa sipër botimi i këtij vendimi i shërben transparencës shumë të nevojshme për Qeverinë dhe biznesin, shmangies së korrupsionit dhe njohjes së personave të interesuar me rregullat dhe procedurat që parashikohen në të.

Realizimin e botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare e kemi parë edhe si një obligim ndaj këtij Parlamenti, pasi në Raportin Vjetor 2000 e kemi trajtuar si problem. Tani kemi kënaqësinë t'u vemë në dijeni se u arrit të bindet Qeveria për nevojën e realizimit të kësaj detyre kushtetuese. Përgjigjen pozitive dhe angazhimin për realizimin e kësaj kërkëse e morëm nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, pas Rekomandimit tonë të përsëritur dhe jo nga ish-Ministri i Financave, të cilit ja kishim Rekomanduar shumë kohë më parë.

2) Rekomandimi drejtuar Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, për marrjen e masave për nxjerrjen e udhëzimeve që përcaktohen në pikat 1 dhe 4 të V.K.M. nr. 335, dt. 02.06.1998 "Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit". Nga mosveprimi i patolerueshëm i këtyre dy ministrave, për zbatimin e Kushtetutës dhe akteve ligjore, siç është edhe ky vendim Qeverie, vlerësojmë se pa këto udhëzime, vendimet e formës së prerë të gjykatave mbeten në letër e të pazbatueshëm. Për mangësitë e pajustificueshme në zbatim të këtij vendimi ne po informojmë për arsye se, mosplotësimi i kërkesave të vendimit të sipërcituar, ka vënë përpara një përgjegjësie të madhe organet drejtuese të pushtetit lokal në gjithë vendin, përballë banorëve të njësive të tyre vendore. Atyre nuk u krijohen mundësi reale për përmbushjen e detyrimit kushtetues që parashikon neni 142, pika 3 e Kushtetutës, që të ekzekutojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë.

Vendimi i Qeverisë ngarkon në radhë të parë Ministrin e Financave, Ministrin e Drejtësisë dhe Institutin e Integritetit të Përndjekurve Politikë për nxjerrjen e udhëzimeve brenda vitit 1998, detyrë që s'është kryer akoma deri sot.

Është e patolerueshme dhe nuk mund të justifikohet me asnjë arsye, fakti që vendimi i Këshillit të Ministrave nr.335, dt.2.06.1998, nga 4 pika që përmban, 3 i ka të pazbatueshme sepse nuk janë nxjerrë dhëzimet nga institucionet që përmenda më lart. Për pasojë jo vetëm vendimi i Qeverisë bëhet i pazbatueshëm e diskretitues nga pikëpamja praktike, por nuk lejon që të zbatohen kërkesat e nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me çështjen e vendimit nr.355 datë 17.02.1998 të Qeverisë mund të përmendim edhe ankesën e mëposhtme:

Pranë Avokatit të Popullit, u paraqit shtetasi M.V., i cili u ankua në lidhje me pikturat e realizuara prej tij gjatë regjimit monist, të konfiskuara me anë të vendimit të gjykatës së asaj kohe. Në vitet e para të pluralizmit në Shqipëri, ky shtetas kërkoi rimbursimin e këtyre pasurive të luajtshme në mjete monetare në seksionin e financës pranë Bashkisë Tiranë, dhe mori një pjesë të dëmshpërblimit. Më pas kjo procedurë u bllokua nga ana e Ministrisë së Financave dhe shtetasi ankohet për bllokimin e kësaj procedure të rëndësishme për rivënien në vend të së drejtave të tij pasurore.

Pas paraqitjes së ankesës i kemi kërkuar shpjegime Ministrisë së Financave. Nga përgjigja e tyre jemi vënë në dijeni se pengesë është Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.335 dt.17.02.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë”. Vendimi i sipërpërmendur parashikon në njërin nga pikat e tij, se Ministria e Financave dhe Instituti i Integritit të ish të Përndjekurve Politikë detyrohen të bashkëpunojnë për hartimin e një projekti për mënyrën e dhënies dhe shpërndarjeve të vlerave monetare ndaj pasurive të luajtshme të konfiskuara ish të përndjekurve politikë. Duke parë rrethanat e kësaj çështje ne paraqitëm dy rekomandime për institucionet e lartpërmendura dhe përgjigja ndaj këtyre rekomandimeve ka ardhur pozitive. Themi kështu sepse, Instituti i të Përndjekurve Politikë njofton se i ka paraqitur Ministrisë së Financës një projekt konkret për mënyrën e shpërndarjes së pasurive të luajtshme të ish të përndjekurve politikë. Por ky projekt, pasi është analizuar nga Departamentet përkatëse të Ministrisë së Financave, është refuzuar me arsyetimin se nuk përmbush kushtet dhe formën e përcaktuar. Në vetvete ky projekt sipas Institutit të ish të Përndjekurve paraqet një dokument tepër konkret dhe të arsyeshëm në të cilin ishin parashtruar të gjitha mënyrat dhe format e këtij kompensimi. Arsyeja e refuzimit sipas tyre qëndron vetëm tek fatura e madhe financiare që paraqet ky projekt për t’u vënë në zbatim. Komunikimi, në lidhje me këtë projekt vazhdon midis institucioneve të mësipërme, por deri tani nuk

është evidentuar asnjë shenjë përmirësimi. Për këtë çështje, mendojmë se ka orvatje për lënien në harresë të një detyrimi që shteti ka marrë përsipër.

3) Dihet se Banka e Shqipërisë nuk varet nga Ministri i Financave, por për lehtësi studimi e kemi radhitur në këtë vend.

Rekomandimi drejtuar Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë për mangësi ligjore në kapitullin e 3-të, pikat 3 dhe 8 të Udhëzimit të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë, miratuar me Vendimin nr. 39, dt. 31.03.1999 “Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive të depozitave në Banka”.

Kemi marrë përgjigje pozitive nga Guvernatori, i cili na ka konfirmuar se po punohet për nxjerrjen e një udhëzimi të ri dhe aty do të gjejnë vend dhe sugjerimet e Rekomandimit të Avokatit të Popullit.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë në vijim të kësaj përgjigje pozitive, na dërgoi më pas për mendim edhe projektudhëzimin “Për sekretin Bankar” ku konstatova se ishin bërë korrigjimet e nevojshme ligjore për sa i kishim Rekomanduar.

Në lidhje me këto institucione të financës mund të themi se për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, shpesh duke mos pasur argumenta ligjore për të kundërshtuar Rekomandimet tona, gjejnë rrugën e moskthimit të përgjigjes. Janë jo të pakta edhe rastet kur nuk e njohin sa dhe si duhet Kushtetutën, ligjet dhe vendimet e qeverisë e për pasojë janë kthyer përgjigjet e pabazuara në ligj. Në ato raste që na kanë ardhur përgjigje të tilla të paargumentuara, ne i jemi drejtuar përsëri me shkrim dhe kemi bërë të qartë se kërkojmë vetëm zbatimin e Kushtetutës e ligjeve, duke ju argumentuar më hollësisht qëndrimin tonë, duke bërë dhe interpretimet e duhura. Si pasojë kemi arritur të zgjidhim problemet, apo t’i vëmë në rrugën e zgjidhjes, por kemi edhe pa përgjigje. Të tillë mund të përmendim ankesën e shtetas N.Q, si administratore e shoqërisë “Skerdi” sh.p.k. që ka 5 vjet që sorrollatet nga Drejtoria e Tatim-Taksave e cila nuk ekzekuton vendimin gjyqësor të formës së prerë. Ky vendim detyron këtë institucion, si mbartës i detyrimeve të ish Policisë Financiare t’i kthejë ankueses 18.183 548 lekë. Çështja është në ndjekje.

Raste pozitive janë dy Rekomandimet që i kemi bërë Ministrisë së Financave për ekzekutimin e vendimit gjyqësor në favor të shtetasit P.P, i cili për të realizuar të drejtën e tij, kishte 9 vjet që sorrollatej nga Ministria e Financave me pseudoargumenta. U desh ndërhyrja jonë e përsëritur që të realizonte të drejtën e tij.

Gjithashtu, kur kemi konstatuar se nëpunës të caktuar bëhen pengesë për mosekzekutimin e vendimit të gjykatës, kemi kërkuar edhe masa disiplinore, siç është rasti i Shefes së Financës në Drejtorinë e Përgjithshme

të Tatim-Taksave. Pas kësaj kërkesë reagimi ka qënë pozitiv për rastin konkret që lidhej me ankesën e dy shtetasve nga Puka, duke u ekzekutuar vendimi i gjykatës së Rrethit Pukë, i cili nuk zbatohet nga ajo nëpunëse.

Në lidhje me moszbatimin e vendimeve gjyqësore ku janë debitorë Institucionet e Administratës Publike mund të themi se edhe kur fondet financiare janë, vendimet e gjykatave nuk ekzekutohen. Kjo sepse Ministria e Financave nuk ka transparencë për fondet dhe nuk kërkohet llogari kur mbyllet viti buxhetor, pse këto fonde nuk realizohen. Për pasojë fondet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, megjithëse të vogla, nuk realizohen çdo vit.

Aktualisht, ndodhemi në të njëjtën situatë si viti i kaluar, pasi po rreth 60% është realizuar fondi edhe gjatë vitit 2001.

Në përgjigjen zyrtare të Ministrisë së Financave që kemi marrë për këtë problem thuhet shprehimisht se: “Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit, ju informojmë se fondi i planifikuar për vitin 2001, ka qënë 100 milion lekë, nga të cilët deri në 31 dhjetor të vitit 2001 janë shpenzuar 56 milion lekë.”

Shifra e deklaruar nga kjo ministri, flet qartë se pengesë nuk ka qënë fondi i miratuar për këtë qëllim (për të cilin duhet thënë se është i pamjaftueshëm pasi siç dihet nga një studim i shpejtë që kemi bërë duhen rreth 6 milion dollarë amerikanë për t’u ekzekutuar gjithë vendimet). Mendojmë se janë neglizhenca dhe paaftësia e kësaj ministrie për të mos menaxhuar dot këtë fond si dhe mungesa e një strategjie të qartë, shkaqet për mosrealizimin e kësaj detyre mjaft të rëndësishme që ka të bëjë me seriozitetin e shtetit në përgjithësi dhe të pushtetit gjyqësor në veçanti.

Siç del nga ankesat po kështu veprohet edhe për vjeljen e Tatim-Fitimit, që merret në fillim të vitit sipas një parashikimi. Edhe kur subjektet paraqesin bilancet dhe argumenta se është realizuar një fitim ndryshe nga parashikimi, është e pamundur t’u rimbursohen shumat e marra, pasi gjenden lloj-lloj mënyrash e bëhen lloj-lloj kontrollesh e presionesh nga tatim-taksat. Për sa thashë po e ilustruj me ankesat e dy subjekteve që i janë drejtuar institucionit tonë.

Shoqëria “Transalbania” sh.p.k ankohet se ajo ka parapaguar tatim fitimin, të parashikuar nga dega e tatim taksave Tiranë, por mbështetur në bilancin kontabël të vitit 2000, të verifikuar dhe miratuar dhe nga ekspertët kontabël ligjor, si edhe bazuar në nenin 39/c të ligjit nr.8560, dt.22.12.1999, rezultoi se kjo shoqëri ka parapaguar tepër dhe kërkon t’i kthehet kjo shumë. Pa u ndalur në hollësitë nëse shoqërisë në fjalë i takon apo jo të marrë shumën e pretenduar, konstatohet se megjithëse i ka bërë kërkesë për verifikimin e situatës degës së tatim taksave Tiranë, kanë

kaluar rreth 9 muaj dhe nuk i jepet asnjë përgjigje, qoftë pozitive apo negative. Për më tepër, kjo administratë në mënyrë arbitrare ka nxjerrë urdhër bllokimi për detyrimin e parapagimit të tatim fitimit për vitin në vazhdim (2001), pa sqaruar akoma situatën e pretenduar për vitin e kaluar. Të njëjtën ankesë dhe të njëjtin qëndrim paraqet në kërkesën e saj dhe shoqëria “Infosoft system” sh.a, me një ndryshim që qëndrimi i degës së tatim taksave Tiranë, për rastin e saj, lidhet me një qëndrim neglizhues për një periudhë më të gjatë kohe, duke mos i kthyer asnjë përgjigje.

Ndër shkaqet për këtë gjendje jo të mire në administratën publike të sektorit të Financës mendojmë se janë mosnjohja e Kushtetutës, ligjit “Për informim”, dhe Kodit të Procedurave Administrative, që vendosin rregulla të qarta për detyrimin e administratës në kthimin e përgjigjeve ndaj ankuesve. Mungesa e kërkesës së llogarisë nga ana e drejtuesve, ndaj nëpunësve të kësaj administrate për të bërë detyrën që u ngarkon ligji, që të ushtrojnë kontrole të programuara e jo të gjejnë rrugën më të lehtë nëpërmjet qëndrimeve arrogante, duke e konsideruar biznesin jo si partner, por si vartës të tyre. Këto veprime, së bashku me mungesën totale të transparencës, çojnë në mënyrë të pashmangshme në abuzime dhe në qëndrime korruptive e diskretituese për administratën shtetërore.

Në këtë konkluzion arrihet dhe nga verifikimi i disa ankesave të tjera që lidhen me veprimet arbitrare që mbahen nga këto organe, të cilat në vënd që të ushtrojnë kontrole e të bëjnë verifikime, vendosin tatime në kundërshtim me ligjin “Për TVSH-në” dhe udhëzimet në zbatim të tij. Këto udhëzime përcaktojnë qartësisht dhe pa ekuivoke se subjektet e ndërtimit, paguajnë TVSH mbi bazë situacionesh, por këtyre të fundit u kërkohet pagesa mbi bazë fikse, sipas parashikimeve që bëjnë vetë këto organe apo inspektorët e tyre.

Sa më sipër vërtetohen në mënyrë të përmbledhur dhe me qëndrimet që janë mbajtur ndaj shoqërisë “Fertila” shpk, për të cilën kemi informuar dhe në raportin e vitit të kaluar. Vazhdon dhe sot të mos ketë një qëndrim ligjor nga dega e tatim taksave Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave për këtë çështje. Kjo shoqëri u ankua të Avokati i Popullit se dega e tatim taksave Tiranë nuk bën në favor të saj rimbursimin e TVSH-së. Ky fakt ishte i pranuar nga inspektorët e tatim taksave në procesverbalin e firmosur pas kontrollit të kryer dhe u vërtetua nga eksperti që ne ngarkuam për këtë qëllim. Më pas, me kërkesën tonë, u ribë një verifikim nga një grup tjetër i tatimeve, i cili nuk dha konkluzione se u tërhoq në fund të kontrollit. Më pas një grup i tretë, përcaktoi përsëri se kjo shoqëri duhej rimbursuar, por pas këtij konkluzioni, këtyre inspektorëve ju është dhënë masë disiplinore. Ankesa është akoma e pazgjidhur, se megjithëse Drejtoria

e Përgjithshme e Tatim Taksave na deklaroi se do të çojë një grup të katërt për verifikim, deri më sot nuk ka kthyer asnjë përgjigje zyrtare.

Në degën e tatim-taksave Tiranë kemi ankesa se subjektet e kanë të pamundur të takohen me drejtuesit apo të komunikojnë për problemet që kanë dhe po kaq e vështirë është të marrin përgjigje me shkrim për pretendimet që ngrenë.

Në Dogana mungon transparencja, siç e trajtova më lart për V.K.M. nr. 205. Nga kjo mungesë transparence ndodh që në ç’doganimet e mallrave të veprohet në shumë raste direkt me çmimet e referencës, kur në Ligjin “Për Kodin Doganor”, çmimi i referencës parashikohet të përdoret në ato raste kur nuk plotësohen kriteret për format e tjera të ç’doganimit.

Vlen për t’u theksuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave se në lidhje me Rekomandimet dhe komunikimet e tjera shkresore që kemi pasur, për ankesa që na kanë ardhur, ka qenë mjaft korrekte dhe ka pranuar Rekomandimet apo dërguar shpjegimet e duhura.

Si konkluzion mund të themi se Ministria e Financave dhe organet vartëse të saj ka raste që veprojnë me metoda pune të kohës së monizmit, vetëm me qëllimin për të grumbulluar paratë e planifikuara. Pra, vjelja e parave me çdo kusht, pa respektuar Kushtetutën dhe ligjin, ka bërë që të ketë raste që shkelen rëndë të drejtat e qytetarëve si dhe dëmtohet rëndë biznesi e perspektiva e tij, veçanërisht ato biznese të brishta, për të cilat ka aq shumë nevojë zhvillimi i vëndit tonë.

11. Ministria e Arsimit

Gjatë vitit 2001 për Ministrinë e Arsimit dhe institucionet në vartësi të saj siç janë Universitetet apo Drejtoritë Arsimore në rrethe kanë ardhur 26 ankesa apo kërkesa. Nga këto në favor janë zgjidhur vetëm 2 ankesa.

Pjesa më e madhe e ankesave apo kërkesave kanë qenë për vendimet që ka marrë Drejtoria Arsimore Tiranë për shkarkimet apo largimet nga detyra të mësuesve të shkollave. Për këto çështje komunikimi ynë me këtë Drejtorinë ka qenë i mirë, gjë që ka bërë të mundur që ankesat e ardhura të përfundohen brenda një afati të shkurtër. Por duke marrë shkas nga fakti se ankuesit kanë pretenduar pushime apo shkarkime pa të drejtë nga detyra nga kjo drejtori, del problemi se Ministria dhe kjo drejtori nuk kanë masa për të përcaktuar standartet e vlerësimit të efektivitetit në punë të një mësuesi në raport me mbarëvajtjen e shkollës në tërësi. Kjo duhet të bëhet për të mënjeluar sa më shumë që të jetë e mundur subjektivizmat në

vlerësim, dhe si rrjedhim do të sjellë si pasojë edhe zgjidhjen e drejtë të ankesave në këtë drejtim.

Gjithashtu, parë nën prizmin e decentralizimit të pushtetit vendor, duke patur parasysh se në Ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Organeve të Qeverisjes Vendore”, parashikohet që arsimi parashkollor dhe parauniversitar janë funksione të përbashkëta të pushtetit qëndror me atë vendor, mendojmë se ka ardhur momenti që raportet që ekzistojnë midis këtyre dy pushteteve të rregullohen më qartë.

Problem tjetër që ka dalë nga shqyrtimi i ankesave ka të bëjë me kompetencën që kanë Dekanet e Fakulteteve të Universiteteve të Tiranës, për të lidhur kontrata me personelin akademik shkencor.

Procedura e pranimit dhe e lidhjes së kontratës shpjegohet qartë në nenin 11 të Rregullores së Universitetit të Tiranës. Në këtë procedurë duhet rregulluar roli i Departamentit në këtë proces. Në rastin konkret, Dekani i Fakultetit është në pozitën e një eprori direkt, që ka në kompetencë të lidhë apo të zgjidhë kontratën e punës me personelin mësimor e shkencor. Por nuk evidentohet në aktet nënligjore se cilat do të jenë ato struktura të cilat do të vlerësojnë më pas nivelin akademik të pedagogut. Pra duhet të nxirren akte nënligjore që të parashikojnë rolin e Departamentit apo Këshillit Shkencor për vlerësimin e nivelit akademik të pedagogut, qoftë për ripërsëritjen e kontratës, qoftë për lidhjen e një kontrate të përhershme pune.

Duke marrë në shqyrtim disa raste të ankesave konkrete mund të përmendim problemet që kanë qenë për këtë Ministri:

1. Ankesa e 5 mësuesve të fshatit Cacabezë të rrethit të Peqinit, të cilët ishin pushuar nga puna nga Drejtoresha e Drejtorisë Arsimore të atij rrethi. Ankesa u verifikua në vend dhe rezultoi se nga 7 mësues gjithësej që kishte ajo shkollë, 5 ishin larguar nga puna. U dëgjuan pretendimet e dy palëve, i deputetit të zonës, Prefektit të Qarkut Elbasan dhe mendimi ynë ishte se largimi nga puna ishte i padrejtë, por Drejtoresha refuzoi t’i kthente në punë mësuesit. Pas rekomandimit tonë tek Ministri i Arsimit, i cili u mbështet dhe nga Prefekti, kjo drejtoreshë u largua nga detyra dhe 5 mësuesit u njoftuan të kthehen në punë.

2. Ankuesi I.K. paraqiti një ankesë ndaj vendimit të Drejtorisë Arsimore Tiranë, për shkarkimin e tij nga detyra e drejtorit të shkollës së mesme elektrike në Tiranë. Gjatë hetimit të çështjes rezultoi se ankuesi është shkarkuar nga detyra e tij si drejtor i shkollës së mesme elektrike për shkelje të nenit 26/1 të Dispozitave Normative. Motivi i shkarkimit ka qenë i njëjtë si për drejtorin dhe nëndrejtorin e kësaj shkolle, por ndërsa

nëndrejtori u rikthye në detyren e mëparshme, për ankuesin refuzohej revokimi i vendimit.

Në përfundim të hetimit të çështjes, vendimi i shkarkimit nga detyra për mendimin tonë ishte i padrejtë si përsa i përket shkaqeve, por dhe për faktin e shkeljes së nenit 18 të Kushtetutës, në të cilin është sanksionuar barazia e shtetasve para ligjit, sepse jemi para një rasti të trajtimit të pabarabartë të shtetasve.

Institucioni ynë i drejtoi një rekomandim Drejtorisë Arsimore Tiranë ku kërkohet revokimi i vendimit të shkarkimit nga detyra të Drejtorit të Shkollës Elektrike dhe kthimi i tij në detyrën e mëparshme. Por këtë rekomandim Drejtoria Arsimore e refuzoi. Çështja vazhdon të trajtohet nga ana jonë, por ankuesit i është sugjeruar që njëkohësisht çështjen ta bëjë konflikt gjyqësor.

3. Ankuesi P.F. nga Tirana kërkonte pagesën me 20% të pagës së tij si mësues për periudhën që ai ka qënë për studime jashtë shtetit.

Nga hetimi rezultoi se nga ana e ankuesit nuk ishin respektuar kërkesat e V.K.M. nr.295 datë 18.07.1964, i ndryshuar me V.K.M. nr.55 datë 08.04.1970, “Për dhënien e shpërblimit të familjeve të punonjësve dhe ushtarakëve aktivë që dërgohen jashtë shtetit për studime dhe specializim”, prandaj ankesa ju refuzua si e padrejtë. Por në rastin konkret është i rëndësishëm konstatimi në lidhje me bazën ligjore të çështjes në fjalë. Kështu V.K.M. të cilit i jemi referuar gjatë shqyrtimit të çështjes është i vitit 1955, i ndryshuar në vitin 1970. Siç duket dhe nga viti i hartimit të këtyre akteve, (1955) është i nevojshëm rregullimi i kësaj çështjeje me anë të një vendimi të ri, duke patur parasysh se kanë ndryshuar tashmë ligjet e rregullimit të marrëdhënieve të punës së punëmarrësve në struktura të ndryshme. Kështu ekziston një Ligj “Për statusin e nënpunesit civil”, Kodi i Punës apo ligje të veçanta që kanë dalë pas vitit 1995 dhe determinojnë ndryshimin e Vendimit të Qeverisë. Prandaj do të bëjmë një Rekomandim të veçantë.

4. Ankesa e disa vajzave të shkollave të mesme në Tiranë dhe Fier, që ishin ndaluar të shkonin në mësim me shami në kokë. Kjo nga ana e tyre u konsiderua si shkelje e të drejtës së tyre kushtetuese, të përcaktuar nga neni 24/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për të shprehur lirisht në publik besimin e tyre fetar.

Pas shqyrtimit të ankesave, nga ana jonë për këtë çështje i është dërguar Rekomandimi i mëposhtëm Kryeministrit dhe Ministrit të Arsimit.

“Institucioni i Avokatit të Popullit, si një Institucion kushtetues në mbrojtje të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të

administratës publike, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij ka shqyrtuar disa çështje nga të cilat ka rezultuar se, në mbrojtje të së drejtës kushtetuese të lirisë fetare, të sanksionuar në nenin 24 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave duhet të vihet në levizje për të respektuar detyrimin kushtetues të parashikuar në pikën 5 të nenit 10.

Kështu, në bazë të kësaj dispozite, “Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend”. Pra, megjithëse kanë kaluar 3 vjet që ka hyrë në fuqi Kushtetuta dhe prej 2 vjetësh është krijuar Komiteti Shtetëror i Kulteve, si organizëm qeveritar i ngarkuar për të ndjekur të gjitha çështjet e marrëdhënieve Shtet-Fe, akoma nuk është realizuar detyrimi kushtetues i Qeverisë për lidhjen e marrëveshjeve në fjalë.

Konkretisht, pranë Institucionit tonë kanë drejtuar ankesë disa nxënëse, të cilat si besimtare të fesë myslimane, kishin vendosur që të shfaqnin besimin e tyre në publik duke mbajtur shami në kokë edhe gjatë kohës së procesit mësimor në shkollat e mesme publike ku studjonin, në Tiranë dhe Fier.

Vajzat në fjalë nuk u lejuan ta ushtronin këtë praktikë në ambientet e shkollës, nga Drejtoritë e shkollave përkatëse, duke patur parasysh faktin se mbajtja e shamisë gjatë procesit mësimor, binte në kundërshtim me rregulloret, në bazë të të cilës funksionojnë shkollat e mesme. Por vajzat dhe avokati i tyre pretenduan se po shkeleshin të drejtat e tyre të parashikuara nga pika 2 e nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë se “Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t’i shfaqë ato individualisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve”.

Pra, nisur nga fakti se në bazë të nenit 24 të Kushtetutës është garantuar liria e fesë, përfshirë këtu dhe të drejtën për të shprehur besimin me anë të praktikave dhe kryerjes së riteve, u gjendëm para një situatë, e cila kërkonte zgjidhje, për të përcaktuar në rastin konkret në se dhe kur kjo e drejtë mund të bëhet objekt i kufizimeve.

Duke ju referuar në këtë rast dokumentave ndërkombetare të ratifikuar nga vendi ynë, nga shqyrtimi çështjes rezultoi se, në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në nenin 9 të saj përcaktohet se: “Çdo person ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose bindjet, si dhe lirinë për të shfaqur fenë e tij ose bindjet e tij individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave dhe kryerjes së riteve. Liria e shfaqjes së fesë së tij ose e bindjeve të tij mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera

nga ato që, të parashikuara me ligj, përbëjnë masat e nevojshme në një shoqëri demokratike, për sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit, të shëndetit ose të moralit publik, ose për mbrojtjen e rendit dhe të lirive të tjerëve”.

Sipas kësaj Konvente, liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e besimit përbëjnë bazat e “shoqërisë demokratike”, por kjo liri nuk është e pakufizuar dhe nuk mund të ushtrohet në dëm të shëndetit dhe moralit të shoqërisë shqiptare. Pra drejtorët e shkollave të mësipërme bënë mirë që i penguan ato nxënëse që të ndiqnin mësimet me shami në kokë. Veçse këto kufizime s’duhet të lihen të përcaktohen nga drejtorët me Rregulloret e shkollave, bile as edhe nga Ministri i Arsimit, por kufizimet duhet të përcaktohen me ligj, i cili në këtë rast mund të zëvendësohet vetëm me marrëveshjet që duhen bërë, siç përcakton pika 5 e nenit 10 të Kushtetutës sonë.

Ky ka qenë qëndrimi ynë zyrtar, të cilin ja kemi bërë të njohur edhe Ministrin të Arsimit dhe ankueseve. Por miratimi i këtyre marrëveshjeve rezultoi si një domosdoshmëri urgjente, në mënyrë që në të njëjtën kohë të pajtohen interesat e shtetit tonë laik me ato të bashkësive të ndryshme fetare, me qëllim që të garantohet respektimi i bindjeve fetare të secilit person, por edhe të ruhet karakteri laik i shtetit dhe shoqërisë sonë nga dukuritë e fundamentalizmit islamik, i cili tashmë përbën një kërcënim ndërkombëtar. Në këtë mënyrë arrihet edhe përputhja e legjislacionit tonë me kërkesat e Konventave dhe akteve të tjera ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në përfundim, në bazë të nenit 63 pika 3 të Kushtetutës sonë ku përcaktohet se “ Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, rekomanduam: Përgatitjen dhe lidhjen e marrëveshjeve me bashkësitë fetare, në zbatim të detyrimit kushtetues të parashikuar në pikën 5 të nenit 10 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe dërgimin e tyre në Kuvend për ratifikim”.

Për rekomandimin e bërë, akoma nuk kemi marrë përgjigje.

5. Ankesa e J.P. që kishte të bënte me pagesën e një tarife regjistrimi për ndjekjen e një kursi pasuniversitar të Fakultetit të Mjekësisë. Pasi e verifikuam problemin, rezultoi se nga ana e Dekanatit të Mjekësisë dhe konkretisht e Kancelarit të saj ishte vepruar në kundërshtim me rregullat “Mbi regjistrimin për kualifikimin pasuniversitar”, sepse ishin keqinterpretuar aktet që lidhen me tarifën e regjistrimit. Konkretisht shkresa “Miratim tarife” nr.796/1 prot, datë 28.02.2000, e Ministrisë Arsimit e Shkencës (MASH). Në këtë shkresë bëhej fjalë për tarifë

regjistrimi dhe jo tarifë vjetore regjistrimi siç shprehej kancelari, në shkresat drejtuar departamenteve të Fakultetit. Nga shtesa e fjalës “vjetore” që ai i kishte bërë shkresës së mësipërme të MASH, ka vendosur detyrimin e shumë specializantëve që të paguajnë “një detyrim të paligjshëm” dhe njëkohësisht ushtronte presion të padrejtë mbi specializantët e tjerë, nën frikën e ndërprerjes së specializimit. Në kthimin e përgjigjes ndaj rekomandimit të Avokatit të Popullit, nga ana e Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, arsyetohej që me shkresën e MASH datë 28.02.2000, është miratuar tarifa e regjistrimit (ashtu siç është kërkuar shprehimisht nga Rektorati), dhe si vazhdim i këtij arsyetimi pranohej që ishte bërë saktësimi i shkresës së Ministrisë të Arsimit duke shtuar fjalën “vjetore”.

Theksojmë që në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë thjesht me një saktësim fjale, por me një ndryshim substancial të konceptit “tarifë regjistrimi”. Kështu termi “tarifë regjistrimi” ndryshon nga ai “tarifë shkollimi”, sepse ky i fundit miratohet me Vendim Qeverie për studentët universitarë. Konkluduar se ishte e paligjshme që Dekani i Fakultetit të Mjekësisë të interpretonte tarifën e regjistrimit nga MASH, në analogji me tarifën e shkollimit të studentëve universitarë, të percaktuar me VKM nr.424 datë 4.08.2000.

Ndërkohë theksojmë se Rregullorja e Fakultetit të Mjekësisë (Për ciklin e Tretë Specializimi Pasuniversitar) nuk ishte e firmosur nga Ministri i Arsimit. Pra modaliteti që të konsiderohet regjistrim çdo vit, nuk është i miratuar nga MASH. Ndërkaq nga ana e Drejtores së Drejtorisë Ekonomike të MASH, janë firmosur për këtë problem dy shkresa drejtuar Rektoratit të Universitetit të Tiranës, dhe përkatësisht ajo me nr.prot 4936, datë 30.11.2000 dhe ajo me nr.prot.219/1 datë 22.01.2001. Shkresa e parë drejtuar Rektoratit të Universitetit të Tiranës bën interpretimin e saktë të problemit mbi tarifën e regjistrimit, ndërsa shkresa e dytë, çuditërisht, është e kundërt në përmbajtje me të parën, duke e përlligjur shtesën e fjalës “vjetore” për tarifën e regjistrimit në kurset pasuniversitare dhe duke e hedhur poshtë përmbajtjen e shkresës së parë të firmosur e të nxjerrë nga vetë ajo. Në bazë të kësaj shkrese, arrihet në përfundimin se nga ana e Drejtores është interpretuar tarifa e percaktuar me VKM nr.424 datë 09.07.1998 dhe Udhëzimi nr.34 datë 10.11.1998 (akte nënligjore), në zbatim të Rregullores së Fakultetit të Mjekësisë për specializantët pasuniversitarë. Ligjërisht hierarkia e këtyre akteve nuk është e saktë, sepse në bazë të kësaj llogjike Rregullorja e lartpërmendur vihet mbi VKM.

Për gjithë sa parashtroam, i kemi dërguar Ministrinë të Arsimit, dy kërkesa për vlerësimin e rekomandimit të Zyrës sonë dhe për rrugëzgjdhjen e situatës. Akoma nuk kemi përgjigje zyrtare.

12. Ministria e Shëndetësisë

Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institucionet në vartësi të saj janë bërë gjithsej 17 ankesa, nga të cilat vlen të përmenden, për zgjidhje pozitive, këto raste:

1-Ankesa e shtetases D.T, e cila, duke qenë ish punonjëse në shërbimet farmaceutike në qytetin e Gjirokastrës, u ankua se Drejtorja e Shëndetit Publik Gjirokastrë nuk vepronte për ta futur në listat e procesit të privatizimit. Në vendimin e gjykatës së rrethit Gjirokastrë, i cili kishte marrë formë të prerë, ishte përcaktuar se kjo shtetase duhej të përfshihej në procesin e privatizimit si dhe në të gjitha proceset e kësaj natyre në të ardhmen. Pasi është marrë në shqyrtim ankesa, është konkluduar se ajo ishte e drejtë dhe i janë kërkuar shpjegime me shkrim Drejtorit të Shëndetit Publik Gjirokastrë. Pas kësaj, është bërë e mundur që të zhvillohet edhe një takim pranë Institucionit tonë me këtë drejtues, ku nga ana e tij është pranuar përfundimisht ekzekutimi i vendimit gjyqësor, duke lënë mënjanë interpretimet e akteve nënligjore, mbi të cilat mbështetej ai me mosveprimet e tij. Zgjidhja pozitive e këtij rasti është ekspozuar edhe një herë për fenomenin e moszbatimit të vendimeve gjyqësore nga organet e administratës, ç'ka është një problem që haset gjithmonë e më shumë, pothuajse në të gjitha organet e administratës publike, dhe jo vetëm për financat publike. Hapi më i rëndësishëm, për të eliminuar rënien e autoritetit të gjykatave dhe drejtësisë, qëndron në sqarimin e organeve të administratës për rëndësinë që paraqesin vendimet gjyqësore, të cilat marrin fuqinë e ligjit. Kjo është e domosdoshme të bëhet me drejtuesit, sa herë që vihen re mangësi në këtë drejtim. Gjithashtu, të propozohen masa konkrete disiplinore, në rast të moszbatimit të mëtejshëm të këtyre vendimeve gjyqësore, paralelisht me veprimet procedurale të përmbarimit.

2- Ankesa e shtetasit Xh. M, nga Elbasani, i cili pretendoi shkelje të së drejtës së informimit, në lidhje me marrjen e një raporti mjeksor.

Si pasojë e dëmtimit të shëndetit nga një aksident automobilistik, ankuesi i është drejtuar degës së INSIG-ut Elbasan për të përfituar në bazë të Ligjit një shumë të caktuar. Dega e INSIG-ut Elbasan mori vendim që masa e dëmtimit të shëndetit është 10 % dhe jo 50 %, që ka qenë pretendimi i ankuesit.

Në lidhje me këtë vendim, ankuesi nuk ka qenë dakort, dhe për këtë arsye i është drejtuar gjykatës. Gjatë procesit gjyqësor, si palë paditëse, ai ka kërkuar administrimin e një prove shkresore, konkretisht të vendimit të Komisionit Ndërsptialor (KMCAP) të Qendrës “Nënë Tereza”, të muajit

dhjetor 1999, provë, që është vlerësuar me rëndësi themelore për procesin gjyqësor.

Kështu, ai ka pretenduar se nga ana e Qendrës Spitalore “Nënë Tereza” nuk po i vihej në dispozicion raporti në fjalë dhe ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit tonë për zgjidhjen e problemit. Në themel, ankesa ishte e drejtë, sepse refuzimi i dhënies së dokumentit zyrtar nga Qendra Spitalore ishte shkelje e së drejtës kushtetuese. Neni 23 i Kushtetutës parashikon: “E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore”. Gjithashtu, është shkelur edhe Ligji nr. 8503, date 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Megjithatë, në përfundim të hetimit nuk rezultoi që, në Qendrën Spitalore “Nënë Tereza”, të kishte një dokument të dhjetorit 1999, për caktimin e masës së dëmtimit të shëndetit të ankuesit. Për këtë u informua edhe ankuesi.

3. Ankesa e shoqërisë ”Prodentalfarma” sh.p.k., me seli në Tiranë, ku shprehej shqetësimi i përfaqësuesve të kësaj shoqërie për disa veprime të Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave dhe të Drejtorisë Farmaceutike pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

Në ankesën e tyre, përfaqësuesit e shoqërisë së sipërcituar sqaronin se prej shumë kohësh kishin depozituar pranë Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave, dokumentet përkatëse dhe kërkesën për regjistrimin e rreth 40 medikamenteve. Ndonëse kishte kaluar një kohë e gjatë, mbi 2-3 vjet, shoqëria nuk kishte marrë asnjë përgjigje prej QKKB-së, në kundërshtim me parashikimet e rregullores “Për Regjistrimin e Barnave në Republikën e Shqipërisë”, nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambjentit. Shoqëria nuk kishte marrë asnjë “refuzim të motivuar”, siç e parashikon ligji “Për Barnat”, për kërkesat e depozituara pranë Qendrës.

Pas verifikimit të bërë nga Zyra jonë, rezultoi se shoqëria “Prodentalfarma” sh.p.k., kishte depozituar shumë dosje për shqyrtim pranë Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave, në kohë të ndryshme. Për shumicën e tyre, qendra e sipërcituar kishte patur vërejtje, pasi ato kishin rezultuar me të meta dhe për këtë i ishin lënë afate për plotësime shoqërisë, por vërejtjet ishin bërë gojarisht. Po kështu, nga QKKB-ja u pranuan vonesat në dërgimin e vërejtjeve, duke u justifikuar, ndër të tjera, me numrin e kufizuar të personelit që punon pranë Qendrës dhe mungesën e specialistëve. Veprimet e kryera nga QKKB-ja vinin në kundërshtim me kapitullin II, pika 2, të Rregullores së miratuar nga Ministri i Shëndetësisë për Regjistrimin e Barnave, e nxjerrë kjo sipas parashikimeve të bëra në

nenin 13 të Ligjit nr. 7815, datë 20.04.1994, “Për Barnat”. Sipas përcaktimeve të dispozitave përkatëse të rregullores, duhej që nga Q.K.K.B-ja, të interesuarit për regjistrimin e një bari, (ilaçi) të kishin përgjigjen për regjistrimin apo jo të tij, brenda 9 muajve, nga data e dorëzimit të dokumentacionit përkatës.

Në të gjitha rastet e prezantuara në Zyrën tonë nga ankuesi, rezultonin që afatet e parashikuara nga rregullorja të ishin tejkaluar, duke i mohuar ankuesit të drejtën e ankimit sipas shkallëve në rrugë administrative e më pas në rrugë gjyqësore, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. (Në parim, palët e interesuara në një procedim administrativ, mund t’i drejtohen gjykatës, vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrativ).

Në këto kushte, iu rekomandua organit përkatës të merrte në konsideratë kërkesat e paraqitura pranë QKKB-së, nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë “Prodentalfarma” dhe të merrte masa që të jepte përgjigjet përkatëse, me shkrim, brenda datës 31.07.2001, për të gjitha kërkesat, të cilave u kishte kaluar afati për shqyrtim.

Meqenëse përgjigja për rekomandimin tonë nuk ishte e plotë, iu drejtua me rekomandim Ministrit të Shëndetësisë, i cili në datën 16.10.2001, na bëri të ditur se rekomandimi ynë ishte pranuar dhe se situata ishte rregulluar në përputhje me kërkesat e ligjit.

13. Ministria e Punëve të Jashtme

Gjatë vitit 2001 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe ambasadat apo konsullatat në varësi të saj ka patur 10 ankesa ose kërkesa, nga të cilat janë zgjidhur 7 në favor dhe 3 janë akoma në shqyrtim.

Ankesat apo kërkesat ndaj Ministrisë sonë të Jashtme kanë patur më tepër si qëllim përfshirjen apo ndihmën e organizmave të saj jashtë shtetit në rastet e humbjes apo vdekjes së shtetasve shqiptarë, për të cilat, Drejtoria Konsullore e saj dhe ambasadat apo konsullatat tona jashtë shtetit, mbi bazën e kërkesave të Avokatit të Popullit, në përgjithësi i kanë zgjidhur apo plotësuar kërkesat e shtetasve.

Kurse sa i përket tre ankesave në shqyrtim, mendojmë se ka zvarritje dhe ngathtësi të kësaj Ministrie për t’i zgjidhur.

1. Ankesa e 5 ish punonjësve, diplomatë dhe personel ndihmës të Ambasadës shqiptare në Beograd, Jugosllavi, të cilët më 5 prill 1999, pasi kishin filluar bombardimet e NATO-s mbi Jugosllavinë, për shkak të krimeve të serbëve në Kosovë, u larguan nga Ambasada, pa arritur të

marrin mjaft nga sendet e veshjet e tyre personale. Këto sende, veshje, paisje etj, janë djegur apo shkatërruar dhe ata me të drejtë kanë kërkuar dëmshpërblimin, që sipas tyre arrin afërsisht shumën 6 milion lekë për të gjithë ankuesit.

Megjithëse kanë kaluar më tepër se dy vjet, ankesa e tyre nuk është marrë parasysh nga Ministria, prandaj u ankuan tek ne. Pas shqyrtimit të çështjes, ne konstatoam se ankesa është e drejtë dhe e bazuar. Ministria e Punëve të Jashtme nuk duhet të presë normalizimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe pas çdëmtimit nga pala jugosllave, të bëjë rimbursimin e dëmeve të punonjësve të saj. Përgjegjësia e saj civile parashikohet nga ligji nr.8510 datë.15.07.1999, “Mbi përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”, dhe duhet që nga buxheti i shtetit të planifikojë çdëmtimin. Për këtë arsye i kemi drejtuar Rekomandim me shkrim kësaj Ministrie. Verbalisht na kanë dhënë përgjigje se parimisht janë dakort të plotësojnë kërkesën, dhe se tashmë po plotësojnë procedurat teknike. Çështja vazhdon të jetë në shqyrtim nga ne.

2. Ankesa e shtetasit Ll. K., ish punonjës i asaj Ministrie, i cili është larguar nga puna në vitin 1997, me motivacionin, “Për shkelje të parimit të depolitizimit”. Ankuesi e ka ndjekur çështjen në gjykatë, dhe nëpërmjet zyrës së OSBE në Tiranë na ka dërguar vendimin gjyqësor të formës së prerë, me detyrimin që ai të rikthehet në punën e mëparshme në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Mbi këtë bazë ne kemi Rekomanduar zbatimin e vendimit të gjykatës. Në një përgjigje të dërguar nga drejtori i personelit të kësaj Ministrie, refuzohet ky rekomandim, duke përsëritur të njëjtat argumente që gjykata i ka hedhur poshtë në vendimin e saj.

Duke analizuar këtë qëndrim i kemi kërkuar Ministres së Punëve të Jashtme shqyrtimin e problemit personalisht prej saj dhe kthimin e përgjigjes, në konformitet me Kushtetutën dhe ligjet. Akoma nuk kemi përgjigje dhe çështja është në shqyrtim.

3. Ankesa e shtetasit V. C., të cilit në qershor të vitit 1999 një ushtar belg i forcave të NATO-s që ishte në Shqipëri për shkak të luftës së Kosovës, ka shtypur me kamion, duke i sjellë vdekjen djalit të tij 10-vjeçar. Çështja është shqyrtuar nga prokuroria shqiptare. Ushtari belg është gjetur fajtor për shkelje të Kodit Rrugor që ka sjellë si pasojë vdekjen e fëmijës. Por ndaj ushtarit belg është pushuar akuza për shkak të imunitetit diplomatik që kanë patur forcat e NATO-s, në bazë të një ligji të miratuar nga Parlamenti Shqiptar me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Edhe komanda e forcave belge, nga varej ushtari që kreu veprën, e ka pranuar përgjegjësinë e ushtarit, i ka kërkuar

me shkrim falje familjes, si dhe i ka dhënë privatisht vetëm 700 USD për shpenzimet e varrimit.

Familja kërkon me të drejtë dëmshpërblimin financiar që i takon në bazë jo vetëm të Kushtetutës dhe legjislacionit shqiptar, por edhe të gjithë akteve ndërkombëtare. I jemi drejtuar përfaqësuesit shqiptar pranë NATO-s në Bruksel, por nuk kemi patur reagime pozitive prej tij për ngritjen e problemit pranë Shtabit të Përgjithshëm të NATO-s në Bruksel. Po kështu edhe nga ambasada shqiptare në Belgjikë. Në këto kushte i kemi Rekomanduar Ministrisë së Punëve të Jashtme që të kryejë detyrën e saj për realizimin e të drejtës së dëmshpërblimit të familjes shqiptare.

Ministrja e Punëve të Jashtme na është përgjigjur personalisht se organizmat e saj vartës do përfshihen për paraqitjen në rrugë diplomatike të çështjes pranë organizmave të NATO-s. Çështja vazhdon të ndiqet nga ne.

Është pozitive se kjo Ministri për vitin 2001 dhe në vazhdim, ndër të tjera, ka shpallur si prioritet të saj mbrojtjen e të drejtave të shtetasve shqiptarë që lëvizin, punojnë ose jetojnë jashtë shtetit. Është fakt që nga Mediat ka jo pak raste të informimit të opinionit për shkelje të shumta të të drejtave dhe lirive të shtetasve shqiptarë, deri edhe në vrasje të tyre, nga individë apo segmente të caktuara shtetërore në Greqi apo Maqedoni, të keqtrajtimit të shtetasve shqiptarë të burgosur në këto vende etj.

Edhe Avokati i Popullit i ka patur këto çështje ndër prioritetet e tij dhe ka ndikuar që institucionet e diplomacisë shqiptare të vihen më shumë e më cilësisht në lëvizje për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve shqiptarë. Për këtë kemi siguruar edhe gatishmërinë e zyrës së Ombudsmanit të Greqisë. Vetë Ombudsmani grek, Zoti Diamanduras ka deklaruar në Mediat shqiptare dhe greke gatishmërinë e Institucionit që drejton për të mbrojtur edhe shtetasit shqiptarë në Greqi. Zyra jonë i ka dërguar disa ankesa dhe ato janë mirëpritur prej tij. Të njëjtën gjë synojmë edhe në lidhje me Ombudsmanin e Maqedonisë.

Ministria e Punëve të Jashtme ka mirëpritur dhe është pjesmarrëse në projektin tonë për të ndihmuar të burgosurit, shtetas shqiptarë, që vuajnë dënimet në shtetet e huaja. Për këtë kemi shkruar me hollësi në pjesën për ankesat nga të burgosurit.

Sidoqoftë do të rekomandonim që kjo ministri duhet t'i kushtojë më tepër vëmendje forcimit të Konsullatave apo Sektorëve Konsullorë në Ambasadat tona në ato vende ku ka mjaft shtetas shqiptarë, sidomos në Greqi, Itali, Gjermani, Angli etj. Konsullatat duhet të rriten si numër dhe si personel, sepse të drejtat e rreth gjysëm milion të shtetasve shqiptarë që ndodhen në këto vende, nuk mund të ndiqen se si realizohen dhe nuk mund

të mbrohen vetëm nga 20-30 punonjës konsulorë që janë gjithsej në këto vende.

14. Ministria e Transporteve

Për Ministrinë e Transporteve kanë ardhur pranë Institucionit tonë vetëm 6 ankesa, që lidhen kryesisht me shpronësimet. Në një prej këtyre ankesave, shtetasi R.H. dhe të tjerë shpjegojnë se janë bashkëpronarë në një pronë që e ka zënë autostrada Durrës-Rrogozhinë. Me Vendim Qeverie është bërë shpronësimi, por meqenëse kishin një konflikt gjyqësor, nuk i morën dot paratë e shpronësimit bashkë me banorët e tjerë. Procesi gjyqësor ka përfunduar dhe të gjitha dokumentet e nevojshme i kanë depozituar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve Tiranë, ku me gjithë premtimet që u bëhen, duke u dhënë të drejtë, deri më sot nuk e kanë marrë dëshpërbimin. Ankuesit na shkruajnë se sorrollatjet dhe pengesat artificiale që u nxorrën nga kjo drejtori “merren me mend” se përse bëhen. Na duhet të pohojmë se kjo drejtori po mban të njëjtin qëndrim, si me ankuesit, ashtu edhe me Institucionin e Avokatit të Popullit. I jemi drejtuar edhe me një kërkesë për të na dhënë shpjegime, për një ankesë për largim nga puna në muajin korrik 2001, dhe nuk na ka dërguar përgjigje. Po kështu, nuk ka dhënë përgjigje as për rekomandimin për të prishur kontratat me MBA-Spot për vënie reklamash në autostrada, veprime që vijnë në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Kjo çështje është ngritur edhe në Raportin Vjetor të vitit 2000. Policia Rrugore dhe ajo Ndërtimore kanë shfaqur disa herë impenjimin e tyre për të zbatuar Kodin Rrugor, por Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, që ka lidhur kontratën me çmime abuzive, nuk vepron. Çështjen ia kemi ngritur të gjithë drejtorëve të përgjithshëm që kanë qenë e janë në këtë detyrë.

Në ankesën e ardhur nga Federata e Sindikatave të Pavarura të Punonjësve të Transportit ngrihej një shqetësim i ligjshëm e mjaft serioz që lidhej me zbatimin e gabuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTR) të tarifave të shërbimit dhe TVSH-së në lidhje me taksën për rregjistrimin vjetor të automjeteve dhe taksës mbi aks.

Pas shumë takimesh e verifikimesh që bëmë me disa institucione, duke verifikuar edhe dokumentet për këtë ankesë, u arrit në konkluzionin se D.P.SH.T. Rrugor po zbatonte në mënyrë abuzive ligjin “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, duke caktuar vetë tarifa për vlerën e shërbimit që kryente. I rekomanduam D.P.SH.P. Rrugor që të zbatonte kërkesat e nenit 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se: “Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e

vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si edhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj”, si dhe kërkesat e Ligjit nr. 8581, date 17.02.2000, i cili në nenin 3, përcakton shumë qartë përqindjen që duhet të marrë ky institucion për shërbimin si agjent tatimor. Pas disa hezitimesh, drejtuesit e këtij institucioni kërkuan ndihmën e nevojshme ligjore pranë Avokatit të Popullit dhe sëbashku iu drejtuan Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me propozime konkrete për disa ndryshime në Ligjin “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.

Me miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë të Ligjit nr. 8840, datë 11.12.2001, u bënë ndryshimet e nevojshme në nenin 4, duke rritur ndjeshëm përqindjen që përfiton në rolin e agjentit tatimor, D.P.SH.T. Rrugor, me qëllim që të mbulojë realisht gjithë shpenzimet. Kështu u mbyll shtegu i abuzimit, duke përdorur tarifa shërbimi e TVSH në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin, vlera e të cilave u merrej padrejtësisht drejtuesve të automjeteve.

Nga hetimi i kësaj çështjeje dhe ndërhyrja me rekomandim u ndalua ky abuzim dhe nuk u lejua të vazhdonte, edhe gjatë vitit 2002, shkelja e të drejtave dhe interesave të mbi 200.000 shtetasve, drejtues automjeteve. Kështu, mendojmë se kemi ndikuar njëkohësisht edhe mbi administratën, që të mësohet të zbatojë vetëm ligjin.

Zgjidhja e një ankese të tillë, që lidhet me mbrojtjen e interesave të ligjshme të një numri të konsiderueshëm shtetasish, i shërben jo vetëm qëllimit që Institucioni ynë i ka vënë vetes, por edhe respektit që duhet të kenë ndaj ligjit si shtetasit, ashtu edhe zyrtarët.

15. Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë

Për këtë Ministri kemi patur vetëm dy ankese, nga të cilat njëra ka qënë jashtë juridiksionit tonë, ndërsa tjetra është konsideruar nga ne si e drejtë dhe shumë e rëndësishme, prandaj çështjen e dërguam në Gjykatën Kushtetuese. Rasti përshkruhet si më poshtë:

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë një shtetas i huaj, pronar i një firme, i cili ka parashtruar se nga organet e Shtetit Shqiptar nuk i ekzekutohet një detyrim i lindur para vitit 1991, që ka pasur ndaj tij ish-ndërmarrja e tregëtisë së jashtme “ALBKOOP”, pronë shtetërore.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese ka dalë se ajo lidhet drejtpërsëdrejti me zbatimin e ligjit Nr.8377 dt.22/07/1998 “Për Shpalljen e Moratoriumit për

Detyrimet e Pashlyera të ish-Ndërmarrjeve të Tregëtisë të Jashtme të Republikës së Shqipërisë kundrejt Kreditorve të Huaj” e konkretisht me nenin 1 paragrafi 3 të tij, lidhur me çështjet gjyqësore me objekt, detyrimet e ish-ndërmarrjeve të tregëtisë së jashtme ndaj kreditorëve të huaj. Kjo dispozitë ligjore parashikon se “të gjitha çështjet civile që janë në shqyrtim, në çdo hallkë gjyqësore, si dhe vendimet gjyqësore që kanë marrë formë të prerë ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pezullohen”.

Kurse në paragrafin 4 thuhet se: “Personat e interesuar kanë të drejtë të paraqesin padinë për kërkimin e detyrimeve, të cilat do të rregjistrohen nga gjykata për efekt të parashkrimit të padisë, që ndërpritet në bazë të nenit 131 të Kodit Civil”.

Këto dispozita vijnë në kundërshtim me Kushtetutën si dhe me Aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, sepse:

Ligji, në formë urdhëruese, vendos pezullimin e proceseve gjyqësore dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, që lidhen me detyrimet ndaj kreditorëve të huaj.

Një disponim i tillë nuk ka karakterin e një norme materiale që duhet të zbatohet nga organet e pushtetit gjyqësor në kryerjen e veprimtarisë së tyre kushtetuese. Përkundrazi, duke pasur karakterin e urdhërimit për normat proceduriale, ato cënojnë haptazi këtë veprimtari duke e nderprere atë, çka vjen ndesh me parimet e përcaktuara në nenin 7 të Kushtetutës, ku sanksionohet ndarja dhe balancimi i pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, si bazë për sistemin e qeverisjes në Republikën e Shqipërisë. Bazuar në këtë parim nuk mund dhe nuk duhet të vihet në diskutim se pezullimi i proceseve gjyqësore dhe i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë janë prerogativa të pushtetit gjyqësor, në të cilat nuk mund të interferojnë pushtetet e tjera.

Ligji i mësipërm, duke penguar gjykatën për kryerjen e detyrës së saj kushtetuese, bëhet shkak për të realizuar të drejtën për proces të rregullt, të drejtë e publik, duke u shkelur kështu neni 42 i Kushtetutës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane “Për të Drejtat e Njeriut”.

Është shkelur gjithashtu edhe neni 10 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut që parashikon se: “Çdo person ka të drejtë, në barazi të plotë, që çështja e tij të shqyrtohet me drejtësi dhe publikisht nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e cila duhet të vendosë si përsa u përket të drejtave dhe detyrimeve të tij, ashtu dhe për themelsinë e çdo akuze në fushën penale të drejtuar prej tij”. Pra në rastin konkret shtetasve u është mohuar e drejta që gjykata të shqyrtojë me padi civile kërkesat e tyre, duke ua pezulluar në infinit këtë të drejtë, në një kohë që praktikisht më mirë do të ishte që çështjet të gjykoheshin dhe të liheshin pa u ekzekutuar. Edhe për

shtetin do të ishte më mirë, se do të dijë se cila është shuma e detyrimeve të tij, ndaj këtyre personave.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në një rast konkret, duke shqyrtuar kushtetushmërinë e një dispozite ligjore, e cila përjashtonte gjykatat nga e drejta e pezullimit të akteve që shqyrtonte, është shprehur se një ndalim i tillë përbën dhunim dhe mospërfillje të parimeve kushtetuese, mbi organizimin tonë shtetëror të bazuar në ndarjen dhe ballancimin e pushteteve. Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar më tej, se ky ndalim e ka zhveshur gjykatën nga një prerogative e natyrshme e saj, e për rrjedhojë pengohet ajo që të zhvillojë një proces të paanshëm dhe të rregullt ligjor. (Vendimi nr.9 dt.31/07/1995).

Që dispozita e mësipërme prek drejtpërdrejt të drejtat e Njeriut dhe veprimtarinë e gjykatave, kjo del qartë edhe nga relacioni që ka shoqëruar ligjin të dërguar në Kuvendin Popullor nga Këshilli i Ministrave, ku midis të tjerave shprehet se:

“Aktualisht presioni i kreditorëve të huaj mbi ish-ndërmarrjet e tregëtisë të jashtme nëpërmjet gjykatave është tepër i madh dhe në të shumtën e rasteve me vendime gjyqësore janë sekuestruar gjendjet e llogarive të këtyre ndërmarrjeve për të shlyer detyrimet e trashëguara. Në këto kushte del e nevojshme shpallja e Moratoriumit, sepse ky ligj do të ketë efekt jo vetëm për administratën publike, por edhe për sistemin gjyqësor, duke shmangur gjykimet dhe ekzekutimin e detyruar të këtyre detyrimeve nga përmbaruesit gjyqësor”.

Në këto kushte për këtë ligj, kuptohet qartë antikushtetutshmëria dhe shkeljet e tij flagrante përkundrejt parimeve të lartpërmendura të Kushtetutës sonë, Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventës Evropiane “Për të Drejtat e Njeriut”. Prandaj në mbështetje të nenit 24/a të ligjit Nr.8454 dt.4/02/1999 “Për Avokatin e Popullit” kërkua që të shfuqizohen si antikushtetuese paragrafet 3 dhe 4 të nenit 1 të Ligjit Nr.8377 dt.22/07/1998 “Për Shpalljen e Moratoriumit për Detyrimet e Pashlyera të ish-Ndërmarrjeve të Tregëtisë së Jashtëme të Republikës së Shqipërisë kundrejt Kreditorëve të Huaj”.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e shqyrtoi kërkesën dhe me anë të vendimit të saj Nr.178 datë 08.11.2001 e rrëzoi atë me arsyetimin, ndër të tjera se “Avokati i Popullit nuk ka të drejtë (nuk legjitimohet) të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin e ligjeve, veçse në rast se ligjet që pretendohen si antikushtetuese prekin interesat e Avokatit të Popullit”

Për mendimin tonë ky vendim i Gjykatës Kushtetuese nuk është i bazuar në Kushtetutën tonë, në ligjin “Për Gjykatën Kushtetuese” dhe në

ligjin “Për Avokatin e Popullit”. Ky mendim do të argumentohet në pjesën e raportit mbi marrëdhëniet tona me Gjykatën Kushtetuese. Por në lidhje me çështjen në fjalë, në përputhje me nenin 25 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” i jemi drejtuar Komisionit parlamentar për Ligjet dhe Çështjet Kushtetuese dhe Komisionit për të Drejtat e Njeriut, për të ndërmarrë iniciativën legjislative për shfuqizimin e ligjit të lartpërmendur. Akoma nuk kemi ndonjë përgjigje zyrtare për këtë Rekomandim nga këto dy komisione të Parlamentit tonë.

16. Ankesa për Shërbimet Sekrete

Gjatë vitit 2001 në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë ardhur 12 ankesa apo kërkesa nga 12 shtetas, të cilët kërkojnë ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit për problemet e tyre me Shërbimin Informativ Shtetëror (SHISH), Shërbimin Informativ të Ushtrisë (SHIU) dhe Shërbimin Informativ të Policisë.

Për shkak të natyrës së punës, ankesat në lidhje me Shërbimet Sekrete janë parë me përparësi. Veçse ankesa të tilla që lidhen me shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, si përgjime, kontrolle, korrespondencë të paligjshme etj, nuk ka patur.

Nga ndjekja dhe verifikimi që i është bërë këtyre 12 ankesave, 10 prej tyre janë përfunduar dhe 2 ankesa janë në shqyrtim për vitin 2002. Ndër 10 ankesat e përfunduara, 2 prej tyre janë dërguar nga persona me të meta psikike, prandaj janë arkivuar. Duke grupuar ankesat sipas problemeve që ngrenë ankuesit, del se:

1. Dy persona, R. K. nga Fieri dhe M.D. nga Tirana janë ankuar se janë hequr pa të drejtë nga puna në Shërbimin Informativ Shtetëror.

Nga verifikimi i ankesave dhe dokumentet e paraqitura, doli se ankuesi R.K. ka qenë i paaftë në punën që ka pasur, duke shkelur në mënyrë të vazhdueshme normat e punës. Kurse ankuesja M.D. ka shkelur rregulloren e disiplinës së Shërbimit, kur ky institucion ka qenë në gatishmëri të plotë. Veç kësaj, ankuesja kishte bërë kërkesë-padi në gjykatë dhe kishin filluar seancat gjyqësore midis saj dhe përfaqësuesit të SHISH-it, prandaj verifikimet tona u ndërprejnë.

2. Ankesa e shtetasit G.S. nga Shkodra për heqjen nga puna si shef i kundërzbulimit të repartit ushtarak të Gjadrit që varet nga Ministria e Mbrojtjes. Sipas tij, personi kryesor që ka influencuar për heqjen nga puna ishte drejtori i SHIU-t, me të cilin ka patur debate dhe diskutime për dhënien e informacioneve sekrete.

Pas verifikimit të kësaj ankese me drejtuesit e Ministrisë së Mbrojtjes, u arrit që i lartpërmenduri të rifillojë punën.

3-Xh.Z. nga Tirana u ankua se në testimin që është bërë për një vend pune në Ministrinë e Financave në sektorin e “Antikrimit për Pastrimin e Parave të Pista”, një person tjetër që ka konkuruar bashkë me të, i quajtur A.M. ka mashtruar në CV-in e tij, duke deklaruar se është hequr më parë nga puna në Shërbimin Informativ Shtetëror për shkak të reformës.

Nga verifikimi që iu bë ankesës, doli se A.M. ishte larguar nga puna si punonjës i SHISH-it me motivacionin “për të meta dhe dobësi në punë”. Doli gjithashtu se ky organ, SHISH kishte vënë në dijeni drejtuesit e Departamentit të Administratës Publike për këtë fakt.

Institucioni ynë i dërgoi rekomandim DAP për shkeljen që ka bërë në marrjen në punë të lartpërmendurit. Në përgjigjen e dërguar nga drejtoresha e DAP thuhet se motivacioni i largimit të A.M. “Për të meta dhe dobësi në punë” nuk është shkelje e rëndë disiplinore, në bazë të ligjit “Për Statusin e Nënpunësit Civil”. Megjithatë shpjegon se DAP po vazhdon verifikimet në institucionet e duhura. Çështja është në ndjekje nga ana jonë, për shkak se pretendohet shkelja e një parimi të rëndësishëm, barazia e të gjithëve para ligjit, parashikuar nga neni 18/1 i Kushtetutës sonë.

4-Shtetasi Ll.H. nga Fieri në kërkesën e tij kërkoi ndërhyrjen tonë pranë SHISH-it për t’i dërguar dokumentat e strehimit që ai kishte paraqitur kur ishte punonjës i tij, pranë bashkisë së Fierit. Me ndërhyrjen tonë, këto dokumenta iu dërguan Bashkisë dhe kërkesa iu plotësua.

5-Shtetësja I.N. u ankua se është ndarë nga bashkëshorti, i cili punon në SHISH sepse nuk i firmoste dokumentin noterial për të marrë me vete në Amerikë vajzën e saj.

Kjo ankesë nuk përbënte objekt të punës sonë, megjithatë ndërmjetësimi në interes të fëmijës së mitur, tek personat që kishin lidhje familjare me të shoqin, bëri që problemi të zgjidhej.

6-Shtetasi F.C. nga Ballshi është ankuar se një ish oficer i SHISH-it M.R. ka vrarë vajzën dhe gruan e tij, por sipas tij, drejtuesit e Shërbimit Informativ Shtetëror duhej që këtë person t’a kishin larguar nga detyra e oficerit aktiv para se ky të kryente vrasjen, për arsye se ai i kishte njoftuar për rrezikun që kanoste familjen e tij. Sipas tij, nga drejtuesit e Institucionit ishte ndërhyrë në polici dhe prokurorinë e Tiranës që krimineli të mos procedohej për keqtrajtimet që i kishte shkaktuar disa herë vajzës së tij, disa kohë para se të kryente vrasjet. Kjo çështje është duke u gjykuar në gjykatë për vrasësin, por çështja është në ndjekje nga ana jonë për pretendimet e ankuesit për përgjegjësinë e drejtuesve të SHISH-it.

7-Ankuesja N.A. nga Vlora është ankuar se në Itali i është arrestuar djali nga policia italiane, duke e akuzuar si skafist që dërgon klandestine në Itali. Pretendimi i ankuseses ishte se djali i saj i ngjan skafistit të vërtetë dhe policia italiane e ka ngatërruar me të. Për këtë fakt kanë dijeni SHISH dhe Ministria e Rendit, por këto organe e fshehin këtë fakt për të mbrojtur shkelësin e vërtetë të ligjit.

Nga verifikimi që ju bë kësaj ankese në të dy institucionet, në SHISH dhe në Ministrinë e Rendit doli se pretendimet që ngrinte ankuesja nuk ishin të vërteta. Për këtë u vu në dijeni edhe ankuesja.

8-Shtetasi A.H. nga Fieri është ankuar se segmente të caktuara të SHISH-it, në mënyrë të herëpashërëshme, i kanë bërë presion djalit të tij, për t'a detyruar që të bashkëpunojë me organet e Shërbimit Sekret. Çështja është në shqyrtim.

9-Shtetasi V.D. nga Tirana është ankuar për kërcënimin e jetës së tij dhe të bashkëshortes, për arsye se bashkëshortja ka dhënë informata të vlefshme për Shërbimin Informativ të Policisë, për çështjen e vjedhjes së Thesarit të Shtetit. Ata kërkonin viza Shengen, gjoja të premtuara nga Shërbimi Sekret si kompensim për informacionin e dhënë. Nga ana jonë, ky pretendim u verifikua në Ministrinë e Rendit. Nga verifikimet doli se të lartpërmendurit kanë dhënë informacione, por atyre nuk ju është premtuar se do t'u jepeshin viza për të shkuar jashtë shtetit. Megjithatë, ankuesit iu afrua një vend pune që të ndjejë veten më të sigurtë nga kërcënimet.

Pritet përgjigjia e ankuesit për të ndërmjetësuar në plotësimin e kushteve për të rritur sigurinë e jetës së ankuesit dhe familjes së tij.

Institucioni ynë do të vlerësojë edhe në të ardhmen çdo ankesë, kërkesë ose njoftim për shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut apo shkelje të ligjeve nga Shërbimet Sekrete të Shtetit. Kohët e fundit ka patur deklarime në Media, edhe nga deputetë, për përgjigje të paligjshme, por ato nuk janë paraqitur në formën e duhur si ankesa individuale, siç e kërkon Ligji "Për Avokatin e Popullit". Për shkak se çështja ndodhet në hetim, kemi gjykuar për momentin të mos ndërmarrin hetime me iniciativë.

17. Përgjithësime për Shërbimet Publike

Siç kemi përshkruar më lart, janë të shumta problemet që kemi evidentuar nga ankesat dhe kërkesat e ardhura në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe që kanë për objekt të tyre veprimet e parregullta dhe të kundraligjshme të enteve të ndryshëm që ofrojnë shërbime publike, si KESH-i, Telekom, Ujësjellësi etj. Duke i vlerësuar si tepër të rëndësishme

dhe jetike shqetësimet e shtetasve, si dhe arbitrare e jo ligjore në shumë raste qëndrimet e administratës së këtyre enteve, kemi ngritur një grup pune dhe janë filluar veprimet për evidentimin dhe studimin e tyre, të legjislacionit që rregullon këto marrëdhënie dhe sidomos të kontratave mes palëve.

Konstatimi kryesor është se ndërsa kemi mbi 10 vjet që vendi ynë është futur në rrugën e ekonomisë së tregut, shërbimet jetësore të mësipërme dhe sidomos kontratat e tyre me qytetarin janë po ato të kohës së socializmit. Pjesa më e madhe e problemeve e kanë bazën në mangësitë juridike të kontratave që këto ente u servirin qytetarëve, të cilët janë të detyruar t'i firmosin. Në të kundërt u ndërpritet linja elektrike, telefonike apo uji. Kontratat janë tërësisht të njëanshme duke i dhënë prioritet absolut të drejtave të enteve dhe aspak detyrimeve të tyre, kurse për klientët janë caktuar vetëm detyrime dhe penalitete. Gjithashtu në kontratat përkatëse nuk bëhet fjalë fare për procedurat që duhet të ndjekin qytetarët dhe përfaqësuesit e enteve të tilla publike, me qëllim që konfliktet të zgjidhen në rrugë administrative dhe të mos shkojnë në çdo rast në gjykatën civile. Këto kontrata nuk i përgjigjen realitetit të sotëm të ekonomisë së tregut, duke arritur deri sa ujësjellësi në shumicën e rretheve të veprojë akoma pa kontrata dhe të konsiderojë si të tilla njoftimet në një vend të dukshëm. Kjo konstatohet qartë në përgjigjen që i dërgon Institucionit të Avokatit të Popullit drejtori i SH.A. Ujësjellësit Durrës që thotë shprehimisht:

“Subjekti ynë për të gjithë konsumatorët familjarë nuk ka shpërndarë kontratë Tip, pasi kjo ka një kosto financiare të pa përballueshme për ne. Pranë degës së shitjes dhe arkës ku paguhen faturat, në një vënd të dukshëm, janë vendosur kontrata tip, të cilat njoftojnë konsumatorin në lidhje me të drejtat dhe detyrimet”.

Raste të tilla nuk mungojnë edhe për rrethe të tjera si për ujësjellësin, ashtu edhe për KESH-in. Kështu faturat plotësohen afrofe në mungesë të sahateve matës që është ligjëruar edhe me Vendim Qeverie. Pra nuk bëhet fjalë fare për kontratë e jo më që këto kontrata të jenë të bazuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe aktet e tjera nënligjore.

Institucioni ynë e ka caktuar një nga objektivat kryesore trajtimin dhe ndërhyrjen për përmirësimin e kësaj situatë, duke filluar nga legjislacioni, vendimet e Qeverisë e aktet e tjera si dhe nxitjen e bashkëpunimit real që duhet të kenë këto ente me shoqatat e konsumatorëve, për hartimin e kontratave ligjore e bashkëkohore, me të drejta e detyrime të dyanshme, pa i dhënë prioritet asnjërës palë, siç ndodh aktualisht.

Avokati i Popullit do të bëjë përpjekje maksimale për këtë çështje, me kompetencat që i jep Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe me synimin që të shmangë konfliktet e panevojshme si dhe të zgjidhë me përparësi ankesat e konsumatorëve, duke u lehtësuar punën, kohën dhe shpenzimet që u duhen kur çështjet shkojnë në gjykatë.

Pra kontributi ynë do të jetë në formën e Rekomandimeve për miratimin e kontratave Tip, me të drejta e detyrime reciproke, si të enteve publike, ashtu dhe konsumatorëve, mbi bazën e barazisë. Në fazën tashmë të privatizimeve totale që po bëhen e do vazhdojnë të bëhen ka ardhur koha që para privatizimit të Keshit, Telekomit, Ujësjellësit, Qeveria të rishqyrtojë edhe çmimet me të cilat aktualisht institucionet buxhetore paguajnë për këto shërbime, të cilat faktikisht janë të rritura, në raport me çmimet që paguajnë shtetasit si individë. Kjo duhet bërë që pronarët që do blejnë këto ente publike të mos nxjerrin fitime të pa merituar në dëm të taksapaguesave shqiptarë.

18. Përgjithësime për Marrëdhëniet e Punës

Siç del edhe nga pasqyrimi i ankesave për çdo degë të administratës publike, del se të tilla ka për secilën prej tyre. Numri total është 150, nga të cilat 30 janë zgjidhur në favor të ankuesve apo kërkuesve.

Pjesa më e madhe e ankesave lidhur me marrëdhëniet e punës, ka të bëjë me parregullshmërinë e kontratave të punësimit e të mbarimit të marrëdhënieve të punës, mosderdhja e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga ana e punëdhënësve etj. Vë në dukje se shumë prej ankesave drejtohen edhe ndaj punëdhënësve privatë. Duke pasur parasysh kompetencat e kufizuara në këtë drejtim të Avokatit të Popullit, këta ankues i kemi orientuar për shqyrtim gjyqësor të problemeve që shtrajnë në ankesa, ndaj punëdhënësve privatë.

Duke shqyrtuar ankesat, kërkesat apo njoftimet që kanë si objekt marrëdhëniet e punës kemi arritur në konkluzionin se ka nevojë për ndryshime në legjislacionin që është në fuqi dhe që rregullon këto marrëdhënie. Kështu Kodi i Punës, duhet të ndryshohet apo të plotësohet sepse konstatohen mjaft të meta në zbatimin e tij, kështu nuk i jepet rëndësia e duhur si momentit fillestar të fillimit të marrëdhënieve të punës, hartimit të kontratës së punës, e cila duhet të jetë e detajuar, ashtu dhe procedurës që duhet të zbatohet nga të gjithë punëdhënësit, për pezullimet apo pushimet nga puna për të drejtat që ju takojnë punëmarrësve pas këtij momenti.

Gjithashtu të meta ka dhe në përcaktimin e shkaqeve që duhet të shërbejnë si motive për pushimet nga puna, të cilat duke qenë të papërcaktuara saktë lenë vend për abuzime apo qëndrime subjektive nga punëdhënësit. Po kështu mund të themi edhe për ligjin “Për statusin e nëpunësit civil”. Rregullimi i marrëdhënieve të punës me Kodin e Punës dhe për nëpunësit civilë me “Statusin e nëpunësit civil”, lenë vend për diskutime, pasi të dy ligjet kanë nevojë për rishikime. Kështu ligji “Për statusin e nëpunësit civil”, ka përcaktuar në dispozitat e para të tij fushën e veprimit, por kjo në shumë raste nuk kuptohet. Në këtë ligj në shumë raste, autorizohet Këshilli i Ministrave për të nxjerrë akte në bazë e për zbatim të tij. Do të ishte mirë që ligji vetë të ishte më i plotë dhe të mos linte shumë hapësira për t’u rregulluar më pas me vendime të Këshillit të Ministrave.

Nga ana tjetër nuk del e qartë shtrirja e legjislacionit të punës dhe ligjit “Për Statusin e Nëpunësit Civil”. Me sa jemi në dijeni Ministria e Punës po punon për përgatitjen e ndryshimeve në Kodin e Punës dhe ne kemi qënë të gatshëm t’i përcjellim vendimet dhe vërejtjet tona për përmirësimin e tij.

1. Kërkesa e Bashkësisë së Sindikatave të Shqipërisë

Kërkesa e kësaj Bashkësie, në fakt ishte një përmbledhje kërkesash, të cilat, të përmbledhura paraqiten si më poshtë:

1. Ulja menjëherë në dialog e Qeverisë me të gjitha Sindikatat e vendit për nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës në nivel kombëtar, me vlerën e një marrëveshjeje sociale mirëkuptimi.

2. Mbajtja e premtimit qeveritar për deklarimin e minimumit jetik brenda shtatorit 2001.

3. Ulja e çmimit të energjisë elektrike për popullatën, deri në vjeljen 100% të shpenzimeve të saj nga të gjithë konsumatorët.

Pas konsultimeve me përfaqësues të Dikastereve përkatës ankuesit u sqaruan se:

1. Dialogu për të cilin bëhet fjalë në kërkesë duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe institucional për të gjitha marrëveshjet kolektive të punës. Janë bërë mjaft takime lidhur me problemin në fjalë, janë hartuar programe konsultimi dhe është ngritur një Këshill i përbërë nga 5 ministra për trajtimin e të gjitha problemeve të punës. Ky Këshill kryesohet nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale. Në bazë të nenit 200 të Kodit të Punës “Në Këshillin Kombëtar të Punës përfaqësohen të gjitha organizatat e rëndësishme të punëdhënësve dhe punëmarrësve, që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave”. Në Këshillin Kombëtar të Punës përgatitet draftmarrëveshja dhe arritja e saj nuk përbën një detyrim të Qeverisë, por

vetëm një synim të saj për harmonizimin sa më të mirë të interesave. Ndaj dhe nuk mund t'i diktohet Qeverisë të nënshkruajë marrëveshje, por vetëm mund të negociohet me të.

2. Përsa i përket deklaramit dhe fiksimit të minimumit jetik, është krijuar një Këshill Kombëtar dhe një grup pune në bazë të një Vendimi të Qeverisë dhe janë bërë mjaft anketime për caktimin e tij. Ishte menduar të përfundojë në Nëntor 2001 dhe më pas do t'i kalonte Këshillit Kombëtar të Punës dhe Qeverisë. Qeveria ka lëvruar fondin përkatës për këtë studim. Grupi i Punës përfshin edhe përfaqësues të partnerëve socialë, dhe në fundin e dhjetorit 2001 e ka përfunduar studimin e minimumit jetik. Tashmë procesi është në fazën e pritjes për t'u miratuar nga Këshilli i Ministrave. Çështjen e caktimit të minimumit jetik ne e kemi ngritur në Raportin Vjetor të vitit 2000.

3. Përsa i përket kërkesës për çmimin e energjisë elektrike, na është konfirmuar se një projekt i tillë është bazuar në politikën e mbrojtjes sociale që bën Qeveria duke mbajtur si normativë të paprekshme çmimin për një sasi të caktuar të energjisë elektrike, për të ndihmuar kategoritë sociale me të ardhura të vogla.

Në përgjigjen e dhënë kësaj Bashkësie i kemi vënë në dukje se Zyrës së Avokatit të Popullit, duhet t'i drejtohen me ankesa konkrete se ku vërejnë shkelje ligjore të të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve dhe të shprehen qartë se ku duhet të konsistojë ndërhyrja jonë, sepse Avokati i Popullit nuk mund të ndërhyjë për çështje të caktuara të politikave sociale që përcakton Parlamenti apo Qeveria, por veçse për shkelje konkrete të të drejtave të Njeriut.

*
* *

19. Konkluzione lidhur me rastet që kanë të bëjnë me Administratën Publike

Nëpërmjet numrit të ankesave të shqyrtuara nga Avokati i Popullit, në lidhje me administratën, si dhe përqindjes së rasteve kur janë shfrytëzuar mjetet ligjore të parashikuara nga ligji (Kodi i Procedurave Administrative), arrijmë në konkluzionin se në fushën e administratës publike ka mjaft raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Përveç thyerjes së afateve të përcaktuara për zgjidhjen administrative të çështjeve në fusha të caktuara, nga shqyrtimi i ankesave del se kryesisht ka mospërgjigje ndaj letrave të qytetarëve, refuzim për pranimin e aplikimeve, mohim të së

drejtës për të marrë pjesë në një procedurë administrative dhe mohim të së drejtës për tu njohur me dokumentet zyrtare. Raporti ynë është plot me përshkrime të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe parregullsi të tjera, por mund të themi se në kontaktet tona me organet e administratës, në të gjitha nivelet, shpesh kemi vënë re një qëndrim të drejtë dhe nivel të pranueshëm të vet korigjimit të shkeljeve nga këto organe.

Përveç përmirësimit të efektivitetit dhe kompletimit të sistemit të ri administrativ brenda procesit të integritetit me Evropën e Bashkuar, është një nga detyrat kryesore të administratës zbatimi i dispozitave të përcaktuara qartë në ligjin nr.8485, datë 05.12.1999, “Për Kodin e Procedurave Administrative”. Në planin praktik, Qeveria duhet të synojë të zbatojë dhe të kontrollojë:

1. Koordinimin më të mirë të punëve brenda ministrive, e në veçanti midis ministrive.

2. Koordinimin dhe mbikqyrjen e rolit të ministrive në marrdhëniet e reja të decentralizimit dhe autonomisë me pushtetin vendor.

3. Depolitizimin e plotë të administratës publike dhe zbatimin e plotë të ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”.

4. Zbatimin më të mirë të procedurave administrative në të gjitha fushat e administratës publike dhe në të gjitha nivelet.

5. Rritjen e kontrollit lëndor për fushën e veprimtarisë konkrete të hallkave të administratës. Kjo do të thotë që në veprimtarinë e administratës të mos kontrollohet vetëm aspekti financiar, por vetë veprimtaria dhe funksioni përshkruar i punës së çdo nëpunësi. Për këtë duhen forcuar si kontrolli i brendshëm ashtu dhe i jashtëm mbi administratën. Është inkurajuese puna në Drejtorinë e Kontrollit të Këshillit të Ministrave, e krijuar pak kohë më parë, por sipas modelit të saj duhen krijuar, dhe atje ku ekzistojnë, duhen forcuar këto hallka kontrolluese. Natyrisht që roli i Kontrollit të Lartë të Shtetit është i pazëvendësueshëm, veçse rekomandimet e tij duhen zbatuar pa hezitim.

6. Forcimi i punës së hallkave (drejtorive juridike) në dikastere dhe respektimi i sugjerimeve të tyre nga titullarët, si dhe plotësimi me juristë i organeve më të ulta, veçanërisht në pushtetin vendor. Nga konstatimet tona rezulton se në shumë bashki të vogla dhe komuna, nuk ka juristë. Kjo ka ndikuar në nivelin e vendimeve të këtyre organeve, përfshirë këtu edhe raste të marrjes së vendimeve të kundërligjshme.

Për momentin, ne nuk jemi në gjendje të themi nëse kjo është një listë e plotë me rekomandime (përshkrime), të cilat do t’a bëjnë punën e administratës shqiptare më të mirë ose do të përmirësojnë rrënjësisht cilësinë e saj. Qëllimi ynë është modest: mbi bazën e trajtimit të rasteve të

paraqitura pranë nesh, lidhur me punën e administratës, të japim shkurtimisht vëzhgimet dhe gjetjet tona, pra disa elemente të këtyre rekomandimeve (përshkrimeve).

Ne kemi thënë dhe në raportin e mëparshëm, se puna jonë konkrete me organet e administratës ka si objekt kryesor: të merremi me rastet, ku ka dhunim të të drejtave të njeriut ose parregullsi të tjera që çojnë në shkeljen e këtyre të drejtave dhe të ndihmojmë qytetarët. Mbi këtë bazë, është e pamundur që të japësh, një gjykim të pakontestueshëm për punën e administratës publike në Shqipëri.

KREU I KATËRT

I. Në ndjekje të rasteve të prezantuara në Raportin Vjetor 2000

Disa nga rastet(ankesa, kërkesa apo rekomandime) që janë prezantuar në Raportin e vitit të kaluar kanë përfunduar dhe gjatë këtij raporti janë pasqyruar në pjesët përkatëse ku trajtohet problematika e tyre. Prandaj në këtë Kre të këtij Raporti do të paraqesim shkurtimisht, vetëm ato raste të cilat janë akoma në ndjekje edhe për vitin 2002.

1. Ndryshime në Kodin e Procedurës Penale; në lidhje me dhënien e së drejtës që familjarët e viktimave të veprave penale të kenë të drejtë që të marrin pjesë në gjykim, për mbrojtjen e interesave të tyre. Ky rekomandim do të përsëritet duke rekomanduar edhe për ndryshime të tjera që do duhet t'i bëhen Kodit të Procedurës Penale, si për shkurtim të afateve të hetimeve paraprake etj.

2. Ndryshime në Kodin e Procedurës Civile, në lidhje me pjesëmarrjen e avokatëve të të dyja palëve ndërgjyqëse kur në Gjykatën e Lartë shqyrtohet kërkesa e ndonjërës nga palët për pezullim të ekzekutimit të vendimit. Gjithashtu edhe për gjykimin e çështjes me një qytetar të vetëm etj.

3. Ndryshime në Kodin e Punës. Është pranuar rekomandimi ynë. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale na ka dërguar projektligjin për ndryshimet e këtij Kodi. Çështja do të ndiqet deri në miratimin e këtyre ndryshimeve nga Parlamenti.

4. Miratimi i Kodit të Ri të Familjes. Projekt ligji për Kodin e ri nga Qeveria, u paraqit në Kuvend, ku ndodhet për miratim.

5. Plotësimi i ligjit “Për të Drejtat e të Dënuarve” me aktet nënligjore për shpërblimin e punës së të dënuarve, ndryshime të rregullores së policisë së burgjeve dhe plotësimi me rregullat e çdo burgu në veçanti.

6. Ndryshime në ligjin “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, për përfitime të ushtarakëve të aksidentuar në krye të detyrës, si dhe për ndryshimin e termit “braktisje detyre”, si pasojë e të cilit rreth 40 ushtarakë humbasin të drejtën e pensionit.

Për këtë të fundit Kryetari i Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes, z.Dashmir Shehi, ka marrë iniciativë personale legjislative.

7. Për shfuqizimin e nenit 289 të Kodit Doganor, është paraqitur kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, është zhvilluar gjykimi, por vendimi nuk është dhënë akoma.

8. Rekomandim drejtuar Kryeministrit për moszbatimin nga ana e organeve të administratës shtetërore të vendimeve gjyqësore, duke shkelur nenin 142 të Kushtetutës së Shqipërisë. Njëkohësisht për mos plotësimin nga Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë të kërkesave të vendimit të Qeverisë nr. 355, datë 02.06.1998, për këtë qëllim. Në buxhetin e shtetit të vitit 2001, nga 6 milion \$ ose rreth 900 milion lekë të nevojshme për këtë qëllim, u miratuan vetëm 100 milion lekë, ose 12% e sasisë që nevojitet për të ekzekutuar të gjitha vendimet e gjykatave që kanë marrë formë të prerë, ku debitore janë insitucionet buxhetore. Është përsëritur rekomandimi dhe problemi vazhdon të jetë në ndjekje.

8. Rekomandim për masat për zbatimin e të drejtës së informimit për dokumentet zyrtare. Nuk kemi marrë përgjigje me shkrim nga: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve Publike, Ministria e Pushtetit Vendor, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve. Do të ripërsërisim rekomandimin për këto Ministri dhe do të bëjmë një studim në shkallë kombëtare për zbatimin e ligjit të sipërcituar nga organet e Administratës Publike.

9. Për mosbotimin në Fletoren Zyrtare të V.K.M. NR. 205, datë 13.04.1999, "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor". Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave e ka dërguar vendimin për botim në Qendrën e Publikimeve Zyrtare, por për arsye teknike ky vendim nuk është botuar akoma.

10. Shtyrja e afatit të paraqitjes së kërkesës nga personat që kanë humbur banesat në firmat piramidale, sipas VKM Nr. 585, datë 11.12.1997. Kryetari i Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave na ktheu përgjigje se problemin do ta zgjidhte me urdhër administrativ drejtuar komunave dhe Bashkive. Por, nga ankuesit që u riparaqitën në Zyrën tonë u informuam se ky urdhër administrativ nuk zbatohet nga Bashkitë. Kemi përsëritur rekomandimin për zgjidhje me anë të ndryshimit të vendimit përkatës të Qeverisë.

11. Kalimi i Dhomave të Izolimit pranë Komisariateve të Policisë në vartësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Ka nisur të vihet në zbatim dhe është në ndjekje nga ana jonë deri në përfundim.

12. Ngritja e shërbimit të kontrollit mjekësor të të ndaluarve që mbahen në Rajonet e Policisë. Meqenëse nuk janë marrë masat për zbatimin e këtij

rekomandimi ai është ripërsëritur nga ana jonë. Jemi në ndjekje të këtij problemi.

II. Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit

Sipas nenit 13 të Ligjit nr.8454, dt.4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, “Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike, por me pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit”.

Ankesat e ardhura nga Zyra e OSCE nuk janë konsideruar me iniciativë. Por në të gjitha rastet që ankesat na kanë ardhur nga Zyra e OSCE Tiranë, është filluar shqyrtimi dhe është shkuar në vend për të takuar ankuesit, apo atyre u është kërkuar të paraqiten tek ne, për të dhënë pëlqimin dhe shpjegimet përkatëse. Në përfundim të çdo rasti është njoftuar Zyra e OSCE me shkrim për mënyrën e përfundimit.

- Në total çështje të filluara me iniciativë gjatë vitit 2001 janë: 27
- Ankesa të drejta ose zgjidhur në favor 7
- Jashtë kompetence ose juriksionit 4
- Të refuzuara për shkak se nuk u bënë ankesa individuale sipas ligjit, ose gjatë shqyrtimit u tërhoqën, ose në përfundim ankesa ishte e padrejtë apo e pavërtetë 11
- Në shqyrtim 5

Informacion më i hollësishëm është pasqyruar në tabelat përkatëse.

**ANKESA OSE PROBLEME TE TRAJTUARA ME INICIATIVE
TE INSTITUCIONIT GJATE VITIT 2001**

Nr	Media	Ankuesi	Përmbajtja e ankesës	Vendi Rrethi	Mënyra e zgjidhjes			
					Në favor	Moskompetencë	Refuzuar ose e padrejtë	Në shqyrtim
1	Gazeta RD. Kaseta nga OSCE.	Keqtrajtime në 28-ntor 2000	Kundër policisë për keqtrajtim.	Tiranë	+			
2	Gazeta RD.	A.H.	Kundër policisë për shkelje ligji.	Tirane			+ U terhoq nga ankesa	
3	Gazeta RD.	A. H.	Kundër policisë për keqtrajtim.	Tirane			+ Nuk bëri ankesë	
4	Gazeta RD.		Kundër policisë për keqtrajtim.	Kavajë			+ Nuk u paraqitën	
5	Shekulli.	B. Zalla, N. Kola etj, te arrestuar.	Grevë urie kundër Prokurorisë.	Krujë	+			
6	Shekulli.	D. Sala, N. Zalla etj.	Grevë urie kundër Prokurorisë për familjarët e arrestuar.	Krujë	+			
7	Koha Jonë.	F.Hysi	Vdekur në burg me 22.03.2001.	Lushnjë				+

Nr	Media	Ankuesi	Përmbajtja e ankesës	Vendi Rrethi	Mënyra e zgjidhjes			
					Në favor	Moskompetencë	Refuzuar ose e padrejtë	Në shqyrtim
8	Inicuar nga Avokati i Popullit.		Projekti për pajisjen me ligje dhe libra në gjuhën shqipe në burgjet jashtë shtetit, ku janë të dënuar shqiptarë.	Gjithë vendet				+
9	Shekulli.		M. Çausi ankohet për trajtim jonormal në burg.	Burrel	+			
10	Amnistry Internacional		Keqtrajtme në burgje. <i>(Bëhet fjalë për tre të dënuar të rrahur nga policia e burgut 302 Tiranë).</i>	Tiranë	+(filluar çështja penale)			
11	Koha jonë	Të ndryshme	Keqtrajtim i Shqiptarëve nga Policia Greke.	Greqi		+		
12	Koha Jonë	Të ndryshme	Keqtrajtme nga policia Maqedonase.	Maqedoni		+		
13	Inicuar nga Avokati i Popullit	Sh. A.	Ankohet për policinë dhe Prokurorinë për ndjekje penale të padrejtë.	Gjirokastër			+	
14	Inicuar nga Avokati i Popullit.	D. A.	Ankohet për policinë dhe Prokurorinë për ndjekje penale të padrejtë.	Gjirokastër			+	
15	Inicuar nga Avokati i Popullit.	R.M.	Ankohet për policinë dhe Prokurorinë për ndjekje penale të padrejtë.	Gjirokastër			+	

Nr	Media	Ankuesi	Përmbajtja e ankesës	Vendi Rrethi	Mënyra e zgjidhjes			
					Në favor	Moskompetencë	Refuzuar ose e padrejtë	Në shqyrtim
16	Gazeta Shqiptare.		Vrasja e shtetasit shqiptar Halim Munga nga Policia Greke në territorin e shtetit Grek.	Sarandë Greqi		+		
17	Gazeta RD.	U.E.	Keqtrajtim nga Policia.	Korçë			+ Nuk bëri ankesë.	
18	Republika.	E. Dervishi	Mbahet në burg padrejtësisht.	Tiranë	+ Filluar çështja penale			
19	Koha Jonë	Shoqata e rinisë dhe Gruas Maqedonase (Druzhba Prespa)	Shkelje të të drejtave të minoritarëve maqedonas në Shqipëri. Titulli i shkrimit “Minoriteti Maqedonas kërkon zjarr, Korça përgjigjet me qytetari”.	Korçë			+ Nuk pati ankesë konkrete	
20	Tv “Top Chanel” Gazeta Shqiptare, Koha Jonë dhe Ekonomia.	Të ndryshme	Tarifat afrofe që vendos KESH-i dhe mungesa e sahatëve.	Të ndryshme				+

Nr	Media	Ankuesi	Përmbajtja e ankesës	Vendi Rrethi	Mënyra e zgjidhjes			
					Në favor	Moskompetencë	Refuzuar ose e padrejtë	Në shqyrtim
21	TVA	Të ndryshme	Problemet e furnizimit me ujë dhe mungesa e kontratave.	Të ndryshme				+
22	Tv "Gjelivizion"	Të ndryshme	Arbitrariteti në TELEKOM.	Tiranë				+
23	Koha Jonë.	Të ndryshme	Keqtrajtim i 29 Shqiptarëve nga Policia Maqedonase.	Maqedoni Shkup		+		
24	Gazeta 55	50 familje	Ankohen për një ndërtim pa leje.	Tirane			+ Nuk u bë ankesë.	
25	Inicuar nga Avokati i Popullit	N. A.	Ankohet për policinë dhe Prokurorinë për ndjekje penale të padrejtë.	Gjirokastër			+	
26	Koha Jonë		Pretendohet se në burgun e Vlorës nuk lejohen Familjarët të takohen me të dënuarit, dhe nuk u pranohen ushqimet.	Vlorë			+ Nuk ishte e vërtetë.	
27	Koha Jonë Shekulli etj	Shtetase Romune Moldave Ruse	Zvarritje të procesit të hetimit nga Prokuroria	Tiranë	+ U gjykuan			

MBULIMI MEDIATIK 2001

MEDIA E SHKRUAR

Nr.	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
1.	10.01.2001	Albania	Qeveria 1.6 milion borxh 450 qytetareve	Interviste
2.	11.01.2001	Republika	900 dosje per Avokatin e Popullit.	Prononcim
3.	31.01.2000	Ushtria	Avokati i Popullit dhe te drejtat e Ushtarakut.	Interviste
4.	01.02.2001	Republika	Haklaj, Ankese tek avokati i Popullit.	Njoftim
5.	01.02.2001	Republika	Perfundon tek A.P. ceshtja e shkolles "Asim Vokshi".	Prononcim
6.	02.02.2001	Albania	A. P. "Nuk po hetojme, presim kerkese per kreun e P.D.-se Tropoje.	Prononcim
7.	05.02.2001	Koha Jone	A.P. shprehet per nismat kunder korrupsionit.	Prononcim
8.	06.02.2001	Albania	Prokuroria injoron kerkesen e A.P.	Prononcim
9.	06.02.2001	Koha Jone	A.P. ze ne flagrance Prokurorin.	Prononcim
10.	08.02.2001	Rilindja Demokratike	Ermir Dobjani takohet ne burg me kryetarin e PD-se se Tropojes.	Prononcim
11.	09.02.2001	Gazeta Shqiptare	Dobjani:"Ceshtja Ferexhe " deri ne Gjykatën Kushtetuese.	Prononcim
12.	13/02/2001	REPUBLIKA	13 perfaqesuesit e BE diskutojne me AP.	Njoftim
13.	13/02/2001	KOHA JONE	AP: Te drejtat Evropiane jane te njejta, si per shqiptaret, edhe per greket.	Njoftim
14.	18/02/2001	SHEKULLI	Ne deren e AP, ku trokasin hallexhinjte.	Intervistë
15.	21/02/2001	REPUBLIKA	AP takon Grupin e Komisionit Monitorues te Asamblese Parlamentare	Intervistë
16.	27/02/2001	KOHA JONE	AP: Mos pushoni nga puna per inate personale.	Intervistë
17.	02/03/2001	REPUBLIKA	AP paraqet raportin vjetor ne parlament.	Prononcim

Nr.	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
18.	02/03/2001	55	AP nuk e pyesin me as deputet qe e kane zgjedhur.	Artikull
19.	02/03/2001	RD	Ombudsmani, mburoje e skandaleve qeveritare.	Artikull
20.	02/03/2001	RD	AP: Gazetaret kane faj.	Artikull
21.	02/03/2001	Z. i POPULLIT	AP. Ja ligjet qe duhen per institucionin e Avokatit te Popullit.	Prononcim
22.	02/03/2001	Z. i POPULLIT	AP.: Puna e nje viti ,601 ankesa te shqyrtuara.	Prononcim
23.	02/03/2001	SHEKULLI	AP: Kam zgjidhur 150 ankesa te qytetareve.	Prononcim
24.	02/03/2001	KOHA JONE	AP: Pushteti Gjyqësor, më problematiku.	Njoftim
25.	06/03/2001	RD	Arbnori: “AP,funksion sa per forme”.	Artikull
26.	07/03/2001	KOHA JONE	Ministrat mungojne tek Raporti i Dobjanit Arsyeja; Akuzat e Dobjanit ndaj tyre.	Njoftim
27.	14/03/2001	REPUBLIKA	Kengetarja kosovare i drejtohet AP.	Njoftim
28.	28/03/2001	ÇAMERIA	AP i pergjigjet nje çami qe nuk do shtetesine shqiptare.	Prononcim
29.	05/04/2001	KOHA JONE	AP kerkon largimin nga detyra te shefit te rendit qe dhunoi barbarisht 24 vjecaren.	Prononcim
30.	19/04/2001	KOHA JONE	AP kerkon hetime ne Athine per vdekjen e Esmerines.	Njoftim
31.	19/04/2001	REPUBLIKA	Vajzat e trotuareve i drejtohen AP.	Njoftim
32.	19/04/2001	REPUBLIKA	Historia e deshmitares se nje rrembimi. Babai i vajzes ankohet tek AP.	Prononcim
33.	19/04/2001	SHEKULLI	Shtate prostitutat e huaja ne deren e AP.	Njoftim
34.	20/04/2001	SHEKULLI	AP heton dosjen “ERMALI”.	Njoftim
35.	25/04/2001	KOHA JONE	AP kerkon mase per te 2 prokuroret.	Prononcim
36.	28/04/2001	G.SHQIPTARE	AP fiton gjyqin me qeverine per çeshtjen e tokes.	Njoftim
37.	03/05/2001	KOHA JONE	Pse hodhem poshte vendimin e qeverise.	Intervistë
38.	10/05/2001	KOHA JONE	AP jep alarmin: “Gjeni vend per 35 autore te cmendur”.	Prononcim
39.	11/05/2001	KOHA JONE	AP i drejtohet Kryetarit te Parlamentit: “Viktimat te marrin pjese ne gjyq”.	Njoftim
40.	13/05/2001	KOHA JONE	AP kerkon ndryshime ne Kodin e Procedures Penale.	Njoftim
41.	15/05/2001	KOHA JONE	AP: “Po vidhen leket e ushtarakeve”.	Njoftim

Nr.	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
42.	25/05/2001	G.SHQIPTARE	Shpresa ime e vetme- AP: “Dua te largohem nga ky vend”.	Njoftim
43.	30/06/2001	SHEKULLI	AP ne Shkup: “Shqiptaret jane keqtrajtuar”.	Interviste
44.	05/07/2001	SHEKULLI	AP ben me telefon te burgosurit.	Njoftim
45.	07/07/2001	KOHA JONE	AP: Materialet per keqtrajtim te shqiptareve do t’ia dergoj Gjykates Nderkombetare.	Intervistë
46.	10/07/2001	REPUBLIKA	AP fillon hetimet per dhunen ne ditën e zgjedhjeve.	Njoftim
47.	10/07/2001	REPUBLIKA	Lume ankesash ne tavolinen e Dobjanit.	Njoftim
48.	12/07/2001	REPUBLIKA	Te shpronesuarit ankohen tek AP.	Njoftim
49.	12/07/2001	KOHA JONE	Pas kerkeses se Dobjanit, Amnesty International kerkon hetime per keqtrajtimin e shqiptareve.	Njoftim
50.	13/07/2001	KOHA JONE	Keqtrajtimet e policise ne duart e AP.	Njoftim
51.	18/07/2001	KOHA JONE	Shqiptaret e keqtrajtuar nga maqedonasit i drejtohen AP.	Njoftim
52.	18/07/2001	KOHA JONE	AP ne Bilisht per zgjedhjet.	Njoftim
53.	21/07/2001	KOHA JONE	Konference Kombetare per gjakmarrjen “Nje vize per te shuar gjaksit”.	Njoftim
54.	21/07/2001	G.SHQIPTARE	AP: Tani nje mal me dosje.	Intervistë
55.	21/07/2001	REPUBLIKA	AP nxjerr bilancet e punes 6 mujore.	Njoftim
56.	21/07/2001	REPUBLIKA	“Pronesi me drejtesi” i drejtohet Avokatit të Popullit.	Njoftim
57.	21/07/2001	SHEKULLI	Jane shqyrtuar 1092 ankesa.	Intervistë
58.	21/07 2001	SHEKULLI	OSBE i dergon Dobjanit dosjen e opozites.	Njoftim
59.	21/07 2001	ALBANIA	1485 ankesa per AP-në.	Njoftim
60.	21/07/2001	ALBANIA	Pas KQZ dhe Gjykatës Kushtetuese, zgjedhja shkon ne AP	Njoftim
61.	Korrik 2001	TRIBUNA JURIDIKE	Hapesirat dhe instrumentet e AP-së.	Artikull
62.	Korrik 2001	T.JURIDIKE	Kater nene brenda nje dispozite.	Artikull
63.	03/08/2001	ALBANIA	AP tregon aventuren me grabitësit.	Njoftim

Nr.	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
64.	03/08/2001	SHEKULLI	Nje makine sulmon AP ne autostrade.	Njoftim
65.	03/08/2001	G.SHQIPTARE	Grabitet AP.	Njoftim
66.	03/08/2001	KOHA JONE	AP pa badigard.	Intervistë
67.	03/08 2001	R.D	Maskat nuk kursejne as zyrtaret e larte shteterore.	Njoftim
68.	03/08/2001	“55”	Sulmohet dhe grabitet AP.	Njoftim
69.	03/08/2001	Z. i POPULLIT	Per 8 ore, 3 ne pranga nga 5 grabitesit e AP.	Njoftim
70.	06/08/2001	SHEKULLI	AP i Kosoves nje dite para takimit me AP në e Shqiperise, E.Dobjani.	Intervistë
71.	07/08/2001	SHEKULLI	Presidenti shqiptar pret AP e Kosoves dhe Dobjanin.	Njoftim
72.	09/08/2001	SHEKULLI	Institucioni i AP me afer hallexhinjve. Novicki dhe Dobjani do takohen ne Kosove.	Konferencë shtypi
73.	09.08.2001	ATSH	AP bën të njohura arritjet e 6-mujorit	Prononcim
74.	10/08/2001	G.SHQIPTARE	AP ne takim per gjaqet.	Njoftim
75.	10/08/2001	SHEKULLI	AP ne kullat e te ngujuarve “Shteti te marre masat”.	Njoftim
76.	11/08/2001	KOHA JONE	AP: "Te gjithë bashke ne nje revolucion anti gjak".	Prononcim
77.	11/08/2001	KOHA JONE	Shteti tjetër i Republikës së gjakut. AP ndërhy	Njoftim
78.	14/08/2001	REPUBLIKA	Te ngujuarit kerkojne ndihme nga AP.	Prononcim
79.	14/08/2001	G.SHQIPTARE	Zyre ne Shkoder per gjakmarrjen.AP premtion ndihme.	Prononcim
80.	15/08/2001	DITA	AP: “Ushtaraket kryejne punen, por nuk paguhen”.	Prononcim
81.	15/08/2001	DITA	AP mbron te drejtat e autorit.	Njoftim
82.	16/08/2001	G.SHQIPTARE	Nje Gjeneral Brigade lufton per te marre rrogen.	Prononcim
83.	16/08/2001	REPUBLIKA	Nje Gjeneral i drejtohet AP-së.	Prononcim
84.	16/08/2001	DITA	AP zgjidh problemin e gjeneralit.	Prononcim
85.	16/08/2001	G.SHQIPTARE	Komiteti i pajtimit te gjaqeve: “Mbeshtesim ligjin dhe AP-në”.	Njoftim
86.	16/08/2001	“55”	Nje General i harruar ne dispozicion i kerkon AP te shperblehet per pese vjet pune.	Prononcim

Nr.	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
87.	17/08/2001	KOHA JONE	AP: "Hetimi i trete i policise maqedonase".	Njoftim
88.	19/08/2001	KOHA JONE	Nje femije, peng i Gjykates .AP ofron amicus curiae.	Njoftim
89.	22/08/2001	ALBANIA	Ombudsmani shenon vitin e pare pozitiv.	Intervistë
90.	23/08/2001	DAILY NEWS	Ombudsmani shpall rezultatet e 6-mujorit.	K. Shtypi
91.	23/08/2001	REPUBLIKA	Dobjani nis komisioneret ne pikat kufitare shqiptare per te verifikuar rastet e dhunes.Urdher ne kufi."Merrni denoncime".	Artikull
92.	28/08/2001	KOHA JONE	Avokati i Popullit te Maqedonise i shkruan Dobjanit: "Hetuam per incidentin e shqiptareve".	Prononcim
93.	28/08/2001	KOHA JONE	Milo takon Dobjanin: "Dhuna ndaj shqiptareve ne Konferencen kundër racizmit".	Prononcim
94.	28/08/2001	REPUBLIKA	AP merr persiper ta ndihmoje me ane te Sherbimit Ligjor Falas. I burgosuri futet ne greve urie: "Nuk kam para te paguaj avokat".	Prononcim
95.	28/08/2001	REPUBLIKA	Avokati i Popullit njihet me akuzen dhe ligjet. Dy shqiptare burgosen ne Slloveni. Del nga burgu shqiptari nga Fieri. Sarandioti punesohet ne burg.	Artikull
96.	30/08/2001	KOHA JONE	Gjaksit e falur, ne dore te Presidentit. Vetem kreu i shtetit mund te fale ligjerisht ata qe kane bere vrasje per kanun.	Artikull
97.	30/08/2001	KOHA JONE	Ku e çon "avioni" Milon. AP informon Milon.	Artikull
98.	18/09/2001	DITA	Avokati i Popullit: Dhjetra ankesa nga oficeret. U jepet deri tani vetem njeqind leke per nate.	Artikull
99.	18/09/2001	GAZETA SHQIPTARE	Hije skandali ne Ministrine e Mbrojtjes. 40 oficere ngrene padi tek Avokati i Popullit. Vetem 80 leke per 24 ore sherbim. Gjeneralet reagojne. "Pagesat jane te padrejta".	Artikull
100.	18/09/2001	GAZETA SHQIPTARE	Avokati i Popullit -leter Majkos: "Rregulloni pagat per oficeret" Fillojne telashet per Ministrin e Mbrojtjes.	Artikull
101.	22/09/2001	GAZETA SHQIPTARE	Avokati i Popullit edhe ne qytetin jugor. Ermir Dobjani zhvillon takime në Gjirokastër.	Artikull

Nr.	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
102.	22/09/2001	SHEKULLI	Dobjani ne Lazarat; Kam marre 20 ankesa, mos i diskriminoni. Pritet të hapet zyra rajonale e Avokatit te Popullit ne qytetin e Gjirokastrës.	Artikull
103.	25/09/2001	BALLKAN	Avokati i Popullit. "Disa ligje shkelin te drejtat e njeriut".	Prononcim
104.	25/09/2001	BALLKAN	Avokati i Popullit: Ankesat me te medha jane per gjyqesorin, policine, dhe pronat.	Prononcim
105.	25/09/2001	REPUBLIKA	Dobjani: Ndaloni vjedhjen e pronave ne Ujin e Ftohte! Pronaret e ligjshem i bejne apel Avokatit te Popullit.	Artikull
106.	27/09/2001	KOHA JONE	Skandal me vdekjen e te burgosurit. Avokati i Popullit kerkon nisjen e hetimeve per te zbuluar shkaqet e vdekjes se Fatmir Hysit.	Prononcim
107.	30/09/2001	SHEKULLI	Hadergjonaj i drejtohet AP-së per pergjuesin. "Te ndeshkohen personat qe më vune pergjues ne shtepi".	Artikull
108.	03/10/2001	USHTRIA	Shqyrtohen ankesat e 50 ushtarakeve per pagesën e shërbimit 24 orësh.	Artikull
109.	03/10/2001	USHTRIA	Avokati i Popullit në mbrojtje të interesave të "shtetasve me uniformë".	Artikull
110.	13/10/2001	REPUBLIKA	Lazarati i ankohet Avokatit te Popullit per policine. Forcat e rendit nuk na lene te dalim nga shtepite	Artikull
111.	14/10/2001	DITA	AP: "Policia ushtron dhune ndaj qytetareve".	Artikull
112.	16/10/2001	KOHA JONE	Avokati i Popullit kërkon rishikimin e çështjes së policit që rrahu femijën jetim.	Artikull
113.	16/10/2001	G.SHQIPTARE	Jetimi rrefen torturat ne Komisiariatin e Sarandes.	Artikull
114.	27/10/2001	REPUBLIKA	AP pergjigjet:"Nderhyni per pronat e pronareve legjitime".	Artikull
115.	31/10/2001	KOHA JONE	AP nderhyn: Familjaret e viktimes,pale ne proces.	Artikull
116.	31/10/2001	REPUBLIKA	AP nderhyn : A mund te falet shkelja e ligjit.	Artikull
117.	02/11/2001	KOHA JONE	Pas kerkeses se AP,Prokuroria Ushtarake nis hetimet ne burgun 302.	Artikull
118.	08/11/2001	GAZETA SHQIPTARE	AP: "Ja si u manipulua lista e te pastreheve". Ish kryetari i Keshillit te Rrethit çohet per ndjekje penale.	Artikull

Nr.	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
119.	15/11/2001	KOHA JONE	AP: Ky është çmimi i drejtësisë. Per te vertetuar gabimin e gjobes se policit, AP paguan 10-fish me shume per ekspertizen.	Artikull
120.	20/11/2001	REPUBLIKA	AP dërgon sugjerimet e tij në Komisionin e Ligjeve në Parlament. Dobjani kundër projektligjit të qeverisë.	Artikull
121.	20/11/2001	REPUBLIKA	Antenat e celularëve në zyrën e Dobjanit: "Filluan Hetimet".	Artikull
122.	12/12/2001	Z. i POPULLIT	Mbrojtja e te drejtes se jetes, themeli i nje shoqerie demokratike. A.P. organizon Konferencë kombëtare.	Artikull
123.	11.12.2001	MBROJTJA	"Per te drejtat e ushtarakeve te siguruara me ligj".	Artikull
124.	11.12.2001	KOHA JONE	AP per plagen e shoqerise shqiptare. Shekulli i ri, shtegetimi i gjakmarrjes.	Artikull
125.	12.12.2001	G.SHQIPTARE	AP: Plaga jone, vetegjyqesia.	Artikull
126.	12.12.2001	SHEKULLI	AP: Gjakmarrja, motivi i 40 perqind te vrasjeve qe kryhen ne vend.	Artikull

MEDIA ELEKTRONIKE

Nr.	ORGANI	DATA	RUBRIKA	PASQYRIMI	
1.	TNSH	09.01.2001	Cikli mbi A.P.	E. Dobjani	Emision
2.	Vizion +	12.01.2001	Interviste Speciale	E. Dobjani	Interviste
3.	TNSH	16.01.2000	Cikli mbi A.P.	Dy nd/komisionere	Emision
4.	TNSH	23.01.2001	Bisede me Seksionin e Administrates	Komisioneri + stafi	Emision
5.	TVSH+TNSH+TVA	29.01.2001	Seminari i USAID-it me teme "Lufta kunder korrupsionit".	E. Dobjani	Prononcim
6.	TNSH	30.01.2001	Bisede me Seksionin e Vecante.	Komisioneri +Stafi	Emision
7.	TNSH	06.02.2001	Bisede me Seksionin e Pergjithshem.	Komisioneri +Stafi	Emision
8.	TV. Koha	07.02.2001	Interviste per dhunen ne polici	E. Dobjani	Interviste
9.	TNSH	08.02.2001	Ceshtja e fereksesë	E. Dobjani	Interviste
10.	Rad. «Europa e Lire»	08.02.2001	Probleme të fesë në Shqipëri	E. Dobjani	Intervistë
11.	TV. Teuta	09.02.2001	Bisede ne studio.	E. Dobjani	Emision
12.	TNSH	13.02.2001	Bisede ne Studio.	Pese Nd/komisionere	Emision
13.	Zëri i Amerikës	17.02.2001	AP mbi Raportin e Departamentit të Shtetit	E Dobjani.....	Intervistë
14.	BBC	05.03.2001	AP dhe ndërhyrjet e tij	E.Dobjani	Intervistë
15.	Tele Norba	13.03.2001	Ankesa e Albërie Hadërgjonaj	E. Dobjani	Intervistë
16.	TVSH-TNSH-TVA-KLAN-VIZION-TV2000	20.03.2001	Përrurimi zyrtar i Selisë së A.P.	Njoftim i AP	
17.	TVA	22.03.2001	500 Çështje nga janari 2001 deri tani	E.Dobjani	Prononcim
18.	TVSH	29.03.2001	Kryetari i Parlamentit S.Gjinushi viziton A.P.		Njoftim

Nr.	ORGANI	DATA	RUBRIKA	PASQYRIMI	
19.	TVA	19.04.2001	Problematika dhe metoda e punës. Bashkia nuk ka reagu për 500 familjet e skemave piramidale	E.Dobjani	Prononcim
20.	Radio Tirana	20.04.2001	AP për Emigrantët	E. Dobjani	Intervistë
21.	BBC	01.05.2001	Gjykata Kushtetuese aprovon AP për privatizimet e 470 ndërmarrjeve.	E. Dobjani	Intervistë
22.	TOP Albania Radio	02.05.2001	Efektet e V.Gj.Kushtetuese për Qeverinë.	E. Dobjani	Interviste
23.	Teuta TV	04.05.2001	Reagime mbi Vendimet e Gj. K.	E.Dobjani	Intervistë
24.	TVSH-TVA-TNSH-KLAN	07.05.2001	AP në Konferencën e Dhomës së Tregëtisë.		Prononcim
25.	VIZION +	09.05.2001	Me rastin e Ditës së Drejtësisë.	J.Dhrami (Komisioner)	Emision
26.	VIZION +	04.06.2001	Mbi problemin e Gjakmarrjes (A.Çani).	F.Nuni (Komisionere) Ajzberg	Emision.
27.	TV.KOHA	28.06.2001	AP për zgjedhjet.	E.Dobjani	Intervistë
28.	TV.KOHA	14.06.2001	AP për zgjedhjet parlamentare.	E.Dobjani	Intervistë
29.	TOP ALBANIA RADIO	02.07.2001	Ankesa për zgjedhjet parlamentare.	J.Dhrami	Intervistë
30.	TVSH-TVA-TNSH-KLAN-ALBA TV-TV-2000	20.07.2001	Analiza e punës 6-mujore.	E.Dobjani	Konferencë shtypi
31.	TNSH	02.08.2001	Incident me Avokatin e Popullit.	E.Dobjani	Prononcim
32.	TVSH-TNSH-TVA-KLAN-RADIO 2	06.08.2001	AP pret Ombudsmanin e Kosovës.		Njoftim
33.	TVSH-TNSH-TVA-KLAN-RADIO 2	08.08.2001	AP dhe Ombudsmani i Kosovës në konferencë shtypi.		Konferencë shtypi

Nr.	ORGANI	DATA	RUBRIKA	PASQYRIMI	
34.	DOJÇE VELE	08.08.2001	AP për zgjedhjet Qershor 2001.	E.Dobjani	Intervistë
35.	TVSH-TNSH-TVA-KLAN-TV KOHA	10.08.2001	AP viziton të ngjuarit për gjakmarrje.		Njoftim
36.	VIZION +	14.08.2001	Strategjia e AP për gjakmarrjen.	Zëdhënësi	Prononcim
37.	TVA	15.08.2001	AP dhe plaga e gjakmarrjes.		Emision
38.	SHIJAK TV	15.08.2001	AP takon misionin e pajtimit të gjaqeve.		Njoftim
39.	TVSH	11.09.2001	AP në Konferencën për trafikimin e qënieve njerëzore Fier		Njoftim
40.	TV Gjirokastrë	19.09.2001	AP në Gjirokastrë dhe Lazarat	E.Dobjani, S.Knudsen	Emision
41.	Radio Tirana	05.10.2001	AP i ftuar në Studio	E. Dobjani	Intervistë
42.	TVSH-TNSH-KLAN etj	27.11.2001	Ombudsmeni grek siguron Dobjanin për bashkëpunim dhe mbrojtje të të drejtave të emigrantëve.	E. Dobjani	Njoftim
43.	TVSH-TNSH-KLAN-TVA etj	27.11.2001	Presidenti Mejdani pret mikun e Dobjanit.	E.Dobjani	Njoftim
44.	TVSH-KLAN-TVA-TNSH-TOP CHANEL	11.12.2001	Avokati i Popullit «Konferencë për të drejtën e jetës».	E.Dobjani	Njoftim
45.	TVSH	15.12.2001	«Gjakmarrje, Jo.»	E.Dobjani, R.Gjoka	Emision i posaçëm

STATISTIKE PERMBLEDHESE E MBULIMIT MEDIATIK 2001

MEDIA E SHKRUAR

a)

Artikuj	Prononcime	Njoftime	Intervista	Konference shtypi	Gjithsej
36	32	43	13	2	126

MEDIA ELEKTRONIKE

b)

Njoftime	Prononcime	Intervista	Emisione	Konferenca shtypi	Gjithsej
9	6	16	12	2	45

Shenim

Problematika e nderhyrjeve te Avokatit te Popullit duket edhe nga titujt qe eshte gjykuar te paraqiten ne Statistike. Sidoqofte veprimtaria e Avokatit te Popullit eshte edhe me shumeperفشirese, pasi ka mjaft ceshtje te zgjidhura qe Avokati i Popullit e ka gjykuar te mos u jape publicitet. Per kete shihni statistikat sipas seksioneve.

1. Vlerësime të Institucioneve dhe Personaliteteve Ndërkombëtare për punën e Avokatit të Popullit

1. Në mesazhin e tij të datës 28.06.2001 drejtuar Avokatit të Popullit, Ministri i Punëve të Jashtme i Mbretërisë së Danimarkës, zoti **Mogens Lyketoft** ndër të tjera thotë:

“Po përfitoj nga ky rast t’ju përgëzoj për ngritjen e Institucionit të Ombudsmanit Shqiptar dhe për rezultatet shumë të mira që keni arritur deri tani. Hapja e Institucionit në Mars shënoi finalizimin e ngritjes së tij; tani duhet të forcohet dhe konsolidohet. Shpresoj që bashkëpunimi i frutshëm dhe inkurajues midis Institucioneve të Ombudsmanit Shqiptar dhe Danez mund të shënojë hapa të mëdha në këtë drejtim.

Jam i kënaqur që Qeveria Shqiptare ka përqaftuar këtë Institucion dhe unë sinqerisht shpresoj që do të jetë në gjendje të nxisë dhe inkurajojë mirëqeverisjen në të gjitha nivelet e administratës.

Më lejoni të përfundoj duke ju uruar fat në përpjekjet tuaja për ta bërë Institucionin një instrument për mbrojtjen e të drejtave të gjithë Shqiptarëve”.

2. Në konkluzionet e Konferencës së 4-t “**Mbi Reformën Gjyqësore në Shqipëri**”, zhvilluar nga Këshilli i Evropës në Strasburg nga 28 deri 29 Janar 2002, shkruhet se: “Pjesëmarrësit vunë në dukje me kënaqësi se Avokati i Popullit ka zhvilluar një bashkëpunim konstruktiv me autoritetet shtetërore. Më tej ata mirëpritën mënyrën konstruktive, përmes së cilës Avokati i Popullit ka ngritur çështje të rëndësishme, duke kërkuar të vërë në veprim shtetin”.

3. Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, zoti **Geert Ahrens**, po në këtë Konferencë, ndër të tjera theksoi se: “Bashkëpunimi i suksesshëm ndërkombëtar, i pasqyruar në krijimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të institucionit të Avokatit të Popullit, veçanërisht gjatë vitit të kaluar, tregon se mund të bëhet ndryshim i vërtetë në Shqipëri dhe se institucionet demokratike mund të ndërtohen nga fillimi”.

4. Zoti **Aleck.H.Trawick**, ish Ombudsman në Alberta, Kanada i dërguar tek ne nga **Shoqata e Juristëve Amerikanë ABA Ceeli** në raportin lidhur me vlerësimin e Zyrës së Avokatit të Popullit, ndër të tjera ka nxjerrë përfundimin: “Më ka bërë përshtypje cilësia e përgatitjes së personelit dhe përmbushja e detyrave nga Zyra e Avokatit të Popullit, duke u nisur edhe nga ajo që pasqyrohet në raportin vjetor. Nga përvoja ime e

gjatë, mund të them se arritja e këtij niveli progresi në një institucion të ri (dhe të panjohur më parë) është e paprecedente. Takimet që pata me Z. Dobjani dhe stafin e tij më krijuan bindjen e plotë që ata janë të aftë dhe të përkushtuar në punë. Duke i ofruar ndihmë dhe përvojë të mëtejshme unë kam besim se Avokati i Popullit do të ecë përpara, duke u shndërruar në një shtyllë të rëndësishme për ngritjen e institucioneve demokratike në Republikën e Shqipërisë”.

5. Zonja **Marianne Von der Esch** - Eksperte e Zyrës së Ombudsmanit Suedez, e dërguar nga Këshilli i Evropës, në raportin e saj, pas vizitës në Tiranë, më 2-15 dhjetor 2001 ndër të tjera shkruan se:

“Shpreh kënaqësinë dhe admirimin më të madh, tek pohoj se në ç’masë Avokati i Popullit i ka realizuar detyrat e shtruara para tij. Të arrihet një shkallë e tillë progresi në më pak se dy vjet, pas krijimit të institucionit, është tepër mbresëlënëse. Zoti Dobjani dhe stafi i tij kanë bërë një punë të shkëlqyer për krijimin e një institucioni të respektuar, të besueshëm dhe efikas në procesin demokratik, që po kalon Shqipëria, një vend ende në tranzicion. Unë u uroj atyre fat në të ardhmen”.

6. Zoti Jens Olsen, kryeekspert në Zyrën e Ombudsmanit të Danimarkës na ka shkruar më 7 gusht 2001, ndër të tjera se: “... më lejoni të përgëzoj çdo njërin në Zyrën e Avokatit të Popullit për Raportin tuaj të vitit 2000. Mendoj se është pak e habitshme se si mundet që ju të ndërtonit një raport kaq të mirë për një kohë aq të shkurtër”.

2. Letra falenderimi nga qytetarët

**Falenderim Z. Ermir Dobjani.
AVOKAT I POPULLIT**

Këto ditë mora letrën tuaj, në kthim përgjigje të një ankesë drejtuar Juve më pare, për një çështje ligjore, për të cilën kisha 6-vjet që kërkoja një sqarim nga ato institucione që e kanë patur për detyrë si Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë.

Jeni i vetmi institucion që na ktheni përgjigjen e duhur, duke ju falenderuar sinqerisht. Kjo për mua është një fakt që ju personalisht dhe stafi që punon me Ju e ndiejnë përgjegjësinë e detyrës që kanë për zgjidhjen e halleve që ka populli, dhe jo si burrokratët që përmenda pak më lartë. Duke përfituar nga rasti, në këtë letër falenderojmë edhe Z.S. Koçollari që na priti me bujari dhe më sqaroi për së mbari.

Duke përfunduar ju uroj shëndet dhe gjithë të mirat Juve personalisht edhe stafit tuaj. Më falni për kohën që po ju marr me leximin e kësaj letre.

Me respekt dhe konsideratë të lartë

**Anesti Dhimitri
Firma**

Korçë 15.02.2002

**Drejtuar. Zyrës së AVOKATIT TE POPULLIT
Z. Ermir DOBJANI**

Unë e nënshkruara Dhora Isak, kam kënaqësinë t'ju njoftoj se:

Mbas kërkesës së bërë nga ana ime, pranë Zyrës tuaj, në lidhje me problemin tim të marrjes së pensionit të invaliditetit, më datë. 21 Janar 2002, këtij problemi ju dha zgjidhja përfudimtare. Në këtë datë tërhoqa pranë degës së Bankës së Kursimeve sasinë e parave të llogaritura për

përiudhën e prapambetur Dhjetor 1994-Janar 2002, e cila arrinte vlerën 714.000 (*shtatëqind e katërmbëdhjetë mijë lekë të reja*).

Me këtë rast dua t'ju falenderoj për përkushtimin dhe korrektësinë tuaj në trajtimin dhe ndjekjen e këtij problemi. Gjithashtu falenderoj veçanërisht dhe të ngarkuarin tuaj Z. A. Jaupi.

Ju uroj punë të mbarë në detyrën tuaj fisnike.

Me respekt

**Dhora Isak.
Firma**

Tiranë, më. 23.01.2002
Rruga e Durrësit P.144, shk.2, ap.11
Tel 223 303
Tiranë

AVOKATIT të POPULLIT

Tiranë

Ne përfaqësuesit e fisit Çomo në letrën drejtuar Instiucionit Tuaj në gusht të vitit 2000 kërkonim ndihmë nga ana juaj për të verifikuar privatizimin e Fabrikës së ujit mineral "GLINA" për arsye se në vendimin e Komisionit të Tokës Bujqësore nr.2, datë 04.05.1996, na është njohur e drejta e parablerjes së fabrikës së ujit të Glinës sipas legjislacionit në fuqi. Mirëpo në datën 26.03.1999, pa njoftuar fisin tonë dhe pa ankand, ju dha ortakut jo shtetëror "ALFA" sh.a në një vlerë qesharake.

I jemi drejtuar disa herë Ministrisë së Privatizimit dhe AKP-së si edhe institucioneve të tjera, por asnjë përgjigje nuk kemi marrë. Ndërsa AKP-ja në dy përgjigjet e para të saj thotë se privatizimi do të bëhet në mbështetje të V.K.M.-së nr.230, datë 04.04.1998 dhe V.K.M.-së nr.21, datë 21.01.1999, ndërsa kur ne kemi kërkuar njohjen me dosjen e privatizimit na është përgjigjur se nuk mund të na i vinte në dispozicion ato. Interesimi jonë ka filluar që nga dita që ajo u privatizua.

Ishte institucioni juaj i cili na dha aktin e shitjes me anë të së cilit u bë e mundur bërja e Kërkesë-Padisë bashkangjitur me dokumentacionin tonë të pronësisë.

Ishte përsëri këmbëngulja e Institucionit tuaj sipas kërkesës tonë datë, 27.12.2001, që bëri të mundur që AKP në datën 14.01.2002 mbasi na sorrollati 6-muaj, të marrim dosjen konform rregullave. Ju falenderojmë për ndihmën Tuaj të madhe që na dhatë dhe tani ne jemi në gjendje të mbrojmë përpara Gjykatës të drejtat tona që na janë mohuar duke na grabitur pronën tonë në mënyrë të paligjshme.

Meqënëse institucioni juaj është njohur me dosjen dhe ka bërë edhe verifikime, lutemi na ndihmoni me mendimin tuaj të specializuar i cili do na shërbente shumë.

Dhe një herë ju falenderojmë Juve për ndihmën që na keni dhënë si edhe punjonjësit tuaj Z. A.Jaupi dhe Znj. B.Gjikondi të cilët ishin shumë të përkushtuar duke na e zgjidhur çështjen përfundimisht.

Me nderime dhe respekt

Agim Jaho Trim Çomo
Firmat

Tiranë më 15.01.2002

Falenderim

Unë Myzejen Bërxolli ju falenderoj për zgjidhjen e problemit tim me pensionin që ka filluar të rregullohet si e kam pasur.


Pra edhe një herë falenderoj Avokatin e Popullit Ermir Dobjani për nderin që më bëri.

Me nderime


Myzejen Bërxolli
Firma

Dt. 18.09.2001

Mënyra e zgjidhjes së ankesave të përfunduara gjatë vitit 2001, pavarësisht nëse kanë qenë brenda ose jashtë juridiksionit
Totali 1759




Ankesat e trajtuara gjate vitit 2001
Totali 2194



- Numri i ankesave të ardhura gjithsej gjatë vitit 2001
- Numri i ankesave të mbartura nga viti 2000


**Mënyra e zgjidhjes së ankesave që kanë qenë brenda
juridiksionit gjatë vitit 2001
Totali 1049**



■ Ankesa të padrejta


■ Ankesa në favor

Gjendja e ankesave në fund të vitit 2001
Totali 2194




- Ankesa të përfunduara gjatë vitit 2001
- Ankesa që vazhdojnë të jenë në shqyrtim gjatë vitit 2002

**Ankesa dhe kërkesa të paraqitura verbalisht pranë
zyrës së pritjes së popullit
Totali 1125**



- Ankesa verbale të regjistruara në sekretari për shqyrtim, pasi u bënë me shkrim
- Ankesa dhe kërkesa verbale, të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë, në zbatim të nenit 17/a dhe 17/b të ligjit.


**Struktura e ankesave që kanë marrë përgjigje të menjëhershme
nga zyra e pritjes së popullit
Totali 619**




Ankesat dhe kërkesat e paraqitura pranë zyrës së pritjes së popullit, të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë, sipas nenit 17/a dhe 17/b të ligjit nr. 8454, datë 04/02/1999

"Për Avokatin e Popullit"

Totali 839




Ankesa, kërkesa dhe njoftime të trajtuara nga zyra e AP gjatë vitit 2001
Totali 2826




A: Ankesa të trajtuara gjatë vitit 2001 (1985 të vitit 2001 dhe 209 të mbartura nga viti 2000)

B: Ankesa të paraqitura në zyrën e pritjes së popullit, gjatë vitit 2001, të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë

**Krahasimi i ankesave të ardhura për vitet 2000 dhe 2001,
të pranuar për shqyrtim
Totali 2795**




Shpërndarja e ankesave sipas degëve të qeverisjes




MEDIA E SHKRUAR PER VITIN 2001


Gjithsej 126



MEDIA E SHKRUAR PER VITIN 2001



MEDIA ELEKTRONIKE PER VITIN 2001



MEDIA ELEKTRONIKE PER VITIN 2001

